REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

N/KRYETARI I K.K.T-së

Z. DAMIAN GJIKNURI

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Znj. VOJSAVA SHKURTAJ

Kryetari i Bashkisë

Z. DRITAN LELI

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË VLORË

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

STUDIO KONSULENTE "DEA STUDIO" Nr.Liç. 4919/4 dhe "THYMIO PAPAYANNIS & ASSOCIATES INC"

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE 7
1.1 Qëllimi i raportit 7
1.2 Autoritetet përgjegjëse 9
1.3 Ekipi konsulent 9
1.4 Përshkrim i përgjithshëm i përmbajtjes së Planit së Bashkisë Vlorë 9
1.5 Metodologjia dhe përmbajtja e Raportit Mjedisor të VSM 11

2. ANALIZA E KUSHTEVE TË SOTME KRYESORE MJEDISORE 14
2.1 Sistemi urban 14
2.1.1 Demografia dhe shperndarja hapësinore e popullsisë 14
2.1.2 Ekonomia dhe punësimi 17
2.1.3 Perdorimi i Tokes dhe modelet e zhvillimit 20
2.1.4 Ndotja akustike 23
2.1.5 Trashegimia kulturore 26
2.2 Sistemi ujor 39
2.2.1 Trupat ujor dhe deti 39
2.3 Sistemi natyror 47
2.3.1 Biodiversiteti , Fauna & Flora, Pyjet dhe Natyra 47
2.3.2 Pyjet dhe natyra 53
2.3.3 Klima dhe cilesia e ajrit 63
2.4 Sistemi bujqesor 70
2.4.1 Boniteti i tokes 70
2.4.2 Ekonomia bujqesore 73
2.5 Sistemi infrastrukturor 73
2.5.1 Menaxhimi i mbetjeve dhe infrastruktura mjedisore 73
2.5.2 Aksesi dhe rrejti i transportit 75
2.5.3 Energjia dhe telekomunikacioni 88

3. OBJEKTIVAT E VSM 90
3.1 Objektivat ndërkombëtare dhe të BE për zhvillimin e qëndrueshëm 90
3.1.1 Politikat ndërkombëtare 90
3.1.2 Politikat në nivel Europian 91
3.2 Objektivat kombëtare të zhvillimit te qendrueshem ne nivel kombetar 100
3.2.1 Objektivat kombëtare të mjedisit 100
3.2.2 Objektivat kombetare të planifikimit të territorit 114
3.2.3 Plani i Pergjithshem Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara 116
3.3 Përmbledhje e objektivave 118
3.4 Bashkëngjitja e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare 121

4. SKENARËT ALTERNATIVË 127
4.1 Hyrje - Metodologjia 127
Skenari A: Skenari zero 128
Skenari B: Intensifikimi i zhvillimit urban 128
Skenari C: Mbrojtja e mjedisit 129

4.2 Vleresimi i skenarëve 130
4.2.1 Skenari A: Skenari Zero 130
4.2.2 Skenari B: Intensifikimi i zhvillimit urban 133
4.2.3 Skenari C: Turizëm i interesit te veçantë 136

5. VLERESIM I EFEKTEVE TE PRITSHME MJEDISORE TE PLANIT TE PROPOZUAR DHE MASAT PER PARANDALIMIN / ZBUTJEN E TYRE 141
5.1 Metoda e realizimit te vleresimit 141
5.2 Zberthimi i planit te Bashkise Vlorë 140
Orientimi Strategjik 1 140
1.1 Perforcimi i identitetit dhe shkëlqimit te Vlorës 140
1.2 Terheqja e investimeve me cilësi te larte në rivieren e Vlores 141
1.3 Promovimi i vlerave turistike ne territoret rurale dhe malore 141
Orientimi Strategjik 2 143
2.1 Promovimi i konsolidimit hapësinor 143
2.2 Mbeshtetje për përmiresimin dhe rritjen e vlerës së shtuar për ekonomi bujqësore 143
Orientimi Strategjik 3 144
3.1 Organizimi i aktiviteteve ekonomike 144
Orientimi Strategjik 4 145
4.1 Ulja e periferialitetit të zonave rurale dhe malore 145
4.2 Reduktimi i periferialitetit brenda zonave urbane 146
Orientimi Strategjik 5 147
5.1 Përmiresimi i lidhjeve nëpërmjet rrugëve ndër-rajonale 147
5.2 Përmiresimi i lidhjeve lokale 147
5.3 Zhvillimi i transportit detar 149
Orientimi Strategjik 6 150
6.1 Menaxhimi i mbetjeve 150
6.2 Furnizimi me uje 150
6.3 Trajtimi i ujerave të zeza 151
6.4 Perdorimi i energjise dhe burimeve te reja 151
6.5 Rihabilitimi i tokës / rimarrja 152
6.5 Vleresimi i detajuar i efekteve 152

6. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM i SISTEMIT TË PLAN - MONITORIMIT **184**
6.1 Vlerësim i përgjithshëm 184
6.2 Sistemi i monitorimit 185
6.2.1 Normat për parametrat e ujit të pijshëm 186
6.2.2 Monitorimi i ujit të detit 187
6.2.3 Cilësia e ajrit dhe standardet 188
6.2.4 Ndotja akustike 190
6.2.5 Synimet për mbetjet 190
6.2.6 Ujërat e ndotura 192
6.2.7 Monitorimi i pyjeve, hapësirave të gjelbra dhe të mbrojtura 192
6.2.8 Guroret dhe industria e vajit 193
6.3 Objektivat, indikatoret & synimet per VSM-ne e Vlorës 194

7. STUDIMET REFERUESE KRYESORE 206

8. VËSHTIRËSITË E HASURA 205

9. PERMBLEDHJA JOTEKNIKE 209
9.1 Hyrje 209
9.2 Konteksti i Planit Vendor të Përgjithshëm të Territorit 209
9.3 Sfidat kryesore mjedisore te zonës së studimit 210
9.4 Objektivat e VSM-së 210
9.5 Skenarët alternative 211
9.6 Vlerësimi i Planit Vendor 211
9.7 Masat zbutëse mjedisore 211
9.8 Monitorimi 211
9.9 Konkluzioni i raportit 211
Prezantime me publikun 211
Degjesa me publikun nr.2 213

10. BIBLIOGRAFIA 214

TABELA E FIGURAVE

Figura 1: Metodologjia për hartimin e raportit të VSM-së në lidhje me specifikat e Planit Lokal të Vlorës dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar të VSM-së 13
Figura 2: Analiza Makro e Zonimit të Bashkisë Vlorë 20
Figura 3: Aulona, 1573 27
Figura 4: Katrumi Romak, Muret rrethuese te Aulones 28
Figura 5: Treport 29
Figura 6: Shtrirja e habitateve të ndryshme në zonën Peisazh i mbrojtur Karaburun - Llogara 31
Figura 7: Pamje nga Sahati 34
Figura 8: Monumenti i Pavaresise 35
Figura 9: Kisha e Manastirit te Zvernecit 38
Figura 10: Pamje nga Tragjasi i vjetër 39
Figura 11: Ishujt në Lagunën e Nartës 43
Figura 12: Kanalet komunikuese midis detit dhe lagunes së Nartës 44
Figura 13: Llojet e bimësisë në Vlorë 52
Figura 14: Dunat ranore në Zvernec 57
Figura 15: Shtrirja e habitateve të ndryshme në zonen Peisazh i mbrojtur Karaburun - Llogara 59
Figura 16: Harta me zonat dhe nënzonat klimatike Shqipërisë 60
Figura 17: Temperatura mesatare në Vlorë 61
Figura 18: Rreshjet mesatare në Vlorë 61
Figura 19: Harta e shpërndarjes vjetore të rreshjeve dhe rajonizimi i rreshjeve ne Shqiperi 62
Figura 20: Trendafili i drejtimit te eres në Bashkinë Vlorë 63
Figura 21: Shperndarja territoriale e sasise vjetore te oreve me erë 63

Figura 22: Projektimi ne perqindje i ndryshimit te indeksit te deficitit ujor per 2030 65
Figura 23: Mbetjet në fshatin Kerkove 70
Figura 24: Vendodhja e aeroportit te Vlores 72
Figura 25: Projekti By Pass, Vlora 74
Figura 26: Hierarkia e rrugeve Vlorë 76
Figura 27: Harta ekzistuese e infrastruktures rrugore të Njësisë Qender 78
Figura 28: Harta ekzistuese e infrastruktures rrugore te Njësisë Novosele 81
Figura 29: Harta ekzistuese e infrastruktures rrugore te Njësisë Orikum 83
Figura 30: TEC Vlorë 85
Figura 31: Prezantime me publikun 211
Figura 32: Degjesa me publikun nr.2 212
Figura 33: Njoftimi per degjesn publike te VSM-se date 09.03.2017 213

TABELAT

Tabela 1: Popollsia rezidente ne Bashkinë e re Vlorë 15
Tabela 2:Sruktura e popullsise ne Bashkinë Vlorë 15
Tabela 3: Dendesia e popullsise ne Bashkinë Vlorë 16
Tabela 4: Ndermarrjet aktive sipas Bashkisë Vlorë 17
Tabela 6: Ndermarrjet aktive sipas Bashkisë Vlorë 18
Tabela 7: Ndermarrjet aktive sipas Bashkisë Vlorë 18
Tabela 8: Punesimi sipas sektoreve 19
Tabela 9: Monitorimi i zhurmave të Qytetit të Vlorës 23
Tabela 10: Temperaturat ne Bashkine Vlore 60
Tabela 11: Vlerat e lagështise dhe rrezatimit diellor në Vlorë 61
Tabela 12: Tabela krahasuese 2914-2715 per PM 65
Tabela 13: Monitorimi i ajrit 2014-2015 66
Tabela 15: Përmbledhja e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar 87
Tabela 16: Përmbledhje e objektivave të zhvillimit të qëndrueshem të vendosura në nivel Evropian 95
Tabela 17: Masat përparësore për mbrojtjen e biodiversitetit 97
Tabela 18: Objektivat paraprake te strategjise se burimeve ujore 99
Tabela 19: Objektivat për mbrojtjen e tokës 101
Tabela 20: Cilesia e ajrit 104
Tabela 21: Nivelet normale kombëtare të elementeve të cilësisë së ajrit 104
Tabela 22: Ndryshimi i klimes 107
Tabela 23: Objektivat kombetare ne menaxhimin e mbeturinave 108
Tabela 24: Objektivat per ndotjen akustike 110
Tabela 25: Planifikimi i territorit 111
Tabela 26: Permbledhja e objektivave te Planit te Integruar Ndersektorial 114
Tabela 27: Tabela koordinuese e 5 Sistemeve dhe e objektivave te SEA 118
Tabela 28: Vleresimi i skenarit A 126
Tabela 29: Skenari B 129
Tabela 30: Skenari C 133

TABELAT E VLERËSIMIT

Tabela 31: Vlerësimi i VSM-së i Komponenteve 139
Tabela 32: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 1 154
Tabela 33: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 1 156
Tabela 34: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 1 159
Tabela 35: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 2 161
Tabela 36: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 2 163
Tabela 37: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 2 165
Tabela 38: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 4 169
Tabela 39: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 4 171
Tabela 40: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 5 172
Tabela 41: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 5 174
Tabela 42: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 5 176
Tabela 43: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 6 178
Tabela 44: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 6 180
Tabela 45: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 6 181
Tabela 46: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 6 183
Tabela 47: Vlerësimi i VMS-së Orientimi strategjik 6 184
Tabela 48: Treguesit fiziko-kimike te ujit te pijshem dhe objektivat 188
Tabela 49:Treguesit mikrobiologjike te ujit te pijshëm dhe objektivat 189
Tabela 50: Kerkesat cilësore të ujrave të plazheve në përputhje me BE 190
Tabela 51: Vlerat e kufi të ndotesve 190
Tabela 52: Niveli i kufi i ndotesve të ajrit 191
Tabela 53: Objektivat për reduktimin e mbetjeve 193
Tabela 54: Objektivat e reduktimit të ndotjes se ujit 194
Tabela 55: Monitorimi pyjeve dhe zonave të mbrojtura të gjelbra 195
Tabela 56: Monitorimi i guroreve dhe rehabilitimi 195
Tabela 57: Monitorimi i tokës bujqësore 196
Tabela 58: Indikatoret për vlerësimin e objektivave të VSM-së 197

HARTAT

Harta 1: Harta e shpërndarjes së monumenteve të kulturës në Vlorë 25
Harta 2: Harta e shpërndarjes së monumenteve të kulturës në Vlorë 36
Harta 3: Harta hidrografike e zonës 41
Harta 4: Harta hidrogjeologjike 47
Harta 5: Harta e burimeve natyrore 51
Harta 6: Hartae Zonave te Mbrojtura natyrore dhe kulturore 59
Harta 7: Harta e kategorive të tokave në zonën në studim dhe më gjere 67
Harta 8: Harta e bonitetit të tokës 68

SHPJEGUESIT E TERMAVE

AKPT (NATP)	Agjencia Kombëtare e Planifikimit te Territorit
BE	Bashkimi Evropian
BSAP	Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin
EIMS	Sistemit Të Menaxhimit Te Informacionit Mjedisor
GIS	Sistemi Gjeografik i Informacionit
GoA	Qeveria e Shqipërisë
KE	Këshilli i Evropës
KKE	Komisioni i Këshillit te Evropës
ME	Mjedisi Evropian
INSTAT	Instituti i Statistikës- Republika e Shqipërisë
MPËTT	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
NGO	Organizata Jo-Qeveritare
PKK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mjëvjeçarit
PMP	Plan ii Menaxhimit te Pyjeve
PVM	Plani Veprimit Mesdhetar
PMZIB (ICZMP)	Projekti i Menaxhimit te Zonës se Integruar te Bregdetit
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor (i Bashkisë Vlorë)
PZHBJ	Plani i zhvillimit te bregdetit jugor
SBZHQ	Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm
SMM	Statusi i Mjedisit te Mire
SNT	Studimi i Ndikimit te Trafikut
SNM (NES)	Strategjia Ndersektoriale e Mjedisit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SKZHT	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit
SËOT	Pikat e Forta, Pikat e Dobëta, Mundësitë dhe Rreziqet
ToR	Termat e Referencës
TPA	Thymio Papayannis & Associates (Athens, Greece)
USAID	Ndihma e Shteteve te Bashkuara
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësim Strategjik Mjedisor
WSSD	Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm
DEA	DEA Studio
PINS	Plani i Integruar Ndersektorial i Bregdetit
PKMM	Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve

1. HYRJE

1.1 Qëllimi i Raportit të Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM)

është metoda sistematike për të vlerësuar efektet potenciale të rëndësishme të planeve dhe programeve strategjike si edhe për zbutjen e presioneve ekzistuese në fushat ku këto plane janë të aplikueshme.

Hartimi i këtij raporti është që të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis në hapsirën e kësaj bashkie. VSM mund të konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për arritjen e vendimeve të drejta të planifikimit në lidhje me çështje të tilla si:

- Integrimin e vlerësimeve mjedisore në planifikimin strategjik/urban dhe vendimmarrjen e planifikimit të investimeve në zonën e studimit.
- Vlerësimin e alternativave të planifikimit të zhvillimit, orientimin e zhvillimit, përdorimit të tokës dhe zgjedhjeve për investime në infrastrukturë.
- Përmirësimin komponentëve të mbrojtjes mjedisore të planeve.
- Ndikimi i cilësisë dhe sasisë në pasuritë natyrore dhe kapacitetet e këtyre burimeve për të pranuar zbatimin e qëndrueshëm të planit.

Sipas kërkesave të Ligjit Nr.107/2014 për "Planifikimin dhe zhvillimin e territorit", miratimi i çdo plani të ri territorial në Shqipëri i nënshtrohet procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), sipas specifikimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 91/2013 për "Për Vlerësimim Strategjik Mjedisor".

Ligji Nr. 91/2013 është përafruar plotësisht me direktivën 2001/42/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Europian, datë 27 qershor 2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara", (*Numri CELEX: 32001L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 197, datë 21.7.2001, faqe 30 – 37*) e njohur ndryshe si "Direktiva VSM", e cila kërkon që planet dhe programet duhet t'i nënshtrohen një procesi vlerësimi mjedisor në nivel strategjik. Qëllimet e përgjithshme të këtij procesi janë për integrimin e vlerësimeve mjedisore në përgatitjen e planit dhe vendim-marrjeve, për të përmirësuar planet dhe për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit si dhe për të rritur pjesëmarrjen publike në vendim-marrjen mjedisore. Ky proces përfshin përgatitjen e Raportit Mjedisor.

Ky raport është **Raporti Mjedisor** i përgatitur për të vlerësuar efektet mjedisore dhe ato mbi shëndetin publik të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkise së Vlorë. Raporti Mjedisor është përgatitur duke marrë në konsideratë kërkesat e parashikuara

në nenin 10 të Ligjit 91/2013 dhe përmban të gjithë informacionin e specifikuar në këtë Ligj. Ky informacion përfshin:

a) përshkrimin e qëllimit dhe objektivave kryesore të planit ose programit dhe të përputhjes se tij me plane ose programe të tjera që lidhen me të, fazën e vendimmarrjes dhe sqarimet nëse disa çështje janë vlerësuar ose do të vlerësohen në nivele dhe procese të tjera planifikimi;

b) përshkrimin e metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të VSM-së, përfshirë vështirësitë e hasura gjatë përgatitjes së tij, dhe burimet e informacionit ekzistues, që përdoren për qëllim të hartimit të raportit;

c) përshkrimin e alternativave të konsideruara gjatë hartimit, rishikimit, ndryshimit apo modifikimit të planit ose programit të propozuar, përfshi edhe alternativën e mosplanifikimit (alternativa zero), si dhe arsyetimet përkatëse;

ç) objektivat për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në shkallë ndërkombëtare, nivel kombëtar, rajonal apo lokal, të cilat lidhen me planin ose programin dhe mënyra në të cilën këta objektiva janë marrë në konsideratë në propozim;

d) përshkrimin e përbërësve të mjedisit në zonën e shtrirjes të planit ose programit të propozuar;

dh) përshkrimin e cilësisë së elementeve të mjedisit në zonën ku propozohet plani apo programi, të cilat mund të ndikohen nga zbatimi i planit ose programit të propozuar;

e) ndërveprimet e mundshme me mjedisin të planit ose programit të propozuar, duke përfshirë në veçanti problemet që lidhen me zona të një rëndësie të veçantë mjedisore, si "Zonat e Mbrojtura";

ë) pasojat e mundshme negative në mjedis, duke përfshirë ndikimet në biodiversitet, në shëndetin e njerëzve, në tokë, në ujë, në ajër, faktorët klimaterikë, trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike, peizazhin apo dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;

f) pasojat e mundshme negative në mjedisin ndërkufitar, në rast të zbatimit të nenit 17 të këtij ligji;

g) masat e parashikuara për të shmangur apo zbutur sa më shumë të jetë e mundur pasojat e ndikimeve në mjedis, gjatë zbatimit të planit ose programit;

gj) identifikimin e investimeve apo të infrastrukturës mjedisore të nevojshme, në kuadër të planit apo programit të propozuar;

h) përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e pasojave në mjedis gjatë zbatimit të propozimit;

i) përmbledhjen në gjuhë joteknike të raportit paraprak të VSM-së.

Ky studim i VSM analizon një territori që shtrihet përgjatë bregdetit duke mbuluar një sipëfaqe prej 629 km^2 që përfshin një zonë bregdetare prej 172 km^2 me një gjatësi prej rreth 57 km dhe gjerësi që varion midis 4-16 km së cilës i korrespondon një popullsi aktuale prej afro 196,547 banorësh duke ju adresuar një periudhe prej minimumi 10 vitesh në përputhje me dokumentin e planifikimit të propozuar.

1.2 Autoritetet Përgjegjëse

Autoriteti propozues për raportin mjedisor të VSM-se të Planit te Vlorës është Bashkia e Vlorës. Raporti është përgatitur në kuadrin e studimit *"Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë"* i cili është përcaktuar të kryhet me firmat konsulente "DEA Studio" dhe *" Thymio Papayannis Inc "* Athinë, të mbështetur nga *"Kompania Nënkontraktore"* Tiranë. Dr. Athanasios Pagonis – Planifikues Urban, Eirini Tsakiropoulou – Planifikuese Urbane, Dimitris Poulios GIS ekspert, Thymio Dimoupoulos Urbanist per zonat e mbrojtura, Emil Xhuvani Ekspert i licensuar ne Mjedis, Mirlinda Rusi eksperte e licensuar ne Mjedis, Kostantinos Zekkos Ing transporti, Ivy Nanopoulou Arkitekte- Peisazhiste, Ervin Taçi Urbanist, Altin Kokaj Arkitekt, Genti Qiriazi Ing Gjeodet (GIS), Albert Gajo Ekonomist dhe Ela Tollkuçi Eksperte Sociale. Ky ekip përbën një garanci për një punë të kualifikuar ku një rendësi të madhe merr të kuptuarit e proceseve të zbatimit dhe monitorimit të VSM.

1.3 Ekipi Konsulent

Realizimi i këtij raporti mjedisor është realizuar nga konsulentë dhe specialistët që kanë përgatitur studimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, si dhe plane të tjera territoriale dhe studime të VSM në Greqi dhe në Shqipëri. Ekspertët, (lokal dhe të huaj) të kombinuar me përvoja ndërkombëtare dhe lokale, me reputacion të fortë në fushën e mjedisit, kanë përgatitur, ndër të tjera, studimin e "Vlerësimit Strategjik Mjedisor" të Planit Rregullues të Athinës dhe kanë zhvilluar komponent të projektit LAMP të Bankës Botërore ,Shqiperi. Ky ekip përbën një garanci për një punë të kualifikuar ku një rendësi të madhe merr të kuptuarit e proceseve të zbatimit dhe monitorimit të VSM.

1.4 Përshkrim i Përgjithshëm i Përmbajtjes së Planit

Ky projekt përfshin përgatitjen e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit të Bashkisë Vlorë (PPVTB) sipas ndarjes së re territoriale, sipas përcaktimeve të kuadrit të ri ligjor të planifikimit të territorit (të Ligjit Nr.107/2014 për "Planifikimin dhe zhvillimin e territorit") dhe në përputhje me Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe PINS Bregdeti. Ky i fundit siguron një kuadër gjithë-përfshirës për përgatitjen e planeve vendore. Koncepti kyç i Planit të Përgjithëshëm Vendor të Vlorës është promovimi i **zhvillimit urban** dhe **turizmit të qëndrueshëm** në zonë, i cili adreson nevojën për të mbrojtur burimet e vlefshme dhe për të promovuar menaxhimin e qëndrueshëm të

burimeve natyrore dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke minimizuar ndikimet negative në mjedis të zhvillimit lokal dhe të infrastrukturës.

Zona bregdetare Vlorë, e cila përbën pjesën më të madhe dhe më tërheqëse të Rivierës shqiptare, është një rast unik i njësisë territoriale me karakteristika të dallueshme, që aktualisht përballet me një dilemë të madhe në lidhje me zhvillimin e saj të ardhshëm. Pavarësisht se cilësia e rrugëve në vitet e fundit është përmirësuar ndjeshëm dhe shpejtësia mesatare e vozitjes është rritur, koha e mbërritjes në qendrën administrative është relativisht e gjatë (rreth 2 orë nga Tirana) megjithese distancat nuk janë të konsiderueshme. Zbatimi i pjesshëm planeve të mëparshme të zhvillimit bën që aktualisht të këtë një mungesë vizioni dhe rregullash konkrete për ndërtim dhe zhvillim të qëndrueshëm urban. Ndërkohë potenciali për zhvillimin e turizmit duket se ka kapacitete që mund të sjellin përmirësime rrënjësore të kapitalit vendas dhe të cilësisë së jetës së popullatës lokale.

Sipas metodologjisë teknike së propozuar, Konsulenti duhet të përgatisë produktet e mëposhtme të strukturuara sipas fazave nëplanin e aktiviteteve:

- Një vlerësim i plotë i gjendjes ekzistuese të bashkisë duke identifikuar tendencat ekzistuese, problemet kryesore dhe mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të turizmit që do të përdoret si bazë për hartimin e planit urbanistik.
- Hartimi i një vizioni të qartë në të ardhmen dhe strategjinë e zhvillimit duke u fokusuar në aspektin e turizmit që do të bazohet në të dhënat nga konsultimi me publikun duke vlerësuar skenarët alternativë.
- Përgatitja e Planit të Përdorimit të Tokës që do të përcaktoje kategoritë kryesore të përdorimit të tokës dhe rrjetin kryesor të infrastrukturës në të gjithë territorin bashkiak, bazuar në strategjinë e zhvillimit të përzgjedhur dhe duke ndjekur parashikimet reale ekonomike dhe demografike.
- Përgatitja në përputhje me planin e rregulloreve të kontrollit të zhvillimit (të tilla si, të zonimit, raporteve ne parcelat për ndërtim, limitet e lartësisë, sipërfaqes së tokës), të shoqëruara me hartat përkatëse të detajuara të zonimit për çdo zonë të banuar dhe ne zhvillim, në përputhje me specifikimet e legjislacioni kombëtar mbi planifikimin territorial.
- Përgatitja e një Dokumenti të Konsoliduar, i cili do të strukturohet si një version draft projekt për Planin Lokal të Territorit që do të paraqitet për komente ne publik në përputhje me kërkesat e ligjit të mëparshëm të miratuar si dokument zyrtar i planifikimit bashkiak.

Finalizimi i planit është zhvilluar dhe bazuar në procesin e konsultimit në publik, që ka ndodhur gjatë fazave të ndryshme të planit të punës.

1.5 Metodologjia, Baza ligjore dhe Përmbajtja e Raportit Mjedisor të VSM

Metodologjia për përgatitjen e këtij Raporti Mjedisor është zhvilluar pas një studimi të hollësishëm ligjit Nr.91/2013, ligjit Nr.111/2012, ligjit Nr.10 431/2011, ligjit Nr.107/2014 dhe ndryshimeve si dhe të dokumenteve udhëzuese bazë të BE[1] dhe VKM-ve. Kjo ka për qëllim që të sigurojë një kuadër të plotë të vlerësimit dhe të identifikimit te çështjeve kritike dhe të konsiderueshme që duhet të adresohen në vlerësimin e mjedisit dhe ndikimet e tij në shëndetin e popullatës, reflektuar ne Planin Vendor të Vlorës. Për këtë qëllim, synimi kryesor i Raportit Mjedisor ka qenë :

- të skicojë në mënyrë efektive fushën e veprimit dhe kontekstin e PPVTB të Vlorës;
- të sigurojë një vlerësim shumë-nivelesh të PPVTB Vlorë në drejtim të:

  qëllimet dhe objektivave;

  politikat e përgjithshme;

  propozimet e veçanta të zhvillimit;
- të shmangë dhënien e informacionit të tepërt që është jashtë fushës
- të sigurojë një prezantim direkt për palët respektive të interesuara të PPVTB; përfundimisht, me qëllim që të sigurojë Planin si një mjet të dobishëm që mund të kuptohet lehtësisht nga publiku dhe autoritetet, **në përputhje me parimet e transparencës dhe konsultimeve efektive publike në vendim-marrje**, të cilat janë mbrojtur në Ligjin 91/2013 dhe Direktivën e BE-së 2001/42/KE.

Parametrat e mjedisit dhe shëndetit që duhet të merren parasysh nga Raporti Mjedisor i VSM-së në bazë të Ligjit 91/2013 janë grupuar, kur ka qenë e nevojshme, në kategori të mëdha sipas çështjeve); ose në kategori paralele ku disa nga parametrat janë nën-ndarë, në mënyrë që të përshtatet më mirë me strukturën dhe përmbajtjen e PPVTB të Vlorës. E njëjta strukturë është ndjekur në të gjithë Raportin e Mjedisit, në mënyrë që

[1]Tregues:
- *Manual për VSM për politikën e kohezionit* 2007-2013, Rrjeti i Programeve të zhvillimit të Gjelbërimit Rajonal, 2006.
- *Zbatimi i Direktivës 2001/42 mbi Vlerësimin e Efekteve të Planeve të Caktuara dhe Programeve për Mjedisin,* Komisioni Evropian, QZH të Mjedisit.
- *Lidhja ndërmjet direktivave të VNM dhe VSM*, Kolegjit Imperial të Londrës, Raporti përfundimtar për Komisionin Europian, 2005.
- *Metodat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis*, botuar nga Peter Morris dhe Riki Therivel, Vëllimi III, 2009.

të lehtësoje të kuptuarit dhe rishikimin e vlerësimit aktual nga ana e publikut dhe autoriteteve. Baza e metodologjisë janë objektivat e VSM-së, që rrjedhin nga vlerësimet mjedisore dhe janë përdorur për të:

vlerësuar ndikimet e pritura mjedisore dhe shëndetit të skenarëve alternativë (Kapitulli 4);

- vlerësuar në detaje rreziqet e pritura mjedisore dhe shëndetësore, ndikimet e politikave të planit vendor dhe projekteve dhe të propozojë masa lehtësuese (Kapitulli 5).
- formuar bazën për formulimin e listës së treguesve për sistemin e monitorimit të propozuar të PPVTB (kapitulli 6).

Metodologjia e hartimit të raportit për VSM-në Vlorë është i bazuar në skemën e mëposhtme:

ANALIZA E KUSHTEVE TË SOTME KRYESORE MJEDISORE
(Kapitulli 2)

Sistem Urban
Profili demografik
(Popullsia, Emigrimi,Densiteti i popullsisë)

Ekonomia dhe Punësimi
(Njësive ekonomike, Turizmi, ***Përdorimi i tokës dhe modelet e zhvillimit***

Trashëgimia kulturore

Ndotja akustike

Sistem Ujor
trupa ujore dhe deti
(Ujërat nëntokësore, Lumenjtë dhe përrenjtë)

Sistem Natyror
Biodiversiteti, fauna & flora pyjet, zonat e rëndësishme dhe të mbrojtura

Klima dhe Cilësia e ajrit

Peisazhi natyror

"Zonat e nxehta" në zonën e studimit
(Guroret, Korridori mjedisor)

Sistemi Bujqesor

Boniteti i tokes

Ekonomia bujqesia
Bujqësia dhe blegtoria,Punësimi

Sistemi Infrastrukturor
Aksesi dhe rrjeti i transportit
Portet detare të zonës
Energjia dhe Telekomunikacioni
(Furnizimi me Energji, Rrjeti i Telekomunikacioni)

Menaxhimi mbetjeve të ngurta dhe infrastruktura mjedisore

Rrjeti i uji te pishem e dhe ujërave të zeza

Presionet kyçe mbi mjedisin (Kapitulli 2.5)

Pjesemarrja publike dhe konsultimi me publikun (ne kuadrin e Planit Lokal)
Konsultimi me shtresat lokale të interesuara dhe konsiderata për zhvillimin lokal lidhur me planin dhe studimet

Politikat kombëtare dhe ndërkombëtare (Kapitulli 3.1, 3.2)
Konsiderata për objektivat e qëndrueshme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe strategjia mjedisore e vendit

ZHVILLIMI I OBJEKTIVAVE TË VSM PËR VLOREN (Kapitulli 3.3)

SKENARËT ALTERNATIVË (Kapitulli 4)
→ **Vlerësimi i përgjithshëm i katër skenareve alternative në lidhje me objektivat e VSM-s**
- Skenari Asgjë
- Dy opsione të zhvillimit lokal dhe impakti

→ **Skenari i Zgjedhur (Plani Pergjithshem Vendor)**

VLERËSIMI I DETAJUAR I PPV (Kapitulli 5)

→Vlerësimi i ndikimeve te pritshme mjedisore dhe shendetesore te PPV në lidhje me objektivat e VSM-se

→Masat e propozuara dhe veprimet për të parandaluar dhe / ose per te zbutur ndikimet e pritshme

- Orientimi Startegjik 1: Përmirësimi i konkurueshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik
- Orientimi strategjik 2: Zhvillimi i zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi të qëndrueshme
- Orientimi strategjik 3: Nxitja e sipërmarrjes dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor
- Orientimi strategjik 4:Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë rezidenciale dhe rritja e kohezionit social
- Orientimi Strategjik 5:Përmirësimi i lidhjes dhe zhvillimi i formave multimodale të transportit
- Orientimi strategjik 6:Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore

Figura 1: Metodologjia për hartimin e raportit të VSM-se në lidhje me specifikat e Planit Lokal te Vlorë dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar të VSM-se

2. ANALIZA E KUSHTEVE TË SOTME KRYESORE MJEDISORE.

2.1 Sistemi Urban

2.1.1 Demografia dhe Shpërndarja Hapësinore e Popullsisë

Vitet 1990 në Shqipëri u karakterizuan nga një tranzicion i gjerë ekonomiko-politik shoqëruar me një lëvizshmëri të lartë demografike të popullsisë vendase. Në këtë kuadër edhe popullsia në Bashkinë e Vlorës, sikurse edhe e gjithë Shqipëria, u karakterizua nga ndryshime të natyrës migratore, por edhe të ndarjeve të shpeshta territoriale. Kështu,me reformën e re territoriale të bazuar nëligjin Nr. 115/2014, "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë",Bashkia e Vlorës e zgjeroi shtrirjen e saj duke u përbërë tashmë nga pesë njësi administrative: qyteti i Vlorës, Njësia e Orikumit, Qëndër Vlorës, Novoselës dhe Shushicës.

Sipas të dhenave të tabelës së meposhtme, regjistrimi i popullsise se vitit 1989, tregon një popullsi rezidente prej 114,497 banorësh që përfaqëson rreth 4% të popullsisë së Shqipërisë në këtë periudhë[2].

Tabela 1:Popullsia rezidente në Bashkinë e re Vlorë për vitet 1989, 2001, 2011

	Popullsia sipas vitit			Diferenca 2001-1989	Diferenca 20011-2001
Njësi Administrative	1989	2001	2011		
Vlorë	71662	77652	79513	5990	1861
Orikum	8565	6376	5503	-2189	-873
Qender	13470	10496	7621	-2974	-2875
Novoselë	12565	10640	8209	-1925	-2431
Shushicë	8235	6212	3981	-2023	-2231
Bashkia e re Vlorë	114497	111376	104827	-3121	-6549

Burimi: INSTAT, Census, 2011

Sipas regjistrimit të vitit 2001 popullsia e Bashkisë Vlorë ulet me 3% në krahasim me vitin 1989 ose 111,376 banorë, me një renie prej 3121 banorësh në krahasim me vitin 1989. Megjithatë edhe në këtë vit në Bashkinë Vlorë rezulton një popullsi rezidente prej 4% të totalit të popullsisë së Shqiperisë në vitin 20013.

Censusi i fundit i vitit 2011 shënon një popullsi rezidente në Bashkinë Vlorë prej 104,827 banorësh me një renie prej 6,549 banoresh ne krahasim me vitin 2001, ose rreth 6% te popullsise. Kjo renie është megjithatë më e vogël se renia e popullsisë së Shqiperisë nga viti 20114 ne vitin 2001 që është rreth 8%.

Po të shihen të dhënat e ndryshimeve sipas njësive të vjetra administrative vihet re se pjesa urbane e Bashkisë Vlorë, që perfaqesohet nga Bashkia e vjetër Vlorë, ka pësuar një rritje të popullsisë për 5990 banorë në vitin 2001 nëkrahasim me 1989 dhe 1861 banorë në vitin 2011, në karahasim me 10 vitet e para, duke kompensuar ne nje fare mënyre ndryshimet negative të popullsisë në të gjitha njesitë e tjera administrative që përbejnë Bashkinë Vlorë, si Orikumi qe shenon 5503 banore rezident në krahasim me 8565 ne vitin 1989. Po kështu, nje renie të ndjeshme e popullsisë rezidente shënohet edhe në njësitë e tjera adminsitrative si ish Komuna Qendër, Novoselë dhe Shushicë.

Tabela e mëposhtme tregon strukturën e popullsisë meshkuj-femra për të gjitha njesitë përbërëse të Bashkisë Vlorë.

Tabela 2: Struktura e popullsise në Bashkinë Vlorë sipas gjinisë, 2011

	Popullsia	Meshkuj	Femra
Orikum	5503	2717	2786
Novosele	8209	4086	4123
Qender	7621	3816	3805

[3]Popullsia e Shqiperise sipas regjistrimit te vitit 2001 është 3,069,275 banore
[4]Popullsia e Shqiperise sipas regjistrimit te vitit 2011 është 2,831,741 banore

Shushice	3981	2026	1955
Vlore	79513	39620	39893
Total Bashki Vlore	104827	52265	52562

Burimi: INSTAT, Census 2011

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme Bashkia Vlorë ka në total një shpërndarje pothuajse të barabartë meshkuj-femra të popullsisë rezidente, gjë që tregon se flukset migratore tashmë janë stabilizuar duke eliminuar shpërndarjen jo të regullt në popullsi sipas gjinisë. Po të njëjtën rregullsi të shperndarjes kanë edhe njësitë administrative të Bashkisë Vlorë.

Bashkia e Vlorës ka një sipërfaqe prej 629 km^2. Duke marrë të dhënat e censusit, densiteti i popullsisë në këtë bashki është 167 banorë për km^2.

Tabela 3: Dendësia e popullsisë Bashkisë Vlorë

NJësi Administrative	Sipërfaqja km^2	Popullsia 2011	Dendësia
Vlorë qytet	30	79513	2650
Orikum (me Karaburun)	313	5503	18
Novoselë	137	8209	60
Qendër	84	7621	91
Shushicë	65	3981	61
Bashkia Vlorë	629	104827	167
Shqipëria	28748	2831741	99

Burimi: INSTAT, 2011

Dëndesia e popullsisë së Bashkisë Vlorë është më lartë se dëndesia e popullsisë në nivel kombëtar, e cila sipas te dhenave te censusit të vitit 2011 është 99 banorë për km^2.

Siç shihet nga tabela e mesiperme dendesia më e madhe e popullsisë në Bashkinë Vlorë është në qytetin e Vlorës, në të cilën jetojnë 2650 banorë për një km^2. Ndërsa në territorin e njësisë administrative Qendër, e cila rrethon pjesën urbane të qytetit të Vlorës jetojnë rreth 91 banorë për km^2. Në ndyshim me njësisnë administrative Qëndër, kemi njësitë administrative Novesele dhe Shushice në të cilat jetojnë respektivisht 60 dhe 61 banorë për km^2. Territori i Orikumit rezulton të ketë dendesinë më të vogël në Bashkinë Vlorë me 18 banorë për km^2. Por duke hequr siperfaqen e gadishullit te Karaburunit prej rreth 120 km^2, e cili është një territor i pa banuar, atehere dendesia e njësisë Orikum rezulton të jetë rreth 29 banorë për km^2, e cila është përsëri niveli më i ulet i densitetit të popullsisë në gjithë Bashkinë Vlorë.

2.1.2 Ekonomia dhe Punësimi

Zhvillimi ekonomik në territorin e Bashkisë Vlorë ka mundësi dhe potenciale të jashtëzakonshme në drejtim të zhvillimit ekonomik, në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë. Gjiri i Vlorës është përdorur dhe vazhdon të përdoret edhe sot si një vend me mundësi të mira për ankorimin e anijeve të tipeve të ndryshme. Porti i Vlorës është porti më i madh i Shqipërisë Jugore dhe i shërben të gjithë rajonit përreth, në transportin e mallrave dhe udhëtarëve.

Në tabelën 4 të mëposhtme tregohet numri i ndërmarrjeve aktive në fund të vitit sipas njësive të vjetra administrative në Bashkinë Vlorë për vitet 2013 dhe 2014, si dhe numri total i tyre në nivel kombëtar dhe nivel Qarku.

Tabela 4: Ndërmarrjet aktive sipas Bashkisë, Vlorë, 2013, 2014 (gjendje në fund të vitit)

Komunë / Bashki	Viti			
	2013		2014	
		Ne %		Ne %
Total Shqipëria	111,083	5.1	112,537	5.3
Qarku Vlorë	9,363	60.8	9,580	62.0
Novoselë, Vlorë	205	3.6	196	3.3
Orikum	453	8.0	471	7.9
Qendër, Vlorë	265	4.7	264	4.4
Shushicë, Vlorë	108	1.9	89	1.5
Vlorë bashki e vjeter	4,660	81.9	4917	82.8
Bashkia Vlore	5,691	100	5,937	100

Burimi: INSTAT, Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve

Në nivel kombëtar, në vitin 2014, ndërmarrjet aktive në Bashkinë Vlorë zenë 5.3% të ndërmarrjeve aktive, nga 5.1% që zininin në vitin 2013. Po kështu rritje të peshes specifike të ndërmarrjve aktive ka edhe në nivel qarku, ku në vitin 2014 arrihet në 62% nga 60.8% për vitin 2013, gjë që tregon se përgjithësisht rajoni i Bashkisë Vlorë po merr përparësi në drejtim të zhvillimit të biznesit.

Po të vërehet struktura e ndërmarrjeve aktive brenda njësive administrative të Bashkisë Vlorë vihet re se pjesa më e madhe e këtyre ndërmarrjeve ndodhen në ish bashkinë e vjetër Vlorë. Në vitin 2014 numërohen 4,917 ndërmarrje aktive nga 5,917 të tilla për gjithë Bashkinë, ose 82.7% të totalit të ndërmarrjve aktive. Ndërsa në njësitë e tjera administrative ky numër është relativisht më i vogël, duke variuar në 7.9% në Orikum dhe më pak ose 1.5% nërastin e Shushicës.

Duke parë ndryshimet e peshës specifike të ndërmarrjeve aktive në vitin 2013 në krahasim me 2014, vihet re një ulje e peshës specifike të këtyre ndërmarrjeve në njesitë administrative rurale dhe gjysëm urbane duke u përqëndruar gjithnjë e më shumë si aktivitete prodhuese në zonën urbane të ish Bashkisë Vlorë. Kjo situate të shtyn drejt përfundimin se Bashkia Vlorë nuk ofron kushte të njëtrajtshme për zhvillimin e biznesit në të gjitha rajonet e saj gjë që duhet të reflektohet edhe në planifikimin e zhvillimit urban.

Tabela 5 tregon shpërndarjen e ndërmarrjeve ekonomike aktive sipas sektorëve të ekonomisë në Qarkun e Vlorës dhe në Bashkinë e re Vlorë. Të dhënat më të hollësishme, për çdo njësi territoriale, nuk qe e mundur të viheshin në dispozicion nga INSTAT për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të ndërmarrjeve. Të dhëna më të detajuara u morën nga konsulenti pranë Bashkisë Vlorë, por në çdo rast, ky grup të dhënash nuk u vu në në përdorim për shkak të mospërputhjes së tyre si nga pikpamja numerike e ndërmarrjeve aktive ashtu në shpërndarjen e tyre sipas sektorëve të ndryshëm ekonomikë.

Tabela 6: Ndërmarrjet aktive në qarkun Vlorë sipas ndarjes administrative dhe aktivitetit ekonomik, 2014

Bashkia	Gjithsej	Bujqësia, pyjet, peshkimi	Industria	Ndërtimi	Tregtia	Transporti dhe magazinimi	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Shërbime të tjera
Qarku Vlore	9,580	428	820	529	3,556	716	2,019	153	1,359
Vlorë	5,937	277	488	337	2,202	466	1,143	91	933
ne %		4.7	8.2	5.7	37.1	7.8	19.3	1.5	15.7

Burimi: INSTAT, Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve

Nga tabela. 17 vihet re se numri më i madh i ndërmarrjve ekonomike ndodhen në sektorin e tregtisë me 2,202 njësi ose 37.1% të ndërmarrjeve aktive. Në vend të dytë me 19.3% nga pikëpamja e numrit, radhiten sektori i hotelerisë dhe resoranteve (akomodimi dhe shërbim ushqimor) me 1,143 ndërmarrje aktive dhe sektori i industrisë përpunuese dhe transporti me 8.2 dhe 7.8 % të totalit të ndërmarrjve.

Tabela 7 e mëposhtme paraqet në linja të përgjithshme karakterin ekonomik të rajonit të Bashkisë Vlorë, pa ju referuar peshës specifike të çdo sektori në prodhimin e përgjithshëm rajonal, pasi këto të dhëna nuk janë të disponueshme nga INSTAT ashtu edhe nga Bashkia Vlorë.

Tabela 7: Ndërmarrjet aktive në qarkun Vlorë sipas ndarjes administrative dhe formës ligjore, 2014

	Gjithsej	Person fizik	Person Juridik
Qarku Vlorë	5937	4673	1264
Vlorë	5,937	4,673	1,264

Në %	100	78.7	21.3

Burimi: Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve

Nga numri total i ndërmarrjve aktive, i barazvlefshëm me 5,937 në Bashkinë Vlore, 78.7% e tyre janë organizuar si person fizik (PF) dhe 21.3% dhe 1,264 ndërmarrje aktive janë në një prej formave të tjera të shoqërive tregtare. Kjo situatë flet përgjithësisht për një organizim jo të mirë të ndërmarrjeve aktive, pasi forma si PF nuk i lejojnë këtyre ndërmarrjeve të kenë akses shumë të madh në tregun financiar. Mungesa e aksesueshmërisë i referohet si kredimarrjes afatgjata, ashtu edhe krijimit të formave dhe sinergjive për tërheqjen e kapitaleve pranë këtyre ndërmarrjeve, në formën e kapitalit aksionar apo pjesmarrjen në shoqëri.

Punësimi dhe shpërndarja e të punësuarve sipas tre sektorëve më të rëndësishëm, industri, bujqësi/agrikulturë dhe shërbime, na tregon jo vetëm shkallën e punësimit por dhe karakterin e çdo rajoni që përbën Bashkinë e re Vlorë. Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 8: Punësimi sipas sektorëve, Bashkia Vlorë, 2011

Njësia Administrative	Nr total i të punësuarve- 2011	Të punësuarit në industri - 2011	Të punësuarit në agrikulturë- 2011	Të punësuarit në shërbime - 2011
Novoselë	26.2	16.5	54.2	29.3
Orikum	42.8	22.5	30.3	47.2
Qendër	40.9	25.5	41.9	32.6
Shushicë	30.9	16.7	50.6	32.7
Bashkia e vjeter Vlorë	67.5	28.8	2.7	68.4
Bashkia Vlore				
Shqipëria	54.5	20.4	26.1	53.5

Burimi: INSTAT, Census 2011

Nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Vlorë, përqindja më e lartë e punësimit është në Bashkinë Vlorë me 67.5%, e cila tejkalon edhe nivelin kombëtar prej 54.5% të popullsisë. Njësitë e tjera administrative kanë një nivel punësimi shumë të ulët gjë që flet për diferenca mjaft të mëdhe sociale. Kështu niveli i punësimit në Noveselë është vetëm 26.2%, ndërsa në Shushicë vetëm 30.9%. Disi më i lartëështë ky nivel në dy njësitë e tjera Qendër dhe Orikum, respektivisht me 40.9% dhe 42.8%, por përsëri shumë poshtë nivelit të punësimit në nivel Kombëtar dhe aq më shumë në krahasim me qytetin e Vlorës.

2.1.3 Përdorimi i Tokës dhe Modelet e Zhvillimit

Përdorimi i tokes në NJQV-të e reja është ndarë për qëllime të planifikimit në pesë sisteme territoriale: Urban, Natyror, Bujqësor, i Ujit dhe Infrastrukturor.

Skicimi i mëposhtëm paraqet një analizë të përafërt në nivelin makro të përdorimit të tokës.



Figura 2: Analiza Makro Zonimit te Bashkise Vlore.
Burimi: Grupi i eksperteve te punes

Analiza e sistemeve për Bashkinë e Vlorë është si në vijim:

Sistemi Urban i referohet një toke tashmë të zhvilluar; Pjesa më e madhe e tokës urbane, rreth 70% përbëhet nga qyteti i Vlorës duke përfshirë luginën bregdetare nga ultësira deri në bregdet. Zona urbane përfshin gjithashu edhe komponentë të karakterit industrial që radhiten pranë saj si fabrika e Sodës dhe TEC të cilat janë të vendosura në perëndim. Qyteti është relativisht kompakt, por gjatë dy dekadave të fundit paraqet një shtrirje dhe zgjerim dinamik. Pas vitit 1990 zona urbane është zgjeruar kryesisht në jug përgjatë bregdetit Jon drejt Orikumit, ku janë të pozicionuara zonat kryesore të shtëpive dytësore dhe infrastruktura çlodhëse. Një drejtim dytësor i zhvillimit urban është formuar në lindje përgjatë rrugës që kalon përmes kodrave të Vlorës përmes luginës së Shushicës. Ka një përqendrim të zonave informale të banimit të kombinuara me zhvillime të reja me shfrytëzim ekonomik. Disa tendenca në zhvillimin urban të pjesën veriore përgjatë rrugës së vjetër nacionale janë braktisur pas hapjes

së rrugës së re nacionale gjatë 15 viteve të fundit. Përveç qytetit të Vlorës sistemi urban i bashkisë përbëhet nga vendbanimet e shumta rurale të Shushicës, Qendrës, Orikumit dhe Novoselës të cilat formojnë rrjete të një densiteti relativisht të ulët. Modeli i shpërndarjes ndryshon nëse ndjekim karakteristikat e secilës zonë. Përqëndrimi më i lartë i përdorimeve urbane vihet re në verilindje dhe është i lidhur me relievin e butë, vendndodhjen e tokës bujqësore dhe të afërsisë me Vlorën. Zona në veriperëndim të lagunës dhe territoret jugore malore të Llogarasë, Karaburunit, janë më pak të urbanizuara.

Sistemi i Ujërave në Bashkinë Vlorë është formuar nga një kombinim elementesh ujërash tokësor dhe bregdetar. Në lidhje me ujërat bregdetar, aspekti më i rëndësishëm është laguna e Nartës e cila zë një sipërfaqe prej 2.900 km^2 dhe prania e saj dominon pjesën veri-perëndimore të territorit të bashkisë. Kjo sipërfaqe e madhe uji ka ndikuar në jetën e banorëve të fshatrave lokal të Nartës, Panajasë, Zvërnecit dhe Novoselës të cilët bashkëjetojnë dhe zhvillojnë aktivitete tradicionale ekonomike, të tilla si peshkimi dhe bujqësia, në harmoni me funksionet ekologjike të zonës për disa qindra vjet duke formuar identitetin e tyre të veçantë përreth lagunës. Laguna parësore kufizohet nga trupa të tjerë më të vegjël ujor. Një tjetër zonë bregdetare ligatinore më e vogël (Pashai i Limanit) është formuar në jug në gjirin e Orikumit, në afërsi të skajit të gadishullit të Karaburunit. Lidhur me ujërat tokësorë duhet të theksohet rëndësia e Vjosës, lumit më të rëndësishëm të Shqipërisë me një gjatësi prej disa qindra km që rrjedh nga rajoni grek i Epirit, duke kaluar nga lugina e Përmetit dhe duke arritur detin në veri të lagunes se Nartes. Kjo përbën edhe kufirin verior të Bashkisë së re të Vlores. Prania e lumit ka një ndikim të fortë në peizazhin bregdetar. Lumi gjarpëron nëpër një luginë të hapur për disa km para se të mbërrijë në det, ku formohet një deltë e gjerë me kon aluvial. Lumi i dytë më i rëndësishëm i njësisë administrative është ai i Shushicës i cili lidhet me sistemin e Vjosës. Ai rrjedh nga jugu në drejtim të veriut pas kodrave të Vlorës, duke formuar kufirin lindor të njësisë dhe derdhet në Vjosë. Burimi i Shushicës është i vendosur në pjesën e pasme të maleve të Himarës dhe lugina e tij formon një lidhje të brendshme të natyrshme midis Vlorës dhe Vranishtit. Një sistem i tretë lumi është ai i Dukatit që rrjedh nëpër luginën e Orikumit duke mbledhur ujin nga pjesët malore të luginës.

Pjesë të mëdha të territorit të bashkisë përshkohen nga rrjedhat me drejtim nga lindje-perëndimi, disa prej të cilave të çojnë drejt lagunës dhe detit dhe disa në brendësi në drejtim të lumenjve. Për më tepër bashkia ka disa rezervuarë të ujit, kryesisht në pjesën verilindore që përdoren për vaditje, disa prej të cilave paraqesin edhe aspekte argëtuese (si Babica e Vogël)

Sistemi i Bujqësisë në bashki është i lidhur ngushtë me sistemin e ujit. Toka bujqësore kryesisht përbëhet nga dy lloje:

a) zonat e sheshta të kulturave intensive bujqësore të cilat janë të ujitura nëpërmjet lumenjve. Ato janë të përqendruara në tre lugina të Vjosës, Novosela në veri, Shushica në lindje dhe Orikumi në jug. Disa toka bujqësore, kryesisht në veri të lagunës së Nartës janë krijuar nga tharja e një pjese të ligatinave në periudhën e socializmit. Kultivimet kryesore në zonën Novoselë, Shushicë, Qendër janë misri, fasulet, patatet, dhe zarzavatet.

b) kultivimet kodrinore janë të përqendruara në dy pjesë, kryesisht në veri të Vlorës përgjatë formacioneve kodrinore të vendosura midis lagunës dhe luginës së Shushicës (fshatrat e Panajasë) dhe në jug, në pjesën lindore të luginës së Orikumit (në afërsi të Tragjasit dhe Dukatit). Kultivimet kryesore përgjatë luginave të vogla janë vreshtat dhe kodrinat e mbuluara me ullinj, pemë frutore dhe agrume.

Prania e sistemeve të ujitjes është ende e dukshme në shumicën e tokave bujqësore (kanaleve, liqeneve artificial, etj). Për shkak të emigrimit si dhe rënies së prodhimit bujqësor, dhe pas zhvendosjes së ekonomisë lokale drejt turizmit dhe ndërtimit, një pjesë e madhe e tokës bujqësore mbetet pak e përdorur, ndërsa operimi i sistemeve të ujitjes mbetet i pasigurt. Pothuajse gjithë toka bujqësore është privatizuar që nga vitet 1990 dhe i është ndarë përdoruesve të tij; domethënë banorëve dhe vendbanimeve fqinje. Sistemi bujqësor është shumë i rëndësishëm për të mbajtur popullsinë rurale të fshatrave të shumtë të zonës dhe mbështet zhvillimin e turizmit.

Sistemi Kombëtar i Rrugëve përbëhet nga rruga e re nacionale që lidh Vlorën me Fierin që është ndërtuar si një sistem i mbyllur autostrade dhe përfundon në qytetin e Vlorës. Nga atje, trafiku ndërrajonal kalon përmes qytetit dhe vazhdon përgjatë rrugës bregdetare që të çon në jug. Një bypass i ri periferial i cili kalon nga kodrat e Kaninës në Orikum është në ndërtim e sipër. Rrjeti rajonal i rrugëve në sektorin verior të Novoselës në Qendër është formuar nga rruga e vjetër nacionale. Rrjeti i rrugëve sekondare dhe terciare është më pak i zhvilluar.

Bashkia Vlorë është e pajisur me një rrjet hekurudhor të lidhur me Lushnjën dhe Durrësin që përfundon në qytetin e Vlorës. Hekurudha përdoret shumë pak për transportin e pasagjerëve.

Infrastruktura Portuale e bashkisë përbëhet kryesisht nga porti i Vlorës dhe objekte sekondare. Porti i Vlorës është sa komercial aq edhe për funksione pasagjerësh duke qenë dalja e dytë që lidhet me Italinë, është i vendosur në qytet në fund të bulevardit kryesor. Një strukturë e dytë e madhe portuale është në qendrën industriale të Petrolierës e cila është ndërtuar nga perëndimi në brendësi të pyllit të Sodës. Pranë me të është vendosur edhe porti i peshkimit të Vlorës. Në bregdetin e Jonit vihet re prania e Marinës së Orikumit në grykëderdhjen e lumit të Dukatit dhe baza ushtarake e portit të Karaburunit në buzë të gjirit.

Ish-aeroporti ushtarak i Vlorës është braktisur dhe është pjesë e sistemit të infrastrukturës që pret të riaktivizohet dhe shërben aktualisht si territor kryesor për mbetjet urbane.

Sistemi i Infrastrukturës Urbane është përqëndruar kryesisht në qytetin e Vlorës dhe më pak në pjesën tjetër të vendbanimeve rurale. Sistemi i kanalizimit është i kufizuar kryesisht në qytetin e Vlorës, ku është vendosur një impiant i madh për trajtimin e ujërave të zeza.

Konfliktet e Përdorimit të Tokës- Ndërmjet 5 sistemeve territoriale të bashkisë janë formuar sinergji të tilla si ajo midis ujit dhe sistemeve bujqësore, ujit dhe sistemeve natyrore, sistemit bujqësor dhe urban por gjithashtu ka dhe hapësirë për reagime dhe konflikte të

brendëshme midis tyre. Disa nga konfliktet më karakteristike janë vërejtur mes funksioneve urbane rikreative dhe objekteve industriale që janë të vendosura në afërsi të kufirit me qytetin e Vlorës, portit të peshkimit, centralit TEC dhe Portit petrolifer si dhe zonës së kufizuar industriale, të cilat paraqesin një kërcënim potencial për zhvillimin e ardhshëm të turizmit. Një tjetër konflikt mes sistemeve të infrastrukturës urbane është dhe grumbullimi i mbetjeve i vendosur në brendësi të qytetit të Vlores. Një tjetër lloj konflikti mes sistemeve urbane, natyrore dhe bujqësore vihet re në zonat ku ndërtimi i pakontrolluar ka kompromentuar integritetin e zonave natyrore të tilla si ato përgjatë bregdetit dhe tokës pjellore bujqësore.

2.1.4 Ndotja Akustike

Ndotja akustike në mjedis janë të lidhura me sjelljen dhe shëndetin. Çdo tingull i padëshiruar mund të dëmtojë fiziologjikisht dhe psikologjikisht shëndetin e popullatës. Ndotja akustike shkakton bezdi, agresion, hipertension, stres të lartë, humbje dëgjimi, shqetësime gjumi apo edhe ndonjë efekt tjetër të dëmshëm. Mbi të gjitha, stresi dhe hipertensioni janë ato që çojnë në problemet shëndetësore më të rënda, tinitus mund të çojë në probleme të harresës, panik etj. Nivele të larta të zhurmave mund të sjellin probleme kardiovaskulare, në rastet e ekspozimit kundrejt zhurmave për rreth 8 orë, mund të çojë në rritje të tensionit të gjakut me 5 shkallë etj.

Gjithashtu ndotja akustike mund të sjellë dëme të konsiderueshme edhe për faunën në mënyrë të veçantë avifaunën(zogjtë), duke dëmtuar në këtë mënyrë biodiversitetin dhe gjithë zinxhirin ushqimor.

Kjo është edhe arsyeja përse duhen mbajtur nën kontroll niveli i zhurmave në këtë Bashki dhe jo vetëm.

Në qytetin e Vlorës mund të paraqitet problematike gjatë sezonit veror sidomos në rrugët ku edhe trafiku është më i renduar.

Tabela 9-Monitorimit i zhurmave të qytetit të Vlorës, në 5 vitet e fundit[dB]

Pikat e monitorimit	2007	2008	2010	2011	2014
Hyrja e Qytetit	70	60.9	62.6	60.6	62.8
Përballë Xhamisë	68	70.5	64.2	62.4	58.9
Përballë Hot. Bolonjës	71	65.5	64	66.7	59.8
Tek Uji i Ftohtë	69	68.4	59.1	57.6	67.2
Standarti i BE			55		
Burimi: Ministria e Mjedisit					

Sidoqoftë monitorimi disavjeçar jep të dhëna (tabela 5) se qyteti i Vlorës sot është më pak i zhurmshëm se sa në vitet e mëparshme. Situata e krijuar për shkak të ndërtimit të "lungomares" është e përkohshme dhe do të normalizohet me përfundimin e punimeve. Po ashtu edhe rehabilitimi i rrugës transballkanike do të minimizojë zhurmat që vijnë kryesisht nga lëvizja e automjeteve. Prania e TEC të Vlorës në afërsi mund të krijojë shqetësime

megjithëse teknologjia e prodhimit të energjisë sipas manualëve të paraqitura nga ekspertët e fushës nuk i kalon të 70dB gjatë ditës dhe natës. Prania e autostradës në afërsi të disa zonave të banuara të komunës krijon një shqetësim të vogël për banorët. Pajisje e autostradës në disa vende me reduktues të zhurmave nuk janë të mjaftueshme prandaj duhet menduar edhe shtimi i tyre. Kjo zhurmë është shqetësuese edhe për faunën ë zonës.

Më problematike paraqitet ndotja akustike ujore pasi ardhja në port e anijeve të tonazheve të mëdha krijojnë zhurma nënujore shqetësuese për faunën. Këtu mund të përmendim anijet që furnizohen me hidrokarbure por edhe ato të peshkimit.

Zbatimi i ligjit dhe i VKM (587/2010) lidhur me monitorimin dhe kontrollin e zhurmave në qendrat urbane dhe turistike do të ndikonte në përmirësimin e mëtejshëm të situatës territorin e bashkisë.



Harta 1- Harta e Perdorimit Ekzistues te Tokes

2.1.5 Trashëgimia Kulturore

Territori i Gjirit të Vlorës ku bën pjesë vet qyteti, prezanton një nga zonat më të pasura me monumente e site arkeologjike të Shqipërisë. Brenda qytetit të sotëm të Vlorës ruhen gjurmët e Aulonës antike mesjetare e cila rrethohet nga një sërë qendrash të tjera siç janë Treporti në veri, Kanina, Radhima, Tragjasi, Dukati dhe Oriku në lindje dhe jug ku janë zbuluar mbetje dhe gjurmë arkeologjike nga prehistoria deri në mesjetën e vonë. Këto qëndra kanë qenë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Nuk mbeten jashtë ndikimeve e marrëdhënieve midis tyre edhe qendrat e mirënjohura antike më në brendësi të territorit si Amantia, Olympe dhe Cerja. Ndonëse kërkimet dhe gërmimet arkeologjike kanë qenë të kufizuara, materiali arkeologjik i grumbulluar dhe informacionet që vijnë nga burimet e shkruara ndihmojnë të kuptojmë vlerat e mëdha historike, kulturore që ato ruajnë.

Ndarja e re administrative ashtu si për njësitë e tjera, ka zgjeruar shume territorin e Bashkisë së Vlorë duke e shtrirë atë në gjithë Gjirin e Vlorës, me kufi në veri derdhjen e lumit të Vjosës ndërsa në perëndim përfshin gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit. Si kufi lindor shërben lugina e poshtme e Shushicës dhe Malet e Lungarës dhe të Çikës. Territori i Bashkisë me një sipërfaqe më se 600 km^2 ka në juridiksionin e saj përveç qyteteve të Vlorës e Orikut edhe Dukatin, Dukat Fshat, Tragjas, Radhimë, Bestrovë, Babicë e Madhe, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kaninë, Kërkovë, Nartë, Sherishtë, Panaja, Xhyherinë, Zvërnec, Sazan, Novoselë, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Delisuf, Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, Fitore, Akërni, Shushicë, Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithas, Mekat, Llakatund, Çeprat dhe Risili.

Brenda territorit që mbulon, Bashkia e Vlorës është administruese e të gjithë vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe artistike.

Midis qendrave të banuara të përmendura që bëjnë pjesë në Bashkinë e Vlorës në pikëpamje të vlerave të trashëgimisë historike e kulturore që ato mbartin mund të veçojmë qytetin antik të Aulonës, Treportit, Kaninës dhe Orikun si dhe disa qendra të tjera si Gramën e Rrëzën e Kanalit në Karaburun, Kalaja e Sofës dhe Marko Boçarit në Tragjas.

Figura 3: Aulona, 1573 Piri Reis
Burimi: IMK

" Zonat e Mbrojtura te trashegimise kulturore"

Rrënojat historike janë të shpërndara brënda dhe jashtë qëndrës së qytetit të Vlorës, në fshatrat përkatëse të kësaj bashkie. Këto zona të cilat mbartin një rëndësi të veçantë për vetë rrethin e Vlorës, duke marrë parasysh të gjitha vlerat dhe historikun e tyre, janë shpallur zona të mbrojtura. Në këtë rast mund të përmëndim gjashtë zona të cilat janë shpallur të mbrojtura.

Aulona e Lashtë (Vlora)

Qyteti antik gjendet në territorin e Vlorës së sotme. Gjurmët arkeologjike më të hershme që lidhen me këtë qendër datohen në shekullin e VI-V para K. Ai zinte pjesën jugore të Lagunës së Nartës (pjesën verilindore të Gjirit të Vlorës).

Aulona si term do të thotë kanal, emërtim që ndoshta e ka marrë nga ekzistenca e një kanali që lidhte detin me Lagunën e Nartës gjë që dëshmohet edhe nga një gravurë mesjetare e shekullit XVI e realizuar nga Piri Reis. Gjiri i Vlorës dhe Aulona në pikëpamje strategjike ka shërbyer në antikitet për zbarkimin e ushtrive romake në luftërat kundër ilirëve e maqedonasve si dhe gjatë luftës civile midis Pompeit dhe Cezarit.

Figura 4: Kastrumi Romak, Muret Rrethuese të Aulonës
Burimi: foto nga eksperti I. Gjipali

Treport (Vlorë)

Treporti prezanton një nga zonat më interesante e të veçanta arkeologjike të Bashkisë së Vlorës. Kërkimet arkeologjike tregojnë për përdorimin e territorit të Treportit nga periudhat e vjetra të gurit (Paleolitit, Mezolitit dhe Neolitit). Vendbanimi ndodhet 11km. larg bregdetit në veri të Vlorës, mbi kodrën e quajtur Pllakë. Gërmimet arkeologjike në rrënojat e Treportit para viteve 90 zbuluan jo vetëm gjurmë të qytetit antik por edhe ato të një vendbanimi prehistorik të fortifikuar. U identifikuan tre faza kryesore banimi. E para daton në periudhën, nga Epoka e Bronzit të Vonë në Epokën e Hershme të Hekurit. E dyta nga shekujt 7-5 ^{të} p.Kr dhe lidhet me vendbanimin e kodrës së Pllakës. Në fazën e tretë që daton nga shekulli i 4^{të} para Kr në atë të shekullit të 2^{të} pas Kr, vendbanimi zgjerohet përtej kodrës e rrethohet me një brez të ri mure

sh me kulla mbrojtëse përgjatë gjithë vijës bregdetare, gjithashtu edhe porti zgjerohet. Vendbanimi në periudhën Romake tkurret dhe jeta e tij përqendrohet në port. Gjithashtu ka fakte që tregojnë se ky vendbanim banohet dhe në periudhën e vonë Romake por si qendër e reduktuar. Duket se në këtë kohë merr fuqi qendra tjetër Aulona e cila rrethohet me murre mbrojtës duke u bërë më e rëndësishme midis qendrave të banuara të Gjirit të Vlorës.

Zyrtari Otoman i shekullit të 17^{të} Evlyia Çelebiu, informon se një pjesë e madhe e elementëve arkitektonikë që i përkisnin rrënojave antike të Treportit dhe të limanit të tij, u zhvendosën dhe u përdorën për ndërtimin e kalasë otomane të Vlorës. Vendbanimi i Treportit është shpallur monument kulture në 1973.

Figura 5: Treport
Burimi: foto: I. Gjipali

Tragjas (Kalaja e Sofës dhe e Marko Boçarit)

Brenda territorit të fshatit Tragjas gjenden disa vendbanime arkeologjike të veçuara. Në jug, në një kodër jo të lartë ndodhet kalaja e lidhur me emrin e heroit kombëtar Gjon Boçari. Ajo është ndërtuar mbi një kodër ku në shpatin e saj verior ka burime ujore natyrale. Faza e hershme e banimit ndodhet në pjesën e sipërme të kodrës ku ndodhet Kalaja e Sofës që është menduar si e periudhës së Hershme të Hekurit dhe përmban trakte të një muri të gjerë shumë këndor, duke përfshirë një sipërfaqe prej 4ha. Një fortifikim më i vonshëm që është ndërtuar në këtë vendbanim, daton në periudhën Romake të Vonë, por zë një sipërfaqe të vogël prej 1.8 ha. Ky mur gjatë gjithë linjës së tij ka pasur kulla mbrojtëse por që nuk ruhen aktualisht. Qeramika më e vonshme e gjetur në këtë vendbanim daton në shekullin e 6të, gjë që tregon se kalaja u braktis pas kësaj kohe.

Me interes mbeten rrënojat e fshatit të vjetër të Tragjasit të djegur gjatë Luftës së II Botërore ku ruhen traditat e ndërtimit të banesës popullore të zonës.

Rrëza e Kanalit (Karaburun)

"Rrëza e Kanalit" përfaqëson një thyerje shkëmbore e cila është mbetje e një sistemi shpellor të shembur që ka shërbyer siç duket në periudhat e gurit dhe më pas si strehë për banorët e zonës.

Streha gjendet në anën lindore të malit të Karaburunit në lartësinë 140m mbi nivelin e detit mbi skajin perëndimor të fushës së Dukatit.

Ky sit shkëmbor u zbulua nga L. Cardini në 1939 (anëtar i Misionit Arkeologjik Italian para Luftës së II Botërore). Gërmimet e tij zbuluan vegla guri eneolitike, qeramikë dhe kocka kafshësh që i përkisnin prehistorisë së vonë. Gërmimet e Projektit të Butrintit në tarracën para strehës, zbuluan një përqendrim i lartë ashklash stralli që lidhen me Mezolitin. Përqendrimi i lartë i ashklave në një sipërfaqe të vogël tregojnë se diku afër kësaj zone të ketë ekzistuar një vend për prodhimin e mikroliteve. Së bashku me gjetjet në faqen poshtë strehës ato përfaqësojnë një pikë referimi për epokat e gurit.

Gërmimet e fundit të kryera nga Instituti Arkeologjik në bashkëpunim me Institutin Prehistorik të Këlnit, Gjermani (2012-2014) kanë treguar për prezencën e aktivitetit njerëzor nga Paleoliti i Lartë, Mezoliti, deri në epokën e bronzit. Janë evidentuar gjithashtu edhe gjurmë të mesjetës. Rrëza e Kanalit mbetet një pikë e rëndësishme për kërkimet e ardhshme për Paleolitin dhe Mezolitin në Shqipëri.

Figura 6: Shtrirja e habitateve të ndryshme në zonën Peisazh i mbrojtur Karaburun - Llogara
Burimi: foto: I. Gjipali

Gramata (Karaburun)

Mbishkrimet e Gramës ndodhen në Gadishullin e Karaburunit në bregun e jashtëm (perëndimor) të tij, në një gji që ka qenë fillimisht zonë për nxjerrjen e gurit (gurore antike), gjurmët e të cilit duken edhe sot në të dy anët. Si gurore, faqet e Gjirit të Gramës janë shfrytëzuar gjatë që i kanë dhënë anëve prerje të larta 30-50m e me gjatësi rreth 100m të cilat janë të dukshme edhe sot. Gurore të tilla me përmasa shumë të mëdha gjenden edhe në anën lindore të gadishullit, në Gjirin e Orikut. Ato mendohet se kanë shërbyer gjatë periudhës së ngritjes dhe zhvillimit të qyteteve koloni si Dyrrahu, Apolonia dhe Oriku duke filluar nga shekulli i VI para Kr. Nisur nga kjo, mbishkrimet e Gramës ka më shumë mundësi të datohen pas shekullit të III p.e.sonë. Mbishkrimet janë parë prej shumë studiuesve duke filluar nga Qiriako i Ankonës në shek XV e më pas nga H. Daumet, L. Heuzey, C. Patsch etj, në shekullin XIX e fillimit të XX.

Numri i madh i mbishkrimeve (mbi 1500) në Gramë, kapin një periudhë që zgjatë nga antikiteti në mesjetë dhe janë të gdhendura në faqet shkëmbore në greqisht e latinisht. Gjiri duke u përdorur gjatë shekujve si një liman për ankorimin e anijeve për të strehuar lundërtarët në periudha të motit të keq apo stuhive detare, u ka shërbyer lundërtarëve edhe për ti lutur zotit për ti shpëtuar nga fatkeqësia duke lënë dëshmi interesante. Përmbajtja e shumicës së mbishkrimeve të gdhendura kanë formulime lutjesh. Është shpallur monument kulture në 1948.

Orikum (Pashaliman)

Orikumi shtrihet në bregun jugperëndimor të Gjirit të Vlorës, në këmbët e gadishullit të Karaburunit. Qyteti antik ndodhet në një kodër të ulët shkëmbore gëlqerore (e njohur ndryshe si Paleokastër), 20 m të lartë në fundin e skelës që e ndan nga gjiri i Pasha Limanit. Një kanal, tani i shndërruar në një kënetë lidhte lagunën me detin. Qyteti antik zotëron në një anë pamjen mbi portin aktual dhe nga ana tjetër lagunën. Burimet antike e lidhin themelimin e qytetit nga Eubeasit në shekullin e VI para Kr por gërmimet e fundit nuk dëshmojnë për këtë. Tit Livi përmend sesi qyteti luajti një rol të rëndësishëm, në betejën e Romakëve kundër Filipit të V të Maqedonisë si dhe në betejat e Cezarit kundër Pompeit në Orikum që janë dokumentuar në letërkëmbimet e Cezarit me Atikun. Nga monumentet kryesore të qytetit janë ruajtur gjurmë të banesave, të rrugëve dhe shkallëve të gdhendura në shkëmb, depozita uji, mure mbrojtës, portat dhe limani. Në periudhën bizantine dhe në mesjetë njihet si një port i vogël (me emrin Jeriko). Më në jugperëndim të Orikut ndodhet Kisha e Marmiroit e shekullit të XII-XIII. Me pushtimin osman Oriku u quajt Pashaliman.

Qendra Historike dhe Trashëgimia Kulturore në Vlorë

Asambli Historik

Në qëndër të qytetit janë të shpërndara ndërtesa të cilat janë evidencë e gjalle e historikut që ato mbartin. Keto ndërtesa janë akoma funksionale, edhe pse funksioni i tyre është i ndryshem nga funksioni fillestar. Teknika e ndërtimit jepet e detajuar, tek të gjithë ndërtimet e përmëndura. Duke marrë parasysh vlerat estetike, historike, kulturore, keto ndërtime janë shpallur monumente kulture.

Arkitektura e Shekullit XX[5]

Në qytetin e Vlorës, janë të ezauruara pesëmbëdhjetë ndërtime të cilat janë shpallur monumente kulture. Teknika e ndërtimit të tyre është pothuajse e njëjtë, me kolona të brëndëshme, me çati, mure mbajtëse, konstruksione druri, mbulesë me tjegulla, përdorimi i beton-armesë etj. Vlerat estetike dhe ornamenti i korrnizave janë një tjetër tipar i përbashkët i banesave të ndërtuar gjate këtij shekulli.

Muzeu Historik

Është ndërtuar në vitin 1918 nga mjeshtra të kohës. Deri në vitin 1939 ka qënë Bashkia e qytetit. Ne vitet 1944 – 1970, në ambientet e kësaj godine kanë punuar organizatat e masave. Pas vitit 1970 u kthye në Muze Historik të Rrethit. Dallohet për vlerat historike, zgjedhjen urbane e artin e të ndërtuarit.

Konstruksioni i ndërteses është i realizuar me mure mbajtës si dhe me kollona në pjesën e brëndshme të saj. Ndërtesa është pjesërisht me çati, me konstruksion druri dhe mbulesë me

[5] Informacion i marrë nga Kartelat e IMK-së

tjegulla dhe pjesërisht me tarracë. Per ndërtim te soletave jane perdorur trarë si dhe qemer me tulla.

Sahati Kompleksi Rr. 8 Marsi

Është ndërtuar ne vitin 1918. U ndërtua me interesimin e z. Ali Asllani (kryetar Bashkie në atë kohë) dhe është financuar nga tregtaret e qytetit. Përvec anes funksionale ka edhe vlera estetike. Merkata dhe sahati eshte projektuar nga specialiste italiane. Ka sherbyer si pike referimi per qytetin dhe qendren tregetare. Në kete objekt kemi futjen e strukturave dhe teknologjive të reja si betoni i armuar dhe lidhëset me cimento portland. Ne vitin 1996 ndertesa eshte trajtuar me punime restauruese ne mjediset e e brendise dhe fasadat e jashtme. Janë me interes në kete monument prania e ornamentikes ne kornizat dhe rozetat me motive patriotike, nga te cilat vecojme : portretin e Skenderbeut me pamje nga balli i nderteses, shqiponjen dykrenare me pamje nga lindja.

Ne kete objekt kemi futjen e strukturave dhe teknologjive te reja si betoni i armuar dhe lidheset me cimento portland. Ndërtesa është e ndërtuar me sistem konstruktiv me kolona beton arme . Mbulimi është realizuar me konstruksion solet beton arme+cati druri me tjegulla vendi. Muret jane tulle dhe te suvatuara me llac gëlqere .

Figura 7: Pamje nga Sahati
Burimi: IMK

Ish Galeria e Arteve, Rr. Zogu i Parë[6]

Është ndërtuar ne vitet 30 te shek. XX. I pergjigjet zgjidhjes urbane te qytetit. Ne kete godine ka qene vendosur Galeria e Arteve dhe mapua e madhe e qytetit. Sot kati I pare perdoret per tregeti , I dyti dhe I treti pjeserisht perdoren per banim. Sebashku me me komplekset e tjera krijon qendren e vjetertregetare te qytetit.

Ndertesa është e ndërtuar me sistem konstruktiv me kolona beton arme . Mbulimi është realizuar me konstruksion solet beton arme+cati druri me tjegulla vendi.Muret jane tulle dhe te suvatuara me llac gelqere .

Monumenti i Pavaresisë[7]

Në qënder te qytetit ngrihet masiv i larte prej bronzi kompleksi skulpturor 17m i larte eshte inaguruar me rastin e 60 - vjetorit te Shpalljes se Pavaresise me 28 Nentor 1972. Vepër e Skulptoreve te Popullit Kristaq Rama, Muntaz Dhrami, Shaban Haderi. Eshte nga veprat më të mëdha monumentale te skulptures ne. Monumenti perjeteson kujtimin e patrioteve si brenda dhe jashte vendit, qe shkrine jeten e tyre per pavaresine dhe lirine e Shqiperise. Ka dy simbole kulmore: Ne qender patriotin – "simbol" I.Qemalin dhe "Flamurtarin" ne krye, shenja e kurorezimit dhe e perjetesimit te perpjekjeve te rilindasve e patrioteve te te gjitha krahinave, luftetareve te pushkes e te penes. Aty personifikohet lavdia e te reneve, realizimi dhe kurorezimi i endrres se tyre – për lirinë e pavaresinë e Shqiperisë. Ngrihet mbi nje platforme te gjere shumeshkallese, me pamjen e nje piramide. Ne qender Ismail Qemali: prapa tij ideologet e Rilindjes, poeti naim Frasheri dhe luftetare nga gjithe trevat, qe dallohen nga veshja.

[6] Informacion i marrë nga kartelat e IMK-së
[7] Informacion i marrë nga "Guida e Trashëgimisë Kulturore të Qarkut Vlorë"

Figura 8: Monumenti i Pavarësisë
Burimi: http://photos.ëikimapia.org/p/00/00/95/74/34_big.jpg

Monumentet e Kulturës[8]

Në qëndër të Vlorës janë shpallur monumente kulture të ndryshme. Duke filluar me Ansamblin Historik përgjatë qëndrës së Vlorës, me objektet e kultit, fortifikimet e banesat tradicionale.

[8] Marrë nga Kartelat e IMK-së, për secilën kategori, nga kartelat përkatëse.



Harta 2: Harta e Shpërndarjes së Monumenteve të Kulturës në Vlorë
Burimi: Bashkia Vlore

Objektet e Kultit

Përveç ndërtimeve të shekullit të XX, brënda qytetit të Vlorës janë prezente dhe objekte të ndryshme kulti të cilat janë shpallur monumente kulture. Ato mbartin në vete vlera të mëdha estetike, historike dhe kulturore. Të ezauruara janë tre objekte kulti, xhami, kishë, teqe.

"Zonat e Mbrojtura te trashegimise kulturore"

Zvërneci

Ndodhet në pjesën veri-lindore të Vlorës. Monumentet e mbrojtura të ndërtuar brënda këtij ishulli janë Manastri i Zvernecit dhe Kisha e Manastrit, të cilat mbartin vlera të mëdha historike, kulturore. Përveç monumenteve, Zvërneci është shpallur në tërësi si një zone e mbrojtur, ku spikat natyra e gjelbër, ndërtimet në brëndësi, si dhe qasja e këtij ishulli me ujit.

Manastiri i Zvernecit [9]

Në Zvërnec ndodhet Manastiri ne te cilin mund te gjejme gjithashtu Kishen e Shen Merise monument kulture bizantin e shek. XIV. Kjo kishe ndodhet ne ishullin piktoresk te Zvernecit ne lagunen e Nartes. Kjo kishe i takon shekullit te 31-te. Eshte e tipit kryq me kupole

[9] Marrë nga Kartelat e IMK-së

e nartes. Ne ambjentet e brendshme te saj ruhen fragmente te piktures murale e altari i gdhendur ne dru zbukuruar me motive me lule e kafshe. Vlere origjinale kishes i jep edhe hajati shtruare me plake guri e qe ne anen veriore merr drite nga shtate harqe te mbeshtetura ne kollona guri. Kisha eshte e restauruar dhe eshte monument kulture. Kisha e Shën Merisë sherben si vend lutjeje, bëhen ceremoni fetare ortodokse si dhe çdo vit kujtohet 15 gushti, ditelindja e Shën Merisë.

Kisha e Manastirit të Zvernecit

Kisha është e tipit: kryq i lirë me kupolë, me narteks dhe ekzonarteks e një hajat të hapur me kolonadë ne anën veriore. Pjesa e vjetër përbëhet nga naosi ne formë kryqi të lirë me narteks, ndërsa pjesa tjetër është shtuar më vonë. Narteksi është drejtkëndësh në plan, me brinjë më të gjatë nga veri-jug dhe me dritare të vogël në murin jugor. Ai ka në anën perëndimore portën e mbuluar me arkitrarë të rrafshët dhe dy dritare anash. Naosi ka planimetri në formën e kryqit me krahët lindorë dhe perëndimorë më të gjatë se ata veriorë dhe jugorë. Objekti ka konstruksion me mure mbajtës. Muri është ndërtuar me gurë zakonshëm duke patur edhe copa tullash. Si lidhës është llaci I gëlqeres. Kultura e perdorur ne këtë konstruksion është e tipit bizantin në të cilin janë përdorur dhe kolona cilindrike guri në arkaden e hajatit. Mbulesa është me cati me tjegull vendi.

Figura 9: Kisha e Manastirit të Zvërnecit

Burimi: IMK

Tragjas [10]

Gjurmet e vendbanimit te lashte jane shfaqur ne qytezen e sofes (SOFA),ku jane dukur edhe tuma Ilirie. Akoma dhe sot aty prane (tragjasit te vjeter) gjendet nje vend i qujtur maja e qytetes. Arkeologët kane datuar rrenojat e disa ndertimeve qysh nga shekulli i IV-VII para Krishtit.Ky fshat ka qene i njohur me disa emra si:Tregas, Dragjat, Tregasaj, Dragjiates. Ne antikitet ky vendbanim bënte pjesë ne qendrat e fortifikuara të gjirit te Vlorës dhe lidhej me Orikumin. U shkatërrua disa here nga pushtuesit Osmane e u rindërtua ne shekullin XVI, ku përmendet edhe kalaja e Gjon Boçarit. Kjo kala mesjetare përforcohet nga dy kulla gjashtëkëndore.Lartësia e mureve shkon ne 5,5 metra e gjerësia 1,25 metra.Ndërtimi i saj eshte i lidhur me fisin e Boçarëve. Themelues i hershëm përmendet Gjon Boçari,bashkëkohës i Skënderbeut.

[10] Informacion i përgjithshëm i marrë nga burime të ndryshme për Tragjasin

Figura 10: Pamje nga Tragjasi i vjetër (varr monumental)
Burimi: foto: I. Gjipali

Monumentet e Kulturës

Në njësitë administrative përbërëse të Bashkisë së Vlorës janë të shpallura monumente kultura: objekte të ndryshme kulti, banesa tradicionale, ndërtime inxhinierike, qytete antike. Ato i përkasin periudhave të ndryshme historike.

2.2 Sistemi Ujor

2.2.1 Trupat Ujor dhe Deti

Ujërat Nëntokësore. Bashkia Vlorë ka një numër të madh ujërash nëntokësore më një rendësi si natyrore ashtu edhe ekonomike. Ato përfshihen në basenin e ujërave nëntokësore kuaternare të Vjosës me një koeficent shfrytëzimi që varion nga 0.5-0.7; temperatura nga 14-18.7°C; pH varion nga 7.00-8.25. Ato janë burime karstike që gjenden përgjatë zonës bregdetare, dhe në brendësi të territorit të kësaj bashkie. Burimet e këtyre ujërave dalin në dy nivele; niveli i parë është ai afër zonave të banuara dhe niveli i dytë përfaqësohet nga burimet nëndetare. Burimet buzëdetare dhe nëndetare janë një lloj i veçantë i burime karstike. Në zonën e Nartë-Vjosës këto ujëra gjenden në thellësi të cekta kryesisht në thellësi nga 1m deri në 10 m. Në pjesën tjetër të Bashkisë (Xyherinë, Panaja, etj) ujërat nëntokësore gjenden edhe më thellë dhe janë burimi kryesor i ujit të pijshëm për pjesën më të madhe të fshatrave, pasi uji i rrjetit është mjaft i ndotur si pasojë e amortizimit shumëvjeçar të tij dhe si pasojë e mungesës së investimeve të rehabilitimit. Në Novoselë fortësia e këtyre ujërave rezulton Fp nga 15.01-15.43°gj; ndërsa përmbajtja në Ca rezulton e lartë në vlera nga 52.14-97.08mg/l. Tendenca e rrjedhjes së këtyre ujërave është drejt perëndimit në detin Adriatik. Mungesa e kanalizimeve të ujërave urbane dhe e mos trajtimit të tyre paraprak përbën një rrezik të madh për cilësinë e këtyre ujërave dhe përdorimin e tyre për ujë të pijshëm. Në përgjithësi rreziku i ndotjes përcaktohet si mesatar.



Harta 3- Harta Hidrografike

Ujërat Sipërfaqësore në këtë rajon përfaqësohet kryesisht nga lumi i Vjosës, i cili derdhet në detin Adriatik, veri të lagunës së Nartës. Kjo pasuri e madhe ujore sot po degradon sidomos në pjesën e saj që gjarpëron në këtë Bashki si pasojë e aktivitetit të kompanive të

inerteve por edhe si pasojë e ndotjeve (ujërave të zeza etj) që vijnë nga komunat dhe fshatrat (rreth 40 të tilla) përreth luginës së tij. Ndotja ka ndryshuar ekosistemin duke sjellë si pasojë më të dukshme, shfarosjen e rrapit lumor. Përveç ndotjes, përgjatë gjithë luginës së Vjosës po ndodh edhe shpyllëzimi masiv, tharja e rrapit lumor dhe gjuetia e paligjshme po çon drejt degradimit një prej pasurive më të rëndësishme ujore të Shqipërisë. Nga monitorimet e raportuara në raportin mjedisor 2014 të kryera në pesë pika(stacione) të ndryshme si Mifol, Carshovë, para derdhjes në det etj, të realizuara me një shpeshti prej më së paku tre herë në vit rezulton se NBO_5 është në vlera të ulta që variojnë nga 2-3mg/l me një tendencë në rritje në vite; vlerat NKO janë të ulta nga 3.5 deri në 6.8mg/l; fosfori total me vlera nga 0.014 deri 0.029 mg/l; përmbajtja me NO_2 rezulton në vlera shumë të ulta; për nga përmbajtja e NH_4 ky basen rezulton i cilësisë së dytë me vlera që shkojnë nga 0.049 deri 0.123mg/l; në përgjithësi gjendja e këtij baseni konsiderohet akoma e mirë por me tendenca rritjeje të ndotjes nga Carshova në grykë-derdhje në det. Një numër masash urgjente, përveç gjobitjes, duhen ndërmarrë për të parandaluar një katastrofe ekologjike. Lumi disa herë ka përmbytur zonat përreth duke shkaktuar dëme të mëdha në kompanitë e inerteve dhe në ekonomitë e vogla bujqësore. Këto masa duhet të sjellin parandalimin e hedhjes së mbeturinave, parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në luginën e lumit si dhe reduktimin e nxjerrjes së inerteve nga lugina e tij.

Lumi tjetër i rëndësishëm është edhe ai *Shushicës* apo siç njihet ndryshe lumi i *Vlorës*, i cili është një tributar i lumit Vjosa. Në pjesën e poshtme të rrjedhjes së këtij lumi, gërryerjet në shtratin e këtij lumi janë bërë një rrezik real për banorët që jetojnë në brigjet e tij. Kjo sjell pasoja kur bien reshje të shumta, lumi del nga shtrati duke përmbytur rrugën, por edhe shtëpitë pranë, duke prishur edhe tokat bujqësore me inertet që bart gjatë përmbytjeve. Gjithashtu të dy këta lumenj me ndotjen e tyre ndikojnë negativisht në pastërtinë e ujërave të detit në grykëderdhje. Kjo ndotje mund të sjellë pasoja negative edhe në ndotjen e ujërave të lagunave pranë.

Lagunat janë një tjetër trup ujor i rëndësishëm i kësaj bashkie dhe përfshin lagunën e madhe të Nartës, lagunën e vogël të Limopuas si dhe lagunën e Orikumit. Të trija këto Laguna janë mjaft të rëndësishme për zonën si nga pikëpamja turistike ashtu edhe ajo biologjike. Shumëllojshmëria biologjike e këtyre lagunave si dhe funksioni i tyre për folëzim të shpendëve i japin atyre një rëndësi të veçantë dhe mbrojtja e tyre bëhet një domosdoshmëri.

Laguna e Nartës përfaqëson një nga lagunat më të mëdha dhe të rëndësishme në Shqipëri me një sipërfaqe ujore rreth $42km^2$, me një thellësi që luhatet nga 0.70 m ne 1.50 m. Laguna ne jug dhe jugperëndim kufizohet nga kodrat piktoreske te Zvërnecit dhe në brendësi të saj gjenden dy ishuj. Në ishullin me sipërfaqe më të madhe ndodhet Manastiri i Zvërnecit. Ishulli i **Zvërnecit** është *monument natyre*, është një nga pasuritë më të mëdha të zonës. Ai është pjesë e lagunës së Nartës dhe ka një sipërfaqe prej 7 ha dhe karakterizohet nga një sipërfaqe e mbuluar me pyll halorësh. Ishulli tjetër është i zhveshur.

Zona e Nartës është konsideruar si një nga zonat lagunore me te rëndësishme ne Shqipëri duke u bazuar ne vlerat e larta te biodiversitetit dhe ne numrin e habitateve te gjetura atje. Ekosistemi natyror i Nartës karakterizohet nga një llojshmëri e pasur e habitateve si zona lagunore, delta e lumit Vjose, moçali kripor, dunat ranore, pyjet me pisha, ishulli i Zvërnecit. Lidhjet midis tipeve te ndryshëm te habitateve kane një rëndësi te madhe ekologjike. Në këndvështrimin ekologjik ato krijojnë shteg për migrimin. Laguna e Nartës mund të plotësojë kushtet e një Ramsar-i dhe merr edhe një rëndësi edhe më të madhe për Shqipërinë, duke iu shtuar edhe një zonë tjetër Ramsar.



Figura 11: Ishujt në Lagunën e Nartës(majtas); rezervuarë (djathtas)
Burime: Foto te Eksperteve

Të dyja këto laguna janë të rrezikuara si nga faktorë natyrorë por edhe nga ato njerëzorë që lidhen kryesisht me presionet që vinë në zonë nga turizmi dhe aktivitetet që lidhen me të dhe nga prania e industrisë së rëndë në afërsi të tyre. Mungesa e ujërave të ëmbël, mbushja e kanaleve lidhëse me detin, marrja e ujit nga kriporja, ndotja urbane dhe industriale si dhe gjuetia e vazhdueshme dhe pa kritere shkencore janë disa nga faktorët që duhen adresuar shpejt dhe në kohë nga autoritetet përgjegjëse për të shmangur katastrofën ekologjike. Menaxhimi shkencor duhet të prijë veprimtarinë që zhvillohen dhe që do të zhvillohen në të ardhmen në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Laguna e Orikumit-ndodhet midis Karaburunit dhe qytetit të Orikumit. Dallohet për shpendët dhe speciet e shumta të liqeneve detare, ku nga veprimtaritë ekonomike mund të veçojmë peshkimin

Ruajtja me fanatizëm tyre në të ardhmen do të ketë një ndikim pozitiv në cilësinë e turizmit në zonë.

Figura 12-Kanalet komunikuese midis detit dhe lagunës së Nartës
Burimi: Foto të ekspertëv

Faktorët ndotës për Lagunën e Nartës, që përbën dhe elementin më të rëndësishëm ekosistemit, janë kryesisht të lidhur me të shkuarën e industriale të zonës dhe me të tashmen e saj që lidhet kryesisht me keq shfrytëzimin dhe mungesën e menaxhimit të saj si dhe shkarkimet urbane të qytetit të Vlorës dhe të fshatrave përreth.Disa studime serioze të realizuara vite më parë kanë ngritur si mjaft të rëndësishëm problemin e eutrofikimit për Lagunën e Nartës, i cili shkaktohet kryesisht nga ujërat e reshjeve. Ky fenomen theksohet shumë gjatë periudhës së verës kur vëllimi i ujit në Lagunë bie shumë. Monitorimi i lagunës në mënyrë sistematike dhe shkencore në përgjithësi nuk realizohet.

Burimin më të rëndësishëm potencial të ndotjeve kimike për Lagunën e Nartës e përbën ish Uzina e Sodë-PVC, (*Vlerësimi i mërkurit dhe i metaleve të rënda në biota, sedimente dhe tokën e lagunave të Nartës dhe Orikumit Raporti teknik i monitorimit Lazo, Cullaj,Baraj*) që gjendet në afërsi të saj e cila në vitet 1967-1992 ka shkarkuar drejtpërdrejt në det mbeturina të lëngëta (rreth 500 m^3/orë) me përmbajtje të lartë mërkuri, rreth 1.1 mg/L me një total prej 64 ton. Uzina po ashtu pranë Lagunës ka shkarkuar një sasi shumë të madhe të mbeturinave të ngurta në një damp me sipërfaqe 25 ha. Studimet e kryera deri në vitet 2004 kanë referuar ndotje të konsiderueshme nga merkuri në sedimentet detare të marra në thellësi të ndryshme deri 700 m nga bregu. Këto vlera janë shumë më të larta sesa ato që janë raportuar për sedimentet e Adriatikut Jugor (0.020-0.120 mg/kg) dhe të krahasueshme e ato të brigjeve të ndotura të Adriatikut Verior (0.240m). Ndotja ka ndikuar edhe tek ujërat e Lagunës dhe në disa studime të specialistëve kanë treguar edhe gjurme të ndotjes tek disa lloje peshqish. Studimi i mësipërm thekson se ndikimi i sedimenteve do ndjehet edhe për disa dekada në rast se nuk ndërmerret një aksion për pastrimin e tyre.

Në korrik të vitit 2002, një mision i UNEP/MAP në kuadrin e Projektit GEF/ME/6030-00-08, gjatë vizitës monitoruese në Shqipëri e ka identifikuar këtë zonë si "hot spots"-"high risk" dhe

tani është duke u zhvilluar studimi para-investues *"Environment Remediation Project for Vlora Hot Spot in Albania"*. Mund të pritet që ndotjet e ujërave dhe sedimenteve në këtë zonë detare fare afër Lagunës së Nartës të kenë patur ndikimin e tyre edhe në Lagunë. Për më tepër, një pjesë e mbeturinave teknologjike të Uzinës në formën e shllameve janë shkarkuar brenda Lagunës së Nartës, në bregun jugor të saj. Për rreth 6 muaj janë shkarkuar mbeturinat e lëngëta të kollonës së distilimit të amoniakut të Fabrikës së Sodës së kalcinuar. Në janar 2013 *Eden Center dhe Arnika Association* përforcuan studimet për këtë "hot spot" në Vlorë dhe ringritën nevojën e domosdoshme për rehabilitim.

Mbeturinat urbane janë një burim tjetër ndotjeje sidomos ato të ujërave të zeza të vendbanimeve të reja përreth Lagunës. Gjithashtu, në afërsi të Lagunës ndodhet fusha e depozitimit të mbeturinave të ngurta urbane të qytetit të Vlorës.

Nga shumë studiues është vlerësuar se gjendja ekologjike e Lagunës së Nartës është kritike në lidhje me eutrofikimin e saj. Në një studim thuhet se "Laguna ka nisur rrugën e vdekjes". Kjo ka disa shkaqe veç atyre me karakter natyror, si - moskryerja e shërbimeve për mirëmbajtjen e kanaleve të komunikimit me detin; - mosrespektimi i rregullave të hapjes dhe mbylljes së dajlanit dhe mënyrave të peshkimit; - dhënia e lejeve të peshkimit pa kritere ose edhe peshkimi nga persona të palicencuar; - ndotjet urbane dhe bujqësore, kryesisht për shkak të urbanizimit të pakontrolluar të territoreve rreth Lagunës.

Gjatë funksionimit të fabrikës së birrës Norga, mbetjet e lëngshme të së cilës derdheshin në lagunë, ka ndikuar në përshpejtimin e eutrofikimit të lagunës, pasi mbetjet e lëngshme ishin me përmbajtje e lartë të lëndëve organike, të cilat nga ana e tyre konsumojnë oksigjenin etj.

Një tjetër faktor i rëndësishëm në zonë është edhe kriporja, e cila është ndërtuar në vitet 1958 dhe vazhdon edhe sot por me një kapacitet prodhimi të kripës që është reduktuar deri në 27000 t/vit. Në vitet 2000 teknologjia e kripores u përmirësua në saj të kontributeve të organizmave ndërkombëtare. Studimet e shumta për kriporen dhe lagunën si dhe për marrëdhënien midis tyre janë kontradiktore. Një pjesë e ekologjistëve argumentojnë që kriporja po ndikon negativisht në ekosistem duke e degraduar atë ndërsa një pjesë e specialistëve, inxhinierë të fushës, argumentojnë që në rast se kriporja plotëson disa kushte nuk sjell asnjë ndikim negativ në lagunë. Për këtë nevojiten një numër masash nga ana e kompanisë që menaxhon prodhimin e kripores siç janë si sigurimi i fondeve për të pajisur me të gjithë aksesorët e infrastrukturën përkatëse me një stacion pompash në det duke e bërë të pavarur sigurimin me ujë të kripores nga Laguna, shtrirjen e ujit nëpër vaskat e avullimit të kripës që kapin rreth 750 ha sipërfaqe gjatë fillimit e mbarimit të sezonit sjell një ndryshim thelbësor gjallërimin dhe popullimi të gjithë ambientit përreth kripores me një faunë të pasur. Gjithashtu duhet të realizohet edhe monitorimi i rregullt i veprimtarisë së kripores dhe siç e sugjerojnë edhe vetë specialistët e saj duhet që ky monitorim të përfshijë: Kontrollin e hapjes së kanalit të detit (dajlanin i peshkut) dhe sasinë e ujit që futet në Lagunë, të ndiqet sasia e ujit që futet nëpërmjet shandorëve (pragjeve prej dërrase)për në kripore, duke racionuar tërheqjen pa kriter, çdo ditë nga ujarët dhe pompistët, të kontrollohen për funksionimin e rrjetës së vendosur

për mos kalimin e rasateve të peshkut, të matet densitetet i shëllirave në Lagunë e veçanërisht në verë, kontroll nga specialistët për furnizimin me ujë të freskët deti, kontroll për futjen pa leje në territorin e kripores të personave për gjuetinë e paligjshme të zogjve, shpendëve apo peshkut si dhe mbajtja pastër e gjithë ambienteve të kripores në drejtim të hedhjes së mbeturinave e papastërtive nga zona përreth duke mos e ndotur atë.

Investimi i realizuar për TEC e Vlorës, gjendet në afërsi me zonën në studim, megjithëse akoma nuk është bërë efektiv për shkaqe teknologjike, paraqet një rrezik potencial për biodiversitetin dhe shëndetin publik në zonë me efektet që ai mund të sjellë. Këto efekte lidhen me zhurmat në mjedis, me emetimin e gazeve dhe grimcave PM_{10}, me shkarkimet në det të ujërave që ai do të marrë po nga deti, me ndikimet në temperaturën e ujit të detit në afërsi të shkarkimeve etj. Megjithëse Vlerësimi i Thelluar Mjedisor i realizuar për këtë vepër i përjashton këto ndikime për shkak se teknologjia e përdorur për ndërtimin dhe funksionimin e këtij TEC është mjaft e përparuar dhe ndikimet mbeten akoma hipotetike sidoqoftë nevojitet një kujdes, një kontroll i kujdesshëm dhe një monitorim i rregullt nga ana e autoriteteve përkatëse.

Incidentet e herëpasherëshme me derdhjet e sasive të karburanteve në det nga pakujdesia janë të lidhura me aktivitetin e Petroliferës që paraqet një tjetër rrezik të vazhdueshëm mbi këtë bregdet.



Harta 4- Harta Hidrogjeologjike

Rezervuarët e Ujërave të ëmbla që gjenden në fshatrat e Vlorës (si në Bestrovë, Zvërnec etj) kanë një rëndësi të dyfishtë për zonën. Së pari shërbejnë si i vetmi burim uji i ëmbël për faunën dhe së dyti edhe si burim uji për ujitje për tokat.

Këtu duhet theksua edhe dëmtimi i madh që ka pësuar sistemi ujitës dhe drenazhues i zonës si pasojë e dëmtimit nga ana e njerëzve por edhe nga amortizimi dhjetëra vjeçar i tyre.

Kullimi Vlora ka një sistem kullimi i cili është tepër i rëndësishëm për zonën duke vlerësuar dhe elemetin Lagunë. Ndërkohë ish njësitë administrative Qendër, Orikum, Novoselë janë të varur nga funksionimi i këtyre kanalizimeve për të patur akses në ujin për vaditje të tokës apo për të ruajtur kualitetin e saj.

Deti

Kjo Bashki laget në veri nga deti ***Adriatik*** dhe në jug edhe nga ai ***Jon***. Cilësia e ujërave, sipas raportit mjedisor 2014 në këto plazhe është monitoruar në katër pika të ndryshme duke filluar nga pylli i sodës, plazhi i hidrovorit, plazhi i vjetër, në plazhin e skelës dhe pranë ish shkollës së marinës dhe rezulton përmbajtja e NH_4 është në vlera të larta, vlerat e fosforit që tregojnë presionin e ujërave urbane rezultojnë të larta në stacionin e plazhit të hidrovorit;NBO_5 rezulton në dy prej stacionve mbi vlerat e lejuara (hidrovori dhe plazhi i vjetër); në përgjithsi tendenca e ndotjes është në rritje sidomos në pyllin e sodës.

Plazhi i Vlorës për vitin 2014 rezulton: 36 % të cilësisë së ujrave i përkasin kategorisë A; Cilësi shumë e mirë e ujrave; 18 % i përkasin kategorisë B; Cilësi e mirë; 9 % i përkasin kategorisë C - Cilësi e mjaftueshme dhe 36 % i përkasin kategorisë D - Cilësi shumë e keqe. Masa të menjëherëshme duhen marrë tek Plazhi i Vjetër(D), Plazhi i Vjetër zona e Kabinave(D), Shkolla e Marinës(D), Plazhi i Ri(D), ndërkohë zonat si Ish Vilat Blloku(A), Jonufer (A), Plazhi Paradise(A), Plazhi Lame Borshi(A,) Radhimë, Hotel Grand(B), Lokali Boja(C), Komplexi Orikum(B) kanë një cilësi më të mirë.

2.3 Sistem Natyror

2.3.1 Biodiversiteti, Fauna & Flora, Pyjet dhe Natyra

Biodiversiteti-Bashkia e Vlorës përfshin zona të rëndësishme natyrore siç është parku Kombëtar i Llogarasë, Parku kombëtar tokë/deti Sazan-Karaburun, Pejsazhi i mbrojtur Nartë-Vjosë, Rezervat Natyror i Menaxhuar i Karaburunit të cilat për vetë llojshmërinë, veçantinë e llojeve që ato strehojnë dhe sasinë e tyre të konsiderueshme, e bëjnë hapësirën e kësaj bashkie të një rendësie të vecantë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sistemi ligatinor Nartë-Vjosë me VKM Nr.680, datë 22.10.2004 është shpallur peizazh ujor/tokësor i mbrojtur, ndërsa më datë 28 tetor 2010 është shpallur Parku Kombëtar tokë/det që përfshin ishullin e Sazanit dhe gadishullin e Karaburunit, Rezervat Natyror i Menaxhuar "Karaburun" që është kategoria e IV e mbrojtjes me vendimin Rreg.MB nr. 1, datë 27.7.1977 dhe Parku Kombëtar Llogara kategoria e dytë e mbrojtjes shpallur me vendimi Nr. 289, datë 28.04.2010.

Ndër këto ZM dallohet siguristh laguna, kodrat e mbjella me ullinj dhe vreshta, dallohet bimësia tipike mesdhetare, pyjet me pisha, rezervuarët me ujë të ëmbël për ujitje, dunat, fushat

dhe lëndinat. Siguristht që kjo zonë mbart një numër të madh habitatesh natyrore të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo pasuri natyrore përbën një tërheqje turistike që do të ushtrojë një presion mbi të si pasojë e zhvillimit të saj.

Në habitatet detare dhe bregdetare, ne stadin mediolitoral, jane te pranishme, si ne ishullin e Sazanit edhe ne gadishullin e Karaburunit, biocenozat e dominuara nga Lithophyllum byssoides. Kjo alge e kuqe kalcike, lloj karakteristik i Mesdheut perëndimor dhe detit Adriatik, rritet pak mbi nivelin e detit, ne zgavra te vogla, korridore dhe pergjate faqeve shkembore. Në këtë zone ajo formon jastek te vegjel (masa gjysem sferike) dhe rralle formon breza, zakonisht te njohur si ''trotuar''. Një tjetër biocenoze e mediolitoralit është ajo e shpellave te mediolitoralit, te cilat jane te çara apo hyrje te shpellave qe jane pjeserisht jashte ujit. Biocenoze tjeter e rendesishme është ajo e shpellave gjysem te erreta, ku jeton korali i kuq (Coralium rubrum) dhe disa lloje sfungjeresh. Biocenoza e Koraligjenit gjendet ne substratet e forta, me alga te kuqe te kalcifikuara, gorgonie dhe briozoare. Kjo biocenoze është e zhvilluar me te mire ne anen perendimore te ishullit te Sazanit dhe gadishullit te Karaburunit.

Në ujërat e zonës Karaburun–Sazan është raportuar prania e breshkave te detit, delfineve, dhe fokës së Mesdheut, të cilat janë ndër llojet më të kërcenuara në shkalle globale.

Raporte të ndryshme shkencore theksojne se pergjate bregut perendimor te gadishullit te Karaburunit gjenden habitate mjaft te pershtatshme per foken e Mesdheut.

Kjo zone është edhe nje korridor i rendesishem per migrimin e breshkave te detit nga zonat e tyre te folezimit ne ishujt Greke ne detin Jon per ne bregdetin e Patokut ne pjesen shqiptare te detit Adriatik, e cila se fundmi është identifikuar si nje zone e rendesishme ushqimi per këtë lloj breshke.

Brigjet e Gadishullit te Karaburunit dhe ishullit te Sazanit karakterizohen nga nje shumellojshmeri peisazesh me shkembinj te pjerret e te pakalueshem, me shpella, hone, kepe, plazhe te vogla e gjire. Keto formacione terheqese behen edhe me interesante per syrin e vizitorit fale bimësisë se zhvilluar mire, e cila mbulon pothuaje te gjithe gadishullin qe nga maja e malit e deri ne breg.

Vlerat mjedisore, natyrore, kulturore, historike dhe arkeologjike, biodiversiteti dhe larmia e peisazheve e bejne këtë zone nje nga pikat me terheqese persa i takon turizmit. Topografia interesante nenujore, me shpella e mikro habitate shume te larmishem, si dhe prania e anijeve te mbytura, i japin zones me teper vlera turistike, veçanerisht per te apasionuarit pas sportit te zhytjes.

Larmia e madhe e formacioneve topografike me shkembinj te thepisur dhe te pakalueshem, kanione, shtigje e fushegropa ofron mundesi te mira qe perveç sporteve te ujit te zhvillohen edhe alpinizmi, shetitjet me kuaj apo sporteve te tjera.

Aneksi i kufizuar në zonen e Sazan-Karaburunit, kryesisht si pasojë e mungeses së rrugeve dhe bregut te thepisur shkëmbor, ka mbrojtur dhe ruajtur habitatet natyrore. Sidoqofte, ekzistojnë mundesite per nje akses te kontrolluar te turisteve dhe vizitoreve ne zone nepermjet shtigjeve qe kalojne nga zonat pyjore e kodrinore dhe/ose me varka ne plazhet dhe gjiret e

vegjel, ku ka mundesi ankorimi, si gjiri i Raguzes dhe gjiri i Shen Janit ne bregun lindor, dhe gjiri Bristanit, gjiri i Dafines dhe gjiri i Grames ne bregun perendimor te Karaburunit.

Studimet e shumta në zonën e Nartës e kanë renditur atë si zonën e dytë më të rëndësishme për shpendët e ujit në Shqipëri (Karavasta është zona më e rëndësishme) ku gjatë periudhës së dimrit strehohen një numër i madh i tyre.(më shumë se 23% e shpendëve të ujit). Për flamingot Phoenicopterus ruber roseus, rosen laramane Tadorna tadorna, rosën bishtgjele Anas acuta, rosën me katër sy Bucephala clangula, vraponjësin gushëbardhë Charadrius alexandrinus dhe gjelzën pikaloshe Pluvialis squatarola, Narta përbën vendin më të rëndësishëm të dimërimit në Shqipëri. Vlen të përmendet edhe prania e pelikanit kacurrel Pelecanus crispus (9%) dhe pulëbardhës së Audouinit Larus audouinii (100%), lloje këta të konsideruar si "Globalisht të Rrezikuar".

Ekosistemi natyror i Nartës shihet si një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë natyrore të Evropës dhe si një kompleks i rëndësisë ndërkombëtare. Për tri lloje, Narta kap më shumë se 1% të popullatës rajonale. Një e treta e llojeve (11 lloje) që i takon listës së "Gjitarëve Globalisht të Kërcënuar" (IUCN, 1996), tregon për rëndësinë jo vetëm kombëtare të zonës, por edhe për atë ndërkombëtare. *(Medwetcoast Raporti i Nartës, 2004).*

Kjo zonë shpesh për shkak të larmisë që ofron ka qenë dhe është një zonë objekt-studimi për mjaft kërkues, studiues, institucione shkencore dhe mësimore etj. Kjo tregon për rëndësinë e lartë në nivel lokal por edhe në nivel kombëtar si dhe për disa elementë të saj edhe në nivel ndërkombëtar.



Harta 5- Harta e Burimeve Natyrore

Figura 13: Llojet e bimësisë në Vlorë
Burime: Foto te Eksperteve

Të gjitha këto lloje përbëjnë një pasuri pasi një pjesë e tyre përdoren për qëllime mjekësore, industrinë ushqimore dhe si bimë dekorative. Një pjesë e tyre janë të rralla dhe rrezikohen të zhduken. Zona në studim përmban rreth 1400 lloje bimësh enëzore që përfaqësojnë rreth 42% të tërësisë së bimëve në Shqipëri.

Habitatet më të rëndësishme të saj mund t'i përmbledhim sipas karakteristikave në:

Habitatet ujore që përbëhen nga ana e tyre në subhabitate si ai i kënetës së përhershme, kënetës së përkohshme, kënetat me ujë të kripur, kanalet e ujitjes dhe të kullimit, rezervuarët e ujit të ëmbël; pyjet aluvionalë dhe pyjet e pishës; kodrat e ullinjve dhe vreshtave; dunat ranore; shtrati i lumenjve, toka dhe deti.

Në *kënetat e përkohshme* që dallohen nga lëvizjet e nivelit të kripësisë që është më i lartë në sezonin e thatë dhe më e ulët në atë të lagësht. Në këtë habitat mbizotërojnë lloje si Ranunculus spp, Callitriche truncata,Chara spp.,Tolypella spp., Chara canescens,

Chara galioides, Ruppia maritima, Zannichellia pedunculata, Suaeda maritima dhe Suaeda splendens. Nuk mungojnë dhe disa zona kullotjeje ku zhvillohen Scirpus spp. që zëvendësohen vende-vënde nga Phragmites communis.

Kënetat e përhershme në zonë janë laguna e Nartës, Kallëngës dhe e Orikumit ku gjenden *Zostera noltii* dhe *Ruppia cirrhosa* si dhe disa lloje algash janë llojet që kryesisht gjenden në fundin e tyre dhe përbëjnë biocenozën.

Në këtë habitat përfshihen kënetat ekripura si ajo e Nartës me një bimësi tipike që përballon kripësinë e lartë si Salicornia spp., Arthrocnemum spp., Salsola soda, Limonium spp por edhe lloje si Arthrocnemum fruticosum, A. perenne, A. glaucum, salicornia europea, Salsola soda, Juncus acutus, Juncus maritimus, Inula crithmoides, Limonium vulgare, Artemisia coerulescens, Halimione portucaloides etjkur niveli i kripësisë bie.

Në grupin e habitateve të *kanaleve të kullimit dhe ujitjes* si dhe ato të *rezervuarëve të ujit të ëmbël* gjenden tipe halo-higrofile si Phragmites australis, Typha angustifolia, Typha latifolia, Scirpus lacustris, Scirpus maritimus, etj, po ashtu janë dhe algat notuese si Lemna minor, Lemna minuta, Spyrodela polyrhiza etj. Habitatet e tyre janë të rëndësishme pasi përbëjnë të vetmin burim uji të ëmbël në zonë.

Fauna-Përveç bimësisë të përmendur më sipër në këtë zonë dhe që janë të lidhura me të gjendet një *faunë* e pasur rreth 747 lloje vertebrorë, si peshq, shpend, amfibë, reptilë, gjitarë, molusqe, insekte,ekinodermatë etj. Ndër invertebrorët dallojmë rreth 390 lloje molusqe, flutura, krustace dhe ekinodermatë. *Peshqit* më të njohur në këtë zonë janë ato të detit dhe të ujit të ëmbël ku dallojnë Ngjala (Anguilla anguilla), Koca (Sparus aurata), Levreku (Dicentrarchus labrax), Qefulli (Mugil cephalus), si dhe Aterina sp, Solea vulgaris, Liza aurata, Trachurus trachurus, Mullus barbatus etj.

Nga *shpendët* ku dallohen ato të llojit dimërues dhe folezues dhe janë në total rreth 192 lloje mund të përmendim Pelikani kaçurrel (Pelecanus crispus), Capka e madhe e bardhë (Egretta gazeta), Rosat e ndryshme (Anas sp.), Lejleku (Ciconia ciconia), Kredharakët e ndryshëm (Podiceps sp.), Skifterët e ndryshëm (Falco sp), Shqiponja (Halieetus albicilla), Thëllëza e fushës (Perdix perdix), Laraska e detit (Haematopus ostralegus), Pulëbardhat e ndryshme (Larus sp.), Dallëndyshet, Bilbilin, Laureshat, Korbin, Sorrat, Mëllenja (Turdus merula), Harabelat (Passer), etj.

Amfibët po ashtu janë të shumtë në numër dhe mund të përmendim Triturus sp., Bufo sp., Rana sp. Në total ka 9 lloje, ndërsa nga reptilët Caretta caretta, Coluber sp., Lacerta sp., Testudo hermani, Vipera ammodites, Elaphe sp., etj në total 26 lloje.

Gjitarët në këtë zonë janë të shumtë në numër rreth 32 lloje ku mbizotërojnë brejtësit dhe lakuriqët e natës, por mund të përmendim edhe gjitarët e rendit të Insectivora, Chiroptera, Carnivora, Cetacea etj.

Flora-Ishulli i *Sazanit,* i cili nuk është i banuar, është pjesë e *Parkut Kombëtar detar dhe tokësor* së bashku me Karaburunin dhe janë kategoria e dytë e zonave të mbrojtura. Ishulli i Sazanit është 4,8 km i gjatë dhe 2 km i gjerë me një sipërfaqe prej afro 5,7 km^2. Ai është i përbërë nga shkëmbinj gëlqerorë të periudhës së Kretakut dhe në anën lindore të tij me depozitime terrigjene. Klima e Sazanit është e butë, mesdhetare. Temperatura mesatare vjetore është 16,2 gradë Celsius. Mesatarja e janarit është 10°C dhe e korrikut 23,4^{o}C. Sasia mesatare e reshjeve është 715 mm në vit. Ai karakterizohet nga një biodiversitet i larmishëm. Në shpatet kodrinore të ishullit në lartësi të ndryshme janë të mbuluara nga shkurre të dendura të dominuara nga Quercus coccifera si dhe Murtus comminis, Fraxinus ornus etj. Në pjesën e brendshme të tij gjendet një brez vegjetacioni me ekspozim nga deti në lartësi 50-100 m i dominuar nga Euphorbia dendroides, Pistacia lentiscus etj. Në këtë bimësi gjenden edhe lloje të kërcënuara si Athamanta macedonia, Brassica oleracea, Capparis spicosa etj.Habitatet bregdetare dhe detare të ishullit dallohen në pjesën shkëmbore të bregut.

Brigje me rërë janë të ngushta dhe të pakta. Brezi më i ulët i habitateve bregdetare deri në lartësinë 5-6 m dominohet nga komuniteti ksero-halofitik Crimtho-Limonietea, ndërsa brezi i sipërm dominohet nga aleanca Capparo-Putorion Lov.

Kati Mediolitoral me dy biocenoza karakteristike:*Biocenoza e shkëmbinjve të mediolitoralit të poshtëm* me lloje karakteristike të Mesdheur perëndimor si Lithophyllum byssoides, e cila është një algë e kuqe që krijon pamjen e një "trotuari" në breg. Gjithashtu këtu dallojmë edhe biocenozën e shpellave të mediolitoralit.Kati Infralitoral karakterizohet nga *livadhet me Posidonia oceanica.* Prania e tyre dëshmon për pastërtinë e ujit të detit në këtë gji.

Gjithashtu pjesë e këtij kati janë edhe Biocenozat e algave të murme, e koraligjenit, që ka një substrat të fortë me alga të kuqe të kalcifikuara si gorgonie dhe briozoarë. Kjo biocenozë është e zhvilluar më mirë në pjesën perëndimore të ishullit. Këtu gjendet edhe alga Corallium rubrum, që është lloj i përfshirë në Aneks II të Konventës së Barcelonës, shfrytëzimi i së cilës është i kontrolluar. Së fundi, mund të përmendim *makrofaunën bentike* të zonës së Sazanit ku gjenden grupe të rëndësishëm të molusqeve, krustaceve dhe ekinodermatë.

2.3.2 Pyjet dhe Natyra

Natyra. Shqipëria jugperëndimore është një zonë e tradita vetë qëndrueshme, mjedis i natyror me nje bukuritë madhedhenjë histori të gjatë që daton që nga kohët parahistorike, e cila është edukshme për mes mbetjeve arkeologjike dhe monumenteve të epokavetë ndryshme. Ndër burimet e konsiderueshme natyrore të vendosura brenda Bashkisë së Vlorës do të përmendim, Gjirin e Vlorës, lagunën e Nartës, Zvërneci, lagunën e Orikut si dhe Parkun Kombëtar Karaburun-Sazan, parkun Kombëtar të Llogarasë etj.

Parku kombëtar i Llogarasë ka njw sipëfaqja aktuale prej 1010 ha.Kufijtë e dixhitalizuar përfshijnë:Në Veri: Kuota 487.0 m (43788304.59L/4455899.28V), ndjek Përroin e Bucelave, kuotën 1942.7 m, majën e Qores (2018.2 m) (4381428.53L/4454556.69V); në Lindje: Majën e Qores (2018.2 m) (4381428.53L/4454556.69V), ndjek rrugën këmbësore, qafën e Llogarasë (1025 m) (4380181.59L/4452708.39V); Në Jug: Qafën e Llogarasë (1025 m) (4380181.59L/4452708.39V), kuotën 1218.0m, majën e Thanasit (1352.8 m), rrugën këmbësore, kuotën 1415.o m, majën e Gjipalit (1446.0 m) (4477219.04L/4453829.80V); në Perëndim: Majën e Gjipalit (1446.0 m) (4477219.04L/4453829.80V), ndjek kurrizin, kuotën 487.0 m ((43788304.59L/4455899.28V). Rrugët me anë të të cilave shkohet në destinacion:është rruga utomobilistike Vlorë – Orikum-Dukat-Llogara(rruga nacionale Vlorë- Sarandë).

Zona ka biodiversitet të lartë dhe të rëndësishëm në Mesdhe: livadhe alpine e subalpine, pyll pishe (Pinus nigra) dhe rrobulli (Pinus leucodermis), bredhit të Maqedonisë (Abies borisii-regis), dushkut (Quercus coccifera), makie tipike mesdhetare, bimësi tipike e shkëmbinjve, etj. Është zonë me një florë e faunë shumë te pasur detare dhe tokesore. Zonë ku takohen lloje

endemike e subendemike si dhe shumë lloje tw rallw e te kërcënuar (Taxus bacata, Ceratonia siliqua etj.). Zonë me potenciale te mëdha per zhvillimin e turizmit dhe ekoturizmit.
Monumente natyre është Pisha flamur.

Gadishulli i Karaburunit që është RNM ka një sipërfaqe prej 20000 ha. Kufijtë e dixhitalizuar përfshijnë: Në Veri: Kepi i Gjuhëzës (43.0m)(4355080.46L/4477923.30V), vijion përgjatë vijës bregdetare të detit Adriatik deri në afërsi të Orikumit, kuota 64.0m, përroi i Gjimarës, ndjek rrugën këmbësore te Brinajt e fushës së Karaburunit, përgjatë rrugës automobilistike Orikum-Llogara, ndjek përroin e Dukatit dhe të Shatait, kuotën 487.0 m (4378403.59L/4607097.40V); Në Lindje: Kuotën 487m (4378403.59L/4607097.40V), ndjek kurrizin dhe rrugën këmbësore, maja Gjipalit (1446.0m) deri te qafa e Llogarasë (1025.0m)(4380181.59L/4452708.39V); Në Jug: Qafa e Llogarasë (1025.0m) (4380181.59L/4452708.39V), zbret përroin e Qerashës, vijon me kuotën 465.0 m, deri te pika e takimit me detin Jon (4379200.75L/4449719.59V); Në Perëndim: Deti Jon(4379200.75L/4449719.59V), vijon përgjatë vijës bregdetare derite Kepi i Gjuhëzës (43.0 m)(4355080.46L/4477923.30V).

Rrugët me anë të të cilave shkohet në destinacion është rruga tokësore Vlorë-Orikum-Pashaliman, ose rrugën detare.

Zona ka biodiversitet të lartë dhe të rëndësishëm në Mesdhe: livadhe alpine e subalpine, pyll pishe (Pinus nigra) dhe rrobulli (Pinus peuce, Pinus leucodermis), bredhit të Maqedonise (Abies borisii-regis), ilqes (Quercus coccifera), valanidhit (Q. macrolepis), makie tipike mesdhetare, bimësi tipike e shkëmbinjëve detare, ligatina dhe mbetje të pyjeve aluvionale, me katin litoral të shprehur mjaft mirë, me një bentos mjaft të zhvilluar, livadhe të gjërë të posidonies (Posidonia oceanica). Është zonë me një florë e faunë shumë të pasur detare dhe tokësore. Në ujrat detare takohen delfinet (Delphinus delphi dhe Tursiops truncatus), dhe mjaft lloje të tjerë të kërcënuar që mbrohen nga disa konventa. Ujrat detare të Karaburunit vizitohen nga foka e mesdheut (Monachus monachus), një nga llojet më të kërcënuar në botë. Kufiri verior i aleances OleoCeratinion; kufiri verior i qepës së detit. Zonë ku tokohen lloje endemike e subendemike si dhe shumë lloje të rrallë e të kërcënuar (Taxus bacata, Ceratonia siliqua etj.).

Si monumente natyre janë të shpallura:Shpella dhe Gjiri i Gramës : Rruga nëpërmjet të cilës mund të arrihet është Vlorë- Llogara-Gramë; Vlorë Delta e Palasës Gramë, dhe rrugës detare nga Vlora apo Dhërmiu; Shpella e Duk Gjonit : Rruga nëpërmjet të cilës mund të arrihet është Vlore-Pashaliman- Brisan-Ana e Detit; Shpella e Haxhi Alisë (Iliriane) : Rruga nëpërmjet të cilës mund të arrihet është rruga detare me anije dhe varkë nga porti i Vlorës, Qendra e Peshkimit Radhime dhe Moli i Jahteve Orikum, për në kepin e Gjuhëzës.konsiderohet si nje krah shkembor i gjate 16 km dhe i gjere 4 km. Brigjet veriore dhe perendimore jane rreth 14 km te gjata e shkojne nga Kepi i Karlovecit deri ne Kepin e Gjuhezes (perfshire nje baze ushtarake te braktisur) e me pas nga veri – veriperendim drejt jug – juglindjes tek kepi i Bristanit, ku ndodhet nje baze ushtarake aktive.

Shpatet e anës perëndimore janë vende – vende shumë të thepisura. Bregu perendimor i Karaburunit, shenuar nga kanione te thella (perrenj sezonal) qe rralle mbarojne me xhepa plazhesh ranore apo me guraleca, karakterizohet nga faqe shkembore vertikale e te larta qe shkojne deri ne thellesi te medha nen uje. Këta shkëmbinj janë mjaft të eroduar dhe në to mund të shihen një numër shpellash (shumica nën uje) ku shpesh rrjedhin burime me ujë të fresket. Pyjet e Valanidhit në Gadishullin e Karaburunit konsiderohen si pyjet më të ruajtura në Shqipëri. Shpatet kodrinore dhe habitatet e tjera të Gadishullit dhe ishullit karakterizohen nga nje diversitet i larte i tipeve te vegjetacionit.

Ishulli i Sazanit- ka një formë elipsoide me drejtim veri – veriperendim – jug – juglindje, me gjatësi rreth 4.8 km, gjeresi maksimale 2 km, dhe një siperfaqe totale prej 5.7 km^2. Pjesa perendimore karakterizohet nga shkembinj qe ngrihen vertikalisht mbi det te nderprere nga kanione te thella qe zgjerohen nga shpellat, kryesisht nenujore, ashtu siç verehen dhe ne Karaburun. Në anën lindore, bregu është me i ulet dhe ne pjesen jugperendimore formohet nga shtresa shkembinjsh gelqeror te pjerret qe zhyten ne det.

Ne këtë zone gjendet edhe laguna interesante e Orikumit, e vendosur ne brendesi te nje zone te ndaluar ushtarake. Ajo zë një sipërfaqe prej 130 ha, ka një thellësi maksimale prej 3 km dhe është ne komunikim te vazhdueshem me detin nepermjet nje kanali 50 m te gjate.

- **Laguna e Nartës**-me sipërfaqe 45 km^2 është liqeni i dytë detar për nga madhësia në Shqipëri. Veçori e saj është numri i madh i shpendëve dhe peshqve që jetojnë në të. Prej disa shekujsh këtu jeton edhe një koloni pelikanësh. Edhe sot në këtë lagunë ruhet tradita e peshkimit me varka druri. Në kodrat përreth peshkatarët nartiotë kanë treguar se janë kultivues të famshëm edhe të vreshtarisë, e cila prodhon verën e njohur të Nartës.
- **Zvërneci** është një nga zonat turistike të Vlorës. Këtu ndodhet Triporti një bukuri natyrore e paeksploruar nga vizitorët. Në vitet 1970 arkeologu Vasil Bereti kreu këtu disa fushata gërmimesh, ku dolën në dritë porti detar, disa mure rrethuese, disa ndërtesa, karkasën e një anijeje dhe qeramika të ndryshme.
- **Gjiri i Vlorës** është gjiri më i madh i bregdetit shqiptar, që nis që nga Kepi i Pllakës në Treport dhe vazhdon drejt jugut, duke krijuar formën e një krahu të hapur deri në gjirin e Shën Janit në veri të Karaburunit. Në hyrje të tij gjendet ishulli i Sazanit me një largësi prej 17 km nga qyteti i Vlorës. Gjiri i Vlorës ka një gjatësi prej 19 km, gjerësi prej 9.5 km dhe thellësi 54 m. Pjesa perëndimore e tij që shtrihet përgjatë gadishullit të Karaburunit përbëhet nga një bregdet shkëmbor ndërsa pjesa lindore përbëhet nga një bregdet i ulët ranor, I pasur me disa plazhe. Ujërat e Adriatikut që përbëjnë këtë gji arrijnë temperatura që variojnë nga 13°C në stinën e ftohtë të dimrit e deri në 25°C në muajt e nxehtë të verës, të cilat mundësojnë banjat detare dhe peshkimin pothuajse gjatë gjith vitit. Relievi përreth i mbart të gjitha format, duke nisur nga kurrizi i kodrave të Treportit, pasqyra e Lagunës së Nartës, Kodrat e

Zvërnecit, gropa e Vlorës, kodrat rreth saj, kalaja e Kaninës, mali i Shashicës, mali i Lungarës, Llogoraja, për të vazhduar më tej me Rrëzën e Kanalit, luginën e Dukatit, Karaburunin duke e mbyllur unazën në Sazan, pikën më perëndimore të Shqipërisë.

- **Laguna e Orikumit** dallohet për shpendët dhe speciet e shumta të liqeneve detare, ku nga veprimtaritë ekonomike mund të veçojmë peshkimin.
- **Mjedisi Natyrore** – Mjedi natyror i Bashkisë Vlorë është pjesë e një zone më të gjerë peizazhi bregdetar, i cili formon një vazhdimësi mjedisore. Plani i Menaxhimit të Integruar te Bregdetit (1995), identifikon pesë fusha ekologjikisht të ndjeshme, domethënë zonat me bukuri natyrore, vlera historike dhe kulturore dhe biodiversitet të pasur: Gadishulli i Karaburunit; Kanioni i Vunoit; Porto Palermo; Plazhi i Kakomes; Butrinti. Gadishulli i Karaburunit ndodhet brenda Bashkise së Vlorës, ndërsa të tjerët janë gjithashtu në afërsi. Strategjia e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit, e cila është miratuar nga Qeveria Shqiptare në vitin 1999 identifikon zonat ekologjikisht të ndjeshme. Kjo listë përfshinë të gjitha fushat e përmendura më lart, me përjashtim të Kanionit te Vunoit.

  Llogara- Orikum, Karaburun- Sazan- Radhime- Tragjas- Dukat (Vlora)
  Kanioni i Gjipese (Vlora)
  Porto Palermo (Vlora)
  Përroi i Borshit (Sarandë)
  Plazhi i Kakomes dhe Kepi i Qefalis (Sarandë)
  Kanali i Cukës – plazhi i Ksamilit dhe ishujt (Sarandë)
  Liqeni i Butrintit dhe rrethinat (Sarande dhe Delvinë)
  Pagane- Kepi i Stillos dhe ishujt (Sarandë)



Harta 5a- Parku Kombëtar detar Sazan-Karaburun. Burimi: Plani i Menaxhimit



Harta 2f- Harta e Zonave te mbrojtura natyrore dhe kulturore

Parku Kombëtar Detar Karaburun – Sazan. Me propozim të Ministrise së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, më datë 28 tetor 2010, Këshilli i Ministrave me vendimin Nr. 289, shpalli zonën Karaburun – Sazan si të parën zonë të mbrojtur detare (Park Detar) në Shqipëri. Ky park është kategoria e dytë mbrojtjes. PKD ka sipërfaqe 12428 ha. Mbulon zonën detare përgjatë vijës bregdetare të gadishullit të Karaburunit (Nis në kepin e Shën Vasilit deri në derdhjen e përroit të qerashesë) dhe ishullit të Sazanit, 1 milje detare (1852m) nga vija bregdetare. Parku Kombëtar Detar ndodhet në Qarkun e Vlorës dhe në rrethin e Vlorës. Sipërfaqja e përgjithshme e "Parkut Kombëtar" Karaburun-Sazan është e ndarë, si më poshtë:

Pjesa detare pranë gadishullit të Karaburunit ka sipërfaqe 9 848.95 (nëntë mijë e tetëqind e dyzet e tetë pikë nëntëdhjetë e pesë) ha, me kufijtë e e dixhitalizuar si mëposhtë:

a. Veri:Pika 1 (në det), me largësi 1 milje detare (1852m) nga kepi i Gjuhëzës, me koordinata 4353018.48 V e 4478005.72 L, deri te pika 2 (në det), me largësi 1 milje detare (1852m) nga kepi i Shën Vasilit, me koordinata 4363780.19 V e 4477378.71 L;

b. Lindje:Pika 2 (në det), me largësi 1 milje detare (1852m) nga kepi i Shën Vasilit, me koordinata 4363780.19 V e 4477378.71L dhe më pas vijon përgjatë vijës bregdetare nga kepi i Shën Vasilit, kepi i Dhim Kushtës, kepi dhe gjiri i Shën Janit, kepi i Gjuhëzës, ndjek vijën bregdetare perëndimore të malit të Karaburunit, bregun e Gjinarës, faqen e Bishtit të Malit, Rrëzën e Kanalit, faqen e Langadhës deri te pika 3, me koordinata 4379221.15 V e 4449696.28 L; Jug: Pika3, me koordinata 4379221.15 V e 4449696.28 L, deri te pika 4 (në det), me largësi 1 milje detare (1852m) nga faqja e Langadhës, me koordinata 4378104.94 e 4448193.75 L; Perëndim:Pika 4 (në det), me largësi 1 milje detare (1852m) nga faqja e Langadhës, me koordinata 4378104.94 e 4448193.75 L dhe ndjek izobatin deri te pika 1 (në det), me largësi 1 milje detare (1852m) nga kepi i Gjuhëzës, me koordinata 4353018.48 V e 4478005.72 L.

Pjesa detare pranë ishullit të Sazanit ka sipërfaqe 2 721.87 (dy mijë e shtatëqind e njëzet e një pikë tetëdhjetë e shtatë) ha, me kufijtë e mëposhtëm: Pika 1, me koordinata 4354004.14 V e 4487718.40 L; Pika 2, me koordinata 4355536.33 V e 4486707.03 L; Pika 3, me koordinata 4351587.21 V e 4485140.06 L; Pika 4, me koordinata 4357134.42 V e 4486668.09 L; Pika 5, me koordinata 4355142.57 V e 4486658.75 L

Rrugët me anë të të cilave shkohet në destinacion: duke ndjekur rrugën detare me anije apo varkë nga porti i Vlorës dhe nga Marina Orikum. Përfaqësuesit specifik të Florës dhe Faunës: Kjo zonë konsiderohet me larmi të pasur peizazhesh nënujore, habitatesh për rritjen e shumë organizmave bimore e shtazore nënujore, duke filluar me algat detare, sfungjerët, knidarët, molusqet, krustacet, lëkurëgjëmborët, koralin e kuq, reptilët, gjitarët, për Fokën e Mesdheut, dhe lloje globalisht të rrezikuara në shkallë kritike, si disa lloje peshqish, peshkaqenësh,

breshkash deti, delfinësh dhe Foka e Mesdheut (Monachus monachus). Karakteristik për këtë zonë jane edhe livadhet nënujore të posidonias(Posidonia oceanica), dhe shkëmbinjtë koralor. Në monumentet e natyrës mund të përmendim: Shpella dhe Gjiri i Gramës:Rruga nëpërmjet të cilës mund të arrihet është Vlorë-Llogara-Gramë; Vlorë – Delta e Palasës-Gramë; Shpella e Haxhi Alisë (Iliriane) : Rruga nëpërmjet të cilës mund të arrihet është rruga detare me anije dhe varkë nga porti i Vlorës, Qendra e Peshkimit Radhimë dhe Moli i Jahteve Orikum, për në kepin e Gjuhëzës; Barriera koraloree Grykës së Djallit:Rruga nëpërmjet të cilës mund të arrihet është rruga detare me anije apo varkë nga Vlora për në ishullin e Sazanit. Mund të vizitohet vetëm nga vizitorë të specializuar dhe zhytës, perderisa ndodhet brenda zonës qëndrore të parkut detar; Faleza e Sazanit: Rruga nëpërmjet të cilës mund të arrihet është rruga detare me anije nga porti i Vlorës për në ishullin e Sazanit.

Në zonën Sazan – Karaburun gjenden të paktën 36 lloje me interes ndërkombëtar të përfshira në listat e llojeve të rezikuara dhe/apo të mbrojtura të disa konventave. Këtu përfshihen bari i detit, sfungjeret, knidaret, molusqet, krustacet, ekinodermatet, peshqit, zvarraniket, fokat dhe cetacete. Ne zonen Sazan – Karaburun jane regjistruar rreth 75% e llojeve të rrezikuara të kafsheve detare në shkallë kombëtare, shumica makro – invertebrore te bentosit, te cilat jane perfshire ne Librin e Kuq të Faunës së Shqiperisë (2006) dhe në listën e Kuqe të Faunës Shqiptare (2007).

Pyjet- zënë një përqindje relativisht të vogël të territorit të bashkisë. Ka dy lloje tokash pyjore. Shumica e tokës pyjore është e pozicionuar në pjesën malore të Llogarasë dhe Shushicës. Pylli me pisha i Llogarasë i pozicionuar në pjesën e brendshme jugore është një nga peizazhet më karakteristike natyrore malore në mbarë vendin. Gjithashtu, pjesa e pyllit të Shushicë me pemët e lisit kontribuon në atraktivitetin e bregdetit të Jonit në Vlorës. Në pjesët kodrinore në veri dhe në lindje të qytetit të Vlorës pemët e lisit janë zëvendësuar me ullinj. Disa kanë mbetur vetëm disa segmente të vogla.

Një lloj i dytë i pyllit me pisha vihet re në tokën e sheshtë përgjatë bregdetit Adritatik (Pylli i Sodës), i cili vazhdon përgjatë bregdetit Adriatik në perëndim të lagunës deri në grykëderdhjen e lumit Vjosa. Një segment i vogël toke pyjore mbetet në ishullin e Sazanit.

Pyjet aluvionale janë një tjetër habitat i rëndësishëm që karakterizohet nga dy kate bimësie, kati i parë nga ai i kallamishteve që përfaqësohet nga klasa Phragmitetalia, si dhe shoqërohet nga Typha angustifolia, Lythrum salicaria, Polygonum hydropiper, Polygonum lapathifolium, Sium latifolium, Gratiola officinalis, Cladium mariscus, Alisma plantago-aquatica, Sparganum erectum etj dhe që gjenden kryesisht në dy anët e kanaleve ujitëse dhe lumenjve, ndërsa kati i dytë nga bimët e bregut të lumit si p.sh ato të klasës Alno-Populetea dhe Salicetea purpurea. Gjithashtu në disa vende gjenden shelgjet si Salix elaeagnos, Salix alba, Salix purpurea,etj.

Pyjet halore janë një habitat masiv në zonë të cilat mbulojnë rreth 1,200 ha,i cili është krijuar nga njeriu rreth 40 vite më parë nga mbjellja që është bërë më qëllim zvogëlimi e

fenomenit të erozionit duke stabilizuar vijën bregdetare. Llojet dominuese janë pishat si Pine sp. si p.sh Pinus maritima, P. pinea dhe P. Pinaster, si dhe nga shkurret mesdhetare me një lartësi jo më të madhe 2m si Pistacia lentiscus, Erica manipuliflora, Myrtus communis etj. Pranë plazhit të Zvërnecit gjendet edhe një brez me Agave americana.

Dunat ranore përbëjnë një tjetër habitat të rëndësishëm ku dunat ranore arrijnë deri në disa metra lartësi dhe ku bimësia mundon në rreth 30 metrat e para, në vazhdim gjenden lloje të Phanerogameve sikurse edhe Cakile maritima, Xanthium strumarium subsp. italicum, Salsola kali, lloji karakteristik i dunave si Ammophila arenaria subsp arundinaceae, etj.

Figura 14: Dunat ranore në Zvërnec
Burime: Foto te Eksperteve

Plazhet: Plazhet me rërë janë të pranishëm në bregdetin Adriatik duke shfaqur karakteristika të ndryshme në perëndim dhe në jug. Plazhi i vjetër i qytetit të Vlorës që ndodhet në perëndim të portit, ka një pamje veçanërisht tërheqëse mbi bregdetin e Jonit. Ai vazhdon të jetë një plazh natyror përgjatë pyjeve të Sodës deri në qëndrën industriale. Plazhi i Nartës dhe Zvërnecit shtrihet në të gjithë gjirin që ka një gjatësi prej rreth 3 km. Përgjatë bregdetit perëndimor ka tre plazhe të madhësive të ndryshme, dy gjire të brendshëm dhe një linear në veri që ndahet midis njësive administrative Qendër dhe Novoselë.

Përgjatë bregdetit Jon të Vlorës plazhet janë më të ngushta për shkak të relievit të pjerrët. Prania e elementeve turistike dhe argëtuese ka çuar në ndryshime të formës së bregdetit. Në segmentin e parë të bregdetit në brendësi të zonës urbane deri në Ujin e Ftohtë ku toka është ende e sheshtë, gjendet plazhi më i populluar turistik i qytetit. Pas tunelit ka një shtrirje të gjatë të bregdetit me karakteristika të ndryshme, me reliev më të pjerrët dhe ndryshime të bregdetit natyror dhe plazhe të vogla. Ndërsa i afrohesh gjirit të Orikumit relievi bëhet gradualisht më i qetë duke formuar plazhin e gjerë dhe të hapur të Orikumit.

Si qytet më i madh dhe nyje e transportit, Vlora shërbehet nga rrjete të ndryshme të infrastrukturës. Sistemi i infrastrukturës së bashkisë përbëhet nga rrjete të nivelit kombëtar dhe

rajonal të infrastrukturës, përkatësisht rrjeti kombëtar dhe rajonal i rrugëve, sistemi hekurudhor, portet dhe infrastruktura urbane, përkatësisht sistemi rrugor urban, furnizimi me ujë dhe rrjeti i kanalizimit. Pjesa më e madhe e sistemit të infrastrukturës është e përqendruar në qytet dhe periferi të zonës urbane të Vlorës.

Ishulli i Zvernecit paraqet një zonë të një rëndësie të vecantë si dhe një habitat të pasur me pyje (rreth 7 ha) të Selvisë (Cupressus sempervirens) që mbulojnë rreth 80-90% i shoqëruar me Quercus ilex, Quercus pubescens dhe Pinus spp., me një lartësi rreth 8-10 m. Gjithashtu në këtë ishull gjendet edhe një shtresë me shkurre si Myrtus communis, Pistacia lentiscus, Laurus nobilis, Rubus spp., Phillyrea angustifolia, Olea olaster, etj, dhe së fundi një shtresë bimësh barishtore e rrallë me lloje si Chrysopogon gryllus, Asparagus acutifolius, Dactylis glomerata, Desmazieria rigida etc.



Figura 15: Shtrirja e habitateve të ndryshme në Zonën Peisazh i Mbrojtur Vjosë-Nartë
Burime: Plani Menaxhimit i Zonës së Mbrojtur Nartës (Ministria Mjedisit)

2.3.3 Klima dhe Cilësia e Ajrit

Klima- kjo zonë ka një larmi mikroklimash. Klima e butë përbën një nga përparësitë më të mëdha të saj, pasi është e lidhur ngushtësisht me karakterin agro-turistik të zonës duke mundësuar shtrirjen në kohë të kësaj industrie të rëndësishme për ekonominë e zonës.



Figura 16: Harta me zonat dhe nënzonat klimatike e Shqipërisë
Burimi : Banka Boterore dhe UNDP, 2012

Temperaturat. Bashkia e Vlorës shtrihet në zonën e ultësirës bregdetare me karakteristikat e klimës Qendrore Mesdhetare ku dimri është në pjesën më të madhe të tij i butë, më një temperaturë minimale në muajin Janar (4,8 ^{o}C), ndërsa vera e nxehtë, e thatë me një temperaturë maksimale në muajt Korrik dhe Gusht (30 ^{o}C).

Tabela 10: Temperaturat në Bashkinë Vlorë (°C)

Maksimale	Minimale	Mesatare vjetore
30	4,8	15,4-16,3

Në grafikun e mëposhtëm tregohet se si ndryshojnë temperaturat mesatare në këtë Bashki.



Figura 17: Temperatura mesatare në Vlorë sipas 12 muajve të vitit
Burime: ËMO

Reshjet karakterizohen nga shirat dhe rrallë herë në formën e borës. Periudha me reshje më të shumta, që bien rreth 80% të reshjeve është ajo nga muaji Tetor deri në muajin Maj të vitit pasardhës dhe rreth 20% bien në pjesën tjetër të vitit, që kryesisht është vera e thatë. Grafiku në figurën e mëposhtme tregon reshjet gjatë gjithë vitit në këtë zonë.



Figura 18: Reshjet e mesatare në Vlorë sipas 12 muajve të vitit

Burime: ËMO

Tabela 11: Vlerat e lagështisë dhe rrezatimit diellor në Vlorë

Karakteristika	Vlera minimale	Vlera maksimale	Vlera mesatare/ Totali
Lagështia (%)	62	69	66
Rrezatimi diellor (kËh/m^2)	52,1	216,5	1540

Burime:Stacioni i Vlorës

Nga grafiku i mësipërm duket qartë se pjesa e thatë e vitit përkon me periudhën qershor-gusht ndërsa periudha më e lagësht korrespondon me stinën e vjeshtës dhe atë të dimrit me një maksimum në muajin e nëntorit. Këto karakteristika të rreshjeve e kategorizojnë bashkinë e Vlorës si një bashki me tipare të theksuara mesdhetare (shiko figurën 15: Harta e shpërndarjes vjetore të reshjeve).

Figura 19: Hartat e shpërndarjes vjetore të reshjeve dhe rajonizimi i rreshjeve në Shqipëri
Burimi: Instituti Meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

Erërat.Trëndafili i erërave në zonën e Vlorës paraqitet në figurën e mëposhtme për dy muajt kryesorë të vitit siç janë Janari dhe Qershori. Nga ky trëndafil kuptohet se gjatë periudhës së dimrit, sidomos në muajin Janar erërat fryjnë kryesisht në drejtim të Lindjes dhe Veri-Lindjes (L-VL) me një shpejtësi mesatare prej 3,5 m/s dhe gjatë verës në drejtimin Veri-Perëndimor dhe Perëndimor (VP-P) me një shpejtësi mesatare rreth 4,8 m/s. Erërat perëndimore karakterizohen nga briza bregdetare në stinën e verës.

Sipas Institutit Meterologjik Shqiptar në Bashkinë Vlorë sasia vjetore e orëve me erëra varion sipas zonave nga një vlerë minimale prej 1000 orësh deri në një vlerë maksimale prej 4500 orësh. Kjo sasi erërash në zonat me mesatare më të lartë mund të shfrytëzohet për ta shndërruar energjinë mekanike të erës në disa forma të tjera të energjisë dhe që mund të shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike, për mullinj etj. Kjo energji e rinovueshme dhe e pastër do të kursente sasi të mëdha të emetimit të CO_2 në atmosferë dhe do të zëvendësonte rolin e një pylli apo një sipërfaqeje ekuivalente të gjelbërt (shiko figurën, ***Shpërndarja territoriale e sasisë vjetore të orëve me erë***). Zonat me 4500 orë/vit mund të konsiderohen si zona të gradës së 1 deri 3 (nga 7 që është më e larta).

Figura 20: Trëndafili i drejtimit të erës në Bashkinë Vlorë(majtas dimër; L-VL: djathtas verë; VP-P)
Burime: Stacioni i Vlorës



Figura 21: (majtas)Shpërndarja territoriale e sasisë vjetore të orëve me erë; (djathtas) Harta territoriale e orëve me diell
Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

Ndikimi i Zhvillimit në Ndryshimet e Klimës

Konferenca e Parisit lidhur me ndryshimet klimaterike (Paris COP21-CMP11) e vuri theksin e saj në krijimin e kushteve për mosrritjen dhe kufizimin e temperaturës globale jo me më shumë se 2 gradë celsius. Në varësi të vlerave të faktorit klimaterik dhe të dhënave të siguruara nga studime të ndryshme lidhur me ecurinë në vite të këtyre vlerave mund të paraqiten disa skenarë për ndryshimet klimatike (modeli i ndjekur sipas MAGIÇ / SCENGEN; v. 5, 3, v 2).

Skenari bazuar në ecurinë e rritjes së **temperaturave mesatare,** jo vetëm në Shqipëri por edhe në mbarë globin, ndryshimet klimaterike të parashikuara do të sjellin një klimë më të ngrohtë në regjimin e temperaturës në zonat bregdetare shqiptare.

Skenari bazuar në rreshjet mesatare në rënie të regjistruara në stacione të ndryshme metereologjike tregojnë një rënie të reshjeve vjetore në lidhje me mesataren e regjistruar në vitin 1990 si dhe një rritje të përmbytjeve si pasojë e rreshjeve të vrullshme. Duke përgjithësuar rezultatet e tyre rezulton se sasia e reshjeve vjetore mund të ulen me 8,5% deri në 2050; dhe deri në 18,1% në 2100. Sigurisht që këto vlera do të sjellin ndryshime të konsiderueshme në

klimën globale dhe për pasojë dhe atë shqiptare. Kombinimi i ndryshimeve të faktorëve klimaterikë do të sjellë disa pasoja të cilat janë të lidhura me :

- Rritjen e temperaturave minimale ditore e shoqëruar kjo me thatësira të zgjatura;
- Ngrohjen dhe shkurtimin e kohëzgjatjes së sezoneve të ftohta e cila do të ulë nevojat për konsum energjie për përdorim ngrohje;
- Parashikohet një rritje e numrit të ditëve me temperaturë mbi 35°C dhe me shira të rrëmbyeshëm do të sjellë përmbytje të zonave të ulta, pranë lumenjve dhe në bregdet kjo e fundit si pasojë edhe rritjes së nivelit të detit.
- Gjithashtu ngrohja globale do sjellë rritjen e temperaturës së tokës duke modifikuar periudhat e rritjes së të mbjellave p.sh zgjatja e periudhës së rritjes së të mbjellave është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990 (shiko figurën 17 hartën e rritjes së temperaturës së tokës).
- Pavarësht se parashikimet na paralajmërojnë për rreshje të vrullshme dhe të shkurtra, sasia totale e rreshjeve parashikohet të reduktohet për pasojë burimet ujore do të reduktohen në njëkohë që kërkesa për uji do të rritet (shiko figurën 18 për hartën e .
- Ndryshimi i regjimit të rreshjeve do të sjellë ndryshime të cilësisë së ujrave në tërësi dhe atij të pijshëm në veçanti;
- Sektori i turizmit është i ekspozuar në mënyrë direkte dhe indirekte ndaj këtyre ndryshimeve si pasojë e rritjes së nivelit të detit dhe acidifikimit të ujit të deteve. Po ashtu këto ndryshimet do të ndikojnë në biodiversitet duke dëmtuar eko dhe agro turizmin. Kjo do të sjelli sfida të reja për këtë sektor.
- Zona e rrezikuar duhet të parashikojnë me kohë investime në infastrukturë për të përballuar ndryshimet.



Figura 22- Projektimi në përqindje i ndryshimit të indeksit të defiçitit ujor për 2030
Burimi: Banka Botërore

Cilësia dhe Pastërtia e Ajrit sot janë ndër faktorët kryesorë të shtimit të një numri të madh sëmundjesh të renda në popul;latë. Në Bashkinë Vlorë mund të thuhet se cilësia e ajrit është relativisht e kënaqshme. Bazuar në raportin mjedisor të vitit 2014 në qytetin e Vlorës, ku edhe parametrat mjedisorë janë më të kërcënuar se sa në zonat e tjera të bashkisë, rezultojnë në nivele brenda normës së BE dhe asaj kombëtare pothuaj për të gjithë elementët ndotës të ajrit. Kështu grimcat PM_{10} dhe $PM_{2.5}$ rezultojnë brenda normës BE prej (40μg/m^3 dhe 25 μg/m^3)dhe nuk ka as edhe një ditë tejkalim të kësaj norme.

Tabela 12:Tabela krahasuese 2914-2915 për PM

Stacionet	PM 10		PM 2.5	
Trendi 2 vjet	2014	2015	2014	2015
Vlorë	15.29	7.61	10.55	7.61
Standarti i BE	40		25	
Burimi: Ministria e Mjedisit				

Përqendrimet ditore të SO_2, përgjegjës për shirat acide, janë përsëri nën vlerën normë ditore të BE prej 125μg/m^{3}dhe nuk ka patur tejkalime as orare dhe as ditore. Po ashtu nivelet e NO_2 janë nën vlerën 40μg/m^3 të BE. Situatë të ngjashme paraqesin edhe gazet si O_3, CO, benzenet etj. Bazuar nga vlerat e marra në vite për qytetin e Vlorës trendi paraqitet dukshëm në rënie. Kjo vjen nga mungesa e një industrie të mirëfilltë, nga mosfunksionimi i TEC-it, nga mungesa e një trafiku rrugor të rënduar (me përjashtim të sezonit të verës) si dhe nga një intensitet më i ulët ndërtimesh në zonë në vitet e fundit. Pjesa tjetër e territorit të bashkisë nuk paraqet ndonjë problematikë të veçantë lidhur me ndotjen e ajrit.

Tabela 13: Monitorimi i ajrit 2014-2015

Ndotësit (μg/m^3)	SO_2		O_3		CO		NO_2		Benzen	
Trendi 2 vjet	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015
Vlorë	8.05	8.44	63.65	79.72	0.37	0.37	10.41	12.62	0.91	1.44
Standarti i BE	125		120		10		200		5	
Burimi: Ministria e Mjedisit										

2.4 Sistemi Bujqësor

2.4.1 Boniteti i Tokës

Bazuar në hartën e kategorive të tokave në Republikën e Shqipërisë hartuar nga Instituti i Studimit të tokave, në zonën e Bashkisë Vlorë gjenden pothuajse të gjitha tipet e tyre. *Brezi i tokave të kafenjta malore* shtrihet në pjesët më të ulëta të maleve, nganjëherë fillojnë nga 300m mbi nivelin e detit dhe shfaqen në lartësi deri në 1000-1300m mbi nivelin e detit, shtrihen si në brezin e shkurreve ashtu edhe të dushkut. *Brezi i tokave të kafenjta pyjore,* shtrihet në brezin e ahut dhe të pishës, në pjesën e mesit dhe të sipërme të luginave lumore, duke zënë lartësinë nga 700-1699m mbi nivelin e detit. *Brezi i tokave kullotë malore* që rrisin dhe zhvillojnë brezin bimor të kullotave alpine, zakonisht vendosen mbi 1500-1700m dhe ndodhet nën ndikimin e një klime të ftohtë dhe të ashpër malore, të brezit të ahut, karakteristikë për pllajat malore veriore. *Brezi i toka pyjore të kafenjta është një zonë* me toka që përmbajnë më pak fosfor krahasuar me elementët e tjerë dhe kryesisht përfaqësohet nga toka pyjore të kafenjta, të cilat janë formuar sidomos nga magma ultra-alkaline TIC e shkëmbinj sedimentarë. Në bazë të strukturës kimike, tokat e zakonshme të tokave kafe pyjore kanë reagim neutral me tendencë aciditeti (pH 5,8-6,0), shkallë të lartë të ngopjes me alkaline (90-95%), përmbajtje të lartë të humusit, azotit (humus 12 - 14%, azotit 1,08-0,48) e kalium.Tokat pyjore kafe të pangopura alkaline janë formuar nga formacionet rërore dhe argjilore. Ato kanë karakteristika të përbashkëta me tokat e zakonshme pyjore, por ndryshojnë prej tyre nga aciditeti, nga shkalla më e ulët e ngopjes me alkaline (20-25%) dhe nga përmbajtja në sasi më të vogël të humusit (6-7 %) dhe azotit (0.35 %).



Harta 6: Harta e kategorive të tokave në zonën në studim dhe më gjerë
Burimi: Instituti i Studimit të tokave, 1985.

Boniteti i Tokës. Sipas librit të bonitetit për tokën bujqësore të dhënat e të cilit janë marrë zyrtarisht nga DAMT, Qarku Vlorë, klasifikimi i kategorive të tokës bujqësore për bëhet sipas çdo njësie administrative:

Njësia administrative Novoselë është IV, VII, V përkatësisht për fshatrat N.B. Fitore, Akërni, Novosele; IV,V,VI për fshatrat Bishan,Poro, Delisuf.

Njësia administrative Qendër kategoritë e tokës bujqësore klasifikohen si vijon: Babicë e Madhe, Babicë e Vogël, Xhuherinë, Kaninë, Kërkovë, Zvërnec, Sherishtë, Panaja, Hoshtimë, K. B. Nartë, Bestrovë përkatësisht VI, VI, V, VI, VI, V, VI, VI, VI, VII.

Në Njësinë Administrative Orikum klasifikimi është: III, III, III për fshatrat: Orikum, Radhimë, Jonufer dhe VI, VI, Dukat dhe Tragjas. Studimi i bonitetit nga ku janë nxjerrë këto të dhëna është kryer në vitin 1984.



Harta 7- Harta e Bonitetit te Tokes

2.4.2 Ekonomia Bujqësore

Bujqësia- Bregdeti jugor i Shqiperise nga Adriatiku ne Jon eshte nje burim i madh ekonomik dhe mjedisor qe vendi ka, per perdorimin ne menyre strategjike dhe promovimin e zhvillimit ekonomik por ne perputhje me parimet e qendrueshmerise. Kjo e fundit nenkupton balancimin e prioriteteve ne nivel lokal dhe kombetar dhe midis nevojave te ndryshme dhe llojeve te aktiviteteve duhet theksuar se ekonomia e vendbanimeve të vogla në shkallë rajoni është në një masë të madhe ende rurale dhe e bazuar në prodhimin bujqësor dhe mbarështrimin e kafshëve. Kështu, nëse i referohemi njësisë administrative të Novoselës dhe asaj të Qëndër Vlorës, konsiderohen me nivel zhvillimi mbi mesataren për Qarkun e Vlorës. Ky nivel percaktohet nga resurset disponibel, nga pozicioni gjeografik dhe nga vete mentaliteti punetor i popullates. Ndër drejtimet kryesore të zhvillimit është edhe bujqësia. Këto janë zona me karakter tipik turistik por edhe të orientuara drejt prodhimeve lokale buqësore. Niveli relativisht i larte i prodhimeve bujqesore (kryesisht në frutikulture) ka sjellë nevojën e ngritjes së punishteve apo edhe fabrikave te perpunimit. Në këto njësi administrative janë ngritur disa fabrika të përpunimit te ullirit, prodhimit të vajit të ullirit, fabrika të prodhimit të lengjeve të frutave, e cila edhe pse tani për tani punon me lendë të parë të importuar, është një garanci për mbështëtje të zgjerimit të prodhimit të frutikulturës. Po ashtu mund të permenden shumë aktivitete prodhuese edhe të karakterit artizanal per prodhim lengjesh freskues të cilat kanë perspektiven të kthehen ne aktivitete te mirefillta industriale. Perpunimi i rrushit për prodhim e verës dhe rakisë ngelet ende në fazë artizanale dhe familiare. Ne krahasim me njësitë e tjera administrative të Bashkisë Vlore, njësia administrative e Novoselës, Qëndër Vlorës dhe Shishicë të cilat kanë fertilitetin më të lartë të tokës dhe kanë përkatësisht 185.000 rrënjë ulliri në Qendër, 42.380 rrënjë ulliri në Novoselë dhe 650,000 rrënjë ulliri në Shushicë. Pamvaresisht treguesve me te mire krahasimorë me Njësitë administrative të tjera, në njësinë administrative të Novoselës dhe Qëndër Vlorës rezervat janë dy apo tre herë më të mëdha.

Në funksion te rritjes së prodhimit bujqësor dhe në mbështëtje të tij, janë hedhur hapa në zhvillimin e agro-industrisë. Industria e përpunimit të produkteve bujqësore perfaqesohet nga fabrika të prodhimit te vajit te ullirit, ku deri tani janë tre të tilla, me teknologji dhe tregues bashkekohore. Fabrika e Skrofotines ka arritur te çertifikoje marken e vet te prodhimit, te marre pjese ne konkurse nderkombetare dhe të fitojë çmime për cilesinë e vajit të ullirit.

2.5 Sistemi Infrastrukturor

2.5.1 Menaxhimi i Mbetjeve dhe Infrastruktura Mjedisore

Mbetjet urbane Vlorë gjenerohen më shumë se 40000T/vit mbetje urbane dhe po aq afërsisht edhe mbetje inerte me një mesatare prej rreth 1.9kg mbetje/ditë/banor. Sot fusha e aviacionit mban afërsisht rreth 250 000m^3 mbetje. Pavarësisht studimeve të fizibilitetit për menaxhimin e mbetjeve gjendja mbetet problematike. Afërsia e pikës së grumbullimit të

mbetjeve me qytetin e Vlorës është një problem akut që lidhet ngushtë me cilësinë e ajrit në zonë, me shëndetin e popullatës dhe zhvillimin e bashkisë. Një zonë të nxehtë përbëjnë edhe mbetjet dhe ndotjet kimike në zonën e plazhit pranë ish Uzina e Sodë-PVC, (Vlerësimi i merkurit dhe metaleve të rënda në biota, sedimente dhe tokën e lagunave të Nartës dhe Orikumit Raporti teknik i monitorimit Lazo, Cullaj, Baraj), e cila në vitet 1967-1992 ka shkarkuar drejtpërdrejt në det mbeturina të lëngëta (rreth 500 m3/orë) me përmbajtje të lartë merkuri, rreth 1.1 mg/L me një total prej 64 ton. urizmit.

Qender Vlore Mbetjet urbane ne te ardhmen do te depozitohen ne landfilfin e Sherishtes. Ky landfild to te akomodoje dhe mbetjet e qytetit Vlore.

Panajaja: Gjendja e mbetjeve urbane edhe në këtë fshat është kaotike dhe mungon një infrastrukturë minimale. Mungesa e konteneirave per keto mbetje, e rëndon edhe më tej këtë gjendje. Natyra e bukur me një bimësi të pasur ku një pejzash të rrallë ofrojnë Eukaliptet në të dyja anët e rrugës së vjetër kombëtare. Ndërtimi i autostradës e ka lehtësuar zonën nga ndotja akustike dhe ambjentale e automjeteve.

Figura 23: Mbetjet në fshatin Kërkovë
Burimi: Foto te Eksperteve

Shushicë

Sasi mesatare e mbetjeve qe prodhon Shushica eshte 8 ton/dite. Per te gjithe fshatrat

Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithas, Mekat, Llakatund, Çeprat, Risili depozitimet shkojnë pergjate bregut te lumit. Grumbullimi i plehrave ne te ardhmen do te depozitohet ne landfildin e Sherishtes.

Novosele

Grumbullimi i mbetjeve per gjithe fshatrat e njësisë Novosele depozitohet afer Lumit Vjose. Novosela prodhon mbetje 15 ton/dite. Për momentin problemi i mbetjeve të ngurta është zgjidhur me një rrjet kazanësh për hedhje mbeturinash dhe largimin e tyre në zonën e minierës së vjetër të Mushqetas. Problem shqetësues janë edhe mbetjet ndërtimore. Për momentin pjesa e dherave të nxjerrë nga gërmimet është zgjidhur nga vetë firmat e ndërimit. Mbetjet industriale ne këtë njësi janë të pakta. Ne te ardhmen mbetjet do te depozitohen ne landfildin e Sherishtes.

Orikum

Mbetjet për njësinë administrative Orikum grumbullohen në hyrje të Dukatit. Sasia e mbetjeve të prodhuara eshte 9 ton në ditë.

2.5.2 Aksesi dhe Rrjeti i Transportit

Aksesi Ajror-Shërbimi i transportit ajror ne Jug te vendit sigurohet në mënyrë indirekte - kryesisht për turistët ndërkombëtarë së pari nëpërmjet aeroportit të Tiranës dhe së dyti nëpërmjet aeroportit të Korfuzit - Greqi. Aeroporti i Tiranës, duke qenë i vetmi aeroport ndërkombëtar në vend, është i vendosur në një distancë prej 145km (2h5m) nga Vlora, 215km (3h50m) nga Himara, 280 km (4h25m) nga Saranda dhe 310km (4h55m) nga Konispoli, dhe nuk konsiderohet i përshtatshëm siç duhet për të mbuluar nevojat e udhëtimit të flukseve turistike ndërkombëtare të jugut te Shqiperise.Me negocimin e marreveshjes ne fund te 2015 - fillim te 2016, qeveria shqiptare aktualisht është në gjendje të zhvillojë aeroportet e tjera te tipt "laë cost", si në Sarandë dhe Vlorë, për të cilat janë konsideruar alternativat e operimit ne vendet ekzistuese.

Studim i ngjashëm i fizibilitetit të aeroportit te Sarandës duhet bërë edhe për vende te jera kandidate, si aeroporti i Vlorës e cili është duke u shqyrtuar si alternativë e dytë për ti shërbyer jugut shqiptar. Mbas vleresimit dhe krahasimit te studimeve te fisbilittet do të merret vendimi i duhur perfundimtar per vendodhjen e nje aeroporti për sa kohe qe nuk ka asnjë te tille ne jug. Vendndodhja e aeroportit të ri në Vlorë konsiderohet më afër me zonën e Novoselës. Aeroporti i vjetër i Vlorë-s (fig. 105), i cili aktualisht është thuajse në zemër të qytetit, është pa rrjet te përshtatshëm rrugor dhe i rrethuar nga banesa informale.

Figura 24: Vendndodhja e aeroportit të Vlorës
Burimi: ICAO: LASR

Një aeroport ne Vlorë/ Novoselë do të promovojë zonën si një destinacion ndërkombëtar. Vlora është aktualisht qyteti i tretë më i madh dhe i dytë më i pasur në aspektin e të ardhurave mesatare të popullsisë në Shqipëri. Në qytet vazhdojnë të bëhën shumë ndërtime dhe po ashtu shumë projekte tashmë janë miratuar duke pasur si objektiv transformimin e Vlorës në një destinacion tërheqës turistik dhe bregdetin e saj në qendër referimi të të gjthë vendit.

Aksesi Hekurudhor

Vendi aktualisht është iaksesueshëm me tren vetëm në Novoselë dhe Vlorë dhe këto kanë stacionet të cilët operojnë në bazë të rrjetit hekurudhor shqiptar që i lidh ato me Durrësin (dhe Tiranën) dhe nëpërmjet transferimit me Librazhdin (dhe Pogradecin)

Tabela 36 tregon oraret e përditshmtë e trenave nga ku është e qartë se ka vetëm një tren që niset nga Vloranë 5:00 të mëngjesit për të arritur në Durrës në 9:45 paradite dhe po ashtu vetëm një tren në kthim nga Durrësi në 13:45 për të arritur në Vlorë në 18:16.

Ky orar lejon udhëtimin brenda ditës nga Vlora në Durrës, por jo anasjelltas nga Durrësi në Vlorë. Teknikisht grafiku orar lejon një udhëtim nga Vlora në Librazhd (duke lënë vetëm 75 min për aktivitetet lokale në Librazhd) para se të kthehet, por jo anasjelltas nga Librazhdi në Vlorë. Duke krahasuar të dy mënyrat treni merr 4:30 orë në vend të 2orë me makinë për udhëtimin mes të Vlorës dhe Durrësit. Shpejtësia e vogël e lëvizjes së trenave, shërbimi i rralluar dhe jo optimal, i shoqëruar me problemet të cilat kanë shkaktuar ndërprerje në funksionimin e segmenteve të caktuara shpjegojnë rëniennë numrin e udhëtarëve që përdorin këtë formë transporti siç shihet në tabelen 35. Prandaj hekurudhat shqiptare kanë hyrë në rrethin vicioz të shërbimit të keq për udhëtarët qe përdorin këtë transport qëdetyrojnë HSH të reduktojë më tej frekuencate lëvizjes sëmjeteve të transportit hekurudhor etj. Në mënyrë indicative stacioni i Vlorës në vitin 2001 kishte 78 pasagjerë çdo ditë, ndërsa në vitin 2015 numri qe ulur në 8.

Aksesi Detar

Vlora ka 2 porte te hapur ndërkombetar Petrolifera Italo-Shqiptare në Pyllin e Sodës për ngarkim shkarkimin e karburanteve dhe Porti Vlora sh.a. që është brenda qytetit. Ka po ashtu nje port peshkimi te vendosur ne veri te Pyllit te Sodes apo zona e njohur si Triporti. Ne Orikum ka dhe nje port turistik (Marine) per akomodimin dhe sherbimin e mjeteve turistike detare.

Porti i Vlorës sh.a. po zbatohet projekti per ndertimin e bankinave te reja me nje vlere 15mln Euro te financuar nga Kooperacioni Italian. Gjate vitit te kaluar ne kete port jane perpunuar 31 anije vendase dhe 3 te huaja me nje total 89,000 ton. Ka dy kompani qe ofrojne transport pasagjeresh drejt Italise "Gerveni Travel" dhe "Red Star". Keto kompani mundesojne dy udhetime ne dite per ne Brindizi. Gjate vitit 2015 numri total i pasagjereve ka qene rreth 105.000 duke shenuar dhe numrin me te madh te viteve te fundit dhe me nje rritje prej 30% krahasuar me vitin e meparshem.

Porti i Jahteve eshte i vetmi i ketij lloji ne gjithe bregdetin Shqiptar. Pervec tij gjate bregut te Vlores ka disa tentative per te krijuar mbrojtje artificiale per mjetet lundruese turistike por keto jane ilegale dhe pervec ankorimit nuk ofrojne asnje sherbim tjeter.

Infrastruktura Rrugore

Investimet në infrastrukturë japin një impakt pozitiv, si në përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve, në ofrimin e mundësive për biznes dhe punësim. Ato do të ndikojnë në rritjen e mundësive së Bashkisë Vlorë për të shtuar burimet e veta financiare me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve për banorët e saj dhe turistet.

Rrjeti i rrugëve kryesore. Vlora është në një distance 140 km nga Tirana dhe është e lidhur me rrjetin rrugor kombëtar nëpërmjet rrugës kombëtare Levan-Vlorë Sh8 dhe në Jug me rrugën e Bregut nëpërmjet Qafës së Llogarasë Sh8. Rruga transballkanike me gjatesi 2.5 km ,me status rrugë primare interurbane, e lidhur se fundmi me rrugën kombëtare Levan Vlorë jep mundesi per zhvillimin e potencialeve të portit dhe ka ulur efektin e mjeteve të rënda në trafikun e rrugëve të brendshme te qytetit. Kjo rrugë është në gjendje të mirë dhe i përket klasifikimit D. Po kështu edhe rruga kombëtare pas ujit të ftohtë Sh8 në Orikum dhe më pas në Llogara është në gjendje të mire. Ndërkohë po punohet për by-passin e Vlorës që lidh autostradën Levan – Vlorë Sh8 me rrugën nacionale bregdetare Vlorë-Sarandë, pjesa jugore e Vlorës. Gjatësia e këtij aksi është 29 km dhe fillon tek rrethrrotullimi në fund të rrugës Levan-Vlorë dhe shmang qytetitn duke kaluar në Veri të tij duke përfunduar në Orikum. Projekti është financim i BEI, BERZH dhe BE dhe shërben për të çliruar qytetin nga trafiku transit për në Jug

të vendit. Pervec zhbllokimit te trafikut sezonal në Vlorë, do te sjellë avantazhe të dukshme për shërbimet e emergjences pasi do të ketë rrugë paralele alternative për raste te tilla (aksidente, transport i lëndeve të rrezikshme etj).



Figura 25: Projekti By Pass, Vlora
Burimi: Ministria Transportit

Gjithashtu po përgatitet projekti "Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës", me financimin e Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik. Projekti do të kontribuojë në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe social të Rajonit të Vlorës nëpërmjet përmirësimit të shërbimit të transportit të udhëtarëve dhe mallrave që do të reduktojë kohën e udhëtimit dhe minimizojë koston e transportit, përveç ofrimit të sigurisë në trafik. Projekti përfshin punimet e rrugës kryesore ekzistuese 74-Km Vlorë-Peshkëpi-Qeparo, dhe zgjerimin e saj në një rrugë me dy drejtime, e gjërë 9m (3.75m gjerësi + 0.75m për çdo rrugë). Projekti përfshin edhe vepra të rehabilitimit për strukturat e kullimit, të sigurisë dhe të ndriçimit përveç vendkalimit të këmbësorëve që përshkojnë qytetet kryesore përgjatë rrugës, si dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme të konsulencës për skicim, dokumentet e tenderit, të projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve.

Një element i rëndesishem i ndërhyrjes urbane në zonen bregdetare të plazhit Skelë, është projekti në zbatim i Lungomares së Vlorës. Ky projekt ka për qëllim transformimin e qytetit të Vlorës në një qytet 'Mega beach' të stilit mediterranean të krahasuar me qytete të tjera mesdhetare si Barcelona etj. Projekti synon ndryshimin rrënjësor të standartit të qyteteve bregdetare shqiptare si dhe ngritjen e cilësisë së qytetit të Vlorës nga pikpamja arkitekturore, lejon shfrytëzimin e hapësirës prej 5 kilometrash të Vijës Bregdetare së Vlorës, dhe mundëson krijimin e hapësirave të gjelbërta, si dhe krijimin e vendeve të caktuara për parkimin e automjeteve.

Rrjeti i rrugëve dytësore Vlora ka rreth 193 rrugë dytësore në gjendje relativisht të mirë. Një pjesë e rrugëve dytësore sidomos ato që lidhen me bregun janë të rikonstruktuara dhe në

gjendje të mirë ndërsa pjesa tjetër që lidhet me pjesën malore janë nën ndërtim me fond të FSHZH.

Hirearkia e rrugëve brenda qytetit Vlorë

Karakterizohet nga: 1. rrugë lokale të tipit F brenda lagjeve, 2. rrugë sekondare urbane të tipit E, 3. rrugë primare ndërlidhëse urbane të tipit D
Rruga Demokracia është në gjendje të mirë dhe i përket klasifikimit D
Bulevardi 'Ismail Qemali' është në gjendje shumë të mirë dhe i perket klasifikimit D
SH8 deri te Uji i Ftohtë është në gjendje shumë të mirë dhe i perket klasifikimit D
Rruga Janaq Kilica-Atë Kristo Negovan është në gjendje të mirë dhe i perket klasifikimit D
Rruga e Paqes është në gjendje shumë të mirë dhe i perket klasifikimit D
Rruga Vasil Puka është në gjendje të mirë dhe i perket klasifikimit D
Rruga Transballkanike është në gjendje shumë të mirë dhe i perket klasifikimit D
Rruga 8 Marsi është në gjendje të mirë dhe i perket klasifikimit D
Rruga Ali Demi është në gjendje të mirë dhe i perket klasifikimit D
Rruga Kosova është në gjendje shumë të mirë dhe i perket klasifikimit D
Rruga e Unazes është në gjendje të keqe dhe i perket klasifikimit D
Rruga Hasan Kushta është në gjendje të mirë dhe i perket klasifikimit D
Bulevardi Princesha Rugine është në gjendje shumë të mire, i perket klasifikimit D
Rruga G. Kastrioti është në gjendje shumë të mirë dhe i perket klasifikimit E
Rruga Lef Salata është në gjendje të mirë dhe i perket klasifikimit E
Rruga Pelivan Leskaj-Sasani është në gjendje të keqe dhe i perket klasifikimit E
Rruga Shefit Zenaj është në gjendje të keqe dhe i perket klasifikimit E
Rruga Zigur Lelo është në gjendje të keqe dhe i perket klasifikimit E
Rruga Mitaq Salata është në gjendje të keqe dhe i perket klasifikimit E
Rruga Mustafa Bello është në gjendje shumë të mirë dhe i perket klasifikimit E
Rruga Riza Salati-Petrit Bisha është në gjendje shumë të mire, i perket klasifikimit E
Rruga Ramzie Gjebrea është në gjendje të keqe dhe i perket klasifikimit E
Rruga Gjergj Arianiti është në gjendje shumë të mirë dhe i perket klasifikimit E
Rruga Konomi është në gjendje të mirë dhe i perket klasifikimit E



Figura 26: Hirarkia e rrugëve Vlorë
Burimi: Harta I rrjetit rrugor egsistues 11c

Njësia Administrative Qendër Vlorë

Njësia administrative Qendër Vlorë aktualisht ka nje prezencë të pasur të rrjetit të infrastrukturës rrugore, (72,4 km gjatesi), por që fatkeqsisht, në pjesën më të madhe të saj është shumë e amortizuar, e demtuar dhe me parametra të ulët në dimensione, kanalizime, trotuare, ndricimin publik, kushte të tjera të shërbimit emergjent, etj. Këto kushte jo të mira fizike të infrastrukturës rrugore janë më tepër evidente në fshatrat e pjesës veri-lindore, lindore dhe jug-lindore të njësisë. Aty ku ndodhen edhe fshatrat më të thella në territorin e kësaj njësie administrative si në fshatrat: Kërkovë, Bestrovë, Hoshtimë, Sherishtë, etj.

Këto kushte vijnë, në një pjesë të tyre, si pasoje e mungeses së investimeve afatgjatë, pra jo domosdoshmeria për një akses të lartë në to, dhe në disa raste të tjera nga përdorimi i shpeshtë i tyre për aktivitete ekonomike të rënda (si gurore, përpunimi i inerteve, dhe akses i makinave me tonazh të lartë), dhe si pasoje mos mirembajtjes apo reabilitimit të tyre. Ndërsa në pjesën perendimore të ish komunës, për shkak të faktorit turizëm dhe afërsisë me bregdetin dhe zonat me atraksion kulturor, edhe infrastruktura rrugore është shumë më e pasur, e mirëmbajtur dhe e rinovuar vitet e fundit në shumë segmente të rëndësishme të saj. Të tilla janë: rikonstruktruksioni i rrugëve Nartë – Tec 1.6 km dhe Nartë – Zvërnec 4.6 km. Gjithashtu është bërë e mundur sistemimi i plazhit të Nartës si edhe ndërtimi i rrugës këmbësore për në Kalanë e Kaninës. Ato janë ndërtuar me parametra bashkëkohore dhe përfshijne kanalizimet, trotuare, ndriçim publik, etj.

Në Njësinë administrative Qendër mund të aksesohet në pjesën veriore të saj nëpërmjet: rrugës kombëtare ekzistuese (Tiranë -Vlorë) me dy korsi, nëpërmjet autostradës Fier-Vlorë me dy karexhata me nga dy korsi secila, e cila është ndërtuar sipas standarteve Europiane dhe ka një aksesueshmeri në fshatra të ndryshem të njësisë Qendër, sic është dalja nga autostrada për në fshatin Panaja që përbën zonën tregtare të njësisë në pjesën lindore, apo dhe dalje në zonën e kriporeve në pjesën perëndimore të njësisë, etj. Nga ky rrjet rrugor i sipërpermendur, mund të aksesohert në fshatrat që ndodhen në pjesën veriore-lindore të Njësisë, sic janë Panaja, Hoshtime dhe Bestrove, ne menyre te drejt-përdrejtë, mes rrugëve me një karexhatë me një korsi (4-5m gjeresi, variabel ne pika te ndryshme të fshatit).



Figura 27:. Harta ekzistuese e infrastruktures rrugore te Njësisë Qendër
Burimi: Harta I rrjetit rrugor egsistues 11c

Inventari dhe gjendja fizike e rrugëve në Njësinë Administrative Qendër

Fshatrat	Km rruge	E asfaltuar (km)	E paasfaltuar (km)
Kanine	22.5	10.0	12.5
Narte	8.2	3.2	5.0
Zvernec	9.7	1.0	8.7
Panaja	1.5	1.0	0.5
Oshtime	4	1.6	2.4
Kerkove	2.0	2.0	0.0
Bestrove	4.4	2.9	1.5
Babice e Vogel	3.6	2.0	1.6
Babice e Madhe	5.4	0.4	5.0
Xhyherine	8.1	2.0	6.1
Totali i rrjetit rrugor	72.4	26.1	46.3

Burimi: Ish Komuna Qender

Nga të dhënat rezulton se 46 % e rrugëve të njësisë janë të pasfaltuara ndërkohë që edhe pjesa e rrugëve të asfaltuara kanë nevoje për investime në mënyrë që të vijnë në standarde bashkëkohore dhe per mirembajtje preventive qe të sigurojne funksionim të vazhdueshëm.

Njësia Administrative Shushicë

Njësia administrative e Shushicës shtrihet në 51 km 2 siperfaqe nga te cilat 21 janë fushore dhe 30 janë kodrinore. 70% e popullesisë është e përqëndruar në fshatra cka do të thotë që popullsia rurale vendase është e koncentruar në qendrat rurale të urbanizuara. Rruga kryesore e qendrës administrative është e shtruar vetem 5 km ndërsa rreth 95 % e saj është e pashtruar dhe në kushte të vështira. Qendra shëndetësore e njesise administrative është në gjendje të rëndë. Transport urban publik brenda njesise administrtive Shushicë nuk ka, vetem kompani me minibus te licensuar nga bashkia operojnë nëpër fshatra. Aktiviteti tregtar është i dobët dhe zhvillohet nëpërmjet bulevardit nga qendra Shushicë në zgjatje horizontale deri në Llakatund qendër.

Shushicë Bulevardi i fshatit me gjatesi 650 m, me gjeresi 9 m (6,0 m asfalt dhe dy trotuare 2x1,5 m) është i asfaltuar por ka nevoje per rikonstruksion. Hyrja në Shushicë Qendër nga kthesa e Grabianit me gjatësi 600m e asfaltuar ka gjërësi 8,0m është në gjendje të mirë. Te dyja keto segmente perfshihen ne totalin e gjatësisë prej 4,5 km. Gjithashtu edhe rruga Shushicë Llakatund me gjatësi totale 4,5 km me gjërësi 6m e asfaltuar ka nevojë për rikonstruksion.

Sistemi rrugor për fshatrat **Bunavi Beshisht Grabian** është i pa strukturuar. Kudo ka rrugë hyrese të pashtruara. Edhe rrugët lidhese janë te pashtruara

Drithas Rruga kryesore prej 1 km që lidh Drithasin me qendër Shushicë është e asfaltuar ndersa pjeset e tjera te segmentit rrugor te fshatit drithas jane te paasfaltuara

Mekat, Çeprat Rruget përkatësisht Çeprat me gjatësi totale 2 km dhe Mekat me gjatësi totale 2,2 km gjërësi 4 m janë të paasfltuara, me cakëll, ne gjendje shumë të keqe. Ne gjendje të keqe është edhe rruga Kthesa Ceprat - Qender Ceprat 1.1 km

Llakatund Pjesa horizontale qe lidh Llakatundin me Shushicen rreth 0.5 km, eshte e asfaltuar. Ndërsa rrugët e brendshme të fshatit janë të paasfaltuara

Risili Vetëm segmenti Risili-Shushicë është në gjendje të mirë në kondicionin e rrugëve rurale ndërsa pjesa që nga Qafa E Kociut - Risili - Llakatund 8.3 km është e paasfaltuar.

Njësia Administrative Novoselë

Njësia administrative Novoselë klasifikohet ne njësitë me rrjet rrugor të gjërë dhe me gjendje teknike relativisht të kënaqshme kryesisht në anën perëndimore. Të gjithë fshatrat e njësisë lidhen me qendrën e njësisë me rrugë automobilistike të asfaltuara. Por mungesa e një sistemi të efektshëm të mirëmbajtjes së rrugëve përkeqëson më shumë situatën aktuale. Volumi në rritje i trafikut në rrugë është burimi kryesor i trafikut të renduar duke shkaktuar probleme ekonomike dhe mjedisore. Volumi i trafikut në stinën e verës përkeqëson më tej situatën për shkak të vërshimit të turistëve. Ndër të metat e sistemit rrugor të njësisë Novoselë është fakti se rrugët që të çojnë në bregdet janë të pasistemuara dhe në gjendje të keqe, gati të pakalueshme sidomos në stinët me reshje. Rruga kryesore e njësisë Novoselë që kalon përgjatë fshatrave Aliban Fitore deri në Bishan, Delisufi, Dellinjë etj ne total 12 km ka mungesë të sistemit të ndriçmit ndërsa Segmenti 7 Bunavi e Sipërme - Bestrovë 2.7 km është i paasfaltuar.

Mungon brenda njësise administrative transporti publik urban, vetem kompani me minibus te licensuar nga bashkia operojne nëpër fshatra.



Figura 28. Harta ekzistuese e infrastruktures rrugore te Novoseles
Burimi: Harta I rrjetit rrugor egsistues 11c

Mifoli Ka rrugë me gjërësi totale 6m (4 asfalt dhe bankinat 2 x1 m), ka qenë e shtruar me asfalt sot është në gjendje tërësisht të amortizuar, sa nuk shihet ekzistenca e asfaltit.

Karakteristikë për rrugët të cilat janë në krahun lindor të ish komunës Novoselë si **Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë** të cilat janë në krahun lindor të njësisë Novoselë rrugët me gjërësi 5.0 m (3,5m asfalt +2 x 0,75 bankinat anesore) janë në gjendje krejtesisht te amortizuar, jane te pamirembajtura në hyrjet e tyre, ndërsa në brendesi janë të paasfaltuara.

Akërni Rruga hyrese ne Akërniu me gjërësi 5.0 m (3,5m asfalt +2 x 0,75 bankinat anësore) është në gjendje është e pamirëmbajtur dhe krejtesisht e amortizuar. Gjatesia e rruges nga Novosela -Akerni-Poro 9.0 km. Gjatesia e rruges Fitore - Bishan _Poro -Delisuf 10,5 km

Njësia Administrative Orikum

Për njesinë administrative Orikum mund të thuhet se sistemi rrugor nuk është edhe aq problematik. Të gjitha fshatrat lidhen me rrugën nacionale me rrugë automobilistike. Rruga nacionale që përshkon zonën e Bashkisë Orikum nga Përroi i Vrizit deri në Qafën e Llogarasë ka pësuar disa herë rikonstruksion duke përmirësuar parametrat e saj. Gjithsesi, nevoja për rehabilitime ekziston, duke pasur parasysh edhe faktin që zona është turistike.Transport publik ne këtë njësi mungon, megjithese eshte teper i domosdoshem gjate sezonit turistik. Operohet ne fshatra me kompani te licensuara nga bashkia per sherbim transporti por ne orar te kufizuar. Ky problem eshte teper imprehete gjate periudhes se veres ku pushuesit nuk kane sherbim me kohe te gjate per transport.

Orikumi qender Rruga me dy korsi 7m dhe 8 m, korsi ndarëse 1m ne mes dhe dy trotuare me gjeresi qe varion deri ne 2m pra me një total trupi të rruges me gjeresi 20m është në gjendje të mire ka infrastrukturë shumë të mire.

Rruga Dukat Fshat 2.5 km me gjërësi 6 m (4,5 asfalt +2 x 1,5 m) dhe Dukat i Ri me bulevardin 10,5 m asfalt dhe trotuaret ne te dy krahet me gjeresi 3m rrugë kryesore janë në gjendje të mire. Shetitorja nga Bashkia në drejtim të bregdetit me gjerësi totale 14,1 m, ka të gjithë elementët e saj në gjendje të mirë (rrugën 8.5 m të asfaltuar, lulishten 0,6m dhe shetitoren 5m të gjërë)

Tragjas Rruga kryesore që të çon ne fashtin Tragjas është në gjendje të mirë ndërsa në Tragjasin e vjeter rruga nuk është në kushte të mira dhe e paasfaltuar.

Radhimë Ruga për në fshatin e vjeter te Radhimës është shumë e mirë, ndërsa në pjesën e poshtme, pra pjesa e rrugës nacionale ka nevojë mirëmbajtje dhe permiresimi kondicionesh.



Figura29:. Harta ekzistuese e infrastruktures rrugore te Njësisë Orikum
Burimi: Harta I rrjetit rrugor egsistues 11c

2.5.3 Energjia dhe Telekomunikacioni

Qyteti Vlorë

Qyteti aktualisht mbulon nevojat per energji nga:
Nenstacioni Vlora1 110/35/20/6kv;
Nenstacioni Vlora 2 110/20kv;
Nenstacioni Uji i Ftohte 35/6kv;
Nenstacioni Skele 35/6kv;
Dhe gjithashu per gjithe bashkine jane edhe nenstacionet Nenstacioni Smokthine 35.10kv; Nenstacioni Gorisht 35/6kv

Zona e studimit të jugut mbulohet kryesisht nga një njësi prodhimi: Vlorë për pjesën veriore (Vlorës deri në Borsh). Në shumë zona, rrjeti është i vjetër dhe akoma punon në kushte teknike antike me 35 Kv për tensionin e 'lartë' dhe 10 Kv për tensionin e 'mesëm'. Si rezultat, për pasojë të vjetërsisë së rrjetit dhe nënstacioneve, sistemi pëson humbje të mëdha.

Fuqizimi i nënstacionit 400/110 kV Zëmblak dhe zgjerimi i rrjetit 110 kV Babicë-Sarandë në zonën juglindore, gjithashtu ka mbyllur në unazë një pjesë të rrjetit ekzistues 110 kV. Në këto kushte krijohet mundësia e furnizimit të zonës Jugore, nëpërmjet fluksit të fuqisë që futet nga nënstacioni 400/110 kV i Zëmblakut. Për pasojë reduktohet fluksi i fuqisë që vjen nga linjat e largëta të rrjetit 220 kV, duke balancuar më mirë dhe vet unazën 220 kV të Jugut, që përbën një problem për sigurinë e furnizimit të një zonë të gjerë.

Ndërkohë në fazë po behet ndërtimi i dy n/st 110 kV në zonën e bregut të detit Jon: Orikum dhe Himarë.

Në Nënstacionin e Vlorës është në zbatim një projekt që transformon rrjetin e vjetër nga 35 në 110 kV. Zona turistike Vlorë - Sarandë do të sigurojë furnizimin me energji si pjesë e rrjetit 110/20 kV së shpejti. Linja 110/20 kV pjesërisht funksionon në qytetin e Vlorës që prej shumë vitesh dhe ka një diferencë të madhe në furnizimin me energji elektrike me zonat të cilat mbulohen akoma me 6 apo 10 kV. Ndërtimi dhe vënia në shfrytëzim apo gadishmëri të plotë të TEC-it në Vlorë, do të rriste sigurinë në furnizimin me energji.Përfundimisht ka shumë stacione hidrocentralesh në rajon të cilët kontribuojnë në furnizimin me energji të linjave lokale. Të tilla sot janë katër në territorin e Bashkise Vlore. Termocentrali i Vlores i ndertuar ne vitin 2009 me nje fond prej 96.6mln Euro me financim te BE, BERZH dhe BEI eshte ne pronesie te KESH. Per momentin nuk eshte ne pune pas nje defekti ne zonen e ftohjes.

TEC eshte i ndertuar prej nje blloku 98 MË me cikel te kombinuar te energjise elktrike dhe perbehet nga turbina me gaz 68MË dhe turbina me avull 30MË dhe gjeneratori i avullit te

tejnxehur. Ka mundesi zgjerimi per dy blloqe te tjera te te njetes fuqi duke arritur nje fuqi totale te instaluar deri 291MË. TEC-i mund te funksionoje me dy lloje lendesh djegese:

1 me nafte diezel nr2 me fuqi kalorifike te ulet ne masen 42612 kj/kg;

2 me gaz natyror me fuqi kalorifike te ulet ne masen 34534kj/m3

Zhvillimi i projektit TAP dhe perfundimi ne nje kohe sa me te shpejte i tij eshte nje mundesi edhe per venien ne pune te TEC-it.

Figura 30: TEC Vlore
Burimi: Foto te Eksperteve

Edhe gjatë vitit 2015 nuk është prodhuar energji elektrike nga TEC Vlora. Ky TEC ishte parashikuar të vihej në punë gjatë vitit 2011, por për shkak të problemeve teknike të konstatuara gjatë testimeve ende nuk është mundësuar vënia në punë e TEC-Vlora.

KESH sh.a dhe kontraktori i ndërtimit të TEC-it janë në proçes gjyqesor për zgjidhjen e kundërshtive lidhur me defektin në sistemin e ftohjes dhe mbylljen e njëanshme të kontratës nga TCM(nga kompania e kontraktuar) që në vitin 2012. Pritet qe një kompani e specializuar konsulence të përfundojë projektin e riparimit të defektit në sistemin e ftohjes në TEC Vlora.Mendohet nga KESH që të përgatitet një studim pre-fisibiliteti ku do të analizohet në mënyrë krahasuese kosto e përdorimit të gazit natyror në prodhimin e energjisë elektrike nga TEC Vlora.

3. OBJEKIVAT KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM - PËRFSHIRJA E OBJEKTIVAVE NË PLAN

3.1 HYRJA

Hartimi i objektivave të VSM mundëson realizimin e një Plani që garanton një zhvillim të qëndrueshëm. Ecuria e procesit të VSM paralelisht me etapat e hartimit të Planit siguron një bashkëpunim frytdhnës midis këtyre instrumentave në drejtim të ruajtjes së parametrave mjedisorë të zonës në studim si dhe atyre të shëndetit publik. Këto objektiva hartohen në përputhje me ligjshmërinë kombëtare dhe ndërkombëtare duke mbajtur parasysh direktivat evropiane, konventat ndërkombëtare dhe dokumenta të tjera të rëndësishëm. Ligjet shqiptare dhe direktivat e ndryshme evropiane lidhur nga njëra anë me tokën, biodiversitetin, pyjet, ujin e pijshëm, detin, lumenjtë, liqenet, rezervuarët dhe nga ana tjetër ato për shëndetin publik kanë shërbyer si orientuese në hartimin e këtyre objektivave, meqenëse Shqipëria aspiron për të qenë anëtare e BE-së dhe të gjitha zhvillimet kombëtare dhe strategjitë mjedisore si dhe legjislacioni përkatës, janë të orientuar në drejtim të harmonizimit me politikat evropiane. Duke patur parasysh edhe rendësin ekologjike të zonës në studim(një numër të madh monumentesh natyrore dhe zonash të mbrojtura të kategorisë së II, III, IV dhe V) si dhe ndjeshmërinë e popullatës lidhur me ruajtjen e mjedisit janë marrë paasysh në radhë të parë ligji 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", ligji 10440/2011 për "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" ligji 10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" , ligjit Nr.107/2014 për "Planifikimin dhe zhvillimin e territorit"si dhe një numër ligjesh dhe rregulloresh të tjera të rëndësishme.

Gjithashtu dokumentet e strategjisë kombëtare kanë shërbyer si orientuese për përcaktimin e afateve kohore dhe të vlerave kufi të ndotësve të ndryshëm. Të gjitha së bashkë janë marrë në konsideratë për hartimin e objektivave dhe në vlerësimin e Planit të Bashkisë së Vlorës.

Seksioni 3.4, përmbledh disa nga këto objektiva. Bashkëveprimi i përmbledhjes së objektivave me objektivat e VSM është paraqitur në seksionin 3.5.

3.1 Objektivat Ndërkombëtare dhe të BE-se për Zhvillimin e Qëndrueshëm

3.1.1 Politikat Ndërkombëtare

Shqipëria është një anëtare e organizatave ndërkombëtare dhe merr pjesë në konferenca dhe aktivitete shumëpaleshe të cilat synojnë të përmirësojnë trajtimin e mjedisit dhe gjendjen ne

nivel global te tij. Objektivat kryesore që Shqipëria kërkon të arrijë në këtë nivel janë Objektivat e Zhvillimit të Mjëvjeçarit (OZHM), të pranuara nga përfaqësuesit e 189 vendeve në Konferencën e OKB-së të vitit 2000, dhe synimeve të përcaktuara në Samitin Botëror të vitit 2002 për Zhvillim të Qëndrueshëm (SBZHQ) në Johanesburg. Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Johanesburg, 2002) ishte kulmi i një serie konferencash, duke përfshirë Konferencën e Stokholmit mbi Mjedisin në vitin 1972 dhe Konferencën e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin në vitin 1992 - e cila paraqiti parimin e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Takimi i parë ngriti shqetësimet e kanalizimeve, ku u vendos të merren masa për të siguruar që deri në vitin 2015 kjo mungesë e rëndësishme te jete reduktuar në 50% të niveleve aktuale. Angazhimi i dytë ishte që të ndërmerren masa për të rritur rezervat e peshkut në oqeane deri në vitin 2015, ndërsa një rrjet global për mbrojtjen e zonave bregdetare duhet të jetë ngritur tre vjet më parë. Nuk kishte vendime të tjera te detyrueshme që kanë të bëjnë me çeshtje të tjera (demografike, varfërisë, mbi-shfrytëzimit të burimeve, të klimës, shpyllëzimi, ozonit, ujit, specieve të rrezikuara, erozionit të tokës dhe zvogëlimit të burimeve detare).

Tabela 15: Përmbledhje e objektivave te zhvillimit te qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar	
INT-1	**Reduktimi i rrezikut për shëndetin publik**
INT-2	**Promovimin e barazisë sociale dhe te mirëqenies**
INT-3	**Promovimin e mjedisit te qëndrueshëm**
INT-4	**Përmirësimin e trajtimit te mbetjeve te ndotura ujore**
INT-5	**Mbrojtje, rritjen dhe rruajtjen mjedisit detar dhe zonës bregdetare**

3.1.2 Politikat në Nivel Evropian

Politika mjedisore e BE-së është udhëhequr nga parimi i parandalimit dhe parimi i "pagesës së ndotjes", nëpërmjet ngritjes së shumë institucioneve dhe instrumenteve menaxhuese dhe financiare për të siguruar zbatimin efektiv të saj. Pjesëmarrja qytetare është gjithashtu një element kyç dhe një prioritet i kësaj politike.

1. Strategjia për ndotjen e ajrit saktëson objektiva afat-gjata specifike, duke synuar reduktimin në vitin 2020 (në krahasim me nivelin e vitit 2000):

- me 47% zvogëlimin e koeficientit të ndikimit në jetëgjatësi, shkaktuar nga ekspozimi ndaj grimcave;
- me 10% shkaqet e vdekjeve akute nga efekti i ozonit;
- tepricat e depozitave acide me 74% në zonat pyjore dhe me 39% në ujërat sipërfaqësore;
- me 43% zonat ku eutrofikimi shkaktohet ne ekosistem.

Realizimi i këtyre objektivave kërkon një reduktim të emetimeve te SO_2 me 82%, NO_x (oksidet e azotit) me 60%, VOCs (përbërësit organike të avullueshme) me 51%, Amonian me 27% dhe PM2,5 parësor (grimca të emetuara direkt në ajër) me 59%, në krahasim me normat e vitit 2000.

2.Strategjia për parandalimin dhe riciklimin e mbeturinave, ka për qëllim për të reduktuar ndikimin negativ mjedisor të mbeturinave gjatë ciklit të tyre jetësor, nga prodhimi i tyre në mbetje përfundimtare, nëpërmjet riciklimit. Kjo qasje lejon trajtimin e çdo lloj mbeturine jo vetëm si një burim i ndotjes e cila duhet të reduktohet, por edhe si një burim potencial për shfrytëzim. Objektivat e Komunitetit Evropian (vendosur përpara miratimit të kësaj strategjie) për zvogëlimin e mbeturinave, promovon ripërdorimin, riciklimin dhe rigjenerimin. Theks i veçantë është vendosur në mbeturinat bio-degraduese, dy të tretat e të cilave duhet t'i nënshtrohen formave të tjera të trajtimit, përveç vendgrumbullimeve në përputhje me Direktivën 1999/31/KE. Strategjia parashikon veçanërisht dhënien e udhëzimeve përkatëse nga Komisioni, miratimin e strategjive të menaxhimit nga ana e shteteve anëtare dhe përfshirjen e kësaj çështjeje në rishikimin e Direktivës se IPPC dhe Direktivën për përdorimin e llumrave të zeza në bujqësi.

3. Strategjia për mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar është përshkruar në Direktivën 2008/56/KE. Direktiva përcakton objektiva të përbashkëta mbi bazën e të cilave shtetet anëtare duhet të formulojnë strategjitë e tyre në bashkëpunim me shtetet e tjera anëtare dhe vendeve te treta, në mënyrë që të arrihet një nivel i mirë ekologjike i ujërave detare nën juridiksionin e tyre. Për të arritur këto objektiva, shtetet anëtare duhet të bëjnë një vlerësim të gjendjes ekologjike të ujërave detare dhe ndikimin e veprimtarive njerëzore, duke përfshirë:

- analizat e karakteristikave baze te ujit (karakteristikat natyrore dhe kimike, tipet e habitateve, speciet e faunës dhe florës, etj);
- Analiza e ndikimit të aktiviteteve të njeriut mbi karakteristikat e ujit (ndotjen nga produktet toksike, eutrofikimit, fragmentimi i habitateve të shkaktuara nga ndërtimet, futja e llojeve jo-natyrore, dëmet e shkaktuara nga spirancat e anijeve, etj)
- Analizat ekonomike dhe sociale te ujit te përdorur, dhe analiza e kostos se degradimit te mjedisit detar.

→ Në bazë të këtij vlerësimi, shtetet anëtare duhet të identifikojnë "status të mirë ekologjik" te ujërave detare (p.sh. duke marrë parasysh shumëllojshmërinë biologjike, praninë e llojeve jo-autoktone te specieve, statusin shëndetësor te rezervave, eutrofikimin, përqendrimet e ndotësve, etj) dhe të vendosin objektivat dhe treguesit për të arritur këtë status. Këto objektiva duhet të jenë të matshme, në përputhje dhe te shoqëruara me afatet e zbatimi. Një program i masave konkrete për

të arritur këto objektiva duhet pastaj të formulohet, duke marrë veçanërisht parasysh ndikimet socio-ekonomike te çdo masë te propozuar (nëpërmjet studimeve VNM dhe me analizat e kostos / përfitimit).

4. Strategjia për mbrojtjen e tokës vlerëson rëndësinë e ruajtjes së cilësisë së tokës dhe funksioneve ekologjike të saj si një faktor kyç për të luftuar ndryshimin e klimës dhe për të parandaluar fenomenet e shkretëtirëzimit që paraqet një kërcënim të rëndë në të gjitha vendet e Mesdheut. Në këtë kontekst, strategjia e BE-së për mbrojtjen e tokës synon të parandalojë korrozionin, përkeqësimin, ndotjen dhe shkretëtirëzimin. Kërcënimet kryesore të identifikuara janë:

- Erozioni, i cili shkaktohet nga një kombinim i faktorëve të tillë si shpate të pjerrëta, klima, përdorimi i papërshtatshëm i tokës, llojet e bimësisë dhe katastrofat ekologjike;
- Reduktimi i materialit organik, për shkak te praktikave bujqësore dhe pyjore;
- Ndotja e lokalizuar si nga (p.sh. minierat, vendgrumbullimet e mbetjeve, industria, etj), ashtu dhe nga (depozitimet atmosferike, praktikat bujqësore, riciklimi i papërshtatshëm dhe trajtimi i ujit dhe ujërave të zeza, etj);
- Përdorimet e ndryshme te tokës, p.sh. mbulime për qëllime banimi, rrugëve dhe aktiviteteve të tjera njerëzore të përcaktuara në kuadrin e planifikimit hapësinor;
- Ngjeshja e tokës, dmth presioni mekanik realizuar në shtresat e tokës nga trafiku i rënduar, mbi gjelbërimi për forma të caktuara të turizmit (të tilla si skit);
- Ulja e biodiversitetit të tokës të shkaktuar nga ulja e materies organike dhe disa praktikave bujqësore (të tilla si përdorimi i gjerë i pesticideve);
- Kripëzimi, i cili është i lidhur zakonisht me praktikat e ujitjes dhe përbën një shkak serioz për shkretërimin;
- Përmbytjet dhe rrëshqitjet e tokës, te lidhura drejtpërdrejt me tokën dhe menaxhimin e saj;

Sipas tematikave strategjike, mbrojtja efektive e tokës kërkon një qasje të integruar dhe rregullimin, si dhe përmirësimin e politikave aktuale. Në këtë kontekst, veprimet për adresimin e kërcënimeve duhet të përfshijë:

→ Zhvillimin e një politike të përshtatshme të mjedisit nëpërmjet zbatimit të direktivave përkatëse të BE-së (Direktiva për ndotjen e nitrateve, ujit, grumbullimin Sanitar të mbeturinave, mbrojtja nga zjarret në pyje, etj)

→ Zbatimin e planifikimit të qëndrueshëm territorial dhe praktikave të menaxhimit të tokës, imponuar, nëse është e nevojshme kufizime për përdorimin e tokës;

→ Politika e Përbashkët Bujqësore (PPB), i cili siguron mundësitë për të promovuar praktikat e qëndrueshme të tilla si bujqësia organike, mirëmbajtjen e tarracave, menaxhimin e integruar te kulturave bujqësore, etj;

→ monitorimin e gjendjes së tokës dhe vlerësimin e faktorëve që përbëjnë kërcënimet kryesore për degradimin e saj;

5. Strategji ne_përdorimin e qëndrueshëm te pesticideve ne kuadër te strategjisë për mbrojtjen e tokës dhe përgatitjen e një politike bashkëkohore për përdorimin e pesticideve, qe ndihmon për:

- Minimizimin e rrezikut për shëndetin dhe mjedisin nga përdorimi i pesticideve;
- Përmirëson kontrollin e përdorimit dhe shpërndarjes se pesticideve;
- Redukton sasitë e substancave te rrezikshme, veçanërisht ne zëvendësimin e me te rrezikshmeve me alternative te tjera;
- Inkurajimin e praktikave bujqësore me pak ose aspak pesticide te përdorura;
- Vendosjen e një sistemi transparent për raportimin dhe monitorimin e progresit për realizimin e objektivave strategjike.

6. Strategjia për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve synon të promovojë një përdorim më efikas dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore gjatë gjithë ciklit te jetës e tyre. Objektivi kryesor është për të zbutur ndikimin mjedisor të përdorimit të burimeve natyrore (shterimin dhe ndotja e burimeve), pa kompromentuar objektivat e strategjisë së Lisbonës për zhvillimin ekonomik dhe punësimin. Për këtë qëllim, strategjia synon të përmirësojë efikasitetin e përdorimit të burimeve, zbutjen e ndikimeve mjedisore të lidhura me te dhe të zëvendësojë ndotjet e rënda te burime me alternativa, por edhe te propozoj krijimin e një Qendre të Dhënash mbi pasuritë natyrore (të menaxhuara nga Komisioni), në mënyrë që të forcojë njohuri në lidhje me përdorimin e burimeve dhe ndikimin e tyre mjedisor dhe të lehtësojnë shkëmbimin dhe shpërndarjen e informacionit për hartuesit e politikave.

7. Strategjia për mjedisin urban, e cila është drejtpërdrejte e lidhur me qëllimin e Planit Vendor, synon të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të performancës mjedisore të qyteteve evropiane, duke reduktuar burokracinë, duke rritur efektivitetin në zbatimin e politikave mjedisore dhe inkurajimin e planifikimit afat-gjatë lokal të mjedisit. Duke pranuar se qyteti dhe planifikimi i përshtatshëm i tij ka një rol të rëndësishëm në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, zbutjen e shkarkimeve të gazrave serrë, ruajtjen e hapësirës peri-urbane dhe habitateve natyrore, përdorimin e mençur te burimeve natyrore, përmirësimin e shëndetit publik dhe cilësinë e jetës, etj, janë propozuar një seri masash për të cilat Komuniteti duhet të ofrojë udhëzime, te cilat janë;

- Menaxhimi i integruar i mjedisit, përqendruar në objektivat e përcaktuara qartë, pranimin e përgjegjësive, procedurat për monitorimin e progresit, për konsultim publik, si dhe për rishikimin, auditimin dhe raportimin: rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe mbështetjen e praktikave më të mira në Evropë;
- Plane të Qëndrueshme të transportit urban; Zbatimi i gjerë i planeve të tilla, së bashku me masat specifike për nxitjen e eficiences se energjisë për automjetet me shkarkime te ulëta te CO_2, do të ndihmonte për të ulur emetimet e gazit serrë në nivel lokal, për më tepër, këto

plane do të ndihmojë në uljen e ndotjes së ajrit dhe zhurmave dhe do të inkurajonte përdorimin e biçikletave dhe ecjen në këmbë, pra përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e obezitetit;

- Metodat ndërtimore bio-klimatikisht të qëndrueshme për të përmirësuar efikasitetin e energjisë dhe për të zvogëluar emetimet e CO_2, të stimuluar qetësin, sigurinë, qasjen dhe për të zvogëluar ndikimin në shëndet të ndotjes së ajrit në dhe jashtë ndërtesave (sidomos nga grimcat e emetuara nga sistemet e ngrohjes);
- Zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe planifikimin e përdorimit të tokës; parandalimin e shtrirjes se ç'rregullt urbane (p.sh. përmes densitetit të lartë dhe të ndërtesave me përdorim të përzier në zonat urbane), e cila ofron disa avantazhe mjedisore dhe është një faktor kyç për mbrojtjen e habitateve natyrore dhe biodiversitetit (ruajtja e zonave peri- urbane) dhe për mbrojtjen e tokës (reduktimin e tokës se mbuluar), pasi ajo kontribuon në përdorimin në mënyrë të konsiderueshme më të ulët të burimeve për person (në aspektin e rrjeteve të infrastrukturës, ofrimin e shërbimeve, transportit, ngrohjes, etj;
- Menaxhimi urban i përgjithshme dhe masat e politikave mjedisore, duke përfshirë ruajtjen dhe rritjen e biodiversitetit urban, zbutjen e efekteve të energjisë dhe ujit te konsumuar, nxitjen e skemave lokale të masave dhe parandalimit të mbeturinave.

Përveç politikave dhe masave të përcaktuara në Planin 6 të Veprimit Mjedisor, mbrojtja e mjedisit dhe politikat e qëndrueshme të zhvillimit të BE-së, janë promovuar nëpërmjet një seri tematikash strategjike dhe dokumentesh të tjera. Dokumentet që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me fushën e vlerësimit aktual janë përshkruar shkurtimisht më poshtë.

Politika e BE-së për Ndryshimet Klimatike ka për qëllim stabilizimin e përqendrimeve të gazeve serë në atmosferë, në nivele që do të parandalojnë ndikimet e rrezikshme njerëzore ne sistemin e klimës; rritja e temperaturës mesatare vjetore te se sipërfaqes nuk duhet të kalojë 2°C, në krahasim me nivelet para-industriale. Kjo politikë është përshkruar si politika **20 - 20 - 20**, e cila në të njëjtën kohë synon:

- Reduktimin e shkarkimeve te gazrave serre deri ne vitin 2020 te paktën ne masën 20%, poshtë nivelit te vitit 1990;
- 20% e energjisë se konsumuar te BE te vije nga energjia e rinovueshme deri ne vitin 2020;
- Reduktimin e energjisë primare te përdorur ne 20%, (nëpërmjet përmirësimit te eficiences se energjisë), krahasuar me nivelin e projekteve deri ne vitin 2020.

Strategjia e BE-së për Biodiversitetin përcakton një seri objektivash që duhen arritur në një numër fushash të politikës dhe tipet e aktiviteteve. Objektivat kryesore të strategjisë për fushën / llojin e aktivitetit janë:

- Rruajtja e pasurive natyrore: Krijimi dhe funksionimi i rrjetit "Natyra 2000", mbrojtjen e llojeve të veçanta të rrezikuara; aplikimi i instrumenteve ligjore të tilla si Direktiva Kornizë për Ujin (2000/60/KE); trajtimin e ndryshimit të klimës;
- Bujqësia: ruajtjen me te mirë te burimeve gjenetike me vlerë të lartë ushqyese; promovimin e praktikave të mira bujqësore që kontribuojnë në ruajtjen e diversitetit gjenetik dhe uljen e ndotjes (arritja e disa kritereve të caktuara ekologjike është vendosur si kusht për dhënien e subvencioneve bujqësore); forcimin e vlerësimeve agro-mjedisore; promovimin e politikave tregtare të cilat janë në përputhje me mbrojtjen e biodiversitetit;
- Peshkimi: promovimin e praktikave që lehtësojnë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të rezervave të peshkut me ndikime të kufizuar në ekosistemet bregdetare dhe detare, shtimin e mbrojtjes se trupave ujor të një rëndësie të veçantë ekologjike;
- Politika rajonale dhe planifikimi hapësinor: promovimin e masave planifikuese të cilat mund të kontribuojnë në mbrojtjen e biodiversitetit, në veçanti në korridoret midis zonave të mbrojtura, në zonat rurale dhe në zonat e ndjeshme te pa mbrojtura, duke marrë në konsideratë vlerat mjedisore për projektet e financuara nga Fondet Strukturore.
- Pyjet: Sigurimin e menaxhimit të pyjeve që nuk ndikon në biodiversitetin ose cilësinë ekologjike të pyjeve, duke marrë masa për ripyllëzim; promovimin e kërkimeve shkencore dhe vlerësimit të ndikimit mjedisor;
- Energjisë dhe Transportit: marrjen e masave kundër acidifikimin dhe ndryshimit të klimës, zvogëlimin e ndikimeve negative të zhvillimit të infrastrukturës, në kërkim të burimeve të përshtatshme te energjisë;
- Turizmi: promovimi i turizmit të qëndrueshëm, përkufizimi i poleve tërheqëse turistike, te lidhura me mjedisin dhe biodiversitetin;
- Zhvillimi i ndihmave dhe bashkëpunimi ekonomik: Integrimi i objektivave të biodiversitetit me mekanizmat e ndihmës për zhvillim dhe bashkëpunim ekonomik, duke mbështetur përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në vendet në zhvillim, duke siguruar koordinimin dhe përfshirjen e masave të marra në nivel kombëtar (përfshirë edhe vendet e treta), BE dhe ato ne nivel ndërkombëtare;

Strategjia e BE-së për Zhvillim të Qëndrueshëm është miratuar fillimisht në Këshillin Evropian të Goteborgut në vitin 2001 dhe është rishikuar në vitin 2005, plotësuar nga parimi i integrimit të dimensionit mjedisor në të gjitha politikat e BE-së. Strategjia e rishikuar përmban katër objektiva kryesore:

1. Mbrojtjen mjedisore;
2. E drejta sociale dhe bashkëveprimi;
3. Prosperiteti ekonomik;
4. Pranimin e përgjegjësive tona ndërkombëtare.

Paralelisht shtate sfida kyçe janë evidentuar, për te cilat janë propozuar një seri objektivash te përgjithshme specifike, veprime dhe objektiva funksional:

- Ndryshimet klimatike dhe energjia e pastër: Objektivi i përgjithshëm është për të zbutur ndryshimet klimatike dhe shpenzimet e lidhura me te si dhe impaktet negative sociale dhe mjedisore.
- Transport i qëndrueshëm: Objektivi i përgjithshëm është që të sigurohet se sistemet e transportit plotësojnë nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore të shoqërisë, duke minimizuar ndikimet negative në shoqëri, në ekonomi dhe në mjedis.
- Prodhim dhe konsum i qëndrueshëm: objektiv i përgjithshëm është promovimi i metodave te prodhimit dhe konsumit te qëndrueshëm.
- Konservimi dhe menaxhimi i pasurive natyrore: Objektiv i përgjithshëm është përmirësimi i menaxhimin për të shmangur mbi-shfrytëzimin e burimeve natyrore, duke njohur vlerën e shërbimeve të ekosistemit.
- Shëndeti publik: Objektivi i përgjithshëm është që të promovojë shëndet të mirë publik dhe përmirësimin e mbrojtjen kundër rreziqeve shëndetësore.
- Përfshirja sociale, demografia dhe emigracioni: Objektivi i përgjithshëm është që të krijojë një shoqëri sociale gjithëpërfshirëse, duke marrë në konsideratë solidaritetin midis dhe brenda brezave dhe sigurimin / përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve si parakusht për mirëqenien individuale të vazhdueshme.
- Varfëria globale dhe sfidat e zhvillimit te qëndrueshëm: Objektivi i përgjithshëm është që të promovojë në mënyrë aktive në mbarë botën zhvillimin e qëndrueshëm dhe të sigurojë që politikat e brendshme dhe të jashtme të BE-së te jenë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm global dhe angazhimet e saj ndërkombëtare.

Karta e Leipzigut për Qytete të Qëndrueshme Evropiane, nxite shtetet anëtare të BE të promovojnë konsultimet publike për integrimin e parimeve dhe strategjive te "zhvillimit të integruar urban" në politikat e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe lokal. Ajo stimulon krijimin e qeverisjes përkatëse dhe masave zbatuese për promovimin e organizimit të balancuar territorial, të bazuar në një strukturë evropiane policentrite urbane. Parimet udhëzuese të "Kartës" për zhvillimin e qëndrueshëm urban janë:

- Promovimin e politikave " urbane për zhvillimin e integruar":
  - Analizimi i situatës aktuale, përshkruan problemet dhe mundësit;
  - Identifikon qëllimet koherente te zhvillimit për çdo zone dhe zhvillimin ne kuadër te vizionit te qytetit;
  - Koordinimin lokal, sektorial, planet teknike dhe politikat dhe siguron kontributin e investimeve te planifikuara për te promovuar zhvillim te balancuar për çdo zone urbane;
  - Koordinon pasurit publike dhe private si dhe përqendrimin e tyre hapësinor;
  - Koordinon planifikimin ne nivel lokal dhe ne nivel qyteti-rajonal;

- Përfshirja e shoqërisë civile dhe partnerëve të tjerë të cilët mund të kontribuojnë ndjeshëm për formimin e karakterit te ardhshëm ekonomik, social, kulturor dhe mjedisor te çdo zone në procesin e planifikimit.

- Krijimin e hapësirave publike te cilësisë se larte:
  - Futjen e "Baukultures" (një koncept i ndërtimit te lidhur me cilësinë estetike), e cila i referohet ndërveprimit në rritje te arkitekturës, projektimit të infrastrukturës dhe planifikimit urban, në mënyrë që të krijohen hapësira atraktive publike të orientuara drejt nevojave të përdoruesve dhe për të arritur standarde të larta në lidhje me mjedisin jetësor te qytetarëve.
- Modernizimin e rrjetit te infrastrukturës dhe përmirësimin e eficiences mjedisore:
  - Nxitjen e një transporti urban efikas, te qëndrueshëm dhe menaxhim të trafikut dhe elementeve perberes përfshirë infrastrukturën për këmbësorë dhe përdoruesit e biçikletave, koordinon planifikimin e transportit me punësimin, strehimin, hapësirat publike dhe nevojat për mbrojtjen e mjedisit;
  - Përmirësimi i infrastrukturës teknike, veçanërisht të rrjeteve te furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; në përputhje me ndryshimin e nevojave, në mënyrë që të mbulojë kërkesat e standardeve më të larta të jetesës ne te ardhmen.
  - Nxit funksionimin efikas dhe përmirësimin e rrjeteve të shërbimeve dhe siguron qëndrueshmërinë e tyre përmes përdorimit të kujdesshëm të burimeve natyrore dhe rritjes së efikasitetit energjetik të ndërtesave, në veçanti rinovimin e shtëpive të abandonuara në mënyrë që të zvogëlojë kostot për bizneset dhe konsumatorët dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës.
  - Promovimi e zhvillimit "kompakt" dhe te përzier te përdorimit (punësim, strehim, arsim, shërbime dhe argëtim), përmes planifikimit të duhur urban dhe hapësinor që parandalon shtrirjes urbane duke kontrolluar efektivisht dhënien e tokës për zhvillim, duke trajtuar zhvillimet spekulative.
  - Sigurimin e një cilësie të mire jetese për të tërhequr bizneset nëpërmjet përdorimit të informacionit të avancuar dhe teknologjive të komunikimit në arsim, punësim, shërbime sociale, shëndetësi, siguri dhe mbrojtje;
  - Përshtatjen me kërcënimin e ndryshimeve klimatike; pranimin e zhvillimit urban me përdorim të ulët te lëndëve djegëse fosile, për të përmirësuar cilësinë e mjedisit dhe për të zvogëluar shkarkimet përmes planifikimit dhe parashikimit të duhur dhe masave zbutëse.
- Futja e politikave pro-aktive te rinovimit dhe arsimimit:
  - Mbështetje edukimit dhe sistemeve të trajnimit dhe organizatave shoqërore dhe kulturore, për të siguruar mundësi për të mësuarit gjatë gjithë jetës; mbështet universitetet, Institucionet kërkimore dhe rrjetet e dijes ndërmjet industrive, biznesit dhe komunitetit shkencore përmes politikave të integruara të zhvillimit urban dhe te mire qeverisjes.

- Duke u fokusuar në zonat e privuar / degraduara në kontekstin e përgjithshëm të çdo urbanizimi
  - Zbaton strategji për rritjen e vlerave mjedisore;
  - Forcimin e ekonomisë lokale dhe punësimit;
  - Promovimin e arsimimit pro-aktiv te te rinjve dhe politika trajnimi;
  - Promovimin e një transporti publik efecient dhe te përshtateshe.

Tabela 16: Përmbledhje e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të vendosura në nivel Evropian

ME-1	**Promovimin e shëndetit publik për të përmirësuar mbrojtjen kundër rreziqeve shëndetësore**
ME-2	**Reduktimin e ndotjes se ajrit**
ME-3	**Reduktimin e shkarkimeve te gazit serre**
ME-4	**Përmirësimi i efikasitetit të përdorimit të burimeve natyrore (shmang mbi-shfrytëzimin), zbute ndikimet negative në mjedis dhe nxit përdorimin e burimeve më pak ndotëse.**
ME-5	**Reduktimi i konsumit te energjisë dhe rritja e përdorimit te energjisë se rinovueshme**
ME-6	**Redukto mbetjet dhe promovo ripërdorimin, riciklimin dhe rigjenerimin**
ME-7	**Krijimi i një rrjeti të zonave të mbrojtura dhe korridoreve ekologjike dhe promovimin e praktikave te qëndrueshme të menaxhimit të pyjeve.**
ME-8	**Promovimi i mbrojtjes efikase të tokës nëpërmjet (a) reduktimit të ndotjes së tokës nga të gjitha burimet (duke përfshirë edhe përdorimin e pesticideve të dëmshme), (b) zbatimin e një planifikimi të qëndrueshëm territorial dhe praktikave të menaxhimit të tokës, dhe (c) promovimin e praktikave bujqësore të qëndrueshme dhe politika bujqësore të zhvillimit ekologjikisht miqësore.**
ME-9	**Mbron, rrit dhe konservon cilësinë e mjedisit detar**
ME-10	**Promovon transport urban te qëndrueshëm (fleksibilitet urban te qëndrueshëm)**
ME-11	**Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm urban, parandalimin e shtrirjes se ç'rregullt urbane dhe sigurimin e një zhvillimi "kompakt" dhe përdorimi të përzier.**
ME-12	**Promovimi i turizmit të qëndrueshëm dhe te përcaktojë nyjet e tërheqjes turistike që lidhen me mjedisin dhe biodiversitetin**
ME-13	**Përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe promovimin e përfshirjes sociale, duke marrë në konsideratë solidaritetin midis dhe brenda brezave**
ME-14	**Përmirësimi i kushteve mjedisore dhe forcimin e ekonomisë lokale dhe punësimin në zonat e privuara**
ME-15	**Promovimin e metodave ndërtimore te qëndrueshme - bioklimatike**

ME-16	**Përmirëson cilësinë dhe atraktivitetin e hapësirave publike**
ME-17	**Promovimi i skemave të integruara të menaxhimit mjedisor dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik**

3.2 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Nivel Kombëtar

3.2.1 Objektivat Kombëtare të Mjedisit

Kuvendi i Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare kanë hartuar dhe miratuar tërësinë e ligjeve të mësipërme me qëllim përafrimin e kuadrit ligjor të lidhur me mjedisin me atë të BE-së si dhe mbrojtjen e tij. Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2013-2020 dhe draft-Strategjia Kombëtare për Mjedisin 2015-2025 janë dokumentet të rëndësishme që përcaktojnë drejtimet kryesore të politikave mjedisore që do të ndiqen nga institucionet ligj-zbatuese në harkun kohor të përcktuar, politika të cilat janë të domosdoshme për ruajtjen dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës duke i siguruar kësaj të fundit standarte të njejta me ato evropiane.

Këto dokumente japin edhe vlerat monetare të cilat do të shpenzohen në infrastrukturë për të plotësuar kushtet e vendosura nga legjislacioni por edhe nga detyrimet ndërkombëtare. Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur kushtet, afatet kohore, përcaktimi i vlerave prag për ndotësit e ndryshëm etj, të përcaktuara këto mbi bazën e dokumentave ndërkombëtare dhe kombëtarë.

a) Biodiversiteti dhe Mbrojtja e Natyrës

Një ndër objektivat më të rëndësishëm është "Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, i zonave dhe llojeve të mbrojtura, si dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe mjedisit në përputhje me angazhimet evropiane dhe ndërkombëtare.

Në fushën e mbrojtjes së natyrës është realizuar transpozimi i Direktivave kryesore të kësaj fushe, respektivisht Direktivës së Habitateve dhe Direktivës së Shpendëve, duke arritur në një masë transpozimi mbi 85% për këto Direktiva. Është plotësuar kuadri ligjor në vite me direktivat e sipërpërmendura si: ligji "Për mbrojtjen e faunës së egër", ligji "Për gjuetinë", Amendimi i ligjit "Për Zonat e Mbrojtura", ligji "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të tregëtimit ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër", amendimi i ligjit "Për bidoversitetin" si dhe një numër aktesh nënligjore në zbatim të tyre. Ruajtja dhe rritja e larmisë biologjike është synuar përmes rritjes së sipërfaqes së zonave të mbrojtura dhe mirëmenaxhimit të tyre. Është realizuar përgatitja e Planeve të Menaxhimi për 10 Zona të Mbrojtura dhe është në përfundim procesi i përgatitjes për 10 Zona të Mbrojtura të tjera. Në zonën e studimit është realizuar zbatimi në praktikë i planeve të menaxhimit të miratuara dhe ndërtimi e forcimi i kapaciteteve të administratave të zonave të mbrojtura në Parkun i Butrintit- Kanali i Vivarit si dhe

fushë Xarra .Gjithashtu është miratuar metodika standarte per hartimin e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Sfidat për të ardhmen përfshijnë përgatitjen për identifikimin dhe ngritjen e rrjetit Natura 2000 të zonave të veçanta të ruajtjes me rëndësi për komunitetin evropian. Zbatimi i planeve të menaxhimit për ato Zona të Mbrojtura që kanë plane të miratuara. Forcimi i zbatimit të ligjit dhe ngritja e kapaciteteve administrative të stafit të administratave të zonave të mbrojtura dhe organeve të kontrollit për ruajtjen e florës dhe faunës së egër përbëjnë prioritet.

Një nga objektivat e realizuara të politikës në sektorin pyjor, nëpërmjet programeve të realizuara është arritur transferimi i pyjeve dhe kullotave drejt njësive të qeverisjes vendore për te siguruar gjithë përfshirjen duke i mbështetur ato me plane menaxhimi dhe punime pyllëzimi dhe përmirësimi ne pyje. Sipërfaqja fondit pyjor kullosor e mbuluar me plane mbarështimi deri ne vitin 2012, është rritur me 48% krahasuar me vitin 2007 nga punimet pyjore te kryera ne 12.000 ha pyje te degraduar, erozioni është reduktuar me rreth 200.000 ton sedimente.

Parandalimi i aktiviteteve të paligjshme nga ana e strukturave të Policisë Pyjore është ulur si pasojë e masave të marra: janë ulur niveli i prerjeve të paligjshme në pyje, nga 8% ne vitin 2007 ne 55 % ne vitin 2011. Sipërfaqe të konsiderueshme të pyjeve aluvionale bregdetare po eleminohen çdo vit si rezultat i erozionit bregdetar i cili është mjaft aktiv. Objektivat e ardhshëm do të jenë: (i) përafrimi dhe zbatimi i legjislacionit europian në fushën e pyjeve dhe kullotave; (ii) rritja e kapaciteteve të menaxhimit të pyjeve bashkiake nëpërmjet grandeve konkurruese dhe forcimit të kapaciteteve; (iii) përmirësimi i sistemit të informacionit dhe data-bazës pyjore; (iv) forcimi i sistemit te kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje; (vi) përmirësimi i marrëdhënieve rajonale, aplikime te përbashkëta ne programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive; (vii) aplikimi në programe kombëtare e ndërkombëtare për te siguruar një mbështetje te nevojshme për zhvillimin e pylltarisë ne vend, dhe (viii) përfshirja e çështjeve te ndryshimeve klimatike në të gjithë aspektet e administrimit e menaxhimit të fondit pyjor.

Tabela 17: Masat përparësore për mbrojtjen e Biodiversitetit

Masat	Përshkrimi	Masat kryesore përparësore publike
B1	Forcimi i Kuadrit Ligjor për Mbrojtjen e Natyrës	Transpozimi i Direktivave kryesore të kësaj fushe duke arritur në një masë transpozimi mbi 85% për këto Direktiva në legjislacionin shqiptar

B2	Forcimi i Menaxhimit të Administratave të Mbrojtjes së Natyrës	Parku i Butrintit - Zona e mbrojtur deri kepi Stillos
B3	Zhvillimi i Planeve të Menaxhimit për të gjitha "Zonat e Mbrojtura"	Deri në 2020 përfundon procesi i përgatitjes për 10 Zona të tjera të Mbrojtura.
B4	Rritja e Menaxhimit të Zonave dhe Specieve të Mbrojtura	Krijimi i strukturave të plota të AKZM-së për e "Zonat e Mbrojtura" dhe përgatitjen për identifikimin dhe ngritjen e rrjetit Natura 2000 të zonave të vaçanta të ruajtjes me rëndësi për komunitetin evropian
B5	Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur dhe Specieve	Sigurimi i objektivave për menaxhime zonës së mbrojtur dhe kontrolli nga ana e AKMZ.
B6	Integrimi i objektivave të Strategjisë së Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit në politikën e Shtetit	Sigurimin që udhëzuesi përmbledhës i instruksioneve i MMP&AU për Ministritë kryesore të asistojë për integrimin e objektivave të biodiversitetit në sektorët strategjik si pjesë e procesit të VSM-së.
B7	Monitorimi i Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Informacionit	Administratat e zonave të mbrojtura me krijimin e AKZM do të kenë një lidhje të drejpërdrejtë me Ministrinë e Mjedisit, si nje agjenci e pavarur dhe e dedikuar në mbrojtjen e natyrës

Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura më 2015, si nje agjenci e pavarur dhe e dedikuar në mbrojtjen e natyrës, krijon premisa për akses më të lehte dhe vizibilitet të administrative të zonave të mbrojtura, duke mundësuar aplikimin e drejtpërdrejtë dhe menaxhimin direkt të fondeve nga ky institucion.

b) Menaxhimi i Burimeve Ujore

Sigurimi i ujit të pijshëm për të gjithë popullatën; Mbrojtja e të gjithë burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Vizioni i Strategjisë Sektoriale e shërbimeve për ujin e pijshëm dhe kanalizimet periudhën 2011 - 2017 si dhe Strategjia e mjedisit për ujrat, reflekton situatën aktuale të Shqipërisë në lidhje me rritjen e investimeve të përgjithshme në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore në mënyrë që në fund të kësaj periudhe planifikimi të jetë arritur përmirësim i dukshëm në nivelin dhe cilësinë e shërbimeve, i perceptuar nga përdoruesi final. Investimet kapitale për sektorin UK përvitet 2016-2017 pritet të arrijë shifrën e afrom 200

miliard lekëve. Vizioni i kësaj Strategjie Sektoriale synon hartimi e politikave të përshtatshme dhe angazhimin e fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimeve, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Evropian dhe me Objektivin e Zhvillimit të Mjëvjeçarit për qëndrueshmërinë e mjedisit.

Sektori i ujit është një nga elementet më të rëndësishëm të menaxhimit mjedisor. Kërkesat për një menaxhim të qëndrueshëm të ujit janë komplekse, teknikisht sfiduese dhe të shtrenjta. Situata në këtë sektor është e ngjashme me atë të menaxhimit të mbetjeve dhe për këtë arsye kalimi i përgjegjësisë për shërbimet Bashkiale po i transferohen autoriteteve lokale.

Në përgjithësi objektivat e strategjisë kombëtare për ujrat ka si synim: Zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të sektorit të ujësjellës kanalizimeve; Orientimi i shërbimeve të ujit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove; Përmirësimin e drejtimit dhe rregullimit të sektorit; Investimet për rritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit; Progresin drejt harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me Direktivat e BE-së për Ujin; përmirësimin dhe forcimin e zbatimit tëe legjislacionit; forcimi i autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal; hartimi i planeve te menaxhimit të të gjithe baseneve te lumenjve si dhe krijimi i kadastres ujore elektronike; hartimi i Strategjisë Kombetare të Menaxhimit të Integruar të Ujërave; përfshirja e çeshtjeve te ndryshimeve klimatike në të gjithë dokumentet strategjike të administrimit të ujrave.

Arritja e objektivave të strategjisë për burimet ujore do të bëje të mundur të arrihen treguesit e tabelës se mëposhtme:

Tabela 18: Objektivat paraprake të strategjisë së burimeve ujore

Masat	Përshkrimi i Masave	Masat kryesore prioritare publike
MBU1	Sistemet efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit në sektorin e ujit	Mbështetje për ndërgjegjësimin e publikut dhe programet e Komunitetit të Arsimit në mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve ujore, përafrimi i plotë i Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/EEC, kontrolle të vazhdueshme ndaj perdoruesve te burimeve ujore, per te siguruar miradministrimin dhe perdorimin e qendrueshem te tyre. Hartimi dhe përhapja e një Kontratë Tip për Dhënien e shërbimeve. Ndjekja dhe monitorimi i subjekteve te cilat shfrytezojne inertet lumore me leje te perkohshme, ndjekja dhe monitorimi i likuidimit te detyrimeve financiare te subjekteve, monitorimi i vazhdueshem i cilesise se ujerave siperfaqesore

		dhe nentokesore nga institucionet pergjegjese ne bashkepunim me MM-ne.
MBU 2	Zbatimi i projekteve prioritare në sektorët e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza	Zbatimin e projekteve prioritare në fushën e ujit të pijshëm dhe të ujërave të zeza në rajone të ndryshme të vendit
MBU 3	Zhvillimi i programit afatgjatë të investimeve, strategjia financiare dhe zbatimi i një mekanizmi të fuqishëm për sektorët e ujit të pijshëm dhe e ujërave të zeza	Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë se shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve; Orientimi i ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove
MBU 4	Reduktimi i ndotjes së ujërave nëntokësore	Respektimi i kushteve te përcaktuara për të gjitha shkarkimet industriale dhe ato të të ujërave të zeza për të kryer para-trajtimin e shkarkimeve - përmirësimin e kushteve të përdorimit të lejeve duke bërë pjesë të procesit të shqyrtimit të saj edhe sigurimin dhe para-trajtimit të gjitha ujërave të ndotur urban dhe industriale
MBU 5	Reduktimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësore	Forcimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Ujërave në rolin e vet si Sekretariat Teknik nën varësinë e Këshillit Kombëtar të Ujërave, si dhe i mbikëqyrjes së Agjencive të Baseneve të Lumenjve
MBU 6	Mbrojtja e ujërave nëntokësore	Monitorimi i vazhdueshem i cilesisë së ujerave siperfaqesore dhe nëntokesore nga institucionet përgjegjese në bashkëpunim me MM-ne.
MBU 7	Monitorimi i ujërave	Respektimi i kushteve te përcaktuara për të gjitha shkarkimet industriale dhe ato të të ujërave të zeza dhe monitorimi i vazhdueshem i cilesisë së ujerave siperfaqesore dhe nëntokesore nga institucionet përgjegjese në bashkëpunim me MM-ne.

c) Mbrojtja e Tokës

Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës me qëllimin për ta bërë më pjellore, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja.

Problematika e tokës dhe e mbrojtjes së saj përfshin një spektër të gjerë cështjesh që në dokumentet e qeverisë shqiptare lidhen me tokën bujqësore, pyjet etj. Çështjet kyçe për mbrojtjen dhe menaxhimin e tokës mund të përshkruhen si më poshtë: Erozioni, lëndët organike, ndotja e tokës, tharja e tokës, kompaktësimi i tokës, zvogëlimi i biodiversitetit, kripëzimi, përmbytjet dhe rrëshqitjet e tokës.

Tetë çështjet kyçe janë grupuar në tre qëllime kryesore për mbrojtjen e tokës, duke shtuar edhe një për nevojën për informacion' Më poshtë është tabela e qëllimeve dhe masave kryesore me qëllim përmbushjen e tyre.

Tabela 19: Objektivat për Mbrojtjen e Tokës

Objektiva	Përshkrimi i objektivave	Masat kryesore prioritare publike
MT1	Reduktimi i niveleve të erozionit të tokës dhe dëmeve të shkaktuara	Parandalimin e aktiviteteve te paligjshme nga ana e strukturave te Policisë Pyjore me masat administrative për të ulur nivelin e prerjeve të paligjshme në pyje dhe zbatimi i Planeve të Menaxhimit të kullotave malore për të lejuar zbatimin e shpejtë të rimbjelljes. Ulja e erozionit te ultësirës përmes zbatimit të masave për të minimizuar erozionin e tokës në Kodin e Praktikës së Mirë Bujqësore
MT2	Ruajtja e tokave bujqësore në gjendje të mirë mjedisore dhe bujqësore	Zbatimi i riciklimit dhe zbatimi i dispozitave të riciklimit për përdorimin e mbeturinave joorganike (urbane, ujërave të zeza, bujqësore, industriale) si pasurues të tokës në zonat me vlera të ulëta të lëndëve organike. Kufizimet në nivelet e lejuara të marrjes se ujit për ujitje në zonat e prekura, në mënyrë për të promovuar efikasitetin e ujitjes
MT3	Reduktimi i ndotjes së tokës	Zbatimi i CGAP gjithashtu do të mbulojnë çështjet e mirëmbajtjes së tokës dhe përdorimin agro-kimik
MT4	Sigurimi i disponueshmerisë së të dhënave të menaxhimit të tokës	Hartimi i planeve vendoret të bashkive

Në arritjen e këtyre qëllimeve, ka edhe një numër masash që referohen në Strategji në seksionet e tjera. Në mënyrë të veçantë masat në lidhje më cilësinë e ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve që duhet të ndihmojnë në reduktimin e ndotjes së tokës. Lidhja midis mbrojtjes së tokës dhe menaxhimit të burimeve ujore është më direkte, në mënyrë të veçantë në lidhje me praktikat e ujitjes. Në një afat të gjatë kohor, nevojat për ujitje duhet të balancohen me objektivat e vendosura për Planin e Menaxhimit të Baseneve Ujore të Lumenjve.

Në veçanti këto plane do të duhet të rregullojnë:

- Prerjen ilegale te pemëve për qëllime tregtie – kjo do të bëhet e mundur përmes survejimit dhe forcimit të teknikave siç përshkruhen në ato në lidhje me gjuetinë ilegale.
- Prerja e drunjve për zjarr – kjo praktike duhet të minimizohet. Plani duhet të identifikojë burime të tjera alternative që të mund të ndihmojë autoritetet lokale për ta ndalur këtë praktikë.
- Duhet të identifikohen në plan projektet për të stabilizuar rrëshqitjet e dheut dhe projekte për rimbjellje – kjo do të mundësohet përmes një procesi të shpejtë që është i përfshirë tek Fondi i Mjedisit

Në tokat e ulëta bujqësore duhet të zbatohet rigorozisht praktika e Kodit te Bujqësisë së Mirë, me qëllim zvogëlimin e erozionit.

d) Cilësia e Ajrit

Përmirësimi i cilësisë së ajrit në mbarë Shqipërinë në përputhje më nivelet e standardeve te BE dhe OBSH.

Cilësia e ajrit në zonat kryesore urbane në shqipëri sipas SNM rezulton të ketë pësuar një përmirësim ne krahasim me vitin 2007, deri në 67%. Një pjesë e treguesve që ndikojnë në cilësinë e ajrit rezultojnë të jenë brenda normave të lejuara kombëtare dhe të BE, ndërsa për dy treguesit $PM_{2,5}$ dhe PM_{10}, përputhshmëria me standartet europiane është e ulët, në vlerën 30% ndërsa treguesit e O_3, dhe benzenit tejkalojne me 1-5% standartet e BE.

Objektivi i përgjithshëm i qeverisë shqiptare është përmirësimi i cilësisë së ajrit, në mënyrë të veçantë në zonat urbane dhe përreth zonave industriale me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik, përputhjen me direktivat e BE dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të njohura në lidhje me cilësinë e ajrit dhe kontrollin e çlirimit të gazeve. Çështjet dhe tendencat kryesore që duhen adresuar për të arritur këto objektiva janë:

- Shkarkimi i gazeve i lidhur me transportin varet nga një numër faktorësh: lloji i karburantit që përdoret nga automjetet private/tregtare, numri i automjeteve, kilometrat e përshkuar, vjetërsia dhe lloji i motorit, mirëmbajtja dhe cilësia e tyre si

dhe nga alternativat e transportit. Përveç automjeteve mund të shtojmë cilësinë e rrugëve që kontribuon në rritjen e sasisë së grimcave të pluhurit si dhe ato të automjeteve. Numri i automjeteve është rritur shumë gjatë këtyre 10 vjetëve dhe do rritet edhe më tej me rritjen ekonomike.

- Grimcat e pluhurit nga aktiviteti i ndërtimit dhe nga rrugët e pashtruara. Të dyja si ndërtimi edhe transporti priten të rriten me rritjen ekonomike.
- Ruajtja dhe shtimi i sipërfaqjeve të gjelbërta
- Shkarkimi i gazeve nga industria në përgjithësi ka rënë pasi pjesa më e madhe e industrive janë mbyllur, çlirimi i gazeve do mund të rritet përsëri me rritjen e ekonomisë, prodhimit industrial, dhe kërkesave për energji.
- Shkarkimi i gazeve rritet edhe si pasojë e djegieve të mbeturinave dhe përdorimit te djegësve për qëllime shtëpiake. Gjithashtu ka mungesë informacioni mbi cilësinë e ajrit gjë e cila duhet të rregullohet me rritjen e monitorimit.

Megjithë përpjekjet për të përmirësuar sistemin e monitorimit të cilësisë së ajrit, akoma ky sistem nuk ploteson standartet europane per shkak te mungeses se investimeve per blerjen e stacioneve te monitorimit, pajisjeve dhe reagenteve, kostos per mirembajtjen dhe kalibrimin e tyre. Implementimi i plotë i legjislacionit të BE në këtë fushë nuk është e mundur brenda një kohe të shkurtër. Strategjia e adoptuar këtu ka për qëllim:

- Uljen e nivelit të çlirimit të gazeve nga burimet lëvizëse dhe ato fikse në nivelin e legjislacionit të BE.
- Përmirësimin e monitorimit për të siguruar informacion për të lehtësuar planet e menaxhimit të cilësisë së ajrit.
- Vendosjen e sistemit te planifikimit për menaxhimin e cilësisë së ajrit i cili do të përcaktojë dhe implementojë masat e nevojshme për të arritur standardet e cilësisë së ajrit.

Janë identifikuar pesë objektiva të përkohshme si të nevojshme për të arritur këtë objektivë të përgjithshëm. Për secilin prej tyre janë identifikuar një numër masash. Indikatori kryesor i efektivitetit të këtyre synimeve do të jetë përmirësimi i cilësisë së ajrit i vlerësuar mbi bazën e rrjetit të monitorimeve. Qeveria Shqiptare synon që deri në 2020 nëpërmjet zbatimit të ligjit, marrjes së masave dhe përmirësimit të infrastrukutrës të rrisë me 43% krahasuar me nivelin 28% te vitit 2011, numrin e stacioneve të monitorimit të ajrit urban sipas standarteve të BE-së ndaj totalit të stacioneve të monitorimit, reduktimim e niveleve kombetare të Nox me 15%, të PM_{10} me 25%, të $PM_{2,5}$ me 25% dhe të ruhen nivelet e SO_2 brenda vitit 2020 krahasuar

me nivelet e vitit 2011 përkatësisht: për NO_x - 40 μ/ m³, për PM_{10} - 83 μ/ m³, të PM $_{2,5}$-33 μ/ m³ dhe SO_2-8 μ/ m³.

Tabela 20: Cilësia e Ajrit

Masa	Përshkrimi	Masat kryesore prioritare publike
CA1	Monitorimi i cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e KE-së	Forcimit te Sistemit Kombetar te Monitorimit të ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër sipas standarteve evropiane
CA 2	Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve nga automjetet me motor	Forcimi i iniciativave mbi taksat e automjeteve për të patur një sistem automjetesh miqësore me mjedisin
CA 3	Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve nga instalimet industriale	Adoptimit plotësisht legjislacionit te BE për cilesinë e ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër (IPPC 96/61/EEC)
CA 4	Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve te pluhurit nga ndërtimet	Forcimi i zbatimit të legjislacionit; bashkepunimi me pushtetin vendor për miratimin dhe zbatimin e planeve te veprimit të cilësisë së ajrit
CA 5	Reduktimi i emetimeve të pluhurit nga burime të tjera duke përfshirë rrugët e pa asfaltuara, godinave jo industriale dhe zjarret e hapura	Plani për përmirësimin e infrastrukturës rrugore janë mbështetëse, përmirësimi i izolimit të ndërtesave, masat për efiçiencën e energjisë

Nivelet shqiptare kombëtare për disa nga ndotësit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabele 21: Nivelet normale Kombëtare të elementeve të cilësisë së ajrit

Parametrat mjedisore	Elementet	Niveli normal kombëtar (µg/m³)
Cilësia e Ajrit	pluhur	140
	PM_{10}	70
	SO_2	60
	NO_2	60
	Ozoni	120
	Pb	1

e) Ndryshimet Klimatike

Reduktimi i gazeve të efektit serë dhe ato të hollimit të shtresës së Ozonit duke kontribuar në parandalimin e ndryshimeve klimaterike

Shqipëria është anëtarësuar në Konventen Kuader te Kombeve te Bashkuara per Ndryshimet Klimatike, në Protokollin e Kiotos, dhe nuk ka detyrime të percaktuara për të reduktuar shkarkimet e gazeve serrë.Ne takimet e paleve te Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) te zhvilluara ne Kopenhagen COP 15, Kankun COP16 dhe në Durban, Shqipëria, si Palë në KKKBNK dhe Protokollit të Kiotos ka mbeshtetur qendrimin e Bashkimin Evropian dhe komunitetin ndërkombëtar për të zbutur ndryshimet klimatike.

Shifrat e paraqitur në konferencën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuar për ndryshimet klimaterike të mbajtur në Paris 2015 (Paris COP21-CMP11) duke u bazuar në të dhënat e panelit Ndërqeveritar për ndryshimet klimatike sot në planetin tonë tregojnë se:

- Që prej vitit 1880 deri 2012, temperatura mesatare globale e planetit tokë është rritur me 0.85°C. Sigurisht që studimet e shumta të realizuara tregojnë një lidhje të fortë midis rritjes me një gradë (1°C) të temperaturës dhe rënies së prodhimit të drithrave me 5%. *Si pasojë e një klime më të ngrohtë* misri, gruri dhe pjesa më e madhe e drithrave të tjera kanë patur një rënie të prodhimit vjetor të tyre në nivel global me një sasi përafërsisht prej *40 megatonesh* (40 000 000 ton) duke filluar nga 1981 deri në 2002. Po ashtu temperatura e oqeaneve është ngritur, sasia e borës dhe e akullit është reduktuar dhe për pasojë niveli i ujit të deteve dhe oqeaneve është rritur me 19 cm në periudhën 1901 deri 2010. Sipërfaqja e Arktik-ut është zvogëluar për çdo dekadë që prej 1979 me një sipërfaqe sa 1.07 million km².

- Bazuar në përqëndrimet e gazeve të efektit serë dhe të emetimit të tyre sot, *ka shumë të ngjarë që në fund të këtij shekulli temperatura globale të rritet me më shumë se 1.5°C krahasuar me 1850 deri 1900*. Niveli i oqeaneve do të vazhdojë të rritet me 24-30cm deri në vitin 2065 dhe me 40-63cm deri 2100. Mjaft aspekte klimatike nuk do të ndryshojnë për disa shekuj që do pasojnë edhe po të ndaleshin këto emetime gazesh.

- Emetimet globale të CO_2 janë rritur me afërsisht 50% që prej vitit 1990. Këto emetime janë rritur me shpejt midis viteve 2000 deri 2010 në krahasim me tre dekadat e mëparshme

Sidoqoftë konferenca theksoi se *akoma është e mundur sot që përmes politikave dhe përdorimit të teknologjive të reja, ndryshimit të sjelljes ndaj mjedisit do mund të kufizojmë rritjen globale mesatare të temperaturës me 2 gradë celsius në raport me periudhën e paraindustrializimit dhe se ndryshimet teknologjike dhe ato institucionale do të krijojnë mundësi që ngrohja globale të mos e kalojë këtë vlerë prag*.

Shkarkimi i gazeve të efektit serë ndodh si rezultat i disa aktiviteteve. Mjeti më i fuqishëm për reduktimin e këtij efekti mbetet reduktimi i shkarkimeve të këtyre gazeve, për këtë arsye duhet adresuar problemi i reduktimit të shkarkimeve duke e integruar objektivat dhe procesin e vendimmarrjes në një numër nivelesh:

- Qeverisje – në mënyrë të veçantë në strategjitë për energjinë, ekonominë dhe transportet për të përfshirë hapa për kufizimin e shkarkimeve.
- Industri dhe tregti –të inkurajohen për të qenë efektive në energji dhe në reduktimin e shkarkimeve.
- Individët- të inkurajohen për ta konsideruar si kriter në veprimet dhe blerjet e tyre çështjen e efektivitetit të energjisë.

Masat që duhen të ndërmerren do të duhet të shoqërohen nga instrumente ekonomike nëse janë efektive. Në mënyrë të veçantë janë të specifikuara masat e mëposhtme:

- Futja e taksës së Karbonit, të ardhurat e së cilës do të futen në Fondin e Mjedisit
- Fushata të vazhdueshme për reduktimin e numrit të lidhjeve të paautorizuara në rrjetin elektrik (nëse konsumatori nuk paguajnë atëherë nuk mund të ketë stimuj për reduktimin e përdorimit të energjisë).
- Zhvillimi dhe publikimi i Strategjisë afatgjate të Çmimeve të Energjisë, duke treguar tendencën e çmimeve të energjisë në një afat të mesëm- kjo do të publikohet që konsumatorët të kuptojnë përfitimet e investimeve në pajisje dhe në aktivitete duke hequr subvencionimet që ekzistojnë midis sektorëve shtëpiakë dhe jo shtëpiakë

- Fondi i Efiçencës Energjetike- ky do të jetë një grant program i një madhësi të vogël e të mesme që do të përdorë të ardhurat nga Taksa e Karbonit tek projektet e Fondit të Mjedisit- nga këshillat e Qendrës për Efiçencë në Energji.
- Ka një mori masash specifike, si ato për te specifikuara kufizimin në ambient të ndotjes së ajrit, që do të kontribuojnë në objektivin për reduktimin e emetimeve të gazeve. Këto janë masat që iu referuam më sipër:

Tabela 22: Ndryshimi i Klimës

Masa	Përshkrimi	Masat kryesore prioritare publike
NK1	Minimizimi i emetimeve të gazeve të efektit serrë	Zbatim i kerkesave te Traktatit te Komunitetit te Energjise te ratifikuar nga Parlamenti; Zbatimi i kerkesave te legjislacionit per energjite e rinovueshme dhe eficiences se energjise
NK2	Menaxhimi dhe reduktimi i emetimeve të substancave të shtresës së ozonit	Zbatimi i dispozitave të Konventës së Vjenës, Protokollit të Montrealit dhe ngritja e sistemit kombëtar teë monitorimit, verifikimit dhe raportimit te gazeve

f) Menaxhimi i Mbetjeve

Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve aq sa të reduktohen rreziqet për shëndetin publik, mjedisin, dhe tregtinë në përputhje me kërkesat e BE.

Hartimi i Planit Kombëtar për menaxhimin e mbetjeve është një projekt për të ardhmen. Ai përcakton objektiva sfiduese, por realiste, për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në Shqipërisë. I ndërtuar mbi një angazhim fondesh të konsiderueshëm nga ana e Qeverisë Shqiptare për të transformuar praktikat e Shqipërisë për mbetjet, ai përcakton drejtimin e politikave të Qeverisë për administrimin e qëndrueshëm të mbetjeve gjatë 15 viteve të ardhshme (deri 2025).

Menaxhimi i mbetjeve në vend është akoma në një nivel të ulë pasi sistemet për grumbullimin e mbetjeve të ngurta janë pajisur vetëm qytetet, por jo zonat rurale, sasia e mbetjeve që riciklohet është 10%, mbetjet asgjësohen kryesisht në vend-grumbullimet e mbetjeve, nga industritë dhe ato shtëpiake), sistemi i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme

është shume i dobët dhe pjesa me e madhe e grumbullimit te mbetjeve kryhet nga sektori privat, gjithashtu edhe impiantet e riciklimit janë ne pronësi te sektorit privat dhe ndergjegjesimi i publikut për menaxhimin e mbetjeve është në nivele të uleta.

Duke pasur si qëllim arritjen e nivelit te standardeve të BE dhe punën që nevojitet është bërë një punë e madhe për përputhjen me legjislacionin e BE. Ky Plan do të do të ngrejë kuadrin për një përtëritje të planeve lokale dhe rajonale. Politikat Kombëtare për Mbetjet dhe Strategjia përcaktojnë drejtimin e politikave të Qeverisë Shqiptare për vazhdimësinë e menaxhimit të mbetjeve në 2025. Politika nënvizon katër shtyllat kyçe te strategjive në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri si dhe mekanizmat e reja që janë prezantuar për të lehtesuar implementimin përmes këtij plani mbi politikën dhe objektivat strategjike të ekspozuara në Politikat Kombëtare për Mbetjet & Strategjine Kombëtare te Mbetjeve për Shqipërinë. MM merr parasysh katër shtylla politike (PEBL), Planifikimin, Edukimin, Burimet & Legjislacionin në lidhje me implementimin e politikës dhe strategjisë nëpërmjet planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve.

Në Ndërtimin e një Shqipërie të Qëndrueshme Qeveria ka vendosur një objektiv të përgjithshëm për të siguruar përparimin drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve të Shqipërisë dhe arritjen e objektivave të Bashkimit Evropian në konvertimin e landfilleve në një metodologji të verifikueshme deri në vitin 2015, 2020 dhe 2025. Plani ka vendosur gjithashtu dy objektiva të përkohshme ku jane pasqyruar nevojat afatshkurtër për t'u përqëndruar mbi mbetjet bashkiake:

- për të rritur sasinë e mbetjeve të mbledhura nga autoritetet lokale të cilat janë ricikluar apo përzier në 25% deri në vitin 2015, dhe
- për të rritur sasinë e mbeturinave të mbledhura nga autoritetet lokale të cilat janë ricikluar apo përzier në 55% deri në 2020;

Tabela 23:Objektivat Kombëtare në Menaxhimin e Mbeturinave

Masat	Përshkrimi	Masat kryesore prioritare publike
MM1	Përcaktimi i praktikave më të mira për menaxhimin e mbeturinave	Udhëzime për përgatitjen e planeve të menaxhimit te mbeturinave nga autoritetet lokale dhe rajonale dhe në standardet që do të aplikohen në përgatitjen e projekteve për menaxhimin e mbeturinave
MM2	Sistemi i planifikimit për menaxhimin e mbeturinave në vend në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar	Planifikimin, Edukimin, Burime njerëzore dhe përmirësim dhe përditsim i legjislacionit

MM3	Zbatimi i projekteve prioritare për menaxhimin e mbeturinave	Marrja e fondeve dhe zbatimi i projekteve prioritare mjedisore të investimeve për projektet e vendgrumbullimit të mbeturinave në Vlorë, Sarandë dhe Himarë Marrja e fondeve dhe zbatimi i projekteve prioritare mjedisore te investimeve për projektet e riciklimit të mbeturinave
MM4	Zbatimi i projekteve prioritare për menaxhimin e mbeturinave Faza II dhe III	Marrja e fondeve dhe zbatimi i projekteve prioritare mjedisore te investimeve për projektet e vend grumbullimit të mbeturinave- Faza II
MM5	Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme	Të ndalohet groposje e mbetjev të rrezikshme dhe të aplikohen kërkesat për para trajtim të Direktives te Gorposjes. Plani kombëtar i menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme.
MM6	Plotësimi i kuadrit ligjor për menaxhimin e mbeturinave	Ligji i Menaxhimit të Mbeturinave
MM7	Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e mbeturinave në mënyrë që të nxisë sjellje të përgjegjshme	Fushata për të nxitur sjelljen miqësore ndaj mjedisit dhe përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave

Në tabelën e mëposhtme janë disa nga objektivat më të rëndësishme të planit:

g) Ndotja Akustike

Kontrolli i niveleve të zhurmës për sigurinë e popullatës

SKM parashikon që të arrihet deri në 2020, 100% e përputhshmërisë së kuadrit normativ me rregulloret e BE në fushën e zhurmave duke synuar njëkohësisht të reduktohet ndotja akustike me 20% në zonat kryesore urbane, krahasuar me vitin 2012 (vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së ditës te reduktohen nga 70 dB (A) në 56 dB dhe vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së natës të reduktohen nga 55 dB (A) ne 45 dB(A);

Tabela 24: Objektivat për ndotjen akustike

Masa	Përshkrimi	Masat kryesore prioritare publike
NA1	Minimizimi i zhurmave në mjediset e	Forcimi i zbatimit te legjislacionit per zhurmat;

	mbyllura	forcimi i zbatimit të ligjit të bashkëjetesës
NA2	Menaxhimi dhe reduktimi i zhurmave në mjediset e hapura	Rritja e numrit të stacioneve të monitorimit të zhurmave; Studimi dhe Vlerësimi i gjendjes së sinjalistikës rrugore dhe hekurudhore për zhurmat dhe propozimi i masave konkrete për ndërhyrje

Nivelet e zhurmës janë të përfshira tek indikatorët që ndiqen nga Programi Kombëtar i Monitorimit (Vendimi No.103, datë 31/03/2003). Niveli i zhurmave është monitoruar dhe rezulton në përgjithësi nën nivelin që mund të dëmtojë shëndetin. Sidoqoftë, gjatë ditës në shumë qytete pragu normal tejkalohet, ndërsa gjatë natës në përgjithësi është poshtë këtij pragu, me përjashtim të Tiranës.

Niveli i zhurmave në ndërtesa është në përputhje me cilësitë strukturore të tyre. Ulja dhe reduktimi i zhurmave nuk janë objekt i projektimit në ndërtesat tona. Deri më sot shumë pak është bërë për të adresuar çështjet e lidhura me nivelin e zhurmave. Standardet e zhurmave nuk janë vendosur për një aktivitet apo pajisje specifike, me përjashtim të aviacionit.

Duke qenë se nivelet aktuale të zhurmave nuk janë aq akute për shëndetin publik si faktorët e tjerë, kjo çështje nuk është konsideruar si përparësore në një periudhë afatshkurtër. Pavarësisht, hapave për të kontrolluar zhurmat qe do të ndërmerren në të ardhmen si në rastin e automjeteve që kalojnë ne rrugë, si pjesë e masave për cilësinë e ajrit.

3.2.2 Objektivat Kombëtare të Planifikimit të Territorit (Ligji 107/2014)

Që nga Korriku i vitit 2014, Shqipëria ka kthyer faqe të re në rrugën drejt arritjes së standardeve të BE në planifikimin hapësinor dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit në hyrjen në fuqi të **Ligjit 107/2014** ***për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit*** dhe akteve nën ligjore, i cili zëvendëson Ligjin 10119/2011 *për Planifikimin Territorial.* Kjo strukturë e re ligjore krijon sistemin e planifikimit territorial të Shqipërisë nëpërmjet krijimit të dy institucioneve, si dhe instrumenteve dhe procedurave që karakterizojnë praktikat bashkëkohore të planifikimit Evropian dhe sistemit të menaxhimit të tokës. Kompetencat e planifikimit të territorit janë ndarë midis autoriteteve të planifikimit kombëtare dhe lokale.
Bazuar në këtë kuadër të ri, është paraparë që i gjithë territori i Shqipërisë do të pajiset me plane lokale që duhet të përgatiten nga njësitë e qeverisjes vendore qoftë në veçanti ose së bashku me njësi të tjera, për të gjithë territorin duke mbuluar kufijtë e tyre administrative. Planet lokale duhet të mbështesin qëllimin e mëposhtëm gjithëpërfshirës, siç thuhet në nenin 1, duke synuar:

Tabela 25:Planifikimi i Territorit

Masat	Përshkrimi
PT1	të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
PT2	të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për: i) mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet; ii) krijimin e garantimin e territoreve të ndërtueshme, të organizuara në mënyrë të harmonizuar e funksionale, duke i dhënë përparësi hapësirës publike, mundësisë së banimit për të gjitha shtresat ekonomike e sociale, krijimit të infrastrukturës fizike të përshtatshme për nxitjen e investimit në ushtrimin e veprimtarive ekonomike, sociale e kulturore, lehtësimit të përdorimit të sigurt të shërbimeve e komoditeteve publike, të transportit, komunikimit dhe infrastrukturës, përfshirë territoret e përshtatura; iii) nxitjen e jetës ekonomike, shoqërore e kulturore në nivel kombëtar e vendor; iv) garantimin e burimeve të furnizimit të mjaftueshëm dhe veçanërisht atij jetësor; v) garantimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare; vi) nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal për të siguruar shpërndarje të qëndrueshme të popullsisë në vend në bazë të burimeve
PT3	të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;
PT4	të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me dokumentet planifikuese dhe sipas legjislacionit mjedisor në fuqi;
PT5	të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë;
PT6	të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale;
PT7	të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit;

Për më tepër siç shprehet dhe në Nenin 20, objektivat e *Planit të Përgjithshëm Vendor* duhet të jenë:

a) balancimi i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor;

b) krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor dhe sipas parimeve të këtij ligji;

c) drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme;

ç) rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;

d) planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;

dh) rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturat publike e servitutet publike, sipas këtij ligji;

e) rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

3.2.3 Plani i Përgjithshëm Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit.

Plan i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin (PINS) do të shërbejë për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit bregdetar, duke mundësuar përdorim e balancuar të resurseve përgjatë vijës bregdetare me shtrirje veri- jug. Për një çështje lehtësie të menaxhimit të proçesit, brezi bregdetar menaxhohet në 4 nënzona, sipas tipareve të ngjashme territoriale, por vizioni i zhvillimit dhe politikat e hartimit të Planit Ndër Sektorial të Turizmit Bregdetar do të shërbejnë si një "mbulesë" e vetme për të gjithë brezin bregdetar, dhe ç'është më e rëndësishmja, do të jenë të integruara me vizionin dhe politikat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

- Zona 1: Velipojë – Derdhja e Lumit Mati
- Zona 2: Derdhja e Lumit Mat – Derdhja e Lumit Shkumbin
- Zona 3: Derdhja e Lumit Shkumbin – Derdhja e Lumit Vjosë
- Zona 4: Derdhja e Lumit Vjosë – Butrint *(zona e studimit tonë)*

Vizioni i shprehur sipas PINS Bregdetit është:

Bregdeti Shqiptar si një aset i rëndësishëm kombëtar dhe pjesë e integruar e rrjetit Mesdhetar me nje hapësirë te mirëmenaxhuar ku harmonizohen nevojat për zhvillim ekonomik dhe nevojat lokale me domosdoshmërinë e mbrojtjes së aseteve kulturore, natyrore dhe historike duke u bere nje destinacion autentik, i shumëllojshëm dhe i pastër.

Mungesa e deri tanishme e një PINS për bregdetin ka shkaktuar parcelizimin e planifikimit, aty ku kompetencat dhe juridiksionet territoriale ndahen. Për më tepër të gjitha planet vendore dhe ato rajonale (të pakta në numër), si dhe zhvillimet deri më sot, janë jetësuar pa rakorduar një vision të qartë rajonal, e aq më pak kombëtar. Ndaj, hartimi i PINS Bregdetit ishte një nevojë urgjente për të ndaluar përkeqësimin e situatës në territorin e bregdetit dhe jo vetëm.

Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin do të përfshijë të gjitha bashkitë e reja që preken nga brezi bregdetar tek të cilat përfshihen: Vlora, Himara, Saranda dhe Konispoli.

Si pasojë e sensibilitetit të menaxhimit të zonës bregdetare të Republikës së Shqipërisë, duke konsideruar rëndësinë e veçantë që ka ky territor si dhe duke marrë parasysh problematikat aktuale që shfaqen në administrimin e saj, nevojitet një menaxhim i integruar i kësaj zone, i cili mund të kryhet duke respektuar dhe vendosur objektiva të qarta, të cilat duhet të:

- *Lehtësojnë përmes planifikimit racional, zhvillimin e qëndrueshëm të brezit bregdetar, duke siguruar që mjedisi dhe peisazhet të trajtohen në harmoni me zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor;*
- *Ruajnë potencialin natyror të zonave bregdetare edhe për brezat e ardhshëm;*
- *Sigurojë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, veçanërisht në lidhje me përdorimin e ujit;*
- *Sigurojnë ruajtjen e integritetit të ekosistemeve bregdetare, peisazheve dhe gjeomorfologjisë;*
- *Parandalojnë dhe pakësojnë efektet e rreziqeve natyrore dhe në veçanti ato të ndryshimit të klimës, të cilat mund të shkaktohen nga faktorë fizikë apo aktivitetet njerëzore;*
- *Vendosin koherencë ndërmjet iniciativave publike dhe private nga ana e autoriteteve publike, në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, të cilat ndikojnë në përdorimin e brezit bregdetar.*

Gjatë zbatimit të këtij "Protokolli Objektivash" palët do të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme të menaxhimit të integruar të brezit bregdetar:

- *Pasuritë biologjike, dinamikën natyrore dhe funksionimin e integruar të gjithë brezit duke plotësuar dhe ndërlidhur pjesët e natyrës detare me pjesët e tokës.*
- *Të gjitha elementet që lidhen me aspektet hidrologjike, gjeomorfologjike, klimatike, ekologjike, social-ekonomike dhe kulturore, sistemet që duhet të trajtohen në mënyrë të integruar pa tejkaluar kapacitetet dhe potencialet natyrorë të zonave bregdetare, si dhe të parandalojnë efektet negative që mund të shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara prej aktiviteteve zhvillimore.*
- *Duhet të zbatohet planifikimi dhe menaxhimi i ekosistemeve bregdetare në mënyrë që të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të brezit bregdetar.*
- *Qeveria duhet të sigurojë pjesëmarrjen dhe transparencën në këtë proces për të krijuar ura komunikimi gjatë vendimmarrjeve me komunitetet lokale dhe aktorët e shoqërisë civile.*
- *Organizmi ndër-sektorial i institucioneve të koordinuara (rajonale dhe lokale) për shërbime të ndryshme administrative në zonat bregdetare*
- *Formulimi i strategjive të përdorimit të tokës, planeve dhe programeve që mbulojnë zhvillimin urban dhe social-ekonomik, si dhe politikave të tjera sektoriale përkatëse të nevojshme për projektet rehabilituese ose zhvillimore.*

- *Duhet të merret në konsideratë shumëllojshmëria dhe diversiteti i aktiviteteve të shërbimeve përgjatë brezit bregdetar, prioritetet që do t'u jepen në raport me përdorimin dhe vendndodhjen.*
- *Të bëhen vlerësime paraprake të rreziqeve që lidhen me aktivitetet e ndryshme njerëzore dhe infrastrukturën, në mënyrë që të parandalohet dhe zvogëlohet ndikimi i tyre negativ në hapësirën bregdetare*

Tabela 26 : Përmbledhja e objektivave të Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin (PINS) është si më poshtë:	
Urbanizimi BJ-1	Objektiva Sektoriale 1: Orientimi drejt një zhvillimi të qëndrueshëm urban Objektiva Sektoriale 2: Zhvillimit sipas arkitekturës tradicionale
Infrastruktura BJ-2	Objektiva Sektoriale 1: Aktivizimi i zonave potenciale përmes infrastrukturës së transportit publik të diversifikuar për turizëm Objektiva Sektoriale 2: Mbulimi i bregdetit me infrastrukturën primare
Energjia BJ-3	Objektiva Sektoriale 1: Përdorimi i energjive të rinovueshme Objektiva Sektoriale 2: Eficensë energjie në ndërtim
Ekonomia BJ-4	Objektiva Sektoriale 1: Rritje ekonomike per te qene zona më e zhvilluar në vend dhe një rajon turistik konkurues në rajon Objektiva Sektoriale 2: Nxitje e avantazhit konkurrues
Turizmi BJ-5	Objektiva Sektoriale 1: Shndërrimi i bregdetit shqiptar në një destinacion unik Objektiva Sektoriale 2: Zgjatja e sezonit turistik
Bujqësia BJ-6	Objektiva Sektoriale 1: Kthimi i bujqësisë në një sektor primar në ekonominë e vendit Objektiva Sektoriale 2: Marketim të produktit lokal
Natyra BJ-7	Objektiva Sektoriale 1: Shtimi i zonave të mbrojtura mjedisore Objektiva Sektoriale 2: Mbrojtja nga erozioni, rrëshqitja dhe përmbytja

3.4 Përmbledhje e Objektivave

Hartimi dhe ndërtimi i Strategjive Kombëtare në pjesën më të madhe të tyre janë në përputhje me strategjitë e vendeve të Bashkimit Evropian, si p.sh ato për ndryshimet klimatike, në zhvillimin e biodiversitetit të qëndrueshëm dhe pak a shumë me shtatë objektivat e veçanta të tematikave strategjike të Planit te Veprimit Mjedisor 6 të BE-së edhe pse fillimisht me element të reduktuar të synuara. Në parim qasja për VSM e ndjekur në rastin e Bashkisë ka ndjekur, së pari përputhshmërinë me objektivat kombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm që përbejnë shumicën e atyre ndërkombëtare. Kur kjo përputhshmëri nuk ka qenë e mundur apo e zbatueshme, në rastin kur politikat kombëtare nuk janë përputhur akoma me ato

ndërkombëtare, është marrë parasysh eksperienca ndërkombëtare dhe është trajtuar kapaciteteve dhe mjedisit administrative dhe ekonomik të Bashkisë, në përpjekje për të shtyrë objektivat e VSM për të përfshirë gjithashtu dhe objektivat ndërkombëtare siç është ndryshimi i klimës aktiviteteve te lidhura me te dhe veprimet ndërgjegjesuese.
Në Planin e zonës në studim Objektivat e VSM, që do trajtohen me gjerësisht në kapitujt e mëposhtëm, janë shumica e objektivave të VSM të lidhura me objektivat e BE-së për zhvillim të qëndrueshëm, të cilat nga ana e tyre janë të përfshira në masë të madhe në Planin e objektivave Kombëtare.

Në plan të parë mbahet gjithnjë ruajtja e parametrave mjedisor duke patur parasysh këtu rëndësinë kombëtare dhe ndërkombëtare të lagunave, ZMD-ve, parkun kombëtar dhe të biodiversitetit të lidhur ngushtë me konservimin e saj duke u bazuar në qëllimet dhe objektivat e Strategjisë Pan-Evropiane të Larmisë Biologjike dhe Peizazhore

Lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Mjëvjeçarit, plani i dhe VSM-ja përkatëse kanë adresuar çështjet e " Reduktimin e Varfërisë se skajshme" nëpërmjet zhvillimit të komponentit ekonomik të planit, qasjes në shkollat fillore (duke ofruar jo vetëm një plan për këtë nivel të ulët të arsimit, por edhe për ato të nivelit të arsimit të mesëm), për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm, një qëllim që mund të përdoret akoma nga VSM dhe plani është "*krijimi i Partneritetit Global për zhvillim*". Krijimi i partneriteteve ndërkombëtare me qytete të tjera të ngjashme, por në nivelin më të përparuar (në aspektin e zhvillimit ekonomik, planifikimi mjedisor dhe atij urban), mund të ndihmojë bashkinë për të marrë njohuri dhe përvojë në përpjekjet e saj për të ndjekur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
Kështu, përveç shtatë strategjive të përmendura më sipër, të tjerat janë më rigoroze, si ajo e ndjekur për parandalimin e mbeturinave dhe riciklimin, për mbrojtjen e tokës, për mjedisin detar /ujë, cilësinë e ajrit në përshtatjen graduale, sikurse edhe përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve për ruajtjen e shëndetit të popullatës, metodat ndërtimore bioklimatikisht te qëndrueshme etj.

Laguna dhe Biodiversiteti

Plani i Bashkisë ndër të tjera përfshin edhe trajtimin e zonave të mbrojtura përmes VKM dhe që zhvillohen sipas një plan menaxhimi të miratuar. Kjo përbën një element të rëndësishëm të objektivave të VSM. Parku i Llogarasë, ZMD Karaburun Sazan, Laguna e Nartës, e Orikumit janë zonat me rëndësi të madhe për bashkinë dhe për vendin. Laguna përbën ekosistemin më të spikatur në zonën në studim dhe në nivel kombëtar. Plani respekton objektivat kombëtare (B1,B3) dhe ato ndërkombëtare (RAMSAR, 2000/60/EC etj). Gjithashtu në Plan shqyrtohen mënyrat e zhvillimit të qëndrueshëm duke respektuar habitatet dhe sidomos ato të specieve me

rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Objektivat e VSM duhet të përputhen me menaxhimin e basenit lumor, nxjerrje të ujit dhe zbutjen e ndotjes dhe ku është e aplikueshme me zona të mbrojtura dhe llojeve të masave.

Menaxhimi i Burimeve Ujore

Burimet ujore në Bashki Vlorë janë një objektiv kryesor i VSM. Në Planin e paraqitur është trajtuar gjerësisht problematika *së pari*, vihet re mungesa e menaxhimit të burimeve ujore, *së dyti*, për rëndësinë e madhe që ka zhvillimi i industrisë së turizmit në Bashki dhe *së treti* për rëndësinë e ujit në shëndetin publik.

Të gjitha masat e Objektivave Kombëtare të zbatuara për rastin e Bashkisë (projekte përparësore në sektorët e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, të programit të investimeve, reduktimi i ndotjes se burimeve ujore sipërfaqësore, mbrojtjen e ujërave nëntokësore etj) dhe duhet të pasqyrohet në VSM-ne e kësaj Bashkie.

Mbrojtja e Tokës

Mbrojtja e tokës përbën një nga objektivat kryesore të planit të Bashkisë duke marrë në mbrojtje fondin e tokës (Novoselë, Panaja, Sherishtë, etj) dhe në mënyrë të veçantë atë bujqësore, nëpërmjet parimeve dhe udhëzuesit të tij. Gjithashtu një vend të veçantë zë riaftësimi i tokave të kripëzuara, tokave në rrezik përmbytje përmes rigjenerimit të sistemit të drenazhimit apo atij kullues ekzistues, ujitjen, hedhjen e pakontrolluar e mbeturinave etj, pra praktikisht të gjitha objektivat kombëtare zbatohen për rastin e kësaj bashkie. Mbrojtja e tokës përbën edhe një nga objektivat kryesore të VSM të Bashkise.

Cilësia e Ajrit

Bashkia karakterizohet nga një cilësi ajri e pastër (sipas raportit mjedisor 2015) por një numër presionesh vijnë nga zhvillimi industrial i saj (TEC, Petrolifera, ndërtimi etj), trafiku i rënduar sidomos në periudhën e verës, të cilët cenojnë këtë pastërti ajri. VSM-ja i ka identifikuar presionet mjedisore që lidhen me nevojën rishikimit të pranisë së këtyre industrive, kontrollit mbi to lidhur me emetimet në ajër, shkarkimeve të ujërave etj, për të zvogëluar ndotjen nga trafiku, nevoja për të kontrolluar emetimet e pluhurave gjatë ndërtimit të godinave te nevojshme, si dhe për të reduktuar emetimet nga vendgrumbullimi i mbetjeve. Objektivat e VSM do të vendosen ne përputhje me çështjet e mësipërme të ngritura dhe objektivat përkatëse kombëtare.

Ndryshimet Klimatike

Objektivat lidhur me ndryshimet klimaterike janë të lidhura ngushtësisht dhe në varësi të iniciativave dhe planeve kombëtare, sidoqoftë vendosja dhe zbatimi i niveleve të emetimeve që

lëshojnë apo do të lëshojnë aktivitetet industriale në afërsi të territorit të Bashkisë do të përbënin një ndër objektivat e VSM. Kjo do të ndikonte në ndërgjegjësimin e popullatës për të kontribuar në nivel kombëtar, në përdorimin me efikasitet të energjisë dhe në përdorimin e energjive të rinovueshme që mund të zhvillohen në nivel lokal. Në mënyrë specifike prania e TEC në brendësinë gjeografike të territorit të Bashkisë e bën edhe më aktual këtë objektiv të VSM.

Menaxhimi i Mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve është një ndër presionet mjedisore të Bashkisë i cili gjen zgjidhje në Planin e saj, në mënyrë të veçantë problemin e vend-hedhjes së tyre dhe atë të përpunimit. VSM 3 merr parasysh këtë zgjidhje por do të kërkojë edhe planin e menaxhimit të plotë të mbeturinave, listën e projekteve prioritare lehtësuese si për reduktimin dhe eliminimin e aktiviteteve ekzistuese te pakontrolluara te depozitimit të mbetjeve ashtu dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve për të ardhmen e Bashkisë. VSM merr në konsideratë mjediset (ish-fusha e aviacionit, etj) që janë në territorin e Bashkisë që me praninë e tyre ndikojnë në ekosistemin e saj siç është rasti për mbetjet e rrezikshme, mjekësore apo industriale apo edhe ato të rrezikshme

Ndotja nga Zhurmat

Ndotja nga zhurmat nuk është një presion i konsiderueshëm mjedisor në Bashki, sidoqoftë prania e parkut energjetik e porteve dhe e trafikut të rënduar në sezonin e verës krijon premisa për një ndotje të tillë, po ashtu edhe shtimi i aktiviteteve të shërbimit. Kjo do ketë të bëjë me monitorimin dhe me zbatimin e ligjeve të zhvillimi në përputhje me ato të kombëtare dhe ato të BE.

3.5 Bashkëngjitja e Objektivave Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Plan

Tabela 27: Tabela koordinuese e 5 Sistemeve dhe e Objektivave të SEA

Nr	*Objektivat e VSM-së (të koordinuara me sistemet territoriale)*	*Përshkrimi*	*Objektivat Kombëtare + Ndërkombëtare*
01	**Sistemi Urban** *Zhvillimi i*	Promovimi i mundësive të të ardhurave dhe përfitimeve për pjesë të ndryshme të Bashkise Vlore duke marrë në konsideratë avantazhet e veçanta dhe nevojat e seciles njesi	**PT2, PT4, PT5,**

	qëndrueshëm social ekonomik per mbrojtjen e mjedisit	administrtive. Krijimi i marrëdhënieve plotësuese me qëllim të përhapjes së ndikimeve pozitive të zhvillimit të turizmit në të gjithë territorin.	
02	**Sistemi Ujor** ***Promovimi i vlerave mjedisore dhe panoramike***	Promovimi i lagunave te Nartes, Orikumit, Parkun Llogora- Karaburunit si një destinacion i veçantë i turizmit dhe tërheqjes së turistëve, natyra, peizazhi dhe vlerat kulturore e të cilit, duhet të shijohen nga vizitorët në mënyra të ndryshme. Promovimi i çdo forme të turizmit në harmoni me mjedisin në zonë, të tilla si ekoturizmi, turizmi kulturor dhe turizmi sportiv.	
03	**Sistemi Bujqesor** ***Impakti mjdisor ne ne aktivitetet tradicionale ekonomike***	Mbrojtja e statusit të tokës bujqësore dhe mbështetja e ekonominë rurale.Kursimi dhe shfrytezimi i tokes ekzisutuese bujqesore ne qellimin e saj primar. Promovimi i kombinimit të aktiviteteve tradicionale ekonomike me zhvillimin e formave të veçanta të turizmit (ekoturizmi dhe agroturizmi).	**MT2, MT3,**
04	**Te gjithe sistemet** ***Promovimi i bashkepunimit nderinstitucional dhe rritja e kapaciteteve menaxhuese mjedisore***	Zhvillimi i sinergjive midis Instrumentit të Përgjithshëm të Planifikimit Vendor dhe Planet e Menaxhimit Mjedisor (Laguna Nartes, zones se mbrojtur e Karaburunit dhe Parkut te Llogorase me qëllim të forcimit të kapaciteteve vendore për planifikimin, menaxhimin dhe monitorimin e burimeve natyrore të zonës së projektit. Përdorimi i IPV-së dhe VSM-së si platformë për bashkëpunim institucional me Bashkine e Vlorës dhe institucioneve të planifikimit kombëtar në fushën e planifikimit të infrastrukturës dhe menaxhimit të pasurive natyrore.	**PT2, PT3**
05	**Sistemi Urban** **Përmirësimi i cilësisë së mjedisit per parandalimin e rrezikut te shendetit publik** **(cilësia e ujit të detit, lumenjve, mbrojtja e lagunave , ruajtja**	Nxitja e rishikimit të politikave ekzistuese kontradiktore kombëtare të cilat parashikojnë zhvillimin e aktiviteteve të reja industriale të rrezikshme në afërsi të lagunës Nartes , zonës bregdetare pergjate portit Vlores dhe zones industriale . Zbatimi i rregullave më të rrepta për funksionimin e aktiviteteve ekzistuese industriale të cilat mund të kenë një ndikim të mundshëm negativ në ekosistemin laguns dhe pergjate zones se zhvillimit .	**CA1, CA3, CA4, MM, B6, MT2, MK1, MBU7**

	e cilësisë së ajrit, vlerësimi i veprimit të zonave industriale)		
06	**Sistemi Natyror** **Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit përmes mbrojtjes së bregdetit dhe pjesës ujore të marinës (mbrojtja e cilesisë se detit, pejsazhit, zonave natyrore)**	Sigurimi i planifikimit të duhur të aksesit të transportit pergjate plazheve te Bashkise Vlore , zhvillimi i zonave të parkimit dhe organizimi i zonave të shërbimeve në plazh. Mbrojtja e karakterit natyror të zonës bregdetare.	**PT1, B2**
07	**Sistemi Natyror** **Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit** ***(ruajtja e pejsazhit,zonave te mbrojtura natyrore, biodiversitetit)***	Kufizimi i qarkullimit te automjeteve përreth lagunave dhe zonave te mbrojtura vetëm në rrugë të caktuara. Nxitja e politikave për ekspozimin e peizazhit dhe përmirësimin e natyrës.Lejimi i formave të organizuara të zhvillimit të turizmit në zonën bregdetare në vende të caktuara, të përcaktuara nga zonimi i hapësirës dhe në lidhje me kufizimet e mjedisit si me poshte.	**PT3**
08	**Sisteme Ujor + Infrastrukturor** **Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit** ***(shëndeti i njerëzve, specieve të rrezikuara, cilësisë së ujrave siprfaqesore dhe nentokesore)***	Parandalimi i shkarkimeve te mëtejshme të ujërave te patrajtuara nga veprimtaritë industriale në kanalin e Nartës dhe ne detin Jon si dhe pergjate lumit Vjose apo dhe degeve te saj ne pjesen e territorit bashkise Vlore. Nxitja e zhvillimit të sistemit efikas të kanalizimit dhe ndërmarrja e masave për pastrimin e vendeve ekzistuese të ndotura si Pylli Sodes etj. Ruajtja nga ndotja e ishullit Sazanit	**MBU2, MBU3, MBU5**

09	**Sistemi Ujor** **Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit** ***(vend pune, ujerat siperfaqesore biodiversiteti, toka)***	Kontrollimi dhe rregullimi i aktiviteteve tradicionale ekonomike (të tilla si peshkimi, gjuetia, kullotja), balancimi i ujit në lagunat Narte, Orkum , nxjerrja e ujit dhe ndërhyrjeve hidrologjike pranë ligatinave bregdetare, zhvillimi i pakontrolluar i infrastrukturës dhe aktiviteteve turistike dhe rrezikut ndaj zjarrit.Kontrollimi i aktivitetit te rezervateve te molusqeve ne Orikum	**MT1, MT2**
10	**Sistemi Bujqesor** **Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit** ***(Cilësia e tokës, habitatet, cilësia e ujit, punesimi, flora fauna)***	Nxitja e përmirësimit të tokës në mënyra të ndryshme, të tilla si rehabilitimi i tokës se kripur ish njesia administrative Novosel, Qender,pjeserisht Orikum , përmirësimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës së vaditjes ne keto njesi dhe me gjere , ripyllëzimi dhe përmirësimi i peizazhit zona e parkut Llogora dhe ne perspektive Karaburun,ndërmarrja e investimeve të rëndësishme që lidhen me qarkullimin e ujit të detit.	**PT1, MT2, B1, B2**
11	**Te gjitha Sistemet** **Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit-Ndergjegjesimi i Publikut** ***(Shendeti i njerëzve,, cilësia e ujit, ajrit,biodiversitet, trashegimia kulturore)***	Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe rritja e përfshirjes se komunitetit lokal në mbrojtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe Peizazhore të vendit nëpërmjet reklamave, programe edukative, sinjalistikës dhe alteve të tjera pilote.	**B7, MM7**
12	**Sistemi Urban** **Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit** **(trashëgimia kulturore dhe mjedisi historik si asete , vende pune)**	Mbrojtja, shtimi dhe rikualifikimi i monumenteve kulturore dhe trashëgimisë arkitekturore. Sigurimi i zonave mbrojtëse tampon duke parandaluar ndërtimin në afërsi të vendeve të trashëgimisë kulturore. Përmirësimi i aksesit dhe sinjalistikës.	**PT3, B1**

13	**Sistemi Infrastrukturor** **Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardeve te shëndetit- Cilesia e Ajrit**	Përmirësimi i kualitetit te ajrit nepermjet reduktimit te transportit rrugor te automjeteve , shtimin etransportit publik ne kete kontekst si dhe zhvillimin e transportit detar alternativ.Krijimi i rrugeve piktoreske per turistet Karaburun si dhe lidhja turistike (ujore) e Sazanit.	**CA1,CA3**
14	**Sistemi Infrastrukturor** **Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit – Cilesia e Ujit** ***(cilësia e jetës,vende pune, cilësisë së ujit, furnizimit energji)***	Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujit të pijshëm me qëllim furnizimin e të gjithë vendbanimeve dhe zonave turistike se Bashkise Vlore . Sigurimi i lidhjes midis zonave ekzistuese me zonat rezidenciale te reja te planifikuara dhe atyre turistike me rrjetin e kanalizimit me prioritet në zonën bregdetare pergjate Orikumit, pjeses bregdetare deri ne Skele.Përmirësimi i kapacitetit të sistemit të furnizimit me energji elektrike me qëllim për të mbuluar zonat bregdetare, zonat informale te qytetit te Vlores e me gjere ne te gjithe njesite administrative Novosele, Orikum, Qender, Shushice, Vlore .	**PT2, 6, MBU2, MBU3**
15	**Sistemi Infrastrukturor** **Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit – Menaxhimi mbetjeve *(cilësia e tokës, cilësia e ujit, cilësia e ajrit, shëndetin)***	Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave nga zonat e vendbanimeve dhe zonat turistike. Parandalimi i hedhjes te paautorizuar te mbetjeve industriale dhe të ndërtimit në zonat natyrore.trjatimi i mbetjeve ne nje pike te vetme grumbullimi si kusht per uljen e rrezikut te shendetit. Promovimi i programeve ricikluese dhe te pastrimit për zonën bregdetare të lagunës.	**MM2, MM5**
16	**Sistemi Infrastrukturor** **Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit – Cilesia e jetes** ***(Cilesia e jetes,mjedisi urban,te mirat materiale,peisazh)***	Përmirësimi i infrastrukturës lokale sekondare në zonën e vendbanimeve ne qytet te Vlores si dhe zonat informale te saj. Përmirësimi i aksesit të zonave periferike te Bashkise Vlore vecanerisht per pjeset e thella te Novoseles verilindore si dhe pjesen malore teTragjasit,Dukatit e Shushices. Sigurimi i instrumenteve të planifikimit urban dhe menaxhimit të tokës për zhvillimin e rrjetit sekondar të rrugëve dhe rregullimin e ndërtimit.	**PT2, 6**

17	**Sistemi Urban** **Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit publik** ***(siguria publike, cilësia e ujit, cilësia e tokës)***	Zbatimi i kontrollit me të rreptë nga organet e specializuara ne fushat e zhvillimit te infrastrukturës publike në lidhje me rrezikun e mundshëm ndaj sigurisë publike ne përputhshmëri me ligjin. Heqja e strukturave që nuk i plotësojnë kriteret. Parandalimi i ndërtimeve te mëtejshme te banimit në afërsi të vendeve të cilat paraqesin rrezik për sigurinë publike. Sigurimi i objekteve të ndihmës së parë dhe pikave vrojtuese në te gjithe plazhet e Bashkise Vlore .	**PT1, PT8**
18	**Sistemi Bujqesor** **Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit publik** ***(siguria publike, cilësia e ujit, cilësia e tokës)***	Ndërmarrja e investimeve për pastrimin e pritave dhe masa për mirëmbajtjen e sistemit të kullimit, për të mënjanuar përmbytjet e tokave dhe grumbullimin e mbetjeve në afërsi të digave.	**MT2**

4. SKENARË / ZGJIDHJET ALTERNATIVE

4.1 HYRJE

Procesi i VSM është instrumenti që ndihmon grupet e interesit për të kuptuar më mirë avantazhet qe i jep Plani zonës së studimit. Për kryerjen e këtij procesi ekipi do të bëje vlerësimin e ndikimeve te mundshme mjedisore, sociale dhe ekonomike të Instrumentit të Planifikimit Lokal si dhe alternativat e pranueshme që mund të ishin ndjekur, pa ekzistencën e këtij plani të veçantë. Roli i VSM nuk është për të vendosur mbi alternativat që duhen zgjedhur, por për të dhënë informacion mbi performancën relative mjedisore, sociale dhe ekonomike të alternativave të ndryshme, për të lehtësuar në këtë mënyrë marrjen e vendimeve midis palëve të interesuara dhe për të ndihmuar në përcaktimin e drejtimeve përfundimtare të Planit lokal, si edhe ndryshimet dhe shtesat pozitive

Alternativat e vlerësuara këtu janë marrë nga plani duke u zhvilluar rreth llojit ideal të turizmit që duhet promovuar për zonën bazuar në një seri kufizimesh dhe vendimesh buxhetore si edhe në skenarët e zhvillimit.

Tre (3) skenarët e përzgjedhur bazohen në supozimet e mëposhtme:

a) Skenari zero, ku zhvillimi i ardhshëm ndjek trendet ekzistuese, dmth një rast ku nuk janë zbatuar propozime të veçanta të ndërhyrjes sipas planit
b) Skenari ambicioz i intensifikimit të zhvillimit që ndryshon rrënjësisht potencialin e zhvillimit të turizmit, sipas projekteve të parashikuara në infrastrukturën e transportit, por implikon alokimin e burimeve serioze për investime dhe stres të konsiderueshëm të burimeve mjedisore të zonës.
c) Skenari konservativ i mbrojtjes së mjedisit i cili lejon vetëm forma miqësore mjedisore të zhvillimit të turizmit, suksesi i të cilit qëndron mbi harmonine e forcave më të gjera sociale dhe ekonomike, angazhimeve të forta të politikave dhe investimeve publike afatgjatë.

Për çdo alternativë, vlerësimi mbi 5 sistemet territoriale do të kryhet kundrejt objektivave të VSM, ndërsa do të bëhet përpjekje në mënyrë që efektet pozitive të secilit të përfshihen në alternativën përfundimtare të zgjedhur. Vlerësimi i skenarëve do të bëhet sipas një sistemi të gravitetit nga minus dy (-2) të një ndikimi të rëndë negativ në plus dy (2) të ndikimit pozitiv me shkallë që variojnë "-2, -1, 0 (pa ndikim), +1 , +2 ".

Tre skenarët e vlerësuar, në mënyrë të detajuar kanë qëllimet si më mëposhtë:

A. Skenari A: Skenari i ekzistues (asgje ose zero)

Skenari i parë është i bazuar në vazhdimin e trendeve ekzistuese. Vlora do të vazhdojë të rritet në mënyrë lineare përgjatë bregdetit jugor duke formuar gradualisht një korridor të vazhdueshëm bregdetar urbanizimi nga Vlora në Orikum. Mungesa e kontrollit të zhvillimit urban do të vazhdojë të ndikojë negativisht në cilësinë e peizazhit bregdetar dhe periurban, duke reduktuar kështu potencialin për zhvillimin e cilësisë së turizmit përgjatë bregdetit Jon. Zonat informale të banimit brenda zonës ekzistuese urbane do të vazhdojnë të paraqesin periferialitet të lartë për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe shërbimeve, dhe qendra historike do të vazhdojë të përkeqësohet si rezultat i mungesës së interesit për investime. Projekti Lungomare do t'i japë një shtysë pozitive turizmit 'diell dhe plazh' por duhet adresuar ndikimi trafikut. Mungesa e infrastrukturës mjedisore, (trajtimi i ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave) që ndikojnë në cilësinë e ujit të detit përbën një kërcënim të rëndësishëm për atraktivitetin e produktit turistik. Prania e përdorimeve me ndikim negativ mjedisor në perëndim të Vlorës, duke filluar nga Landfilli dhe duke vazhduar me portin Petrolifera dhe TEC-in zvogëlon atraktivitetin e bregdetit Adriatik. Modeli i turizmit i fokusuar në turizmin 'diell dhe plazh' dhe shtëpi të dyta do të vazhdojë të gjenerojë një model të paekuilibruar të zhvillimit territorial në drejtim të bregdetit dhe braktisje të zonave malore. Pjesa tjetër e burimeve turistike, vendet kulturore dhe natyrore, të tilla si kalaja e Kaninës, manastiri i Zvërnecit dhe Parku Kombetar i Llogara Karaburunit do të vazhdojë të luajë një rol të vogël në produktin e turizmit pa tërhequr më shumë vizitorë. Konkurrenca e produkteve bujqësore do të vazhdojë të ketë një vlerë të ulët të shtuar për turizëm dhe cilësiae jetës në fshatrat e largëta të bashkisë do të mbetet të ulët duke çuar në braktisje të mëtejshëme. Ky skenar përbën shpërndarjen më të çekuilibruar territoriale dhe vendos theksin vetëm në një pjesë të territorit të bregdetit.

Skenari B: Intensifikimi i zhvillimit urban dhe turistik

Skenari i dytë përcakton qëllimin ambicioz të intensifikimit të zhvillimit urban dhe turistik të Vlorës si një destinacion turistik. Ai fillon me investimet aktuale dhe të parashikuara në infrastrukturën e transportit, përkatësisht aeroporti rajonal, përfundimi i unazës së Vlorës, projekti rruga e Lumit që do të lidhë Vlorën me korridor SH4 dhe Himaren dhe zhvillimi i një marine të re dhe terminalit të lundrimit në portin e Vlorës. Këto investime të rënda në infrastrukturë do të ndryshojnë tërësisht karakteristikat lidhur me vendndodhjen e zonës dhe do të krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit ndërkombëtar në numra shumë më të lartë duke sjellë si pasojë edhe investimet private. Vendndodhja e aeroportit rajonal në Akerni do ta bëjë Vlorën përfituesen direkt si porta kryesore dhe pika e mbërritjes për vizitorët e huaj, por ndërkohë do të shkaktojë ndikim të rëndësishëm në mjedis nëpërmjet shndërrimit të tokës bujqësore dhe natyrore në sistem urban. Ky ndikim prek në mënyrë të drejtpërdrejtë Novoselen

dhe në mënyrë të tërthortë të gjithë rajonin. Mundësia për të zhvilluar Orikumin si destinacion turistik në masë do të krijohet për shkak të aksesit 30min nga aeroporti përmes rrugës bypas. Përfundimi i bypasit të Vlorës do të ketë një efekt pozitiv në zhbllokimin e trafikut përgjatë bregdetit, por ndërkohë do të përmirësojë aksesin e zonave malore por edhe rritjen e kërkesës për tu zhvilluar në pjesët malore të bregdetit. Fshati i Kaninës do të përballet me kërkesën më të lartë sikurse dhe Rradhima. Projekti i Lumit do të ndikojë trendet e zhvillimit në pjesën lindore të qytetit Vlore, korridori Babica-Peshkëpi do të rrisë kërkesën për zhvillimin e ri të aktiviteteve ekonomike. Krijimi i marinës dhe terminalit të lundrimit do t'i japë një nxitje të madhe zhvillimit të turizmit detar por do të sjellë një ndikim negativ në cilësinë e ujit të detit në pjesën qendrore të gjirit. Fokusi territorial i këtij lloji të turizmit është në zonën bregdetare, megjithatë rritja e turistëve ndërkombëtarë me shumë gjasa do të gjenerojë stimuj për përhapjen e shpërndarjeve pozitive mbi pjesët e tjera të zonës lidhur kjo me vendet kulturore dhe natyrore, të tilla si ajo e lagunës së Nartës. Por ndërkohë ekosistemi i lagunes do të ndikohet negativisht nga afërsia me aeroportin e ri. Nevojitet të merren masa për mbrojtjen e ligatinave nga ndotja zhurmat dhe aeroplanët si dhe masa të tjera zbutëse mjedisore për kontrollin e efekteve negative të zhvillimit të ri.

Skenari C: Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i formave alternative të turizmit

Skenari C ndjek më me përpikmëri qëllimin e mbrojtjes së mjedisit dhe marrjen e masave për të kufizuar rritjen e sistemit urban me qëllim për të ruajtur burimet e virgjëra natyrore të rajonit dhe cilësinë e mjedisit natyror. Skenari parashikon mbrojtjen e rreptë të tokës bujqësore, duke mos lejuar ose nese po nje limit shumë të kufizuar të konvertimit së tokës bujqësore në tokë urbane. Ai përkrah ndalimin e shtrirjes urbane përgjatë bregdetit dhe përqendrimin e investimeve të reja për zhvillimin urban vetëm brenda zonave ekzistuese urbane. Krahas atyre ekzistuese në proces nuk do të zhvillohen investime të mëtejshme në infrastrukturën e transportit në rajonin e Vlorës, përveç përmirësimit të rrjetit rrugor dytësor për të përmirësuar aksesin në fshatrat malore dhe zonat rurale, ku do të jetë dhe fokusi i modelit të turizmit. Skenari parashikon zbatimin më rigoroz të gjetjeve të Planit të Menaxhimit duke promovuar vetëm forma të veçanta të interesit të turizmit që lidhen me vlerësimin e mjedisit natyror dhe kulturor (ekoturizmit, agroturizmit, turizmit kulturor, etj) dhe duke u fokusuar në një segment të vogël përsa i përket turistëve ndërkombëtarë. Rregulla të rrepta janë të vendosura në "Zonat e Mbrojtura" dhe në përgjithësi për të gjitha aktivitetet që zhvillohen në zonën bregdetare. Modeli i turizmit te zakonshem është i kufizuar vetëm në zonat ekzistuese të turizmit. Pjesa tjetër e zonës duhet të mbrohet dhe të zhvillohet me shumë kujdes. Gjithashtu ky skenar mbështetet më shumë forcimin e kapaciteteve lokale dhe mbështetjen e iniciativave lokale në shkallës të vogël se sa investimi në shkallë të madhe. Ky është lloji i turizmit që do të kishte më

pak dëm në burimet mjedisore dhe shpërndarjen më uniforme territoriale të efekteve të saj të dobishme. Ndërkohë, megjithatë kjo eshte një ai qe karakterizohet nga perspektivat më të gjata kohore në mënyrë që të ngrihet dhe kërkon investime publike afatgjatë për mbështetjen e zhvillimit të infrastrukturës mjedisore .

4.2 Vlerësimi i Skenarëve

4.2.1 Skenari A: Skenari zero

Skenari i Zakonshem nënkupton se zona do të vazhdojë të zhvillohet sipas trendeve ekzistuese, me turizëm të standardeve të ulëta i shkëputur nga qëllimi i menaxhimit të mjedisit. Vazhdimi i zhvillimit në një mënyrë të pakontrolluar dhe degradimi i mjedisit do të rritet. Megjithatë ky skenar do të ndihmojë për të zbuluar të gjitha efektet negative në drejtimin e zonës pa një plan, si dhe ndikimet e rënda në mos ndërhyrjen në sektorë të ndryshëm të vlerësuara nga VSM.

Tabela 28: Vlerësimi i skenarit A

SKENARI A – SKENARI I ZERO		
OBJEKTIVAT E VSM-SE	**NDIKIMI I SKENARIT**	**GRAVITETI**
VSM 1	Mundësite e të ardhurave nga turizmi do të vazhdojnë të shpërndahet në mënyrë të pabarabartë, tepër te përqendruara në zonën bregdetare. Modeli aktual i turizmit do të vazhdojë të gjenerojë taksat të ulta për përmirësimin e infrastrukturës	***-1***
VSM 2	Peisazhi dhe vlerat kulturore të zonës do të mbeten të paeksploruara.Prania e turizmit të zakonshem do të demtoje potencialin për të zhvilluar turizmin e interesit të veçantë.	***-2***
VSM 3	Ekonomia rurale do të vazhdojë të bazohet në tendencat ekzistuese pa ndonjë mbështetje të veçantë nga turizmi.	***0***

VSM 4	Ky skenar paraqet mundesi te vogla per te ndertuar kapacitete vendore në ndarjen e përgjegjësive me sektorin privat, bashkëpunim ndërmjet nivelit lokal dhe kombëtar dhe ngritjen e vetëdijes per te nxitur mbrojtjen e mjedisit.	***0***
VSM 5	Aktivitetet ekzistuese industriale dhe të tjerat që janë të planifikuara nga qeveria qendrore në afërsi të zonës se Komunës do të vazhdojë të paraqitet një rrezik i mundshëm per shëndetin dhe mjedisin që mund të ndikojë ne cilësinë e ujit, cilësinë e ajrit etj. Ky skenar nuk bën asgjë për të ndryshuar gjendjen ekzistuese.	***-2***
VSM 6	Presioni nga turistët e përditshem ka të ngjarë të rritet megjithatë organizimi i shërbimeve të plazhit në zonën bregdetare dhe zonimi i përdorimit te tokës do të reduktoje ndikimin në asetet mjedisore.	***-1***
VSM 7	Në mungesë të formave të organizuara të investimeve, modeli i shpërndare i zhvillimit të turizmit do të vazhdojë. Zonimi i përdorimit te tokës dhe rregulloret do të reduktojnë informalitetin.	***0***
VSM 8	Presioni i ndotjes nga shkarkimet pritet të rritet. Zhvillimi i rrjetit të kanalizimit dhe impianti i trajtimit të ujit në zonat e vendbanimeve dhe turizmit ka të ngjarë të marrë një kohë më të gjatë për t'u zhvilluar për shkak të modelit të zhvillimit të shpërndarë dhe të mungesës së fondeve.	***0***
VSM 9	Menaxhimi i burimeve natyrore do të vazhdojë të jetë i dobët në mungesë të stimujve, kapaciteteve dhe financimit.	***0***
VSM 10	Skenari i zakonshem ofron mundësi të vogla për trajtimin e problemeve të rehabilitimit dhe përmirësimit te tokës, duke pasur parasysh se këto territore dhe aktivitete nuk janë të rëndësishme për promovimin e modelit te turizmit "diell dhe	***0***

	plazh".	
VSM 11	Ndërgjegjësimi mjedisor i popullatës lokale dhe vizitorëve do të vazhdojnë të jenë të ulëta në mungesë të programeve të veçanta dhe veprimeve të ndërmarra.	***-1***
VSM 12	Zonat e trashëgimisë kulturore do të vazhdojnë të paraqesin tendencat ekzistuese të braktisjes pasi ata nuk janë në fokusin e produktit turistik.	***0***
VSM 13	Aksesibiliteti në plazhe do të përmirësohet. Aksesibiliteti në zona të largëta nuk do të kete gjasa të përmirësohet duke pasur parasysh se këto janë jashtë fokusit të modelit të turizmit. Aksesibilitet në "Zonat e Mbrojtura" nuk do të përmirësohen.	***+1***
VSM 14	Ky skenar do kete përmirësim te vogel te infrastrukturës dhe te cilësisë së jetës dhe standardeve, por vetem per zonen bregdetare dhe me një ritëm të ulët.	***+1***
VSM 15	Problemi i mbeturinave do të mbetet një nga problemet kryesore shëndetësore për zonën, për shkak te mungeses se venddepozitimeve të duhura, mangësi për sistemin e menaxhimit të mbeturinave dhe mungesa e koordinimit me qytetin e afert.	***0***
VSM 16	Shërbimet publike dhe cilësia e mjedisit urban ka të ngjarë të përmirësohet në vendbanimet e zonës bregdetare ku investimi i ri i turizmit do të zhvillohet, por jo në zonat rurale dhe malore.	***+1***
VSM 17	Ky skenar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në lidhje me sigurinë dhe shëndetin publik lidhur me antenat dhe kullave të larta te tensionit dhe një përmirësim të vogël të sigurisë në plazh.	***+1***
VSM 18	Mungesa aktuale e mirëmbajtjes së pritave, të sistemit ekzistues të kullimit dhe mungesa e politikës në lidhje me cilësinë e tokës	***0***

në këtë zonë nuk do të ndryshojë me skenarin e zakonshëm.

4.2.2 Skenari B: Intensifikimi i zhvillimit urban dhe turistik

Skenari i intensifikimit cakton një qëllim shumë ambicioz për të rritur thellësisht fluksin e njerëzve dhe investimet kapitale në rajonin e Vlorës. Kjo presupozon se zona e qytetit të Vlorës do të jetë përfituesi i një vlere të madhe të investimeve publike dhe private gjatë 10-15 viteve të ardhshme. Nxitja e zhvillimit të turizmit do të ketë një ndikim në zhvillimin demografik të Vlorës me gjenerimin e vendeve të reja të punës, si dhe plotësimin e numrit të madh të banesave të zbrazëta dhe shtëpive të dyta. Zhvillimi ekonomik do të kenë një ndikim pozitiv në gjenerimin e të ardhurave dhe cilësisë së jetës, por do të krijojë edhe shtim të lëvizjeve. Intensifikimi i zhvillimit do të krijojë një presion në rritje ndaj sistemeve të ujit dhe atij natyror prandaj duhet të merren masa konkrete për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme. Po ashtu në zhvillimin urban është i nevojshëm më tepër kontroll aktiv rregullator për të mbrojtur cilësinë e peizazhit bregdetar.

Tabela 29: Vlerësimi i skenarit B

SKENARI B – INTENSIFIKIMI I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURISTIK		
OBJEKTIVAT E VSM-SE	**NDIKIMI I SKENARIT**	**GRAVITETI**
VSM 1	Përmirësimi i zonës si destinacion turistik mund te krijojë mundësi të reja për punësim për popullatën lokale në industrinë e turizmit. Prania e turistëve cilesor do të sigurojë burim të ardhurash për zonën, por pjesa më e madhe e të ardhurave do të terhiqet nga format e organizuara të investimeve turistike të përqendruara në zonën bregdetare. Mundësitë e të ardhurave në zonën rurale do të jenë shumë te kufizuara.	*+2*
VSM 2	Ky skenar do të kontribuojë në promovimin e lagunes si një destinacion i veçantë i turizmit dhe terheqes. Kombinimi i turizmit cilesor me ndjeshmërine ekologjike mund të krijojë kushtet për rritjen e natyrës, peizazhin dhe vlerat kulturore të	*-2*

	zonës.	
VSM 3	Ky skenar do të ketë një efekt të vogël në mbështetjen e ekonomisë rurale për ti sherbyer industrisë se turizmit. Ndërkohë rregulla më të strikte do të vendosen mbi funksionimin e aktiviteteve tradicionale ekonomike në zonen e lagunes.	*+1*
VSM 4	Skenari turizmit cilesor do të krijojë mundësi të reja për bashkëpunim publik-privat në përmirësimin e menaxhimit të mjedisit, nëpërmjet përfshirjes në shkallë të madhe te investimeve private në këtë zonë.	*+2*
VSM 5	Ky lloj skenari do të rrisë presionin ndaj planeve kombëtare për zhvillimin e Parkut Energjitik. Veprimtaritë industriale operuese do të jenë te detyruara për të respektuar mjedisin dhe për të ruajtur të gjitha parametrat ndotëse nën prag/kufi.	*+1*
VSM 6	Ndërtimi i objekteve turistike në zonën bazë të mjedisit do të ndikojë në karakterin natyror të bregdetit Adriatik pavarësisht nga fakti se ndikimi do të jetë i kufizuar.Rritja e standardeve të turizmit do të nxisë organizimin e duhur të shërbimeve të plazhit dhe zvogëlimin e numrit të vizitorëve të zakonshme në këtë zonë.	*-1*
VSM 7	Përmirësimi i rrjetit rrugor në zonën bregdetare mund të krijojë një shqetësim të habitateve në disa pjesë të zonës. Problemi i zhvillimit të shpërndare dhe informal do të reduktohet në mënyrë radikale dhe do të kontrollohet me anë të shumë rregulloreve të rrepta të zonimit te përdorimit te tokës dhe menaxhimit të zonës.	*-1*

VSM 8	Prania e turizmit cilesor do të çojë në miratimin e më shumë rregullave të rrepta në lidhje me aktivitetet ndotëse te lagunës. Zhvillimi i formave të organizuara të turizmit do të nxise ndërtimin e objekteve të trajtimit të ujit.	*+1*
VSM 9	Ndërtimi i objekteve të reja turistike do të ndikojë në burimet ujore të zonës. Problemi do të reduktohet në rritjen e kapaciteteve në menaxhimin e pasurive natyrore për shkak të formave të organizuara të investimeve dhe bashkëpunimit publik privat.	*-1*
VSM 10	Ky skenar do të promovojë pjesërisht e ripyllëzimin, peizazhin dhe do të ndërmarrë investime të rëndësishme që lidhen me qarkullimin e ujit të detit dhe balancimit të ujit brenda lagunes, por nuk do të sjellë ndonjë zhvillim në përmirësimin e tokës dhe infrastrukturës se ujitjes.	*-2*
VSM 11	Prania e turistëve do të ketë një ndikim pozitiv në rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor drejt mbrojtjen se shumëllojshmërisë biologjike dhe peizazhore të vendit.	*0*
VSM 12	Tërheqja e vizitorëve më të arsimuar dhe ndërkombëtare në zone do të krijojë stimuj për rehabilitimin e vendeve të trashëgimisë kulturore, përmirësimin e aksesit dhe sinjalistiken.	*+1*
VSM 13	Zhvillimi i organizuar i turizmit cilesor do të siguroje iniciativen për të përmirësuar ndjeshëm aksesin në zonën bregdetare duke reduktuar kohën e udhëtimit. Aksesibiliteti në vendet turistike dhe zonave të mbrojtura do të përmirësohet.	*+1*
VSM 14	Ky skenar do të përmirësojë cilesine e ujit te pijshem dhe do te permiresohe sistemet e sherbimeve komunale dhe	*+1*

	infrastrukturen ne zonen bregdetare.	
VSM 15	Skenari cilesor do të nxisë përmirësime në mangësite e infrastrukturës për sistemin e menaxhimit të mbeturinave, duke ulur rreziqet e shëndetit të njeriut, dhe pjesërisht duke përmirësuar në zonën bregdetare cilësinë e jetesës.	*+2*
VSM 16	Ky skenar do të ketë ndikim të kufizuar në përmirësimin e shërbimeve publike dhe lehtësitë sociale në zonat e vendbanimeve.	*0*
VSM 17	Investitorët privatë do të zbatojnë kontroll më të rreptë dhe do të largojnë strukturat (antenave etj) që nuk i plotësojnë kriteret. Kjo nuk do të jetë e barabartë për të gjitha zonat.	*+1*
VSM 18	Ky skenar do të nxisë përmirësimin e menaxhimit te ujit në lidhje me mirembajtjen e digave dhe kanaleve që janë të lidhura me funksionimin e duhur të lagunës nëpërmjet koordinimit privat dhe Komunës, por jo siç duhet për pjesën tjetër të vendit.	*+1*

4.2.3 Skenari C: Turizem i interesit të veçantë

Ky model i perzgjedhur i zhvillimit te turizmit ka ndikim te qendrueshem tek mjedisi dhe pasurite e tjera. Gjithashtu, ky është i vetmi model me shkallen më të lartë të shpërndarjes së ekuilibruar hapësinore, të ndërhyrjeve dhe të ndikimit dhe duke krijuar nje produkt te vetem te turizmit. Kushtet paraprake të këtij modeli janë nje mekanizem kontrolli dhe administrimi i avancuar, si dhe promovimi i turizmit,tërheqja e investimeve dhe shërbimet ndihmëse. Statusi i Bashkisë si peizazh i mbrojtur duhet të perforcohet gjate fushatës se promovimit edhe ndoshta si pjesë ose paralel me fushatën për turizmin elitar. Duke qene se Vlora ka një pozicion shumë të ulët në lidhje me këto parakushte, modeli duhet të zhvillohet per një periudhë të gjatë , me iniciativa të forta per ndërtimin e institucioneve. Përveç aftësive të burimeve njerëzore si dhe aftësive sipermarrese dhe kapaciteteve që janë relevante për këtë model, nevojiten disa programe dhe infrastrukturë për ngritjen e kapaciteteve të qytetarëve per pjesmarrjen

makismale në zinxhirin e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve. Pengesa me e madhe është mungesa e investimeve private dhe publike per promovimin e këtyre qëllimeve ambicioze .

Tabela 30: Vlerësimi i skenarit C

SKENARI 3-TE – TURIZEM I INTERESIT TE VECANTE

OBJEKTIVAT E VSM-se	NDIKIMI I SKENARIT	GRAVITETI
VSM 1	Ky skenar do të ketë efektin më të balancuar territorial në krijimin e mundësive per te ardhurat. Kthimi ekonomik nga turizmi do të jetë më pak se në skenarin e dytë, por përfitimet do të jenë më mirë të shpërndara në pjesë të ndryshme të Bashkise.	*-1*
VSM 2	Ky skenar do të ketë një ndikim shumë pozitiv per krijimin e një produkti të veçantë te turizmit që perfaqeson kombinimin e të gjitha pasurive turistike të Bashkise dhe promovimin e formave të turizmit te interesit te vecante. Suksesi i produktit turistik do të varet edhe nga standardet e turizmit që do të miratohen.	*+2*
VSM 3	Skenari do të ketë një ndikim pozitiv për mbështetjen e ekonomisë rurale dhe riorientimin e saj drejt prodhimit të produkteve bujqësore organike dhe cilesore, si dhe nxitjen e e praktikave ekologjikisht miqësore dhe rregullimin e aktiviteteve tradicionale ekonomike (peshkimin, gjuetinë, nxjerrjen e kripës).	*+2*
VSM 4	Ky skenar krijon mundësi të konsiderueshme për krijimin e bashkëveprimit midis MP dhe PPV duke kombinuar përmirësimin e kapaciteteve të menaxhimit të mjedisit me promovimin e formave të veçanta të turizmit.	*+1*
VSM 5	Ky skenar do të rrisë gjithashtu presionin kryesisht nga ana e komunitetit lokal ndaj zonës industriale duke i detyruar këto aktivitete të respektojne mjedisin dhe mbajtja e të gjitha parametrave ndotëse nën pragun.	*+1*

VSM 6	Promovimi i formes të turizmit me interes te vecante në prioritet do të reduktoje rendesine e turizmit ditor te plazhit në zonën bregdetare. Do te vendoset kontroll më i rreptë në aktivitetet të cilat potencialisht dëmtojnë karakterin natyror të plazheve.	***+1***
VSM 7	Problemi i zhvillimit të shpërndare dhe informal do të reduktohet në mënyrë radikale dhe do të kontrollohet me anë të zbatimit te me shumë rregullave strikte të përdorimit të tokës dhe parandalimin e zhvillimit te metejshem ne zonen bregdetare.	***+2***
VSM 8	Kontrolli mbi shkarkimin e mbetjeve te patrajtuara nga aktivitetet industrial dhe turistike dhe nga zonat rezidenciale por zhvillimi i një sistemi efikas të kanalizimit dhe pastrimi i vendeve të ndotura ekzistuese të zonës përreth do të vonohet nga mungesa e investimeve.	***0***
VSM 9	Ky skenar nuk nënkupton faktorët që mund të vendos kercenime me burimet ujore të zonës.	***0***
VSM 10	Ky lloj turizmi do të nxisë disa investime (publike dhe private) për të përmirësuar kushtet e tokës të tilla si rehabilitimi i tokës kripur, përmirësimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës për ujitje duke rritur cilësinë e produkteve bujqësore të zonës.	***+1***
VSM 11	Ky skenar do të ushtrojë presion te komuniteti dhe aktivitetet ekonomike në drejtim të ruajtjes së mjedisit.	***+2***
VSM 12	Rritja e numrit te vizitoreve te interesit të veçantë në këtë zonë do të sigurojë incentiva për promovimin e rehabilitimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, përmirësimin e aksesit dhe sinjalistikës.	***+1***
VSM 13	Promovimi i rrugëve ekoturistike dhe te agroturizmit do të nxise përmirësimin e aksesit në zonën e mbrojtur dhe në atë malore	***+1***

	rurale. Përmirësimi i infrastrukturës se transportit dhe krijimi i rrugëve të reja, do të pengohet gjithashtu nga mundësitë e kufizuara të financimit.	
VSM 14	Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujit të pijshëm dhe lidhja e zonave te reja dhe ekzistuese të banimit dhe atyre turistike do të përparojë me ritme të ngadalta në varësi të disponueshmërisë së investimeve publike.	***0***
VSM 15	Sistemi i grumbullimit të mbeturinave do të përmirësohet si dhe zbatimit i programeve te riciklmit e pastrimit, por ndërtimi i objekteve të nevojshme do të kërkoje një periudhë më të gjatë për t'u realizuar.	***+1***
VSM 16	Promovimi i formave të veçanta të turizmit e kombinuar me mbështetjen e ekonomisë rurale ka mundesi të sigurojë përmirësimin e mjedisit urban dhe shërbimeve publike në zonat e banimit.	***+1***
VSM 17	Ky skenar do të parandalojë zhvillimet e mëtejshme residenciale në afërsi të funksioneve të cilat paraqesin rrezik për sigurinë publike, sigurimi i mjediseve të ndihmës së parë dhe pikave vrojtuese në plazhet dhe masa të tjera të sigurisë në pjesën tjetër të Bashkise	***+1***
VSM 18	Ky skenar do të nxisë përmirësimin e infrastrukturës së digave dhe kanaleve që janë të lidhura me funksionimin e duhur të lagunës nëpërmjet koordinimit privat dhe Bashkise në të gjithe zonat.	***0***

Është e qartë se vlerësimi i çdo skenari të përshkruar është bërë për të vlerësuar rolin e tyre në lidhje me mënyrën se si janë përmbushur objektivat e VSM-se. Sipas vlerësimit te gravitetit, skenari A ka -2 pikë, e cila paraqet një rënie të lehtë në lidhje me gjendjen ekzistuese, skenari B 7 pikë dhe skenari C ka mbledhur 16 pikë.

Skenari B kombinon shumë aspekte pozitive në promovimin e vlerave të mjedisit natyror, por nënkupton edhe një ndikim negativ në mjedis. Nga ana tjetër, investimet në zonë do të vënë në dispozicion më shumë burime në drejtim të zonave rurale dhe malore dhe kjo mund të jetë një mënyrë për ti bërë investitorët më të interesuar për mbrojtjen e natyrës.

Skenari C padyshim duket të jetë më i favorshem në lidhje me qëllimet për mbrojtjen e mjedisit. Ky është skenari i cili ndjek politikën ekzistuese të Planit të Menaxhimit me prioritet mbrojtjen e mjedisit dhe vendosjen e ndikim minimal në burimet natyrore. Mirëpo në të njëjtën kohë është e qartë se ka kufizime të veçanta per tu materializuar qëllimet e tij ambicioze në mungesë të një reputacioni si destinacion cilesor turistik dhe turistëve ndërkombëtare ashtu siç është treguar me përparimin e ngadalshëm në zbatimin e planit të veprimit te MP deri tani.

Në këtë kontekst, skenari i promovuar për planin mbështetet në kombinimin e skenarëve B dhe C që konsistojnë në intensifikimin e turizmit me orientim ekologjik. Në përgjithësi, një skenar i tillë do të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve të Vlorës për mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve dhe në këtë formë ruajtjen e mjedisit dhe të standardeve të peizazhit dhe të ndërtesave. Në të njëjtën kohë, do të sigurojë mundësitë për tërheqjen e investimeve tejet të nevojshme për zhvillimin e turizmit.

5. VLERËSIMI I EFEKTEVE TË PRITSHME MJEDISORE TË PLANIT TË PROPOZUAR DHE MASAT PËR PARANDALIMIN / ZBUTJEN E TYRE.

5.1 Metodologjia e Realizimit të Vlerësimit

Siç përmendet në Kapitullin 1.4, në qasjen për këtë raport specifik të VSM-së, ekspertët zbatuan metodologjine e VSM-së bazuar ne secilin nga 6 Orientimet Strategjike të evidentuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, të cilat janë:

OS1: Përmirësimi i konkurueshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik
OS2: Zhvillimi i zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi të qëndrueshme
OS3: Nxitja e sipërmarrjes dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor
OS4: Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë rezidenciale dhe rritja e kohezionit social
OS5: Përmirësimi i lidhjes dhe zhvillimi i formave multimodale të transportit
OS6: Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore

Objektivat e VSM-së tashmë të zhvilluara përfshijnë objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm, si dhe objektivat e identifikuara në mënyrë specifike për Bashkine Vlore, për lehtësimin specifik të problematikave mjedisore, presionet ekonomiko - sociale, shëndetin, si dhe fuqizimin e pikave të forta të qytetit.

Procesi i vlerësimi është bazuar në një korrelacion të matricës dhe metodologjinë e vlerësimit, që krahason 18 zhvillimet e VSM - së në kapitullin 3 ndaj një sërë veprimesh nën-programesh dhe projektet për secilin nga 6 orientimet strategjike te planit të PPV-së. Ekspertët e VSM - së kanë zhvilluar komponentin strategjik të zhvillimit të vizionit dhe më tej kanë identifikuar veprimet konkrete, që do të çojnë në zhvillimin ekonomik (bërë për proceset e VSM - së dhe kohës së planifikuar të lejuar për to).

Procesi i VSM-së si projekt sistematik në tabelën korresponduese:

a. Vlerëson në detaje përputhshmërinë e Planit Kombëtar dhe Vendor me Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, dhe ku është e nevojshme, të propozohen masa shtesë dhe korrigjuese.
b. Vlerëson secilin nga komponentët e Planit në lidhje me objektivat specifike për VSM-në e Vlorës dhe ku është e nevojshme propozon masa të tjera ose korrigjime.
c. Identifikon parametrat e monitorimit/indekset për objektivat e VSM-së të lidhura me ndërhyrjet specifike të planit.

Kështu, procesi i hartimit të VSM-së ne këtë kapitull do të analizohet bazuar të orientimeve strategjike të përcaktuara në raportin e dytë teknik Strategjinë Territoriale, Vizioni Strategjik dhe Objektivat e Zhvillimit, Bashkia Vlorë.

Secila prej tabelave të vlerësimit të pajtueshmërisë, përmban informacion mbi ndikimin e politikës përkatëse, projektit, rregulloreve të çdo VSM-je, në rëndësinë e efekteve (apo edhe në parëndësinë e politikës specifike me VSM specifike), në nevojën për masa të nevojshme potenciale të korrigjuara/ shtesë, në indeksin e monitorimit të parametrit të propozuar në çdo rast.

Një tabelë tipike ka formatin e mëposhtëm:

Tabela 31: VLERËSIMI I VSM-së i KOMPONENTËVE:

	POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
																				Komente:	
																				Efekte anesore:	
1		**0**		**0**	**0**		**d+**	**+**		**+**	**d+**				**d+**	**d+**	**+**	**+**	**d+**	**Ndikime kumulative:**	
																				Ndikime sinergjike:.	
																				Aktet korigjuese:	

Brenda tabelave një seri simbolesh të quajtur çelësat e Vlerësimit të VSM - së, janë përdorur për një vëzhgim të shpejtë dhe referues.

Këto simbole paraqesin seriozitetin e korrelacionit të ndikimit negativ apo pozitiv, apo edhe pa ndikim në secilin prej rasteve. Simbolet e vlerësimit të VSM - së janë dhënë më poshtë:

VLERËSIMI I VSM-së –SIMBOLI/SHENJA KRYESORE			
Pozitive	**+**	**Negative**	**-**
Mundësi/potenciale për pozitivitet	**d+**	**Mundësi/potencial për negativitet**	**d-**
Neutrale/asnjanëse	**0**	**I pacaktuar**	**?**

Duke ndjekur vlerësimin e bërë, siç përshkruhet më sipër dhe identifikimin e lidhjeve të VSM – së me projektet dhe planet, veprimet e mundshme korrigjuese shtesë, si edhe identifikimin e parametrave të monitorimit dhe të indekseve të këtyre rasteve, një grup i vlerave të synuara tek objektivat e VSM-së (ku është e mundur të përcaktohet dhe nëse jo një parametër cilësor i synuar alternativ duhet të vendoset), do të përcaktohet. Këto shifra do të jenë baza e Planit/ VSM-së për zbatimin e monitorimit, dhe do të shërbejnë si bazë për rishikim nga grupet e interesit të qytetit, si në intervalet e rishikimit të PPV-se, ashtu edhe në gjetjen e financimeve serioze për zhvillimin dhe rritjen e mundësive për qytetin (si në rastin e fondeve pre-strukturore/strukturore të më vonshme).

5.2 Zbërthimi i Planit të Bashkisë Vlorë

Orientimi Startegjik 1: ***<u>Përmirësimi i konkurueshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik</u>***

1.1 Përforcimi i identitetit dhe shkëlqimit të Vlorës si një qytet turistik bregdetar

Plani synon forcimin e identitetit të qyteteve bregdetare si çelës për të promovuar konkurrencën e produktit turistik Riviera (Perla të Rivierës). Forcimi i identitetit të turizmit të qytetit të Vlorës bazohet në tri shtylla të cilat do të shikohen në këndvështrimin e zhvillimit të Vlorës si qytet plazh, si qender kulturore dhe si qendër Marine. Nëpërmjet zhvillimit të projekteve dhe thellimit të karakterit të plazhit në qytet si me ndetimin e pedonalesdhe shërbimeve mbështetëse të saj. Një sërë rivitalizimesh të objekteve të veçanta kulturore dhe tradicionale të qytetit, si Pallati i Kulturës, transformimi i pazarit të vjetër apo amftetari në Kaninë, do të përmiresojnë mjaft karrakterin kulturor dhe historik që qyteti do të ofrojë. Kthimi i traditës së

sportit të notit nëpërmjet ndërtimit të një pishine olimpike, si dhe nxitjen e sporteve të zhytjes e lundrimit me vela etj.

1.2 Tërheqja e investimeve me cilësi të lartë në rivierën Vlorës dhe e shërbimeve cilësore

Plani identifikon segmentin bregdetar Vlorë Lungomare deri në hyrje të Orikumit si pjesën më të vlefshme të Vlorës Riviera, ku do te koncentrohen investimet cilesore dhe shërbimet private dhe për këtë arsye të veçantë do të vendosen kritere të forta përdorimi të tokës që të mos kompromentojnë vlerën e këtij segmenti nga ndërhyrjet e investitorëve potencialë. Investitorët e kësaj zone duhet të bëhen pjesë e programeve të veçanta - Programi i Rivieres i cili do të përmbajë kritere rigoroze për të rritur cilesinë e investimit si për hotelet turistike, qendrat rezidenciale, shërbimet tregtare që do të ofrohen, plazhet e peisazhet panoramike përgjatë zonës Rivierë Vlorë/Orikum si përgjatë një pjese përgjatë gadishullit të Karaburunit.

Po kështu në dy zonat lagunave të Nartës dhe atë të Orikumit, ekosistemi do shikohet si një burim i madh strategjik dhe turistik, ku rezultatet e pritshme ekonomike të jenënë përputhje me planet e menaxhimit për ruajtjen e mjedisit për zonat respektive, duke krijuar mundësi të ndryshme rekreacioni për vizitorët si eko-turizem, shtepiza ekologjike, gjurmime, ecje në kembë, vezhgimi i zogjve. Kushtet e krijuara nga ky plan do të tërheqin në zonë shumë investitorë strategjikë, të angazhuar në këto forma të veçanta të propozuara per investime në turizëm, të cilët do të marrin përsipër një pjesë të kostos së zhvillimit të infrastrukturës dhe përgjegjësitë për menaxhimin e mjedisit dhe përmirësimin e peizazhit në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse kombëtare dhe lokale.

Plani parashikon instrumentet për parandalimin e formave të shpërndara të zhvillimeve urbane, duke siguruar kufizime dhe rregulla të përdorimit të tokës të cilat synojnë zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Planin Kombëtar dhe PINS bregdetin mbulojnë të gjithë territorin e Bashkisë Vlorë. Pjesa e jashtme e perëndimore e bregdetit e cila është pjesë e zonës kryesore të mbrojtjes së mjedisit është e caktuar për zhvillimin e një rezorti cilësor, eko- turistik me densitet shumë të ulët. Ndërsa tek pjesa rurale, plani favorizon zhvillimin e shpërndarë urban në tokat bujqësore. Gjithashtu janë caktuar zona të veçanta të cilat janë të përshtatshme për zhvillimin e agritourizmit. Në zonën malore, tendenca për krijimin e vilave në pozicione të spikatura me pamje të mirë është e kufizuar në zonat e përcaktuara nga plani.

1.3 Promovimi i vlerave turistike në territoret rurale dhe malore - Zhvillimi i turizmit të interesit të veçantë në "Zonat e Mbrojtura"

Rikualifikimi i fshatrave malore me interes turistik dhe i hapësirave publike e i blloqeve me banesa të braktisura në fshatrat malorë, si Kaninë, Rradhimë, Tragjas, Dukat dhe Panaja. Një ndihmë në këtë drejtim do të jenë dhe zhvillimi i aktivitetve që nxisin turizmin kulturor dhe aktiv nga gurrorja e Kaninës drejt shëtitores bregdetare. Po kështu aktivitetet që nxisin ecjen në shtigje nga bregu për në mal dhe krijimi i sinjalistikës për pikat e atraksionit kulturor.

Më konkretisht, Plani parashikon një mbrojtje aktive të burimeve natyrore në zonat e Nartës dhe Orikumit, duke synuar mbrojtjen e mjedisit dhe ekosistemit, por njëkohesisht edhe përdorimin e tyre në dobi të publikut dhe zhvillimin e turizmit natyror pa pasoja të drejpërdrejta mbi këto sisteme. Disa nga programet të eko-turizmit në lagunën e Nartës janë:

- ✓ Programi i kombinuar midis turizmit të ngadaltë dhe menaxhimit të mjedisit
- ✓ Ekoturizëm-Vrojtimi i Zogjve
- ✓ Trajtime të kripës
- ✓ Peshkim
- ✓ Kultivime tradicionale dhe brandimi i produkteve të lagunës
- ✓ Transformimi në një natyre të re nëpërmjet programeve të ripyllëzimit, çkripëzimit, dhe menaxhimit më të mirë të ballinave ujore.

Sipas Planit promovimi i turizmit natyror dhe kulturor në njësinë e Orikumit do të realizohet në aktivitete që synojnë:

- ✓ Krijimi i shëtitores bregdetare dhe i fasiliteteve përgjatë ballores së plazhit të Orikumit)
- ✓ Zhvillimi i një lokaliteti arkeologjik në amfiteatrin e Orikumit
- ✓ Krijimi i një parku muze në bazën ushtarake
- ✓ Rikonstruksioni i kishës së Marmiroit
- ✓ Krijimi i një rruge ciklizmi përgjatë gadishullit të Karaburunit

Së fundi, Plani promovon format e turizmit që janë në përputhje me qëllimin e ruajtjes së mjedisit natyror dhe kulturor, si nje atraksion i madh për vizitorët e synuar. Përdorimi i propozuar i tokës dhe rregulloret i shërbejnë këtij qëllimi duke vendosur kufijtë e mbrojtjes dhe "Zonat e Mbrojtura te trashëgimisë kulturore" si: (Keshtjella e Kanines, ishulli i Zvernecit dhe Triporti, bërthama historike e fshatit Nartë), si dhe për zonat e ndjeshme mjedisore. Rezerva ujore e mbrojtur e aplikuar në pjesen e brendshme të lagunës dhe trupat e tjera ujore. Paralelisht skema e propozuar e Planit për aksesin në zonën bregdetare është hartuar duke marrë në konsideratë mos shqetesimin dhe vazhdimësinë e habitateve dhe ekosistemeve duke kufizuar rrugët e panevojshme dhe qarkullimin e automjeteve në rrugët e specifikuara. Plani paraqet mënyrat për rritjen e vlerave rekreative te peizazhit natyror dhe kulturor duke promovuar ripërdorimin e vendeve arkeologjike, (p.sh. krijimi i eventeve në Kalanë e Kaninës dhe seminare në Manastirin e Zvërnecit), përmirësimi i aksesit dhe sinjalistikës dhe krijimin e rrugëve piktoreske apo shtigjet për këmbësorët në mënyrë që të promovojë aktivitetet ekoturistike.

Orientimi strategjik 2: ***Zhvillimi i zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi të qëndrueshme***

2.1 Promovimi i konsolidimit hapesinor nëpërmjet krijimit të sinergjive ekonomike midis turizmit dhe bujqësisë.

Plani adreson problemin e fragmentimit hapësinor të territorit të BashkisëVlorë duke promovuar konsolidimin hapësinor dhe integrimin. Modeli i promovuar i turizmit po kontribuon në këtë drejtim duke rritur zhvillimin e sinergjive në zhvillimin e produkteve të turizmit midis pjesës bregdetare dhe rurale të Bashkisë Vlorë. Mundësitë për akomodim dhe shërbimet e turizmit janë krijuar në të gjitha pjesët e Bashkisë Vlorë në perputhje me karakterin e tyre të veçantë dhe mundësitë. Integrimi ndërmjet pjesës së brendshme dhe zonës bregdetare do të promovohet edhe nëpërmjet rrjetit rrugor të propozuar i cili synon të kapërcejë pengesat ekzistuese të lidhjeve midis pjesëve të ndryshme të Bashkisë dhe përmirësimin e lidhjeve me qytetin e Vlorës. Zonimi i propozuar i përdorimit të tokës është i koordinuar me hierarkinë e propozuar rrugore duke mbështetutr konsolidimin e berthames se vendbanimeve ekzistuese dhe krijimin e zonave të reja të zhvillimit të turizmit.

Një aksion i rëndesishëm në kuadër të Planit Vendor është përdorimi më efektiv i burimeve të tokës ekzistuese brenda zonës urbane, si ish ndertimet e abandonuara industriale të kohës së komunizmit (*broënfilds*), apo tokës së abonuar brenda tokës urbane.

2.2 Mbeshtetje per permiresimin dhe rritjeve e vleres se shtuar per ekonomine bujqesore.

Plani mbron dhe permireson burimet ekzistuese të të ardhurave për popullsinë lokale nëpërmjet angazhimit të tyre në të gjitha nivelet e zinxhirit të vlerave të turizmit.Toka bujqësore është e mbrojtur, ndërsa theks i veçantë i është dhënë në drejtim të mbështetjes se prodhimit te produkteve lokale organike të cilesise së lartë. Vizioni përfshin mundësitë për përhapjen e efekteve pozitive të turizmit në zonat rurale dhe malore nëpërmjet promovimit te formave të ndryshme të përvojave të turizmit që mbështesin ekonominë lokale dhe aktivitetet tradicionale ekonomike (agroturizmi, turizmi peshkimi, trajtimet me kripë, panairet lokale, provimi dhe shijimi i ushqimit dhe verës).

Programet specifike për realizimin e objektivave të këtij orintimi strategjik synojnë promovimin e zinxhirit të produkteve lokale, nëpërmjet:

- ✓ Ngritjes se një sistemi për grumbullimin dhe shpërndarjen e produkteve lokale
- ✓ Promovimin e konsumit të produkteve lokale në hoteleri dhe restorante
- ✓ Brandimin e produkteve lokale
- ✓ organizimin e eventeve promovuese (ekspozita dhe panaire)
- ✓ Promovimin e produkteve te turizmit dhe veçanërisht të eksperiencave të veçanta të shijimit të verës në vreshtat e fshatrave të zonës së Qëndrës dhe Novoselës

Programe të tjera do të nxisin bujqësinë për realizimin e produkteve Bio, si:

- ✓ Promovimin e produkteve biomjeksore si mjalti, çaji i malit, sherebela, etj.
- ✓ Promovimin e produkteve lokale të mishit dhe nënprodukteve të tij nga zona e Tragjasit dhe Dukatit
- ✓ Zhvillimin e peshkimit, akuakulturës në Orikum dhe i tregut të peshkut
- ✓ Sigurimin e stimujve dhe mbështetjes në nxitje të bujqësisë organike
- ✓ Krijimin i sistemit për cilësinë e kontrollit dhe të standardeve

Programe të tjera për agroturizmin, si:

- ✓ krijimin e pikave shitjeje të produkteve lokale për turistët
- ✓ Intinerare për vizitorët për të provuar verën, ushqimin tradicional, etj.
- ✓ Shërbime informacioni dhe sinjalistika për vizitorët

Së fundi, programe qe nxisin agroekonominë si p.sh.:

- ✓ Krijimin e infrastrukturës mbështetëse për bujqësinë
- ✓ Nxitje për zhvillimin e njësive të procesimit të ushqimit

Orientimi Strategjik 3: Nxitja e sipërmarrjes dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor

3.1 Organizimi i aktiviteteve ekonomike në mënyre që të eleminohen konfliktet e përdorimit të tokës midis zonave industriale, turistike dhe residenciale.

Territori i Bashkisë Vlorë është mjaft kompleks, pasi ndërthuren shumë aktivite ekonomike të cilat krijojnë nga natyra e tyre konflikte në lidhje me përdorimin dhe ruajtjen e cilesisë së tokës dhe ekosistemeve në përgjithësi. Duke shtuar këtu edhe zonat me karakter të theksuar natyror dhe atyre të mbrojtur si lagunat e Nartës dhe ajo e Orikumit, bëjnë që të kihet në vemendje përzgjedhja e atyre ndërhyrjeve dhe aktivitetve ekonomike që zbusin në maksimum ose eliminojnë këto konflikte.

Kështu cilësia e mjedisit natyror të lagunës së Nartës është e rrezikuar nga ndotja e rëndë e aktiviteteve industriale të mëparshme (fabrika sodës), që kane vepruar qe nga periudha e komunizmit. Politikat kombëtare te parashikuara për kirjimin e aktiviteteve të reja industriale me ndikim të lartë në zonën bregdetare duhet të rishikohen pasi ato janë në konflikt të drejtpërdrejtë me qëllimin e ketij studimi per zhvillimin e turizmit të standardeve të larta. Plani mbështet fuqishëm këtë qëllim duke krijuar alternativa të përdorimit të tokës të kombinuara me projekte të përmirësimit të peisazhit. Zonat e gjelbra janë sugjeruar që të krijohen në zonën midis fshatit te Nartes dhe qytetit të Vlorës, si dhe për ndarjen e objekteve te TEC-it nga plazhi

i Nartes. Zhvillimi i aktiviteteve të reja të planifikuara industriale dhe tregtare me ndikim të ulët, lejohet vetëm brenda në pjesën rurale, në zona të caktuara të ndara nga zonat e banuara.

Krijimi i rrugës së re të bypass-it nga Vlora, e cila kalon nga sektori lindor i Bashkisë afër Babices krijon mundësi të reja për terheqjen në territorin e Bashkisë të aktiviteteve të reja ekonomike që i sherbejnë ekonomisë së qytetit të Vlorës, të tilla si shërbimet logjistike (përpunim, ambalazhim), industria e lehtë, tregtia me shumicë etj.

Programet kryesore që Plani propozon për të arritur objektivat e këtij orientimi strategjik janë:

- ✓ Zhvillimi i zonave ekonomike në luginën e Sherishtit dhe bartja e funksioneve të pjesës së pasme të shtëpive në qytetin e Vlorës
- ✓ Zhvillimi i programeve të përbashkëta logjistike mes portit të naftës në Vlorë dhe Lushnjë
- ✓ Zhvillimi i një zone ekonomike me ndikim të lehtë në Orikum pranë daljes nga Bypassi
- ✓ Organizimi i zonës ekonomike përgjatë hyrjes së qytetit dhe bypass-it perëndimor

Orientatimi strategjik 4: ***Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë rezidenciale dhe rritja e kohezionit social***

4.1 Ulja e Periferialitetit të Zonave Rurale dhe Malore.

Plani parashikon rehabilitimin e rrugëve sekondare të fshatrave Hoshtima, Kerkova, Babica e Madhe, Xhyherine, Sherishte, Kanina, Narta, Zvernec, si dhe ndërtimin e rrugëve të reja sekondare Panaja, Hoshtima, Babica e Madhe dhe Narta. Krjimi i një shetitoreje për kembësore në bregdet, në plazhet e Nartës dhe Zvernecit dhe rrugë të përshtatshme vertikale dhe parkim në shërbim të turisteve. Krjimi i një shetitoreje në brendësi të lagunës duke lidhur Narten-Zvernec, si dhe zhvillimi i trotuareve për zonat rurale. Përsa i përket parkimit plani parashikon: a) krijimi i hapësirave për parkim përgjatë bregdetit Narta- Zverenci, b) krijimi i objekteve të parkimit në Kështjellën e Kaninës dhe Manastirin e Zvernecit, c) krijimi i hapesirave për parkim që lidhen me kanalin e Nartës. Për hapesirat e gjelbra dhe te hapura plani parashikon: a) Promovimi i puneve urbane permiresuese dhe rehabilituese ne hapesirat publike te fshatit te Kanines. b) Krijimi i një programi për një pedonale te pjesshme te rruges te fshatit kryesor për periudha dhe ore te zgjedhura pergjate dites dhe mbremjes ne terheqjen e vizitoreve për të pare perendimin. c) Nxitja e puneve urbane permiresuese per fshatrat e Nartes dhe pjesen e brendshme te Zvernecit. Krijimi i një zone shetitoreje nëper lagune për lidhjen e fshatrave d)Të sigurojë në sajë të Planit një vend për një shesh dhe park të vogël në fshatin e Panajase. Për infrastrukturën sociale parashikohen projekte per rehabilitmin e shkollave, kopshteve dhe qendrave shendetesore për të gjitha fshatrat e Bashkisë Vlorë. Krijimi i një gjimnazi te ri në Babicë të vogël dhe i dy qendrave të vogla të ndihmës së shpejtë për zonën bregdetare Nartë, Zvernec.

Programet për përmirësimin e shërbimeve nëpër fshatra do të përfshijnë ndër të tjera:

- ✓ Sigurimi i shërbimeve shëndetësore për popullsinë e moshës së tretë

- ✓ Restaurimi i shkollave dhe kopshteve
- ✓ Përmirësimi i hapsirave publike nëpër fshatra, krijimi i qëndrave lokale në zonën e fshatrave
- ✓ Përmirësimi i aksesueshmërisë së këmbësorëve

4.2 Reduktimi i Periferialitetit Brenda Zonave Urbane.

Programet e përcaktuara në Plan synojnë të përmiresojnë sherbimet për të reduktuar perifieralitetin gjithashtu brenda zonave urbane, duke siguruar arritjen njëkohesisht të objektivave specifike, si më poshtë:

Integrimin e zonave informale nëpërmjet:

- ✓ Integrimi dhe konsolidimi i zonave informale nëpërmjet planifikimit të detajuar
- ✓ Përmirësimi i kushteve infrastrukturore në të gjithë zonën urbane
- ✓ Sigurimi i shërbimeve sociale (shëndetësi dhe arsim)

Zhvillimin e parqeve urbane brenda qytetit të Vlorës, si:

- ✓ Krijimi i parkut të madh urban të qytetit në ish- zonën e aeroportit ushtarak i dedikuar për fëmijët me sporte, laboratorë shkencor, hipizëm, rezervuarë uji, kopsht botanik (Parku Kreativ Mesdhetar: Fëmijët e Gëzuar)
- ✓ Zhvillimi i pyllit bregdetar të Sodës në një pyll estetik (zhvillimi i sistemit të rrugëve, menaxhimi i pyllit)

Zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve sportive te qytetit të Vlorës:

- ✓ Zgjerimi i kompleksit sportiv të Vlorës
- ✓ Rikualifikimi i pishinës olimpike ekzistuese në qendrën sportive të Vlorës - ndërtimi i mbulesën (me hapje dhe mbyllje)
- ✓ Rindërtimi dhe përmirësimi i terrenit sportiv të Novoselës

Zhvillimi i programeve te rigjenerimit urban, si:

- ✓ Programi i akupunkturës (acupuncture) urbane për qendrën e Vlorës
- ✓ Restaurimi i fasadave të ndërtesave përgjatë bulevardit kryesor
- ✓ Ndërtimi i trotuareve, ndriçimit publik dhe infrastrukturës përcjellëse në zonën e Topanas
- ✓ Incentintivat dhe instrumentat për rigjenerimin e ndërtesave të braktisura në qendrën historike të Vlorës

Programet mjedisore do të kenë një ndikim të rëndësishem, pasi ato do të ndikojnë në:

- ✓ Ndalimin e funksionimit të deponimeve në Vlorë
- ✓ Kontrollin mbi veprimtarine e aktiviteteve industriale dhe ekonomike brenda zonës urbane (standardet e zhurmave dhe të ndotjes)
- ✓ Pastrimin e kanaleve të ujitjes në pjesën perëndimore të zonës urbane
- ✓ Rikualifikimin e tokës së papërdorur dhe i sipërfaqeve vakante/ të abandonuara brenda zonës urbane

Orientimi Strategjik 5: Përmirësimi i lidhjes dhe zhvillimi i formave multimodale të transportit

5.1 Përmirësim i Lidhjeve Nëpërmjet Rrugëve Ndër-rajonale. Plani identifikon si elemente bazë të Rivierës aksesueshmerinë dhe ndërlidhjen e saj dhe ndërmjet zoanve. Ai mbështet kënveshtrimin se Vlora mund të bëhet një destinacion ndërkombëtar dhe terheqes për investimet e huaja direkte jo vetëm nga lidhja direkte ajrore e saj, ku me mjete të transportit rrugor nga të gjitha apo shumicën e qendrave urbane jugore apo qendrore të vendit mund të aksesohet lirisht. Për këtë arsye është propozuar që Vlora duhet të ketë gjithashtu edhe aeroportin e vet në zonën e Akernisë. Plani identifikon dy projektet e mëposhtme:

- ✓ Zhvillimi i aerportit ne Akerni
- ✓ Përfundimi i bypaess-it të Vlorës

Për sa i përket lidhjes rajonale plani mbështet përfundimin e unazës së Vlorës në hierarki të dytë të rrugës se Rivieres dhe projektin e lumit të Vlorës për përmirësimin e lidhjes ndërmjet Vlorës dhe Himarës për zonën në brendësi. Një lidhje me e mirë ndërmjet Vlorës dhe SH4 është parashikuar edhe në plan.

Plani mbështet politikën e zhvillimit të korridorit SH4 si një korridor lidhës të transportit publik (BRT) me destinacionet e tjera kryesore përgjatë saj. Është propozuar një terminal i ri i autobusëve në zonen e stacionit hekurudhor, si dhe projekteve të meposhtme:

- ✓ Ndërtimi i rrugës lidhëse Babicë-Selenicë
- ✓ Projekti i rrugës së Lumit përgjatë luginës së Shushicës
- ✓ Ndertimi i nje stacioni autobuzash me nje sistem te shpejte tranzitimi

5.2 Përmirësimi i Lidhjeve Lokale.

Planifikimi i ardhshëm dhe zhvillimi i rrjetit rrugor të Bashkisë Vlorë përfshin artikulimin e niveleve interurbane dhe urbane.

Në lidhje me zonën urbane Plani parashikon përmiresimin e rrugëve urbane të qytetiti të Vlorës nëpërmjet këtyre projekteve:

- ✓ Hyrje e re për në Portin e Vlorës (zgjerimi i rrugës Transballkanike)
- ✓ Zgjerim i rrugës Pelivan Leskaj
- ✓ Zgjerim i rrugës nga kryqëzimi i Vlorë-Kaninës deri tek Shkolla e Marinës në Shëtitoren bregdetare
- ✓ Ndërtimi i një rruge të re paralele me shëtitoren bregdetare
- ✓ Shtrimi i rrugëve të qytetit që janë në gjendje të keqe
- ✓ Shtrimi i rrugës së unazës perëndimore në qytetin e Vlorës

Në lidhje me sistemin rrugor interurban propozimi kyç i planit është krijimi i një parametri kryesor për zhvillimin e infrastrukturës, përfshirë adresimin e strukturës së fragmentarizuar administrative, e cila kërkon një nivel të caktuar të bashkëpunimit institucional midis tre juridiksione të veçanta, në nivel kombëtar, qyteti i Vlorës dhe zone të fshatrave.

Projektet kryesore që propozohen për përmirësim i rrugëve dytësore që lidhin fshatrat me Vlorën janë si më poshtë:

- ✓ Përmirësimi i lidhjes së fshatrave me rrugët kryesore
- ✓ Ndërtimi i një unaze lidhëse me fshatrat e Panajasë (Panaja-Bestrovë-Kërkovë-Hoshtimë)
- ✓ Ndërtimi i rruge lidhëse midis Bishisht-Trevëllazër
- ✓ Krijimi i një lidhje midis Babicës së vogël me rrugën e vjetër kombëtare (Bestrovë)
- ✓ Ndërtimi i një rruge nga Kanina në shëtitoren bregdetare të Vlorës (Sheshi Ëilson)

Në të ardhmen një prioritet tjeter për Bashkinë lidhur me zhvillimin e turizmit është lobimi në nivel kombëtar në mënyrë që të ndërtojë një dalje tjeter nga rruga kombëtare për në Nartë. Projekti më i rëndësishëm që duhet të promovohet në aspektin e prioriteteve nga ana e Bashkise është përmirësimi i lidhjes se rrugës bregdetare midis Vlorës dhe Zvernecit. Gjithashtu ajo mundëson aksesin në zonën e Zvernecit nga porti i Vlorës i cili është një portë ndërkombëtare e mbërritjes. Një tjetër projekt i rëndësishëm i bashkëpunimit midis qytetit dhe zonave rurale në aspektin e prioriteteve është rruga lidhese midis Plazhit te Vlorës dhe by-passit të rrugës në pozicionin e daljes së gurores. Kjo është një lidhje shumë e rëndësishme për rajonin rural e cila do të rrisë atraktivitetin e zonës për zhvillimin rezidencial dhe te turizmit dhe të përmirësojë ndjeshëm aksesin e zonës malore. Përmiresimi i ndërlidhjeve të rrugëve nga qyteti i Vlores per ne fshatrat e Bashkise. Zhvillimi i lidhjes rrugore nga Kanina ne plazhin e Vlorës. Zhvillimi i një lidhje unazore midis fshatrave Panaja, Bestrove, Kerkove (Bestrova e Vogel) dhe Hoshtima

si dhe zhvillimi i një lidhje interurbane terciare midis fshatrave se Babices dhe Babicës se Vogël, Xhyherines, Sherishtes dhe Kanines. Përveç rrjetit skenik, lidhje rrugore të tjera interurbane që formojnë një pjesë të programit të Bashkisë të investimeve janë në vijim: Lidhja midis kryqëzimit te By-Passit te Babices me Sherishten, e cila do të jete kolektori kryesor interurban. Një tjetër rrugë e një rëndësie dytësore është lidhja midis Bestroves se Vogel. Projektet e tjera rrugore janë dy lidhjet e planifikuara nga rruga bregdetare e Zvernecit në plazhin e Nartës.

Program tjetër i rëndësishëm që parashikohet në Plan është krijimi i intinerareve turistike me kosto të ulët gjatë rrugëve panoramike, siç janë:

- ✓ Zgjerimi i rrugëve panoramike të rivierës së Vlorës përgjatë gadishullit të Karaburunit
- ✓ Përmirësimi i rrugës për në Zvërnec dhe bregdetin Adriatik
- ✓ Përmirësimi i aksesueshmërisë për në plazhe/ krijimi i zonave të parkimit/peisazhi

Zhvillimi dhe përmiresimi i transportit publik parashikohet të kryehet nëpërmjet këtyre programeve:

- ✓ Lidhja midis qëndrave urbane (autobuza rajonal)
- ✓ Lidhja midis gjithë fshatrave me trasport publik
- ✓ Krijimi i stacioneve në terminalet e Vlorës
- ✓ Krijimi i shërbimit të transportit ujor (taksitë ujore) për të bërë një tur të plazheve kryesore dhe pikave turistike brenda gjirit të Vlorës dhe Sazanit të kontrolluara nga Bashkia

5.3 Zhvillimi i Transportit Detar. Plani propozon përmiresimin e transportit detar në Bashkinë Vlorë nëpërmjet rigjenerimi i Portit të Vlorës, në mënyrë që të ndërtohet një terminal i ri i pasagjerëve, se bashku me terminalin i trageteve, si dhe zhvillimi i sherbimeve të infrastrukturës mbeshtetese.

Marina pashikohet gjithashtu te zhvillohet si një marine urbane në pjesën Lungomares në vijim të Portit të Vlorës.

Po kështu krijimi i një sherbimi taksi në det për të organizuar udhetime turistike përgjatë plazheve kryesore dhe atraksioneve turistike përgjate bregdetitit të Vlorës, gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit.

Orientimi strategjik 6: Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore

6.1 Menaxhim i Mbetjeve.

Plani parashikon projekte për menaxhimin bashkëkohor të mbetjeve në Bashkinë Vlorë që synojnë në grumbullimin në një vend-depozitimi të mbetjeve, paketimin (ngjeshjen) transportin, trajtimin dhe shfrytëzimin e mbetjeve. Parashikohet ndërtimi i një impianti me teknologji moderne që të diferencojë mbetjet dhe të djegë ato që nuk mund të trajtohen më tej, duke shfrytëzuar të gjitha cilësitë e këtyre mbetjeve, i vendosur në zonën industriale gjendet në rrugën për në fshatin Sherishte. Zhvillimi i një sistemi transporti për mbetjet,vendosjen e kontenierëve me një dendësi më të madhe si dhe një program për ndërgjegjësimin e komunitetit të Bashkisë Vlorë. Ne varesi te Planit propozohet dhe nje plan komunikimi dhe edukimi për përgatitjen e komunitetit në këtë komunë për të bërë hedhjen e diferencuar të mbetjeve të tyre (plastike, qelq, letër, tekstile,metal etj), si dhe hartimi dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për zonën bregdetare.

Projektet që plani parashikon ne drejtim te menaxhimit të mbetjeve janë:

- ✓ Hartimi i plani për rehabilitimin e zonave të vendgrumbullimeve aktuale të mbetjeve ku është sugjeruar territori i Bashkisë Sherisht;
- ✓ Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme sipas planit kombëtar të menaxhimit;
- ✓ Zbatimi i planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve për të rritur sasinë e mbetjeve të mbledhura nga autoritetet lokale të cilat janë ricikluar apo përzier në 55% deri në 2020;
- ✓ Shfrytëzimi i energjisë që mund të gjenerohet përmes ngritjes së landfilleve moderne.

Referuar në arritjen e objektivave te legjislacionit kuader te mbetjeve, Strategjise Kombetare te mbetjeve dhe VKM nr. 418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" të rrymave të mbetjeve për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen përmes:

a. optimizimit të grumbullimit të mbetjeve;
b. sigurimit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim;
c. promovimit të ripërdorimit të produkteve;
ç përgatitjes së veprimtarive të ripërdorimit;
d. përmirësimit të cilësisë së riciklimit të mbetjeve.

Realizimi i grumbullimit të diferencuar për këto rryma mbetjesh i përmbahet kërkesave për mbetjet:

a. Letër/karton;
b. Metal;
c. Plastikë;
d. Qelq.

6.2 Furnizimi me Ujë.

Plani parashikon projekte të furnizimit me ujë të ndërhyrjeve të nevojshme që lidhen ngushte më kërkesat e banorëve, me strategjinë e zhvillimit dhe kërkesat në rritje për zhvillimin e turizmit në zonë, te cilat janë të grupuara në 2 lloje: a) Rinovimi i rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë, b) Zgjerimi apo shtimi i rrjetit të furnizimit me ujë. Rehabilitimin e tubacioneve ekzistuese te fshatrave të Panajasë, Hoshtimës si dhe ato të Babicës dhe Bestrovës, si dhe krijimi i një depo e re ne Babice dhe shtimi i një rrjeti i ri tubacionesh ne Bestrove. Fshatrat si Xhyherine me qëllimin për të përmirësuar kushtet e jetesës si dhe mbulimin me kohë të plotë të furnizimit me ujë të fshatit, propozohet një lidhje me rrjetin kryesor që merr ujë nga pusi pranë Lumit te Shushicës, ne Sherishte planifikohet të shtohet një pus i ri me qëllim rritjen e prurjeve dhe përmirësimin e cilësisë së ujit. Krijimi i depove te reja dhe shtimi i tubacioneve të reja ne Kanine dhe në pjesën jugore fundore të saj. Dhe se fundi kemi krijimin e depove te reja dhe shtimi i tubacioneve ne fshatrat e Nartes dhe Zvernecit, si dhe vendosja e nje pompe te re perseri ne fshatin e Nartes. Me rëndësi për zhvillimi e turizmit në zonë është edhe projekti për ndërtimin e një stacioni pompimi të ri pranë kanalit dhe të një depozite të re uji për të mundësuar furnizimin me ujë të zonës ne pjesen perendimore të bregdetit.

Programet që plani parashikon në drejtim te furnizimit me ujë janë:

- ✓ Marrja e masave për realizimin dhe plotësimin e kërkesës për uji të pijshëm me të gjitha parametrat e tij sipas normës së përcaktuar nga strategjia kombëtare e UK me një sasi prej 150l/ditë në të gjithë territorin e bashkisë;
- ✓ Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit ujësjellës dhe atij kullues;

6.3 Trajtimi i Ujërave të Zeza.

Plani parashikon projekte lidhur me ngritjen e rrjetit të ujërave të zeza si dhe të impianteve të trajtimit të tyre qe te sigurojnë një rregullim bashkëkohor të zgjidhjes së këtij problemi madhor për Komunën Qendër. Ky rregullim do te mundësohet përmes investimeve në tre drejtime kryesore: a) Ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotur, b) Ndërtimin e gropave septike sipas standardeve për fshatrat dhe shtëpitë e veçuara, c) Ndërtimin e sistemit të kanalizimeve në zonat pranë detit dhe qytetit të Vlorës. Ndërtimi i impianteve të trajtimit paraqitet i rëndësishëm për zonën bregdetare për vetë faktin sepse kjo lidhet ngushtë jo vetëm me cilësinë e ujërave nëntokësore por edhe me pastërtinë e ujit të detit.

Projektet që plani parashikon në drejtim te trajtimit të ujrave të zeza janë:

- ✓ Rivënia në punë me kapacitet të plotë dhe rritja e kapacitetit të trajtimit të ujrave të zeza në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza në qytetin e Vlorës;
- ✓ Rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujrave të zeza dhe ngritja e tyre në zonat e zhvillimit informal

- ✓ Zhvillimi i sistemit te kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujrave të zeza për zonën bregdetare (Orikum, Qendër);
- ✓ Paisja me sisteme të trajtimit me kapacitete të vogla dhe individuale për zonat që shtrihen në brendësi të territorit(zonat malore);
- ✓ Hartimi i një plani menaxhimi për kanalizimet e hapura ku derdhen ujrat e zeza duke mbrojtur cilësinë e trupave ujore në zonë (deti, lumenj, lagunë) si dhe shëndetin e popullatës

6.4 Përdorimi i Energjisë dhe Burimeve të Reja.

Në zonën në studim janë parashikuar investime të rëndësishme për të përmirësuar gjendjen aktuale të saj. Këto projekte synojnë në disa drejtime përmirësimin e infrastrukturës ne rehabilitimin e lidhjeve dhe linjave ekzistuese. Vendosjen e një nënstacioni të ri në pjesën periferike të qytetit të Vlorës (veri-perëndim të Vlorës) me tension të mesëm që do të furnizonte rrjetin për një pjesë të qytetit të Vlorës dhe pjesën tjetër të fshatrave të ish komunës Qendër. Zhvillimin e një linje të tensionit 20kV paralele për zonën Nartë-Zvërnec për ta shndërruar rrjetin shpërndarës nga rrezor në unazor është parakusht shumë i rëndësishëm për të mundësuar zhvillimin e turizmit në zonën bregdetare. Zhvillimin e një linje të tensionit 10kV dytësore për fshatrat Xhyherine dhe Sherishte. Dhe se fundi zhvillimi i një linje prej 20kV për fshatin e Kaninës, në pjesën veri-lindore paralel me linjën ekzistuese, si dhe zgjatjen e linjës jugore të tij, për arsye të zgjerimit të fshatit si dhe për arsye të ndërtimeve ekzistuese informale.

Projektet që plani parashikon perdorimin e ernergjise dhe burimeve të tjera janë:

- ✓ Rivënia në punë e termocentralit të Vlorës si një back-up për furnizimin me energji elektrike për zonën dhe më gjerë si dhe marrja e masave të domosdoshme për uljen e ndikimit në mjedis gjatë funksionimit të tij sipas udhëzimeve të VNM-së përkatëse;
- ✓ Hartimi i një plani për shfrytëzimin e energjisë së rrezatimit diellor përmes instalimit të paneleve fotovoltaike individuale dhe industriale).
- ✓ Hartimi i një plani për shfrytëzimin e energjisë diellore përmes impianteve eolike.
- ✓ Hartimi i një memorandumi për ndalimin e shfrytëzimit të energjisë së ujrave të lumenjve nga ndërtimi i mëtejshëm i hidrocentraleve
- ✓ Vendosja e standarteve për instalimin e pajisjeve elektrike dhe të ndriçimit (individuale dhe industriale) të kategorisë

6.5 Rihabilitimi i Tokes/ Rimarrja.

Pjesa lindore e bregut të lagunes e cila është larg nga uji i detit karakterizohet nga një peisazh me i qetë, totalisht i sheshte dhe me mungese diferencimi. Efektet e kripës kanë ndaluar bimësinë. Kjo zonë është pa jete, me renie te aktiviteteve tradicionale dhe sidomos te bujqesise. Një pjesë e bregut është lënë e pashfrytezuar, në kushte moçali dhe me akses te kufizuar. Qëllimi kryesor i këtij vizioni është për të kthyer këto karakteristika të veçanta në pika

tërheqese per vizitoret nëpërmjet një strategjie që synon rehabilitimin dhe permiresimin e ekosistemit dhe te natyrës.

Projekte që parashikon plani jane:

- ✓ Rehabilitimi i tokes së kripur ne bregdetin lindor të lagunes dhe riperdorimi i saj si toke bujqesore.
- ✓ Zhvillimi i nje projekti per ripyllezimin dhe rehabilitimin e natyres ne pjesen bregdetare dhe ne fushen midis fshatit te Nartes dhe qytetit te Vlores.
- ✓ Riformimi i pjeses lindore te bregdetit ne brendesi te lagunes afer me fshatin e Nartes. Duke sjellur ujin me afer me fshatin ne menyre qe te zhvillohet nje sistem ishujsh artificiale dhe krijimi i nje natyre te re.

Rehabilitimi i tokes pergjate bregdetit lindor te brendshem te lagunes se Nartes do t'i kthehet perseri bashkise, si nje burim i rendesishem, aktualisht i paperdorur, qe mund te gjeneroje vlera te shumta, ekonomike, rekreative dhe mjedisore.Pyllezimi dhe krijimi i natyres se re mund te siguroje kushtet per rigjenerimin e habitateve. Rehabilitimi i tokes per bujqesi pergjate pjeses veri perendimore te bashkise Vlore, Narte, Novosele si dhe zona e Oriukmit afer lagunes mund te kete ndikim pozitiv ekonomik per te ardhurat e popullates lokale.

Objektivi strategjik nr 6 sebashku me masat perkatese jep zgjidhje per te gjitha problematikat mjedisore te Bashkise Vlore.

6.6 Vlerësim i detajuar i efekteve të pritshme mjedisore nga zbatimi i planit lokal dhe masat parandaluese/zbutëse.

Gjatë procesit të vlerësimit të alternativave të ndryshme të skenarëve të zbatueshëm, kemi identifikuar disa efekte pozitive dhe negative, të cilat mund të ndikojnë në zbatimin e programeve te ndryshme.

Bazuar në skenarin e preferuar, analizën e detajuar të komponentëve të tij dhe metodologjinë e vlerësimit të detajuar, të paraqitura në kapitullin e mëparshëm, puna e kryer nga konsulentët e VSM-së u fokusua në identifikimin e ndikimeve negative. Parashikimi i ndikimeve negative, efekteve sinergjike dhe kumulative të komponentëve të ndryshme të planeve, dhe përpunimin e zgjidhjeve zbutëse, që është dhe përmbajtja kryesore e tabelave të mëposhtme të vlerësimit të detajuar.

Prioritizimi dhe zgjidhja e ndikimeve negative është një proces i përpunuar dhe i komplikuar, i cili është thjeshtuar pjesërisht nga teknikat e matricës së përdorur. Është e nevojshme të përmendim në këtë pikë, që ndikimet në këtë fazë të vlerësimit janë të lidhura kryesisht me kushtet mjedisore dhe të jetesës së banorëve, që kanë të bëjnë me kriterin. Si rrjedhim vlerësimi të çon në propozime për parandalimin dhe zbutjen, të cilat duhet të zbatohen në mënyrë paralele ose në disa raste përpara zbatimit të komponentëve të planit urban. Indekset e monitorimit që do të paraqiten në kapitullin e ardhshëm, janë gjithashtu rrjedhojë e njohjes së kritereve të përmendura më lart, dhe nevojës për të ndjekur efektet e zbatimit të planit me

kriteret dhe objektivat specifike të përcaktuara ose nga vetë VSM-ja, ose legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar, të përmendura në kapitujt e mëparshëm.

Ashtu si vlerësimet e ndikimit në mjedis të projekteve të veçanta, rezultatet e planit lokal të VSM-së janë të detyrueshme për vendimmarrësit dhe të paraqesin bazën kryesore për gjykimin e tyre, në pranimin në aspektin mjedisor të Planit, si dhe masat korrigjuese që ata duhet të vlerësojnë, të marra para ose gjatë zbatimit të tij. Rekomandimet janë propozuar nga ekspertët e VSM-së dhe bazohen në metodat analitike apo krahasime empirike me situata të ngjashme të zhvillimit, që janë hasur në të kaluarën. Është i pashmangshëm parashikimi në plan i shumë aspekteve për shkak edhe të statusit (të tilla si ato ekonomiko - sociale) dhe të statusit të veçantë, përcaktuar në aspekte të tjera (si planifikimi urban, sipërfaqja e mbulimit të parcelës, koefiçentët e ndërtimit etj.). Kështu është e pamundur të përcaktohet aspekti sasior i pasojave negative. Ekspertët propozojnë një paketë korrigjuese dhe zbutëse dhe sugjerojnë një monitorim të vazhdueshëm, që do të çojë në minimizimin e pasaktësive në këtë fazë. Hapat e mëtejshëm të pranimit, të vlerësimit të detajuar të mëposhtëm, nga vendimmarrësit e qytetit, janë si të planifikojnë dhe propozojnë masat korrigjuese dhe
zbutëse, si administrativisht dhe financiarisht, si dhe për të vendosur sistemin shtëpiak, të ndjekura nga plani dhe VSM - ja, e cila do të paraqitet e detajuar në kapitullin e monitorimit.

Në përfundim, sugjerimi kryesor për vendimmarrësit, pas leximit të matricave të këtij kapitulli, është për :

a. planin e veprimeve të korrigjimeve (plani urban dhe masat administrative);

b. planifikimin për nevojat për investime për të redaktuar efektet negative;

c. prioritetet për projektet që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe veprimet e propozuara për korrektimin.

d. përgatitjen e strukturës administrative për ndjekjen e VSM-së, dhe integrimin e rekomandimeve përfundimtare të pranuara në rregulloren e tyre, si dhe në punët përkatëse të zhvillim.

Tabela 32: VLERËSIMI I VSM-së Orientimi Strategjik 1: Përmirësimi i konkurueshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	1.1 Përforcimi i identitetit dhe shkëlqimit të Vlorës si një qytet turistik bregdetar																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
1	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Pergjithesisht masat sipas këtij komponenti kontribuojnë pozitivisht në objektivat e VSM-se, veçanërisht në lidhje me mbështetjen e qëllimit të mbrojtjes së mjedisit dhe kontrollin e aktiviteteve ekonomiko -turistike qe zhvillohen ne pjesen Bregdetare te Bashkise ku parashikohen rritje cilesore te standrteve te nje bregdeti turistik- bazuar ne plazh, kukture dhe marine. Synohet rritja e cilesise se jetes se qytetareve dhe argetimi i viziotreve ne kete zone te Vlores.	Masat zbutëse për zhvillimin e formave të organizuara të turizmit: 1. Hartimi i PDV konform ligjit te urbanistikes nen drejtimin e Bashkise. 2.. Para dhënies së lejes kompania do të nënshkruajë një marrëveshje të veçantë me me Bashkine Vlore.Duke duke siguruar se aksesi publik lejohet në zonen e cila do te zhvillohet. 2. Kompania duhet te kete te ngritur (apo te kooperoje me te trete) nje sistem te plote manaxhimi e monitorimi per: -manaxhimin dhe mirembajtjen e sistemeve te kanaleve, perfshire ato te kullimit apo cfar zona ka ne perdorim publik. - manaxhimin e mbetjeve te ngurta dhe ujrave te zeza; Ne zonat bregdetare te kujdeset per largimin e mbetjeve te ngurta - monitorimin e nivelit te zhurmave dhe te pluhurave
																			Efekte anesore: Si efekte anesore pozitive jane rritja e cilesise se plazheve vecaberisht pjesa e skeles e rinovuar me pedonalen , ku rritja e cilesise se ajrit dhe pastertise se ujit do jene te qendrueshme. Rritja e cilesise se jetes dhe te ardhurave te komuniteteve lokale. Zhvillimi i infrastruktures mund të ketë një efekt anësor të mundshëm negativ në cilësinë e ajrit dhe nivelet e zhurmës, si dhe ne ndotjen vizuale te peisazhit te zonave te mbrojtura.	
	+	+	0	+	d+	d-	d+	d-	-	0	+	+	d-	0	d+	-	-	d-	**Ndikime kumulative:** Rritja e nivelit te jeteses dhe kushteve te pergjithshme ne pjesen e bregdetare te Bashkise Vlore duke shumfishuar te ardhurat nga turizmi si dhe rritja e sherbimeve mbeshtetese te pjeses tjeter te territorit bashkise Vlore. Brandimin e territorit si destinacion te vecante turistik.	

																						dhe planet per zbutjen dhe kufizimin e tyre. - monitorimin e kushteve hidrologjike; - monitorimin dhe rehabilitimin e habitateve dhe specieve; - ruajtjen, zgjerimin dhe rehabilitimin e zones pyjore nese ka ; - monitorimin dhe ruajtjen e flores dhe faunes detare apo te zones ku operon.
																					Ndikime sinergjike:. Zhvillimime afatgjata ne mireqenien dhe integrimin socio ekonomik brenda territorit te bashkise Vlore duke cliruar sinergji ndermjet zones bregdetare dhe asaj te brendshme dhe malore. Permiresimi i imazhit te zones turistike pergjate lumit të Vlorës do te sjelle shtimin e games se turisteve dhe produkteve turistike . **Aktet korrigjuese:**	.

Tabela 33: VLERËSIMI I VSM-së i Orientimi Strategjik 1: Përmirësimi i konkurueshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	1.2 Tërheqja e investimeve me cilësi të lartë në rivierën Vlorës dhe e sherbimeve																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
2	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Të gjitha masat sipas këtij komponenti kontribuojnë pozitivisht në objektivat e VSM-se, veçanërisht në lidhje me mbështetjen e qëllimit të mbrojtjes së mjedisit dhe kontrollin e aktiviteteve që zhvillohen në "Zonat e Mbrojtura "Laguna e Nartes, Orikumit, Zona e mbrojtur e Llogorase dhe Karaburunit. Promovimi i formave të organizuara të investimeve siguron kushtet për ndarjen e përgjegjësive midis publikes dhe privates në menaxhimin e mjedisit dhe kostos së infrastrukturës që është parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e turizmit të standardeve të larta. **Efekte anesore:** Format e invetimit ne turizem mund te kene efekt negativ mbi floren dhe faunen bregdetare e ujore, sidomos ato lagunore, e favorizuar kjo nga shtimi i aktivitetit human dhe sidomos nga shtimi i ndotjes akustike. Zhvillimi i formave të organizuara të zhvillimit të turizmit cilesor mund të ketë një efekt anësor të mundshëm negativ në rritjen e rolit të investitorëve privatë në proceset e vendimmarrjes në lidhje me zhvillimin e ardhshëm të zonës. Efekt anësor pozitiv në bllokimin e planeve kombëtare për zhvillimin e ndikimit të lartë të aktiviteteve industriale Efekt anësor pozitiv në përmirësimin e kushteve për sigurinë publike nëpërmjet zbatimit të shumë rregullave strikte dhe kontrollit. Zhvillimi i rrugëve mund të ketë një efekt anësor	Masat zbutëse për zhvillimin e formave të organizuara të turizmit: 1. Para dhënies së lejes kompania do të nënshkruajë një marrëveshje të veçantë me me Bashkine Vlore Duke duke siguruar se aksesi publik lejohet në kushtet e veçanta në zonat kryesore mjedisore të cilat janë të rezervuara për zhvillimin e turizmit elitar. 2. Kompania duhet te kete te ngritur (apo te kooperoje me te trete) nje sistem te plote manaxhimi e monitorimi per: - manaxhimin e ujrave te lagunes apo menaxhimit te zones se investimit. - manaxhimin dhe mirembajtjen e sistemeve te kanaleve, perfshire ato te kullimit; - manaxhimin e mbetjeve te ngurta dhe ujrave te zeza; Ne zonat bregdetare te

																			të mundshëm negativ në cilësinë e ajrit dhe nivelet e zhurmës, si dhe ne ndotjen vizuale te peisazhit te zonave te mbrojtura.	kujdeset per largimin e mbetjeve te ngurta - monitorimin e nivelit te zhurmave dhe te pluhurave dhe planet per zbutjen dhe kufizimin e tyre. - monitorimin e kushteve hidrologjike; - monitorimin dhe rehabilitimin e habitateve dhe specieve; - ruajtjen, zgjerimin dhe rehabilitimin e zones pyjore; - monitorimin dhe ruajtjen e flores dhe faunes detare apo lagunorte lagunore.
	+	0	d+	+	+	+	+	-	0	d-	d+	d+	d-	d+	d-	d-	d+	0	**Ndikime kumulative:** Prania e turizmit cilesor dhe investimeve perkatese do të ketë një efekt pozitiv kumulativ në zhvillimin e turizmit të cilësisë duke rritur standardet e zonës dhe vlerën e aseteve materiale dhe shërbimeve të ofruara. Përmirësimi i kapaciteteve të menaxhimit të mjedisit do të ketë një efekt pozitiv kumulativ në zvogëlimin e burimeve të ndotjes së ujit te lagunes duke përmirësuar cilësinë e mjedisit	
																			Ndikime sinergjike: Zhvillimi i formave të kontrolluara dhe cilesore të turizmit pritet të ketë një efekt pozitiv sinergjik në përkrahjen e qëllimeve të Planit të Menaxhimit, të tilla si përmirësimi i trashëgimisë kulturore, rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor, mbështetur programet mjedisore për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara, monitorimin, etj Efekti i mundshëm pozitiv sinergjik në bashkë-financimin e punimeve të rehabilitimit të tokës dhe masat për mirëmbajtjen e sistemit të kullimit.	
																			Aktet korrigjuese: Per zhvillimin e ndertimeve me interes te vecante per bashkine dhe komunitetin apo investime strategjike duhen zbatuar rigorozisht PPV duke u mbeshtetur ne plan zbatimin e Planit të Menaxhimit të miratuar. • Menaxhimi i gjithe zonave te mbrojtura , mirëmbajtjen e sistemeve të kullimit dhe kanaleve • Manaxhimin e mbetjeve te ngurta dhe ujrave te zeza. • Monitorimin e nivelit te zhurmave dhe pluhurave, cilesese se detit dhe zbatimin e	

		planeve zbutese dhe kufizuese te tyre. • Monitorimi i kushteve hidrologjike • Monitorimi dhe restaurimi i habitateve dhe llojeve • Ruajtja dhe përmirësimi i zonave pyjore • Mjedisi Detar	

Tabela 34: VLERËSIMI I VSM-së i Orientimi Strategjik 1 : Përmirësimi i konkurueshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE				1.3 Promovimi i vlerave turistike në territoret rurale dhe malore - Zhvillimi i turizmit të interesit të veçantë															KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
3	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Të gjitha masat sipas këtij komponenti kontribuojnë pozitivisht në objektivat e VSM. Ruajtja dhe përmirësimi i peizazhit natyror dhe trashëgimisë kulturore është një parakusht themelor për të promovuar reputacionin e zonës si destinacion të shquar turistik cilësor për forma të interesit të veçantë të turizmit (ekoturizmi , turizmi kulturor, agroturizmi , turizmi malor) Ministria e Turizmit eshte institucioni qe harton politikat e turizmit dhe zhvillimit te tij si dhe percakton zonat me perparesi zhvillimin e turizmit (ku hyn edhe zona ne studim). Ministria e Kulures eshte pergjegjese per zbatimin e politikave te saj ne lidhje me rehabilitimin dhe promovimin e monumenteve dhe objekteve kulturore ne zonat turistike e me gjere. **Efekte anesore:** Duke bërë të mundur ripërdorimin e qendrave arkeologjike për turizmin, për qëllime sociale dhe kulturore do të ketë një efekt pozitiv anësor në tërheqjen e fondeve për restaurimin dhe rehabilitimin. Kthimi i ekonomise bujqesore ne agroturizem ben me te qendryeshem zhvillimin e zones dhe rrit te ardhurat e bujqerve. Zhvillimi i turizmit malor sjell me afër zonat e thella dhe te pazhvilluara. Si vlere me negative eshte ndryshimi i mjedisit nga	1. Propozimet për ripërdorimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore (Kalaja e Kaninës dhe Manastirin e Zvërnecit, Kisha Marmiroit , qyteti antik i Amantia si dhe qendern Historike te qytetit Vlore etj) për qëllime të turizmit do të shqyrtohet dhe miratohet nga drejtoria përgjegjëse e Ministrise se Kulturës. Kushte të veçanta: Manastiri i Zvernecit eshte rehabilituar dhe ri-aktivizuar si objekt kulti, ndaj perdorimi i tij si monument i trashegimise kulturore do te koordinohet me outoritetet perkatese fetare. - Restaurimet dhe ristrukturimet e nevojshme ne Kalane e Kanines do te planifikohen duke

																			ndertimi apo aktiviteti agro biznesit.	respektur ruajtjen eidentitetit dhe funksionimit tradicional te objektit. 1. Monitorimi i niveleve të zhurmës 2. Monitorimi i biodiversitetit 3. Kontrolli i burimeve të ndriçimit
	d+	+	0	+	0	0	+	+	+	+	d+	+	0	+	d+	-	d+	0	**Ndikime kumulative:** Vendosja e rreptë e kritereve te zhvillimeve te lartpermendura do te japë efekt pozitiv afatgjatë kumulativ për ruajtjen e biodiversitetit dhe habitateve duke parandaluar burimet e zhurmës, ndriçimit dhe ndotjes pranë ligatinave apo zonave te tjera te mbrojtura.	
																			Ndikime sinergjike: Përmirësimi i atraktivitetit ne Kalanë e Kaninës , Tragjasit , Shushices etj do të ketë një efekt të mundshëm pozitiv sinergjik në promovimin e zhvillimit të turizmit në zonën malore të Bashkise Vlore. Efekti pozitiv sinergjik në lidhje me zbatimin e objektivave të Planit të Menaxhimit në kontrollimin e aktiviteteve dhe mbrojtjen e habitateve dhe biodiversitetit të turizmit. Efekti pozitiv sinergjik në nxitjen e ndërgjegjësimit mjedisor të popullsisë lokale dhe vizitorëve.	
																			Aktet korrigjuese: Rritja e bashkëpunimit midis propozimeve të PPV me veprimet e Planit të Menaxhimit. Zhvillimi i Planit të Përbashkët të Veprimit për ruajtjen e mjedisit natyror dhe trashëgiminë kulturore midis BashkiseVlore dhe Komitetit të Menaxhimit të Zonës se Mbrojtur Vjosa Narte.	

Tabela 35:VLERËSIMI I VSM-së I Orientimi Strategjik 2: Zhvillimi i zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi të qëndrueshme

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Promovimi i konsolidimit hapesinor dhe integrimit																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
1	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Masat sipas këtij komponenti mund të kenë ose një kontribut neutral ose sinergjik potencialisht pozitiv në objektivat e VSM. Integrimi hapësinor është një parakusht i domosdoshëm për të promovuar vizionin e zhvillimin e turizmit ne te gjithe Bashkine Vlore, çeshtje e cila bazohet në zhvillimin e marrëdhënieve plotësuese midis pjesëve bregdetare dhe në brendësi të bashkise. Gjithashtu integrimi hapësinor është i rëndësishëm për të nxitur përhapjen e përfitimeve nga zhvillimii turizmit në të gjitha pjesët e bashkise duke perfituar ne menyre te ndersjellte territori i bashkise.	Planifikimi i kontrolluar i zhvillimit urban nga ana e komunes. Ndalimi i ndertimeve urbane dhe i aktiviteteve ekonomike ne zonat prane parkut industrial dhe vend-depozitimit te mbetjeve urbane. Planet e manaxhimit dhe monitorimit te trafikut. Monitorimi i shkarkimeve ne ajer i mjeteve levizese. Të gjitha masat sipas këtij komponenti do të kenë një efekt pozitiv ose neutral në objektivat e VSM. Parandalimi i shkarkimeve te ujrave te patrajtuara nga zonat industriale, turistike dhe banimi është një parametër kyç për mbrojtjen e detit dhe cilësi të ujit te lagunave
																			Efekte anesore: Promovimi i konsolidimit hapësinor do të ketë një efekt pozitiv anësor në zhvillimin e formave të veçanta të turizmit. Efekt pozitiv anësor në shëndetin e njeriut duke parandaluar zhvillimin e mëtejshëm rezidencial në afërsi të elementeve të cilat paraqesin rrezik për sigurinë publike Efekt pozitiv anësor në cilësinë e ajrit duke reduktuar kohën e udhëtimit dhe emetimet e karburantit.	
	+	0	0	+	+	d+	0	0	0	+	+	+	d+	d+	d+	d+	d-	0	**Ndikime kumulative:** Efekti pozitiv afatgjatë kumulativ në adresimin e presioneve hapësinore dhe socio-ekonomike midis pjesëve të ndryshme të Komunës.	
																			Ndikime sinergjike:Përqendrimi i zhvillimit të turizmit në vende të veçanta dhe aksesi i duhur i organizuar do të ketë një efekt pozitiv sinergjik mbi	

		ruajtjen e cilësisë së peizazhit dhe mjedisit natyror të zonës bregdetare. Promovimi i konsolidimit hapësinor të zonave ekzistuese të vendbanimeve do të ketë një efekt pozitiv sinergjik mbi lehtësimin e zhvillimit efikas të sistemeve te shërbimit dhe ofrimin e shërbimeve lokale. Efekti pozitiv sinergjik për mbështetjen e ekonomisë rurale dhe aktivitetet tradicionale ekonomike. **Aktet korrigjuese:** Zbatimi i dispozitave të PPV: • Zbatimi i rregulloreve vendore të planifikimit në ndërtim • Përgatitja e PDV për zonat e caktuara me prioritet zonate zhvillimit turistik • Zbatimi i projekteve strategjike të infrastrukturës	te Nartes dhe Orikumit i cili ka një rëndësi thelbësore për mbijetesën e specieve endemike dhe habitateve. Zhvillimi i rrjetit të kanalizimit kontribuon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së popullatës lokale dhe është një parakusht themelor për zhvillimin e turizmit. Nxitja e zhvillimit të jetëses duke mbështetur infrastrukturën dhe shërbimet paralelisht me zhvillimin e turizmit.

Tabela 36:VLERËSIMI I VSM-së I Orientimi Strategjik 2: Zhvillimi i zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi të qëndrueshme

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Krijimi i sinergjive ekonomike me turizmin																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
2	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Masat nën këtë komponent mund të kenë një ndikim neutral ose pozitiv në objektivat eVSM-se. Mbështetja e aktiviteteve ekonomike lokale është e domosdoshme për të adresuar pabarazitë hapësinore dhe ekonomike dhe mundësitë e të ardhurave te pabarabartë ndërmjet zonave bregdetare dhe zonat rurale të territorit të komunës. Zhvillimi i lidhjeve midis turizmit dhe aktiviteteve ekonomike lokale është një parakusht themelor për nxitjen e zhvillimit afatgjatë të qëndrueshëm të zonës.Zhvillimi i agro biznesit si dhe promovimi i produkteve lokale e bio si element shume i rendesishem i ekonomise loka te qendrueshme .	Kushtet e veçanta nën të cilat do të lejohen vazhdimi i veprimtarive tradicionale ekonomike në lagunë: 1. Parandalimi i përdorimit të pesticideve dhe kimikateve në tokë bujqësore në një distancë prej 500m nga bregu i lagunes. 2. Parandalimi i aktiviteteve te blegtorisë ne zonat bregdetare. 3. Parandalimi i aktiviteteve te rritjes se peshqve brenda lagunes 4. Kufizimi kryesisht i aktiviteteve te nxjerrjes se kripës më shumë se 50% brenda 5 viteve të ardhshme dhe të riorientimi i tyre drejt qëllimit ekoturistik.
																			Efekte anesore: Efekt pozitiv -zhvillimi i formave të veçanta të turizmit pritet të nxisin orientimin e prodhimit bujqësor vendas drejt bujqësisë organike duke reduktuar faktorët e ndotjes se ujit te lagunes. -Veprimtarite tradicionale ekonomike që kenë efekte negative në cilësinë e ujit te lagunave dhe ekosistemeve.	
	+	d+	-	0	0	0	d-	d+	d+	0	+	d+	d+	d+	d+	+	0	d+	**Ndikime kumulative:** Mbështetja e popullatës lokale në fshatra duke mbështetur burimet e tyre të të ardhurave pritet të ketë një efekt pozitiv kumulativ në zhvillimin e balancuar demografik të zonës. Përkrahja e ekonomisë lokale pritet të ketë një efekt pozitiv afatgjatë kumulativ mbi forcimin e kapaciteteve dhe aftësive lokale, dhe inkurajimin e aktiviteteve sipërmarrëse iniciatore në nivel lokal.	

		Ndikime sinergjike: Promovimi i vlerës turistike të burimeve lokale mund të ketë një efekt pozitiv sinergjik mbi rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor të popullatës lokale dhe vizitorët drejt qëllimit për ruajtjen e mjedisit natyror dhe kulturor. Zhvillimi i formave të veçanta të turizmit pritet të ketë një efekt pozitiv sinergjik për mbështetjen e kërkesës për përmirësimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës mbështetëse te jeteses duke kontribuar kështu pozitivisht në përmirësimin e kushteve të jetesës për popullsinë lokale.	5. Peshkimi dhe gjuetia të lejohet në mënyrë rigoroze në përputhje me legjislacionin kombëtar. Lidhja me qëllime turistike.
		Aktet korrigjuese: Hartimi ne bashkepunim me Ministrite e linjes dhe me OJQ-te e Fondet e Zhvillimit, te projekteve specifike te biznesit familjar me fokus ne bujqesi, turizem familjar, trashegimi kulturore e folklorike, traditat lokale te kulinarise.Instrumentet për te kontrolluar efektin e veprimtarive tradicionale ekonomike	

Tabela 37:VLERËSIMI I VSM-së I Orientimi Strategjik 2: Zhvillimi i zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi të qëndrueshme

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE				Organizimi i aktivitetit ekonomik ne zona te paracaktuara eliminimi i konflikteve te përdorimit të tokës midis zonave industrial dhe turistike															KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
3	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Masat sipas këtij komponenti kane një kontribut të përgjithshëm pozitiv në të gjitha objektivat e VSM. Parandalimi i zhvillimit të mëtejshëm të ndikimit të lartë të aktiviteteve industriale në zonën bregdetare dhe vendosja e rregullave më të rrepta për funksionimin e atyre ekzistuese është parakusht themelor për të mbështetur vizionin e zhvillimit të turizmit cilesor të zonës dhe nxitje per mbrojtjen e mjedisit. Ndërkohë eliminimi i konflikteve te përdorimit të tokës do të ketë një ndikim pozitiv në kushtet e jetesës së banorëve, standardeve të turizmit dhe sigurinë e investimeve.	1. Studimet e VNM duhet të kryhen për të propozuar zonat e reja turistike dhe të zhvillimit ekonomik Kushtet e veçanta për zonat e reja ekonomike të propozuara në hyrje të Komunës dhe përgjatë rrugës për në Sherishte: 1. Zhvillimi i rrjetit të rrugëve sekondare 2. Vendosja e kufizimeve të veçanta në nivelet e zhurmës në zonë pranë hyrjes ne Komunë Nivelet maksimale të zhurmës, që pranohen: - E vazhdueshme 1.000m nga kompleksi 45dB; - E çastit 1.000m nga kompleksi 55dB; - Niveli maksimal 1m nga pajisja 65dB. 3. Kushtet për trajtimin e ujrave te ndotura dhe depozitimit të mbetjeve industriale
																			Efekte anesore: Ndarja e zones industriale nga përdoruesit rezidenciale dhe turistike do të ketë një efekt pozitiv anësor në cilësinë e ajrit në lidhje me ndarjen e flukseve të trafikut (të trafikut të pasagjerëve nga transporti i mallrave). Kufizimi i zhvillimit te objekteve industriale me ndikim të mesem për të lartë në vende të caktuara do të ketë një efekt pozitiv anësor në përmirësimin e sigurisë publike. Zhvillimi i një zonë te re industriale në pjesën qendrore te Bashkise Vlore mund të ketë ndikim negativ mjedisor mbi tokën dhe cilësinë e ujit nëse standardet e duhura nuk respektohen. Promovimi i sinergjive ekonomike pritet të	1. Specifikimi i llojitte aktiviteteve ekonomike të cilat janë të lejuara të mbeten

																			ketë një efekt pozitiv anësor në mbështetjen e prodhimit bujqësor të Qendres.	brenda zonave të vendbanimeve: ***Zona e konservimit*** Në këto zona përfshihen zonat karakteristike gjeonatyrore me vlerë të lartë peisazhike, mjedisore e turistike të qytetit. Në këto zona nuk mund të jepen leje ndërtimi për objekte e struktura, të cilat cënojnë identitetin e zonës. Objektet e mundshme ekzistuese të zonës mund të restaurohen, duke mos cënuar elementët arkitektonikë te veçantë të tyre. Si e tillë mund të klasifikohet zona e terreneve sportive, golf, hipizëm, etj. ***Funsionet e lejuara*** - Parqe e sheshe (vënd çlodhjeje, duke ruajtur e kultivuar gjelbërimin). - Peisazhe të mbrojtura. - Mjedise me karakter rekreativ (varka, kanoe, peshkim ekamping me shërbimet përkatëse). - Shatrivane e pasqyra ujore. - Skulptura e monumente. - Lulishte. - Kopshte zoologjikë.
	+	0	0	+	d-	d-	d+	d-	d-	d+	d+	d+	d+	d+	+	+	0	0	**Ndikime kumulative:** Kontrolli i aktiviteteve të ndotjes do të ketë një efekt afatgjatë pozitiv kumulativ në përmirësimin e mjedisit dhe shëndetit publik. Eliminimi i konflikteve të përdorimit të tokës të cilat mund të ndikojnë negativisht ne burimet turistike të zonës do të ketë një efekt afatgjatë pozitiv kumulativ në promovimin e reputacionit te zonës si destinacion te vecante për elitën dhe eko turizmin.	
																			Ndikime sinergjike: Eleminimi i veprimtarise industriale nga zonat potenciale do të ketë një efekt pozitiv sinergjik në përmirësimin e mjedisit ne zone dhe ne zonat perreth sidomos ato turistike. Inkurajimi i përqendrimit të aktiviteteve industriale në zonat e caktuara do të ketë një efekt pozitiv sinergjik në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave.	

			- Objekte të përkohshme shërbimi (vetëm me lejë të posaçme e me supervizion të vazhdueshëm të bashkisë). - Vënde për parkime për pronarët dhe përdoruesit e objekteve të kësaj zone (vetëm me lejë të posaçme e me supervizion të vazhdueshëm të bashkisë). **Zona industriale** ***Funsionet e lejuara*** Në zonën industriale do të lejohen ndërtimet me funksionet e mëposhtme: - Furra buke dhe ndërmarrje të përpunimit të ushqimit. - Magazina dhe mjedise të tjera për tregëtimin e frutave dhe perimeve. - Parkime automjetesh ose stacione shërbimi. - Ndërmarje të prodhimit të veshjeve. - Ndërmarje të prodhimit të mobiljeve. - Ndërmarje të prodhimit të makinerive dhe instrumentave. - Ndërmarje të prodhimittë instrumentave muzikorë. - Ndërmarje të prodhimit të mjeteve elektronike. - Ndërmarje të prodhimit të lodrave për fëmijë. - Ndërmarje të prodhimeve të

			galanterisë. - Ndërmarje të prodhimit e ambalazhimit të pijeve. 2. Specifikimi i distancave minimale të veprimtarive ekonomike nga përdorime rezidenciale dhe turistike në varësi të nivelit të ndikimit në mjedis (i lartë / i mesem / i ulët)
		Aktet korrigjuese: Respektimi i legjislacionit kombëtar në lidhje me klasifikimin e aktiviteteve industriale / ekonomike në varësi të ndikimit në mjedis (i lartë / i mesem / i ulët).	Zona industriale do të zhvillohet me lejë të posaçme e me supervizion të vazhdueshëm të seksionit për mbrojtjen e mjedisit dhe seksionit të urbanistikës për zbatimin e parametrave të lejes së dhënë.

Tabela 38:VLERËSIMI I VSM-së i Orientimi Strategjik 4 Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë rezidenciale dhe rritja e kohezionit social

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Ulja e periferialitetit të zonave rurale dhe malore																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
1	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Shumë nga masat sipas këtij komponenti kontribuojnë pozitivisht në objektivat e VSM, ndërsa pjesa tjetër kanë një efekt neutral. Nxitja e zhvillimit të infrastrukturës dytesore në zonat e vendbanimeve, siç janë rrugët e fshatrave, hapësirave publike dhe shërbimet publike) do të ketë një ndikim pozitiv në radhë të parë mbi kushtet e jetesës së popullatës lokale veçanërisht në pjesët rurale dhe malore të Bashkise Vlore duke ulur periferialitetin e zonave te thella. Në një nivel dytesor do të kontribuojnë pozitivisht për synimin e promovimitte formave të veçanta të interesit të turizmit duke përmirësuar atraktivitetin e këtyre zonave për vizitorët, veçanërisht në Kanine, Tragjas, Dukat , Narte etj	1. Monitorimi i zbatimit të dispozitave te PPV për zonat e vendbanimeve ne te cilat do te kete zhvillime urbane. 2. Monitorimi i cilesise se ajrit gjate ndertimit te infrastruktures mbeshtetese . 3. Masa monitoruese per pyjet dhe druret e tjere si dhe mbrojtja kunder zjarrit.
																			Efekte anesore: Zhvillimi i infrastrukturës dytesore do të ketë një efekt pozitiv anësor në përmirësimin e zhvillimit te integruar te bashkise nepermjet uljes se periferialitetit dhe rritjes se komunikimit ndermjet ish njesive administrative	
	+	+	0	+	0	d+	0	0	d+	d+	d+	d+	d-	d+	d+	+	d-	d+	**Ndikime kumulative:** Përmirësimi i mjedisit dhe shërbimeve urbane në zonat e vendbanimeve do të ketë një efekt pozitiv kumulativ në nxitjen e zhvillimit të balancuar territorial duke mbështetur popullsinë e zonave të largëta dhe ruajtjen e balancave demografike.	
																			Ndikime sinergjike: Përmirësimi i cilësisë së jetesës në pjesët rurale tëBashkise do të ketë një	

		efekt pozitiv sinergjik në mbështetjen e aktiviteteve ekonomike lokale dhe zhvillimin socio-ekonomik. Rritjen e standardeve të hapësirave publike në fshatrat dhe përmirësimin e aksesit në pika tërheqëse kulturore do të ketë një efekt pozitiv sinergjik në tërheqjen e vizitorëve në brendësi te Bashkise. Organizimi i shërbimeve ne plazh dhe aksesit ka një ndikim pozitiv sinergjik mbi ruajtjen e karakterit natyror të zonave të plazhit dhe të cilësisë së ujit të detit.	
		Aktet korrigjuese: Zhvillim paralel e jetesës duke mbështetur infrastrukturën dhe shërbimet në zonat e vendbanimeve	

Tabela 39: VLERËSIMI I VSM-së I Orientimi Strategjik 4 Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë rezidenciale dhe rritja e kohezionit social

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Reduktimi i periferialitetit brenda zonave urbane																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
2	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Komente: Shumë nga masat sipas këtij komponenti kontribuojnë pozitivisht në objektivat e VSM ne menyre te drejtperdrejte. Nxitja e zhvillimit të infrastrukturës dytesore në zonat e vendbanimeve dhe vecanerisht ne pjesen informale te bashkise do të ketë një ndikim pozitiv në radhë të parë mbi kushtet e jetesës së popullatës lokale dhe permiresimit te zonave informale dhe te pazhvilluara urbane ne Vlore, duke ulur periferialitetin e tyre si dhe zonave te paaksesueshme. Në një nivel dytesor do të kontribuojnë pozitivisht për synimin e promovimit te aktivitetve te vecabta qe do te organizohen ne hapesirat publike dhe te gjelbera.	1. Monitorimi i zbatimit të dispozitave te PPV për zonat e vendbanimeve si dhe zonat informale. 2. Zbatimi I standarteve te parashikuara per legalizim nga ALUIZNI nr katesh , ndertimesh dhe efektet ne infrasrukture . 3, Masat zbutese Monitorimi nga bashkia i sitates ne zonat informale per sa I perket respektimit te kushteve per hapesira te gjelbra , parkimi dhe tipeve ndotjeve. Monitorimi i ndotjes ajrit dhe ujit gjate ndertimit apo rehabilitimeve ne zona.
																			Efekte anesore: Ndertimi i infrastruktures sekondare krijon perkohesisht ndotje dhe pluhur. Mbetje te ngurta. Zonat informale kane cilesi ndotje te ujit te larte	
	+	0	d-	d+	d+	d+	d+	0	d+	0	d+	0	0	d+	d-	d-	d+	0	**Ndikime kumulative:** Rehabilimtimi i zonave informale si dhe vendbanimeve rrit cilesine ejtes se komunitetit . Ul ndotjet e ndryshme	
																			Ndikime sinergjike: Zhvillon zonene urbane dhe rrit assetet e saj.	
																			Aktet korrigjuese:	

Tabela 40:VLERËSIMI I VSM-së I Orientimi Strategjik 5 Përmirësimi i lidhjes dhe zhvillimi i formave multimodale të transportit

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Përmirësim i lidhjeve nëpërmjet rrugëve ndër-rajonale																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
1	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Pjesa me e madhe e masave sipas këtij komponenti kane një kontribut pozitiv në objektivat e VSM. Përmirësimi i aksesit dhe lidhjet të brendshme midis pjesëve të ndryshme të territorit të Komunës është një instrument kyç për të promovuar zhvillimin e balancuar hapësinor dhe promovimin e zhvillimit të turizmit. Përmirësimi i aksesit në pjesët rurale dhe malore të Komunës do të përmirësojë kushtet e jetesës së popullatës lokale dhe do të mbështesë zhvillimin e formave të veçanta të turizmit në përputhje me modelin e promovuar te turizmit. **Efekte anesore:** Zhvillimi i rrugëve të reja do të ketë një efekt negativ anësor në që ndikon në cilësinë e peizazhit rural veçanërisht në zonat malore me një reliev të madh. Zhvillimi i unazës së Vlorës do të ketë një ndikim të lartë në peizazhin e Kanines. Zhvillimi i rrugëve të reja në pjesen qendrore/kryesore të zonës së mbrojtjes së mjedisit mund të ketë një ndikim negativ sinergjik ne shqetësimin e habitateteve dhe fragmentimin e ekosistemit.	Gjate ndertimit te rrugeve te reja duhet : Vendosja e masave të rehabilitimit te peizazhit në ndërtimin e rrugëve ne ndertim. kalon nga fshati Kaninës: - Largim i materialeve te germuara gjate hapjes se rruges dhe i mbetjeve te tjera te ngurta duke i derguar ne vend-depozitimet e aprovuara te zones. - Gjelberimi i bankinave te rruges dhe faqeve te pjerrta anesore, ku eshte e mundur te behet mbjellje e pemeve te ullirit qe eshte karakteristike per zonen. 2. Masat zbutëse për zhvillimin e rrugëve të adresohen në 2.2 per rruget rajonale Bypass Kanina dhe Rruga e Lumit te Vlores - Gjelberim pergjate rruges me peme tipike te zones ku kalon rruga. - Instalimin e reduktueseve

																				te zhurmave (aty ku pemet anesore nuk arrijne te luajne
	+	0	d+	d+	?	0	d+	0	0	0	d+	d+	d+	d+	0	+	0	?	**Ndikime kumulative:** Reduktimi i kohës udhëtimit do të ketë një efekt pozitiv kumulativ në përmirësimin e cilësisë së ajrit Zhvillimi i turizmit dhe rritja e numrit të vizitorëve në këtë zonë mund të ketë një efekt negativ kumulativ afat të gjatë në rritjen e tensionit te vendosur të burimeve natyrore të zonës dhe të niveleve të zhurmës për shkak të rritjes së numrit të njerëzve, përveç nëse masat e duhura merren	
																			Ndikime sinergjike:	
																			Aktet korrigjuese:	

Tabela41:VLERËSIMI I VSM-së I Orientimi Strategjik 5 Përmirësimi i lidhjes dhe zhvillimi i formave multimodale të transportit

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Përmirësimi i lidhjeve lokale																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
2	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Pjesa me e madhe e masave sipas këtij komponenti kane një kontribut pozitiv në objektivat e VSM. Përmirësimi i aksesit dhe lidhjet të brendshme midis pjesëve të ndryshme të territorit të Komunës është një instrument kyç për të promovuar zhvillimin e balancuar hapësinor dhe promovimin e zhvillimit të turizmit. Përmirësimi i aksesit në pjesët rurale dhe malore të Komunës do të përmirësojë kushtet e jetesës së popullatës lokale dhe do të mbështesë zhvillimin e formave të veçanta të turizmit në përputhje me modelin e promovuar te turizmit. **Efekte anesore:** Zhvillimi i rrugëve të reja do të ketë një efekt negativ anësor në që ndikon në cilësinë e peizazhit rural veçanërisht në zonat malore me një reliev të madh. Zhvillimi i unazës së Vlorës do të ketë një ndikim të lartë në peizazhin e Kanines. Zhvillimi i rrugëve të reja në pjesen qendrore/kryesore të zonës së mbrojtjes së mjedisit mund të ketë një ndikim negativ sinergjik ne shqetësimin e habitateteve dhe fragmentimin e ekosistemit.	1. Vendosja e masave të rehabilitimit te peizazhit në ndërtimin e rrugëve ne ndertim. Bypass te anashkalojë për pjesën që kalon nga fshati Kaninës: - Largim i materialeve te germuara gjate hapjes se rruges dhe i mbetjeve te tjera te ngurta duke i derguar ne vend-depozitimet e aprovuara te zones. - Gjelberimi i bankinave te rruges dhe faqeve te pjerrta anesore, ku eshte e mundur te behet mbjellje e pemeve te ullirit qe eshte karakteristike per zonen. 2. Masat zbutëse për zhvillimin e rrugëve të adresohen në 2.2 - Gjelberim pergjate rruges me peme tipike te zones ku kalon rruga. - Instalimin e reduktueseve te zhurmave (aty ku pemet anesore nuk arrijne te luajne rol kufizues per zhurmat).

	+	d+	d-	+	d-	d-	d+	d+	d+	0	d-	d+	+	d+	d+	-	-	0	**Ndikime kumulative:** Reduktimi i kohës udhëtimit do të ketë një efekt pozitiv kumulativ në përmirësimin e cilësisë së ajrit Zhvillimi i turizmit dhe rritja e numrit të vizitorëve në këtë zonë mund të ketë një efekt negativ kumulativ afat të gjatë në rritjen e tensionit te vendosur të burimeve natyrore të zonës dhe të niveleve të zhurmës për shkak të rritjes së numrit të njerëzve, përveç nëse masat e duhura merren.	1. Monitorimi i cilësisë së ajrit 2. Monitorimi apo nivele e zhurmës në zonën bregdetare turistike të plazhit Zvernec dhe pjeses lagunes Orikum.. Zbatimi i Standardeve te zhurmës të miratuara lidhur me funksionimin e aktiviteteve turistike në zonën bregdetare - Jashte rezidencave nen 55dB(a) - Mjedise publike, të jashtme apo të brënd., nen 55dB(a) - Ceremoni, festivale dhe Argëtime nen 65dB(a)
																			Ndikime sinergjike: Zhvillimi i rrjetit rrugor do të ketë një efekt pozitiv sinergjik në të gjitha llojet e aktiviteteve ekonomike në këtë zonë dhe në rritjen e vlerës së aseteve materiale të banorëve lokalë. Efekti i mundshëm pozitiv sinergjik në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave duke e bërë më të lehtë mbledhjen e mbeturinave nga pjesët e largëta të territorit.	
																			Aktet korrigjuese: 1. **Studimi i Ndikimit te Trafikut**për zonat e propozuara të zhvillimit të turizmit në plazhin e Zvërnecit, si pjesë e kërkesave të PDV. 2. **Studimi i Ndikimit te Trafikut**për zonën industriale të propozuar përgjatë rrugës Sherishte	

Tabela42:VLERËSIMI I VSM-së I Orientimi Strategjik 5 Përmirësimi i lidhjes dhe zhvillimi i formave multimodale të transportit

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Zhvillimi i Transportit Detar																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
2	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Zhvillimi i transportit Detar ne Bashkine vkore pergjithesisht nuk bie ndesh me objektivat e mjedisit vetem ne piken e ndotjes se ujit detar kemi nje risk i cili rrjedh nga aktiviteti i renduar .Zhvillimi i i akttitetit ekonomik dhe argetues me shebimet evarkave taksi apo mini trageteve do te jape nje shtyse zhvillimit te turizmit. Do te promovoje dhe aksesoje zona te cilat deri me sot nuk jane te aksesueshme si ishulli I Sazanit, Zona e Karaburunit etj. Eshte pozitiv fakti qe nne keto zona turistike do te kete dhe transport alternativ.	1.- Largim i mbeturinave nga anijet e ndryshme ne kishtet apo vend depozitimet e caktuara . -Zbatimi i konventes per ujrat territoriale.. - Monitorimi i cilesise se ujit te detit ne pikat ku zhvillohet transporti detar - Ndalimi i ankorimit te tyre prane zonave Lagunore por ne vendodhje te vecanta te percaktuara nga Bashkia. 2. Masat zbutëse për per kontrollin gjate zhvillimit te itinerareve te Korcerave.
																			Efekte anesore: Zhvillimi i transportit detar ul perdorimin etransportit automobilistik gje qe ul trafikun ne sezon si dhe shkallen endotjes nga . Eshte me i lire si tip transporti . Duhet patur kujdes ne vendosjen e standarteve per ndotjen e ujit te detit.	
	+	-	0	+	d-	+	+	d-	d+	0	+	0	d+	d+	0	0	0	d+	**Ndikime kumulative:** Zhvillimi i turizmit (formes Krocera) dhe rritja e numrit të vizitorëve në këtë zonë mund të ketë një efekt negativ kumulativ afat të gjatë në rritjen e niveleit te ndotjes ne det apo mbetjeve pra duhet te merren masa te repta ne kete drejtim	1. Monitorimi i cilësisë së ujit te detit 2. Monitorimi apo nivele e zhurmës në zonën bregdetare turistike të plazheve pergjate Lagunave si dhe zonave te tjera te mbrojtura per te ruajtur qetesine e habitatteve . Ruajtja nga ndotja akustike - Ceremoni, festivale dhe
																			Ndikime sinergjike: Zhvillimi i transporti alternativ detar rrjetit rrugor do të ketë një efekt pozitiv sinergjik në të gjitha llojet e aktiviteteve ekonomike sidomis ne drejtim te shtimit te numrit te turisteve ne zone. Efekti i mundshëm pozitiv sinergjik në	

		përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave duke e bërë më të lehtë mbledhjen e mbeturinave direkt ne det.	Argëtime nen 65dB(a) ne te gjithe territorin e Bashkise Vlore
		Aktet korrigjuese: 1. **Studimi i Ndikimit te Trafikut Detar** për zonat e propozuara të zhvillimit të turizmit në plazhet e Bashkise Vlore e me gjere.	

Tabela 43:VLERËSIMI I VSM-së I Orientimi Strategjik 6 Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Menaxhimi i mbetjeve																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
1	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Masat sipas këtij komponenti kane një kontribut pozitiv në objektivat e VSM që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave është një politikë kritike për mbrojtjen e cilësisë së tokës, ujit nëntokësor dhe të ruajtjen e cilësisë se peizazhit. Ajo mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në kushtet e jetesës së popullsise lokale dhe standardet e turizmit.	1. Rregulla të veçanta të vendosura për deponimin / trajtimin e mbeturinave të kafshëve Ne respekt te: - Ligjit "Për mbrojtjen e mjedisit" - Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" - Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Vendor" 2. Rregulla të veçanta që duhen të respektohen në lidhje me deponimin e bizneseve turistike (vaj i restoranteve ... - ne perputhje me kerkesat e Ligjit "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe Ligjit "Për administrimin mjedisor te mbetjeve të ngurta" qe gjejne pasqyrim ne Planin e Menaxhimit dhe Monitorimit te mbetjeve te ngurta te hartuar nga komuna.
																			Efekte anesore: Reduktimi i djegies se mbeturinave do të ketë një efekt pozitiv anësor në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Efekt anësor pozitiv në promovimin e çdo formë të turizmit mjedisor miqësor në zonë, të tilla si ekoturizmi, turizmi kulturor dhe turizmi sportiv.	
	0	+	-	+	0	0	0	d+	d+	0	+	0	+	+	+	d+	0	d+	**Ndikime kumulative:** Efekti pozitiv kumulativ në cilësinë e burimeve natyrore afat të gjatë dhe cilësinë e jeteses. Efekti pozitiv kumulativ në promovimin e reputacionit te zonës si destinacion turistik të vecante të standardeve të larta.	
																			Ndikime sinergjike: Efekti pozitiv sinergjik mbi trajtimin e ndikimit negativ mjedisor të aktiviteteve tradicionale ekonomike dhe aktiviteteve turistike Efekti pozitiv sinergjik për nxitjen e ndërgjegjësimit mjedisor të popullatës lokale dhe vizitorëve	
																			Aktet korrigjuese:	

		1) Promovimi i programeve vullnetare për pastrimin e zonave të ndotura 2) Miratimi i politikës të reduktimit të mbeturinave. riciklimi dhe ripërdorimi në planifikimin e objekteve të organizuara turistike 3) Programi i riciklimit te mbetjeve dhe ndarja e tyre.	3. Kushte të veçanta / rekomandim për menaxhimin e mbeturinave të zones se plazheve te Bashkise Vlore. 4. Kushtet e veçanta për administrimin e mbeturinave në zonën e mbrojtur 5. Kushte të veçanta në lidhje me depozitimin e mbetjeve të ndërtimit 6. Monitorimi i cilësisë së ajrit - Ndikimi i deponisë së Vlorës - Monitorimi i cilesise se ajrit dhe ujrave ne zonen e landfillit te Vlores - Mbulimi me dhè dhe ngjeshja; - Hapja e kanaleve të veçanta për ujërat e kullimit; - Mbrojtjes nga zjarret; - Ndalimi i hyrjes për personat e paautorizuar; - Gjelbërimi i pjesës së fushës. ku nuk depozitohen mbetje.

Tabela 44:VLERËSIMI I VSM-së I Orientimi Strategjik 6 Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Furnizimi me uje																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
2	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Masat nën këtë komponent nuk kanë ndonjë ndikim negativ në objektivat e VSM, ndërsa disa kontribuojnë pozitivisht në lidhje me aspektet që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës së popullatës lokale dhe kontrollin e përdorimit të burimeve natyrore, si dhe zhvillimit me standarte te turizmit. Sigurimi iujit per vaditje per te kursyer ujin e pishem.	1. Monitorimi i cilësisë së ujit ne pikat e prodhimit te ujit, daljet e depove dhe ne pikat fundore te konsumit. - monitorimi periodik i vetive fiziko - kimike te ujit te pijshëm dhe i treguesve mikrobiologjike Vendosja e rrjetit te kullimit per vaditje dhe eleminimi i ujit te pijshem per vaditje.
																			Efekte anesore: Efekt anësor i mundshëm negativ ndikon në sasinë dhe cilësinë e burimeve ujore nëntokësore.	
	d+	d-	d+	d+	0	0	d+	d+	d-	d-	d+	0	0	+	d+	0	d+	0	**Ndikime kumulative:**Efekti kumulativ pozitiv në përmirësimin e shëndetit të njeriut, potesimi me uje 24 ore i zones turistik. Efekti pozitiv kumulativ në nxitjen e zhvillimit të balancuar hapësinor	
																			Ndikime sinergjike: Efekti pozitiv sinergjik në nxitjen e zhvillimit të turizmit	
																			Aktet korrigjuese:	

Tabela 45:VLERËSIMI I VSM-së I Orientimi Strategjik 6 Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Rrjeti i Kanalizimeve																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
3	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Të gjitha masat sipas këtij komponenti do të kenë një efekt pozitiv ose neutral në objektivat e VSM. Parandalimi i shkarkimeve te ujrave te patrajtuara nga zonat industriale, turistike dhe banimi është një parametër kyç për mbrojtjen e detit dhe cilësi të ujit te lagunave te Nartes dhe Orikumit i cili ka një rëndësi thelbësore për mbijetesën e specieve endemike dhe habitateve. Zhvillimi i rrjetit të kanalizimit kontribuon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së popullatës lokale dhe është një parakusht themelor për zhvillimin e turizmit.	Masat që lidhen me trajtimin e ujërave të zeza të zonave turistike: 1. Projektimi i sistemit të menaxhim te mbetjeve te ngurta dhe të lëngshme te objekteve turistike, do të bazohet në parimet e reduktimit të mbeturinave, riciklimin dhe ripërdorimin. 2. Çdo njësi hoteli me kapacitet mbi 100 dhoma ka për të ndërtuar një impiant individual të trajtimit të ujit. 3. Vendodhja për pozicionimin e impiantit te trajtimit të ujrave për plazhet me kryesore do të specifikohen nga studimi I veçantë i infrastrukturës. 4. Nuk do të jepet leje për objektin e turizmit pa sigurimin e lidhjessë rrjetitte kanalizimit të specifikuar nga PDV
																			Efekte anesore: Efekt pozitiv anësor në promovimin e reputacionin të zonës si destinacion i vecante për turizëm cilesor dhe ekoturizmit. Faza ndertimore e infrastruktures te kanalizimeve shoqerohet nga efekte negative ne levizjen e dherave, depozitimin e mbetjeve te ndertimit, cilesine e ajrit (ndotje nga pluhuri) dhe demtimin e flores ne gjurmen e ndertimit.Evitimi i ndotjes se ajrit.	
	d+	+	+	d+	+	+	0	+	+	d+	+	0	0	d+	d+	d+	0	+	**Ndikime kumulative:**Efekti pozitiv afatgjatë kumulativ në shëndetin publik. Efekti pozitiv kumulativ në rivendosjen e jetës se habitateve në ekosistemit lagunor	
																			Ndikime sinergjike: Efekti pozitiv sinergjik për mbrojtjen dhe përmirësimin e biodiversitetit	

			përkatëse për zonën bregdetare. Nuk duhet te jipet leje ndertimi per infrastrukturen e kanalizimeve dhe perpunimin e ujrave te zeza pa specifikimin e detyrimeve per hartimin dhe zbatimin e planeve te monitorimit dhe manaxhimit : te kontrollit te pluhurave, te mbetjeve te ngurta, per rehabilitimin e siperfaqes ne gjurmen e ndertimit, per rehabilitimin dhe kompensimin e flores te demtuar nga ndertimi.
		Aktet korrigjuese: Studimi i veçantë fizibilitetiti per Infrastrukturen lidhur me qellimin e ndërtimit të veçantë te impiantit të trajtimit të ujrave të zeza për zonën bregdetare të Narte, Zvërnec , Radhime Orkum.	Parandalimi i shkarkimeve te ujrave te patrajtuara nga zonat industriale, turistike dhe banimi është një parametër kyç për mbrojtjen e detit dhe cilësi të ujit te lagunave te Nartes dhe Orikumit i cili ka një rëndësi thelbësore për mbijetesën e specieve endemike dhe habitateve. Zhvillimi i rrjetit të kanalizimit kontribuon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së popullatës lokale dhe është një parakusht themelor për zhvillimin e turizmit

Tabela 46: VLERËSIMI I VSM-së I Orientimi Strategjik 6 Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Përdorimi i energjisë dhe burimeve të reja																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
4	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Të gjitha masat sipas këtij komponenti do të kenë një efekt pozitiv ose neutral në objektivat e VSM. Sistemimi me enrgji 24 ore te zones se Bashkise Vlore do te sjelle permiresime ne mbarevajtjen e turizmit ne zone. Perdorimi alternativ i burimeve te tjera te energjise eshte teper ekonomik si dhe ul ndotjen ne mjedis duke perfituar ne sasi edhe me shume energji.	1.Ndalimi i ndertimit te Hidrocentraleve ku nuk ka fizibilitet te plote. 2.Evitimi i perdorimit te burimeve natyrore sekondare per marrje energjie. 3.Paraqitja e studimit te detajuar mjedisor per cdo nderhyrje ne burimet natyre duke marre lejet perkatese mjedisore. 4. Monitorimi i zonave te zhvillimit si ne vecanti zonart pyjore. 5. Masat kunder zjarrit. 6. Masa te rrepta nese rifunksionon TEC i Vlores
																			Efekte anesore: Energji alternative ul shpenzimet e konsumit te energjise , ben me eficente perdorimin e tyre si dhe ka mundesi te punoje pa nderpreje 24 ore. Si efekt anesor negativ eshte prishja pamore e peisazhit. Perdorimi i enrgjise primare con ne uljen e burimeve natyrore si dhe shkakton deme ne mjedis duke ndryshuar sistemet.	
	d+	0	0	d+	0	d+	0	d+	d+	0	d+	0	0	+	0	d+	0	0	**Ndikime kumulative:** Efekti pozitiv afatgjatë kumulativeshte sigurimi energjise alternative per shtim prodhimi dhe shebimesh te ndryshme.	
																			Ndikime sinergjike: Shtimi i te ardhurave nga perdorimi i energjise alternative.	
																			Aktet korrigjuese:	

Tabela 47:VLERËSIMI I VSM-së Orientimi Strategjik 6 Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore

POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	Rehabilitimi i Tokes																		KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
5	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	**Komente:** Shumica e masave sipas këtij komponenti kontribuojnë pozitivisht në objektivat e VSM. Rehabilitimi i tokës përgjatë bregdetit lindor të brendshëm të lagunës se Nartes do të kthehet përsëri bashkise si një burim i rëndësishëm, aktualisht i papërdorur, që mund të gjenerojë vlera të shumta, ekonomike, rekreative dhe mjedisore. Pyllëzimi dhe krijimi i natyrës së re mund të sigurojë kushtet për rigjenerimin e habitateve. Rehabilitimi i tokës për bujqësi pergjate pjeses veri perendimore te bashkise Vlore, Narte, Novosele si dhe zona Orikumit afer lagunes mund të ketë ndikim pozitiv ekonomik për të ardhurat e popullatës lokale.	Masat zbutëse për bujqësi: 1. Nxitja e kultivimit te produkteve organike dhe vetëm produkte të cilësisë lokale. 2. Parandalimi i përdorimit te pesticideve dhe kimikateve në tokë ne afersi me lagunen 1. Masat zbutëse për krijimin e ishujve artificiale dhe bregdetit: - ndalimi i ndertimit te objekteve rekreative apo te aktivitetit publik ne ishujt artificiale (me perjashtim te ndonje kulle vrojtimi); - rehabilitimi i siperfaqes se ishujve artificiale dhe kultivimi mbi to i bimeve tipike te lagunes; - krijimi i kushteve dhe rehabilitimi i flores dhe faunes tipike te lagunes me synim vijueshmerine e ekosistemit (eliminimin e fragmentarizimit te
																			Efekte anesore: Efekt potencial negativ anësor i aktiviteteve bujqësore në cilësinë e ujit te lagunave. Efektet e mundshme negative anësore të modifikimit të bregdetit te lagunes se Nartes dhe krijimin e ishujve artificiale në ekosistemit lagunor Rehabilitimi i tokës bujqësore do të ketë një efekt pozitiv anësor mbi të ardhurat e komunitetit si dhe shtimi i vlerave te aseteve te tyre.	
	d+	d+	+	+	0	d+	d+	d+	d+	+	+	0	0	d+	0	d-	0	+	**Ndikime kumulative:**Rehabilitimi i peizazhit do të ketë një efekt pozitiv kumulativ në mbështetjen e zhvillimit të turizmit te Bashkise si dhe vlerat ekonomike e bujqesore.	
																			Ndikime sinergjike: Projektet e propozuara për ripyllëzimin dhe krijimin e ishujve artificiale do të	

		ketë një efekt pozitiv sinergjik në rigjenerimin e habitateve dhe biodiversitetit në pjesën lindore te lagunes. Efekt pozitiv sinergjik në zhvillimin e formave të veçanta të interesit të turizmit (ekoturizmit, turizmit rekreativ, agro-turizmi, turizmi natyror). Efekti i mundshëm pozitiv sinergjik me Planin e Menaxhimit në promovimin e projekteve të përbashkëta pilote te ndërgjegjësimit mjedisor në lidhje me zonat per rikuperimin e peizazhit.	shkaktuar nga ishujt); - Mbjellja e shkurretave tipike lagunore dhe krijii i kushteve natyrale per folezimin e shpendeve te rezikuara te lagunes 1. Monitorimi i biodiversitetit 2. Hartim i plan veprimit dhe manaxhimit te formave te turizmit me interes te veçante ne zonen breg-lagunore dhe ate te ishujve artificiale.
		Aktet korrigjuese:	

6. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I SISTEMIT TË PLAN - MONITORIMIT

6.1 Vlerësim i Përgjithshëm

Zona bregdetare Vlorë, e cila përbën pjesën më të madhe dhe më tërheqëse të Rivierës shqiptare, është një rast unik i njësisë territoriale me karakteristika të dallueshme, që aktualisht përballet me një dilemë të madhe në lidhje me zhvillimin e saj të ardhshëm. Pavarësisht se cilësia e rrugëve në vitet e fundit është përmirësuar ndjeshëm dhe shpejtësia mesatare e vozitjes është rritur, koha e mbërritjes në qendrën administrative është relativisht e gjatë (rreth 2 orë nga Tirana) megjithese distancat nuk janë të konsiderueshme. Zbatimi i pjesshëm planeve të mëparshme të zhvillimit bën që aktualisht të këtë një mungesë vizioni dhe rregullash konkrete për ndërtim dhe zhvillim të qëndrueshëm urban. Ndërkohë potenciali për zhvillimin e turizmit duket se ka kapacitete që mund të sjellin përmirësime rrënjësore të kapitalit vendas dhe të cilësisë së jetës së popullatës lokale. Turizmi, peshkimit, bujqësia përbëjnë sot bazën e aktiviteteve ekonomike në bashkinë e Vlorës. Zhvillimi jo i qëndrueshëm i këtyre viteve të fundit ka sjellë një situatë jo normale në këtë bashki. Plani Vendor synon të normalizojë këtë situatë të krijuar duke e shndërruar zonën në një atraksion turistik i cili konkuron globalisht.
Nivelet e monitorimit deri më sot në këtë bashki kanë qenë në nivele të pakënaqshme gjë e cila lidhet me shumëfaktorë. Duke qenë se sot tendenca e turizmit ecën në drejtim të rritjes së kërkesave lind nevoja për një monitorim të vazhdueshëm. Mungesa e kapaciteteve monitoruese si për nga teknologjia ashtu edhe ai njerëzor e vështirëson monitorimin, për këtë arësye ekspertët kanë përpunuar një sistem monitorues të thjeshtë i cili reflekton një nivel mesatar zhvillimi dhe kërkesash për aftësi të stafit, për një të një Bashki Evropiane të një niveli të mesatar. Sistemi përputhet me të gjitha kërkesat kombëtare dhe parashikon edhe kërkesa të reja për integrim në të ardhmen që mund të lindin si rezultat i marrëveshjeve ndërkombëtare që mund të lidhë qeveria shqiptare.

Siç është thënë edhe në kapitujt pararendës sistemi i monitorimit dhe në mënyrë të veçantë objektivat dhe treguesit janë rrjedhojë direkte e punës së detajuar të vlerësimit dhe e nevojës për të ndjekur pranë evoluimin e implementimit të planit paralelisht me masat e detajuara të impaktit.

Në varësi nga niveli i ekspertizës së administrimit të bashkisë, të sistemit ekzistues të monitorimit kombëtar, në varësi dhe të kompleksitetit të zhvillimit dhe të disa parametrave të tjerë mjedisor, sistemi i monitorimit të VSM luhatet nga mjaft i thjeshtë në mjaft i ndërlikuar, të dyja këto duke u bazuar si në të dhënat e grumbulluara deri më tani e deri tek mjetet e monitorimit dhe metodologjia.

Sistemi është mjaft fleksibël dhe mund të bëhet mjaft i ndërlikuar kur flitet për mjetet dhe matjet (p.sh kur flitet për treguesit mjedisorë dhe matjet e tyre në stacione e specializuara) dhe nëse duhet, zhvillimi ekonomik i mundëson këto mjete.

Sistemi është bazuar kryesisht në ato pak të dhëna që janë gjetur dhe grumbulluar nga administrata aktuale për fusha të ndryshme, nga të dhëna në nivel kombëtar si dhe në raportet dhe të kërkimet e realizuara për **Plani Vendor** si dhe në potencialin e eksperteve dhe të aftësive të tyre.

Ekspertët u munduan të optimizojnë midis kërkesës dhe realitetit për matje te mundshme si dhe ndjekjen e vazhdueshme për monitorime, duke mos e rënduar administratën.

6.2 Sistemi i Monitorimit

Qëllimet dhe objektivat e VSM si dhe masat zbutëse lidhur me mjedisin janë paraqitur edhe në kapitujt e mëparshëm.

Më qëllim që VSM të ketë një përdorim praktik për administratën e bashkisë dhe për shtresat e interesuara, do të ishte e nevojshme vendosja e një numri indikatorësh dhe një sistemi monitorimi që do ta bënin atë sa më të thjeshtë dhe praktik, duke përdorur si burimet ekzistuese ashtu dhe aktivitetet shtesë.

Sistemi i monitorimit do tu mundësojë grupeve të interesit:

a) Monitorimin e progresit drejt objektivave të VSM
b) Monitorimin e efekteve mjedisore që vijnë nga zbatimi i PPV
c) Identifikim e efekteve negative të paparashikuara mbi mjedisin apo të paralajmërohen në stade të hershme
d) Mundësim për veprime korrigjuese të përshtatshme

Sistemi i indikatorëve të monitorimit, i qëllimeve dhe metodave të matjes do të paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Një proces rishikimi dhe monitorimi është përgatitur për tu përfshirë në një raport vjetor, që do të hartohet nga sektori i mjedisit në administratën e bashkisë (me ndihmën e eksperteve kur është e nevojshme) dhe që do t'i paraqitet Këshillit Bashkiak.

Është propozuar që informacioni i mjedisit të përditësohet çdo 6 muaj me qëllim për të siguruar një paralajmërim të në kohë të përshtatshme në rastet e një dëmtimi serioz mjedisor, pavarësisht që raporti i monitorimit të VSM është vjetor.

Sistemi i monitorimit do tu mundësojë grupeve të interesit të bashkisë të vlerësojnë nga pikëpamja mjedisore, strategji dhe programe të tjera që mund të zbatohen në të ardhmen, duke ndjekur iniciativat e Këshillit Bashkiak dhe mundësi apo programe të BE.

Procesi i monitorimit të VSM duhet të ecë që sot e tutje paralelisht me zbatimin e PPV duke u bërë pjesë integrale e tij.

Të gjithë qëllimet dhe të dhënat janë të bazuara në objektivat e PPV dhe standardet kombëtare. Në rrugën e zbatimit mundet që Shqipëria të përshtatë edhe më tej standardet e saja me ato të BE-se apo nga marrëveshje ndërkombëtare të reja (p.sh për cilësinë e ajrit, objektivat për klimën dhe efektin serrë etj), duke bërë kështu të mundur që sistemi i monitorimit të përmirësohet me këto objektiva të reja (si dhe arritje të tjera të rëndësishme).

Poshtë janë siguruar disa të dhëna bazë ekzistuese lidhur me gjendjen aktuale si dhe disa vlera normale për parametra të ndryshëm.

6.2.1 Normat për Parametrat e Ujit të Pijshëm

Bashkia në bashkëpunim me institucione të tjera duhet të monitorojë dhe të ulë disa vlera të parametrave të ujit të pijshëm në përputhje me ato kombëtare dhe ato ndërkombëtare si Direktiva */98/83/EC apo standardet e OBSH.* Disa parametra kimikë, mikrobiologjikë, pesticide dhe komponime organike janë plotësisht jashtë monitorimit dhe nuk kanë asnjë vlerë për to. Është shumë e rëndësishme për shëndetin publik që këto parametra të jenë nën monitorim për tu mbajtur në nivelet e lejuara. Të gjitha zonat përreth burimeve ujore duhet të konsiderohen dhe të shpallen Zona Sanitare të Mbrojtura bazuar kjo edhe në ligj (Ligj Nr. 8093, 21.3.1996, Nr. 111/2012).

Tabele 48: Treguesit fiziko-kimike të ujit të pijshëm dhe Objektivat

Nr	Treguesit kimike	Vlerat e monitorua ra të ujit të pijshëm në Bashkinë Vlorë	Standarde Kombëtare ml/ujë	Max	Objektiva nga 2018 (Direktiva e Këshillit 98/83/EC & te tjera)
1	Shija dhe era (numër hollimi)			2deg12^0 C, 3deg25^0 C	E pranueshme nga konsumatoret dhe nuk ka ndryshim jo të rregullt
2	Ngjyra dhe pamja e jashtme (mg/l shkalla Pt/Co)		1	20	E pranueshme nga konsumatoret dhe nuk ka ndryshim jo të rregullt
3	pH		6,5-8,5	9,5	$\geq$ 6.5 dhe $\leq$ 9.5
4	Konduktiviteti elektrik (µS/cm)		400		2500
5	Kalcium (mg/l)		75	200	200
6	Lendet pezull				0

	(mg/l)				
7	Turbullira (FTU)		0.4	4	Nuk ka udhëzime
8	Alkaliniteti (mg ekv/l)			n.v	Acc.pH
9	Karbonate (mg/l)				250
10	Bikarbonate (HCO^-_3) (mg/l)		H_2O not $CaCO_3$	n.v	Ac.pH
11	Amonjak (mg/l)		0	0,05	0.50
12	Nitrite (mg/l)		0	0,05	0.5
13	Nitrate (mg/l)		25	50	50
14	Fortësia Totale (^{o}german)			20	36-71
15	Fosfate (mg/l)		0,4	2,5	2.5
16	Lëndë Organike (mg/l)		1	3	3
17	Klorure (mg/l)		25	200	250
18	Sulfate (mg/l		25	250	250
19	TDS (mg/l)		500		≤1500
20	Magnez(mg/l)		20	50	0.05

Tabela 49: Treguesit mikrobiologjike të ujit të pijshëm dhe objektivat

N°	Treguesit mikrobiologjike	Pus i përbashkët para Klorinimit	Vlerat në Bashki	Standarde kombëtare ml/ujë	Objektiva nga 2016 Direktiva e Këshillit 98/83/KE ml/ujë
1	E. Coli			0/100	0/250
2	Strept			0/100	0/250
3	Pseudomonas aeruginosa			n.v	0/250
4	Numri i kolonive 22°C			n.v	100/ml
5	Numri i kolonive 37°C			n.v	20/ml

6.2.2 Monitorimi i Ujit të Detit

Deti përbën burimin kryesor të të ardhurave direkt dhe indirekte të bashkisë Vlorë për këtë arësye ai është një element shumë i rëndësishëm për këtë bashki dhe duhet monitoruar për të përcaktuar zonat e ndotura dhe ato të pastra. Ndërkombëtarizimi i përbërjes së turistëve vitet e fundi e bën të detyrueshme krahasimin e parametrave të ujit me ato të standardeve europiane.

Bashkia ka detyrimin ligjor dhe është përgjegjëse për marrjen e kampioneve të ujit në zonat e plazheve duke e identifikuar atë. Bashkia duhet të kryejë të paktën pesë (5) monitorime nëpërmjet kampionëve të ujit të marra në plazhet e identifikuara për çdo sezon plazhi, duke filluar nga një kampion për sezonin para fillimit të sezonit veror dhe katër të tjera gjatë sezonit veror. Si sezon plazhi të konsiderohet nga 1 Qershori deri në 1 Shtator dhe para-sezon nga 15 Maji deri në 31 Maj.

Tabela 50: Kërkesat Cilësore të ujërave të plazheve në përputhje me BE

Direktiva e KE për cilësinë e ujërave të plazheve (76/160/EEC)		
Parametra	**Udhëzim**	**I detyrueshëm**
Mikrobiologjike		
Totali i coliform (Numri/100ml)	≤500 [1]	≤10,000 [3]
Foecal coliform (Numri/100ml)	≤100 [1]	≤2,000 [3]
Fiziko-kimike		
Vajra minerale (mg/l)	≤0.3 [2]	Jo film dukshme në sipërfaqen e ujit dhe pa erë [3]
Substanca me sipërfaqe aktive (mg/l)	≤0.3 [2]	Jo shkume te qëndrueshme [3]
Fenol (mg/l as C_4H_3OH)	≤0.005 [2]	Nuk ka ere specifike ≤ 0.05 [3]

Shënim1: ≥80% të mostrave - Shënim 2: ≥ 90% të mostrave - Shënim 3: ≥ 95% të mostrave

Është shumë e rëndësishme për Bashkinë që të mund të kryejë këtë monitorim të këtyre parametrave brenda vitit *2017*. Rezultatet e monitorimit duhet edhe të shërbejnë si bazë për masat e nevojshme që duhen marrë. Rezultatet duhen të bëhen të njohura me mënyra të ndryshme për publikun si dhe përmes faqes së internetit të Bashkisë. Bashkia në bazë të rezultateve mund të hartojë një hartë me cilësinë e ujërave dhe plazheve.

6.2.3 Cilësia e Ajrit dhe Standardet

Në analizën e gjendjes aktuale në bashkinë Vlorë, vlerësimi i cilësisë së ajrit është monitoruar nga institucionet përkatëse. Nga rezultatet ai nuk rezulton shqetësues, por duke marrë parasysh zhvillimin e zonës Bashkia duhet të sigurojë dhe të synojë që parametrat e cilësisë së ajrit të mbeten të mbeten brenda kufijve të përcaktuara si normale nga Direktiva *2008/50/EC për cilësinë e ajrit si dhe bazuar në Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe Ligjin nr. 162, date 04.12.2014 " Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit"*. Bashkia duhet të monitorojë nivelin e ndotësve në mënyrë të rregullt gjatë gjithë vitit dhe duhet shtuar numri i stacioneve sidomos gjatë sezonit veror. Në varësi të monitorimeve Bashkia duhet edhe të marrë masat e nevojshme për uljen apo ruajtjen e vlerave brenda standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Strategjia e mjedisit 2015-20 përcakton objektivat e qeverisë shqiptare për një numër ndotësish si: (i) ulja me 40% e nivelit të ndotjes në zonat urbane; (ii) arritja e niveleve të ndotësve të ajrit, bazuar në shëndetin human, në vlerat përkatëse: për NOx - 40 μ/ m³, për PM10 - 40 μ/ m³, për PM2,5-25 μg/m3 dhe 20 μg/m3 dhe SO_2-125 μ/ m³ per 24 orë ose 20 μ/ m³ në vit.

Tabela 51: Vlerat e kufi të ndotësve (burimi ISHP)

Periudha e Monitorimit				Objektiva nga 2016
Ndotësit	**Metoda**	**Vlera e periudhës mesatare**	**Standarde AL**	**Standarde e BE**
(μg/m³)			**(μg/m³)**	**(μg/m³)**
Pluhuri total	**gravm**		**140**	**80**
PM $_{10}$	**ads**		**40**	**40**

O_3	ads		120	110
NO_2	ads		50	40

Tabela 52: Niveli i kufi i ndotësve të ajrit për tu monitoruar

Ndotësit	Përqendrimi	Periudha Mesatare	Te monitorohet dhe zvogëlohet nga viti
Grimcat e Imëta (PM2.5)	25 µg/m3	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2015
Dyoksidi i Squfurit (SO2)	350 µg/m3	1 ore	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2014
	125 µg/m3	24 ore	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
Dyoksid Azoti (NO2)	200 µg/m3	1 ore	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
	40 µg/m3	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 1.1.2014
PM10	50 µg/m3	24 ore	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
	40 µg/m3	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
PLUMB (Pb)	0.5 µg/m3	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
Monoksid Karbon (CO)	10 mg/m3	Maksimalja ditore 8 ore mesatarja	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
Benzen	5 µg/m3	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2010
Ozon	120 µg/m3	Maksimalja ditore 8 ore mesatarja	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2010
Arsenik (As)	6 ng/m3	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
Cadmium (Cd)	5 ng/m3	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
Nikel (Ni)	20 ng/m3	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
Hidrokarbure Aromatike Policiklike	1 ng/m3 (i shprehur si përqendrim i benzenit (a)pirene)	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
PM2.5 Përqendrim i ekspozuar i detyruar	20 µg/m3 TME (Treguesi Mesatar i Ekspozimit)	Bazuar ne Mesataren e 3 viteve	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2018

Bashkia duhet gjithashtu të përgatisë një plan apo program për të siguruar përputhshmërinë e vlerave me standardet përpara datës së synuar limit të përcaktuar në tabelat e mësipërme. Gjithashtu Bashkia duhet të marrë masat për të siguruar transparencën lidhur me informacioni mbi cilësinë e ajrit për grupet e interesit dhe publikun.

6.2.4 Ndotja Akustike

Të dhënat mbi ndotjen akustike në Bashkinë e Vlorës mbeten brenda intervaleve të. Një bazë të dhënash lidhur me nivelin e zhurmave në zonë sigurisht që do të ndihmonte shumë në përcaktimin e saktë të masave që duheshin marrë në zonat më të ndjeshme për të siguruar një zonë turistike të shëndetshme dhe relaksuese. Shqetësuese në këtë bashki për biodiversitetin uujor është ndotja akusike e ujit të detit si pasojë e pranisë së një numri relativisht të madh anijesh tregtare, peshkimi e tragetesh.

Në përgjithësi **vlera e synuar për zhurmat** nuk duhet të kalojë vlerën maksimale prej ***Lmax-56 dB*** gjatë ditës dhe ***45 dB*** gjatë natës në të gjitha zonat e Bashkisë. Për të realizuar këtë duhen marrë masa të përshtatshme që të jenë në përputhje me parimet dhe objektivat kombëtare dhe ato ndërkombëtare e sidomos me Direktivën e Zhurmave në Mjedis 2002/49/EC.

6.2.5 Synimet për Mbetjet

Bashkia e Vlorës gjeneron në tërësi rreth 125 000t mbetje në vit. Problematika e mbetjeve në këtë bashki kërkon një ndërhyrje të menjëhershme për një zgjidhje të shpejtë dhe afatgjatë. Plani sugjeron ndërhyrje me projekte dhe investime. Në plan parashikohet ndërtimi i një impianti me teknologji moderne që të diferencojë mbetjet dhe të djegë ato që nuk mund të trajtohen më tej, duke shfrytëzuar të gjitha cilësitë e këtyre mbetjeve, i vendosur në zonën industriale gjendet në rrugën për në fshatin Sherishte. Zhvillimi i një sistemi transporti për mbetjet,vendosjen e kontenierëve me një dendësi më të madhe si dhe një program për ndërgjegjësimin e komunitetit të Bashkisë Vlorë.

Këto veprime do të mundësohen përmes respektimit të një numri të madh ligjesh dhe VKM (*Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 " Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"; Vendim nr. 705, datë 10.10.2012 " Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës";Vendim nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"; Vendim nr. 178, datë 6.3.2012 " Për incinerimin e mbetjeve";Vendim nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve"; Vendim nr. 765, datë 7.11.2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"; Vendim nr. 866, datë 4.12.2012 "Për baterritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"; Vendim nr.957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"; Vendim nr.117, datë 13.02.2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje; Vendim nr. 52 datë 5.2.2014 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.117, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojne kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje"; Vendim nr. 798, datë 29.09.2010 "Për administrimin e mbetjeve spitalore"; Vendim nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"; Vendim nr.371, datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"; Vendim nr.418, datë 25.06.2014 " Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; Vendim nr.608, datë 17.09.2014 "Për përcaktimin e masave të*

nevojshme pë nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre";Vendim nr. 641, datë 01.10.2014 "Per miratimin e rregullave per eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit te mbetjeve jo te rrezikshme e të mbetjeve inerte" dhe ligjin përimportin e mbetjeve 2016) parimet e strategjise kombëtare dhe ligjit mbi menaxhimin e mbetjeve si dhe duke zbatuar tre parimet të BE lidhur me reduktimin e sasisë së mbetjeve: 1. *Parandalimi të krijimit të mbetjeve; 2. Duke ndihmuar në riciklim dhe ripërdorim; 3. Duke përmirësuar grumbullimin final të mbetjeve dhe duke monitoruar.* Kjo qasje e re do të çojë në një përmirësim të gjendjes së mbetjeve në të ardhmen.

1. **Parandalimi i krijimit të mbetjeve**: Ky është një faktor kyç në strategjinë e menaxhimit të mbetjeve. Bashkia duhet të synojë pakësimin e krijimit të sasisë së mbetjeve që në origjinë si dhe reduktimin e rrezikut që vjen prej tyre nga pakësimi i substancave të dëmshme, për pasojë edhe hedhja e grumbullimi i tyre do të jetë automatikisht më i thjeshtë.
2. **Ndihmë për industrinë e riciklimit**: Organizimi nga ana Bashkisë i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, do të rrisë interesin e industrisë së riciklimit për grumbullimin dhe largimin e tyre nga zona.
3. **Përmirësimi hedhjes së mbetjeve dhe monitorimi**: Atje ku është e mundur, për mbetjet të cilat nuk mund të riciklohen dhe të ripërdoren ato duhet të dërgohen në incinerator dhe në mundësi të fundit në landfill. Të dyja këto mundësi kërkojnë një monitorim të kujdesshëm pasi mund të sjellin dëmtime serioze për mjedisin.
4. **Shmangie të hedhjes së mbetjeve** det, në shtretërit e përrenjve dhe lumenjve, buzë rrues apo në çdo vend tjetër jo të destinuar për hedhje mbetjesh. Një synim i menjëhershëm duhet të jetë monitorimi i aktivitetit të ndërtimit, industrive prodhuese dhe turizmit.

Në tabelën e mëposhtme jepen disa objektiva dhe synime kohore lidhur me qasjen e përmendur me sipër.

Tabela 53: Objektivat për reduktimi e mbetjeve

Parimi	Objektiva	Nga viti
Asgjësimi i mbetjeve që shkojnë në landfill	Reduktimi në masen 45%;	2020
Riciklimi dhe ripërdorimi	Mbledhja e diferencuar e mbetjeve nga 35%	2020
Përmirësimi i asgjësimit përfundimtar dhe monitorimi	Të gjitha mbetjet e mbledhura me 100%	2017
Shmangia e asgjësimit në shtretër të lumenjve dhe rrugëve anësore	Të gjitha mbetjet 100%	2017
Asgjësimi në landfille në mënyrë të kontrolluar	Në masën 75%	2017
Monitorimi i mbetjeve të industrisë	Shmangia e rritjes se peshkut ne	2017

së peshkut dhe akuakulturës	gjire te mbyllura nga 100%	
Portet e reja dhe ekzistuese (marina)	Shmangia e derdhjes së naftës dhe mbeturinave të tjera në det	2017

6.2.6 Ujërat e Ndotura

Në bazë të Strategjisë Kombëtare brenda vitit 2020 të arrihet plotësisht mbrojtja e ekosistemeve lumore: a)Të realizohet mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ujerave nepermjet zbatimit te Planeve te Menaxhimit te Burimeve Ujore brenda vitit 2020; b)Monitorimi i vazhdueshem i cilesise se ujerave siperfaqesore dhe nentokesore nga institucionet përgjegjëse në bashkepunim me MM.
Në tabelat e mëposhtme ekspertët kanë vendosur disa objektiva dhe synime të reja kohore, në mungesë të një synimi të ri në nivel kombëtar, për ujërat e ndotura dhe çështjet e lidhura me to. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh që niveli i kanalizimeve është mjaft i ulët në këtë bashki (nuk ka asnjë rrjet të mirëfilltë ujërash të ndotura ose gjenden vetëm gropa septike aspak të ndërtuara sipas standardeve), rritet nevoja e monitorimit si dhe ndërtimit të infrastrukturës përkatëse duke siguruar mbrojtjen e shëndetit të popullatës.

Tabela 54: Objektivat e reduktimit të ndotjes së ujit

Parimi	Objektiva	Nga viti
Menaxhimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore me qëllim reduktimin krahasuar me vitin 2011 të ndotjes së tyre	Reduktimi i ndotjes 95 %	2020
Riciklimi dhe ripërdorimi i ujit për qëllime te ujitjes	Riciklimi 35%	2020
Përmirësimi i kritereve për licenca të reja dhe për ripërtëritje (industriale dhe bujqësore) dhe monitorimi	Kriter i ri dhe monitorimi 100%	2018
Shmangia e shkarkimit të ujit të ndotur nga agroturizmi në përrenj dhe lumenj (pa trajtim paraprak) dhe nga peshkimi	Të gjitha shkarkimet nga 100%	2017
Ndërtimi i rrjetit te ujërave të zeza apo i sistemeve individuale (ujërat urbane dhe mbeturinat)	Mbulimi me rrjet i të dyjave 80%	2020
Përmirësimi dhe ndërtimi i gropave septike sipas standardeve të BE-së (të gjitha fshatrat)	Pjesa tjetër e zonës 100%	2020

6.2.7 Monitorimi i Pyjeve, Hapësirave të Gjelbra dhe të Mbrojtura

Hapësirës e pyllëzuar është një element mjedisori rëndësishëm në bashkinë Vlorë. Vetëm pyjet halore bregdetare zënë një sipërfaqe prej 1200 ha. Është e domosdoshme nevoja e një monitorimi të rreptë dhe aplikimit të plotë të ligjit për Pyjet Nr 9385/2005 ndryshuar me Nr. 48/2016. Monitorimi i pyjeve është i domosdoshme për t'i mbrojtur ato nga djegiet aksidentale si pasojë e praktikave të gabuara në zonë për djegien e kullotave apo për shkak të prerjes së drurëve për

qëllim ngrohjeje. "Zonat e Mbrojtura" janë te rrezikuara si pasojë e presioneve të zhvillimit në zonë. Zhvillimet e fundit në pyllin e Sodës tregojnë për domosdoshmërinë e forcimit të ligjit. Dëmi që vjen nga djegiet dhe prerjet e druve nuk lidhet vetëm me pyjet por edhe me llojet e rralla dhe endemike që i përdorin ato si habitate.

Tabela 55: Monitorimi i pyjeve dhe zonave te mbrojtura dhe te gjelbra

Parime	Objektiva	Nga viti
Parandalimi i dëmtimit të kullotave dhe pyjeve	Reduktimi i dëmtimit 100%	2018
Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura	Për zonat e reja të shpallura dhe përditesimi/rishikimi i planeve ekzistuese në masën 100%	2019
Shtimi i sipërfaqes së pyllëzuar	Rritje me10%	2020

6.2.8 Guroret

Në territorin e bashkisë Vlorë gjenden disa gurore monitorimi i të cilave është e një rëndësie të veçantë mgjse aktualisht ato nuk përbëjnë një shqetësim. Riliçensimi dhe rinovimi i lejeve për këto industri është një proces i një rëndësie të veçantë dhe duhet të bëhet në respekt të ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse (udhëzim 3, Maj 2006 Ministria e Mjedisi, ligj për Vlerësim e Thelluar Mjedisor. Në mënyrë të veçantë për guroret është e rëndësishme aplikimi i udhëzimit në pikat e nenit 14 (a, b, c, d). Hapja e guroreve të reja duhet të bëhet në zonat e sugjeruara nga Plani ose duke u bazuar në sugjerimet e specialistëve dhe të Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

Tabela 56: Monitorimi i guroreve dhe rehabilitimi

Parime	Objektiva	Nga viti
Parandalimi i rinovimit te licencës për guroret pa vlerësimin paraprak mjedisor nga Agjencia e Vlerësimit Rajonale të Mjedisit	100%	2017
Rehabilitimi i guroreve ekzistuese sipas Direktives 3, Maj 2006 MoEFËA	100%	2018

6.2.9 Monitorimi i Tokës Bujqësore

Bashkia Vlorë ka njëfond të konsiderueshëm të tokës bujqësore e cila vitet e fundit është cënuar nga presionet e zhvillimit dhe kryesisht ndërtimit. Monitorimi i saj është mjaft i rëndësishëm sidomos në kushtet kur presioni i zhvillimit po e redukton atë në mënyrë konstante. Grupi i ekspertëve ka vendosur dy objektiva lidhur me gjendjen aktuale të tokës bujqësore me qëllim përmirësimin e gjendjes së saj pas aprovimit të Planit.

Tabela 57 : Monitorimi i tokës bujqësore

Parime	Objektiva	Viti
Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore nën ujë	**Me 20%**	**2019**
Rritja e sipërfaqes së tokës me bonitetit të lartë	**Me 15%**	**2020**

6.3 Objektivat, Indikatoret & Synimet për VSM-në e Vlorës

Në tabelat e mësipërme shpjegohet se si një numër monitorimesh dhe vlerësimesh është i nevojshëm gjë e cila kërkon dhe një seri sistemesh dhe metodash matjeje që duhen të implementohen në zonë. Ndër më kryesoret mund të përmendim:

1. Sistemi i monitorimit GIS i PPV. Kjo do të monitoroje të dhënat hapësinore, parametrat peizazhit, pyjet, kullotat bregdetin, zhvillimi dhe pasqyrimi, hapësira të gjelbëria, zonën industriale.
2. Matjet e specializuara teknike përcaktohen nga bashkia për tu realizuar nga palët e treta të specializuara, të tilla si cilësia e ujit të pijshëm, cilësia e ujit të detit, cilësia e ajrit, matje të cilësisë tokës.
3. Metoda e gjetjes se të dhënave nga burimet ekzistuese brenda Bashkisë Vlorë, ose regjistrat kombëtare, siç janë licencat e strehimit, të dhënat e popullsisë, urbanistikes, të dhënat studentëve dhe kompanive, të dhëna mbi pronësinë.
4. Hartimi i rregulloreve në përputhje me ligjin nga ana e bashkim për përdorimin e pesticideve, plehrave kimike etj.
5. Sondazhet bashkiake dhe statistikat mbi çështje që lidhen me kushtet e strehimit, kontrollet ndaj ndërmarrjeve për normat mjedisore qe duhen respektuar, sondazhe të pasurive natyrore të tilla si përrenj, lumenj etj.
6. Këshilli bashkiak dhe veprimet, investimet e vendimet administrative që zgjidhin ne mënyre përfundimtare, problemet kryesore, apo zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese, projekteve pilot mbi "energjinë e gjelbër", për riciklimin,etj.
7. Kontrolli mbi numrin e guroreve në hapësirën e bashkisë por pa e kaluar këtë numër përtej nevojës që ka bashkia, duke llogaritur nevojat për ndërtimet në zonë.

Grupimi i detajuar i objektivave dhe treguesve, së bashku me metodat e nevojshme të matjes për secilën nga objektivat e VSM-se është paraqitur

Tabela 58: Indikatorët për vlerësimin e objektivave të VSM-së

Nr.	OBJEKTIVAT e VSM	FUSHAT KRYESORE DHE PARAMETRAT MJEDISORE	SYNIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJES
1.	**Zhvillimi i qëndrueshëm social ekonomik per mbrojtjen e mjedisit**	Njerëzit dhe vendet e punës, kohezioni social • Mundësia e të ardhurave • Cilësia e jetesës • Asetet materiale	• Krijimi i njësive të agroturizmit në pjesët rurale dhe malore të Bashkisë • Furnizimi me ujë të pijshëm 24 h • Furnizimit me Energji 24 h • Rrjeti i ujërave të zeza • Mjetet e reja të transportit publik • Krijimi i objekteve te reja të shërbimit • Krijimi i bizneseve të reja bujqësore bio	• Të ardhurat • Numri i bizneseve • Investimet në infrastrukture • Numri i restorante, bareve dhe hotele që shërbejnë gjatë gjithë vitit • Sasia e produkteve bio në vit • Numri i vizitorëve jashte sezonit të verës	• Përditësimi i të dhënave • Sondazhet e bashkisë • Sipërfaqja e tokës së kultivuar • Prenotimi i hoteleve
2	**Promovimi i vlerave mjedisore dhe panoramike**	Njerëzit, vendet e punës, peizazhi, trashëgimia kulturore, uji, ajri, florën, fauna, biodiversiteti	• Permiresimi i kushteve ekologjike • Zhvillimi i eko-turizmit dhe turizmit kulturor • Kontroll i erozionit • Ruajtja e cilesise se ujit dhe	• Te ardhurat • Numri i vizitoreve ne monumntet e kultures dhe zonat e vrojtimit • Investimet ne restaurime, infrastrukturen ujore, marketing dhe promovim	• Përditesimi itë dhënave • Te dhenat e fluksit te vizitoreve kulturore • Monitorimi i cilesise se ujit, ajrit, erozionit dhe habitateve • Monitorimi i flores dhe faunes

			pakesimi i ndotjeve • Rehabilitimi i habitateve, pyllezimi dhe permiresimi i tokes	• Investime ne rehabilitim, pyllezim, permireim peisazhi	se rrezikuar • Siperfaqja e pyllezuar dhe e rehabilituar
3	**Impakti mjedisor në aktivitetet tradicionale ekonomike**	Njerëzit, Vendet e Punës, toka, asetet materiale	• Ulja e përdorimit të kimikateve dhe pesticideve në bujqësi • Respektimi i mjedisit në xjerrjen e kripës • Parandalimi i peshkimit brenda lagunave • Parandalimi i blegtorise në zonën bregdetare • Kontrolli peshkimit dhe gjuetise	• Cilesia e Ujit te Lagunave • Subvencionet per prodhimet alternative ne bujqesi • Sasia e peshkimit dhe gjahut • Prodhimi dhe perpunimi i kripes • Penalizimi i shkelesve	• Monitorimi i ujrave te lagunave • Kontrolli dhe monitorimi i peshkimit dhe gjuetise • Licensat/lejet per aktivitetet e peshkimit dhe gjuetise • Numri i penaliteteve
4	**Promovimi i bashkepunimit ndërinstitucional dhe rritja e kapaciteteve menaxhuese mjedisore**	Peisazhi, trashëgimia kulturore, uji, cilësia e ajrit, biodiversiteti, klima, shëndeti i njeriut	• Përmirësimi i bashkëpunimit në planifikimin e infrastrukturës dhe mbrojtjen e mjedisit • Përmirësimi i kapaciteteve ekzistuese në menaxhimin e mjedisit • Promovimi i skemave të bashkëpunimit privat	• Miratimi i standardeve uniforme për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin • Krijimi i kompanisë me qëllim të veçantë në bazë të partneritetit privat publik për promovimin e objektivave të menaxhimit mjedisor	• Monitorimi i cilesisë se ujit dhe ajrit në zonat e aktivitetit te perbashket • Te dhenat e komunes dhe te Bashkise Vlore per mbetjet e ngurta • Eficenca e investimeve ne projektet dhe aktivitetet e pebashketa

			publik		
5	**Përmirësimi i cilësisë së mjedisit per parandalimin e rrezikut te shendetit publik** **(cilësia e ujit të detit, lumenjve, mbrojtja e lagunave , ruajtja e cilësisë së ajrit, vlerësimi i veprimit zonave industriale)**	Shëndeti i njeriut, deti dhe laguna, cilësia e ujit, vendet natyrore, cilësia e ajrit, biodiversiteti, asetet materiale, toka, klima	• Rishikimi i politikës kombëtare për krijimin e ndikimit të lartë të objekteve industriale • Parandalimi i ndotjes se ajrit dhe ujrave • Ngritja dhe konsolidimi i sistemit te kanalizimeve • Eliminimi i derdhjes se ujrave te zeza direkt dhe indirekt ne trupat ujore	• Integrimi i politikave të propozuara të PPV me PINS • Investimi në infrastrukturen e ujrave te zeza • Te dhenat mbi kontaminimet dhe numrin e popullsise së prekur	• Monitorim i shendetit te popullsiës lokale • Të dhenat spitalore • Monitorimi i cilesise se ujit, ajrit dhe nivelit te zhurmave • Monitorimi i ujrave qe derdhen ne laguna • Niveli i investimeve në infrastrukturen e ujrave te zeza
6	**Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit përmes mbrojtjes së bregdetit dhe pjesës ujore të marinës (mbrojtja e cilesisë se detit, pejsazhit, zonave natyrore)**	Cilësia e ujit të detit, peizazhi, biodiversiteti, vendet natyrore	• Ruajtja e biodiversitetit 100% • Grumbullimi i mbetjeve 100% • Mbrojtja e bregdetit • Nuk ka leje ndërtimi në zonat me vlerë panoramike te mbrojtura dhe dalluese • Krijimi i shërbimeve të organizuara të plazhit për turizmin • Organizimi ne zonat e aksesueshmërisë dhe parkimi	• Cilësia e ujit të Detit • Grumbullimi i mbetjeve • Numri i lejeve të ndërtimit • Numri i anijeve dhe varkave të peshkimit • Objektet dhe infrastruktura e krijuar • Pyllëzimi	• Monitorimi GIS te PPV Kerkime e Analiza te ujrave nentokesore Analiza e ujit të Detit Analiza e sedimenteve nga deti • Numri i biletave të parkimit Vendimet e Këshillit të Komunës

			• Rehabilitimi i zonave pyjore		
7	**Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit** **(ruajtja e pejsazhit,zonave te mbrojtura natyrore, biodiversitetit)**	Shëndeti i njeriut, cilësisë së ujit te detit dhe lagunave, biodiversiteti, flora dhe fauna, asetet materiale • Rrjeti i ujërave të zeza • Para-Trajtimi • Cilësia e trupave ujore • Imazhi i Turizmit	• Mirembajtja dhe rritja e specieve endemike dhe të rrezikuara • Ndërtimi i Infrastrukturës sipas standardeve të BE • Reduktimi me 100% e shkarkimeve pa paratrajtim • Nga viti 2023, 100% e shkarkimeve të mblidhen sipas metodave të pranueshme për mjedisin • 100% trajtimi i mbeturinave industriale	• Evidenca të specieve endemike dhe atyre të rrezikuara • Numri i objekteve të para-trajtimit (aktivitete industriale, aktivitetet tregtare etj) • Cilesia e trupave ujore • Gjatësia e sistemit të ujërave të zeza, sistemi i kolektorit, lidhjet • % e ujërave të zeza të përpunuara në impiantin e trajtimit te ujrave te zeza • % e strehimit që ka gropa septike • % e aktiviteteve industriale që kanë sistemet e përpunimit	• Projektet për rrjetin e ujërave të zeza • Matjet e cilësisë së ujit në vende të zgjedhura • Kerkime te Biodiversitetit (sidomos për speciet endemike) • Planet për manaxhimin dhe monitorimin e biodiversitetit në "Zonat e Mbrojtura" dhe ato të reja

8	**Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit** **(shëndeti i njerëzve, specieve të rrezikuara, cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nntokësore)**	Uji, biodiversiteti, flora, fauna, toka • Konsumi i ujit për turizmin	• Ulja e nevojave për konsumin e ujit në objektet turistike • Promovimi i riciklimit të ujit dhe ripërdorimin e metodave • Ulja e nevojave për ujitje	• Nivelet e konsumit të ujit • Cilesia e trupave ujore	• Konsumi i uji • Analizae kushteve hidrologjike • Studime te Biodiversitetit (sid omos për speciet endemi ke dhe ato të rrezikuara)
9	**Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit** **(vend pune, ujërat siperfaqesore biodiversiteti, toka)**	Peisazhi,biodi versitetit, fauna, vendet natyrore • Aktivitetet e turizmit • Baret dhe restorantet • Transporti • Industria e ndërtimit	• Ulja e nivelit të zhurmës në zonat bregdetare turistike sipas ligjit • Kufizimi i orëve të aktiviteteve argëtuese duke punuar pranë zonave të banuara • Eliminimi i burimeve të ndotjes e zhurmës në zonat thelbësore për mbrojtjen e mjedisit • Kontrolli i zhvillimit të rrugëve të reja dhe vendndodhjen e zonave të parkimit • Kufizimi i qarkullimit te vizitorëve në zonën kryesore të mjedisit në shtigje të veçanta	• Masat e marra nga bashkia • Mendimi i Turistëve dhe banorëve • Densiteti trafikut • Volumi i punimeve ndertimore • Parku i mjeteve te perdorura ne ndertim	• Matjet e nivelit të zhurmës • Studime/Kerkime • Vendimet e Këshillit të Komunës • Monitorime te trafikut, punimeve te ndertimit dhe te rehabilitimit
10	**Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së**	Cilësisë së tokës, habitateve,	• Rehabilitimi i tokës se kripur	• Rritja e % se ish-tokës bujqësore te	• Analiza e cilësisë

	Mjedisit **(Cilësia e tokës, habitatet, cilësia e ujit, punësimi, flora, fauna)**	cilësisë së ujit, punë • Produktet bujqësore Bio • Cilësia e ujrave nëntokësore • kushtet e jetesës së njerëzve, dhe kushtet shëndetësore	• Përmirësimi i pjellorisë së tokës • Përmirësimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes • Përmirësimi i Peisazhit	rehabilituar • Sipërfaqja e zones se ripyllëzuar (Ha) • Numri i guroreve të mbyllura • Rritja% e tokës së braktisur te ri-kultivuar	së tokës • Monitorimi GIS i PPV
11	**Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit-Ndergjegjesimi i Publikut** **(Shendeti i njerëzve, cilësia e ujit, ajrit, biodiversitet, trashëgimia kulturore)**	Peisazhi, trashëgimia kulturore, biodiversitetit, uji, ajri, shëndeti i njeriut	• Rritja e ndërgjegjësimit social drejt mbrojtjes së mjedisit • Promovimi i formave miqësore me mjedisin e turizmit • Rritja e përfshirjes së komunitetit lokal në veprimet e ruajtjes • Përmirësimi i infrastrukturës	• Numri i bizneseve turistike per miratimin e standardeve të eko-etiketimit • Fushatë ndërgjegjësimi • Programet edukative, reklama • Akte Pilote	• Anketim i Vizitoreve • Monitorimi i cilesise se ujit, ajrit dhe nivelit te zhurmave
12	**Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit (trashëgimia kulturore dhe mjedisi historik si asete, vende pune)**	Trashëgimia kulturore dhe peisazhi • Asete materiale, • Vende Pune	• Mbrojtja, rritja dhe rivendosja e monumenteve kulturore dhe trashëgimisë arkitekturore • Kontrolli i plote në ndërtimin e paligjshëm • Sigurimi i zonave mbrojtëse tampon pengojnë ndërtimin në	• Punime te ndërmarra për restaurimin e monumenteve Historike • Përmirësimi i aksesit dhe Sinjalistika. • Numri i ndërtimeve pa leje	• Lejet e ndërtimit • Sondazhet e komunes • Monitorimi i sondazheve nga Ministria e Kulturës dhe Sporteve • Fotografi

			afërsi të objekteve të trashëgimisë kulturore. • Përmirësimi i aksesit dhe Sinjalistika.		
13	**Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardeve të shëndetit-** **Cilësia e Ajrit**	• Klima dhe cilësia e ajrit (energjia e rinovueshme, emetimet e gazit); • Kohezioni Social • Transporti	• Automjete të reja për transportin publik për të mbuluar zonën • Ruajtja e cilësisë së ajrit, standardet (BE kombëtare) • Shmangia e trafikut në zonë banimi • Përdorimi i pajisjeve miqësore energjitike • Përdorimi i energjisë diellore • 100% shmangia e djegies se mbeturinave	• Matjet estandardeve te cilësisë së ajrit • Numri i automjeteve të transportit publik • Numri i pajisjeve të kursimit të energjisë, instalimi i paneleve diellore voltaike	• Matjet e cilësisë së ajrit në vende të zgjedhura • Fushata te Ndërgjegjësimi Publik • Anketa e faturimit te Energjisë • Sasia e energjisë nga burime të ndryshme
14	**Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit – Cilesia e Ujit** **(cilësia e jetës,vende pune, cilësisë së ujit, furnizimit energji)**	Cilësia e jetës dhe shëndetit Publik • Uji, • Flora, • Fauna	• Përmirësimi i cilësisë së ujit në standardet e pranueshme • Sigurimi i ujit të pijshëm për ndërtesat private dhe publike • Sigurimi i rrjetit të ujit të pijshëm në zonat turistike	• Cilësia e ujit të pijshëm • Sasia e ujit per person / dite • Sasia e konsumit të ujit në zonat turistike	• Konsumimi i ujit • Cilesia e ujit • Monitorimi i cilesise se ujit te pijshe (ne bashkepunim me Insitutin e Shendetit Publik) periodikisht ne te gjitha pikat e kontrollit ne burim dhe ne pikat fundore te konsumit
15	**Përmirësimi i kushteve të**	Cilësia e jetës dhe shëndeti	• Përmirësimi i sistemit të mbledhjes së	• Reduktimi i numri	• Analiza te trupave

	jetesës dhe standardet e shëndetit – Menaxhimi mbetjeve (cilësia e tokës, cilësia e ujit, cilësia e ajrit, shëndeti)	·Publik • Ndertimi i Industrise se mbetjeve • Toka • Cilësia e ujit • Cilësia e ajrit • Peisazhi • Imazhi i Turizmit	mbeturinave nga zonat e vendbanimeve dhe zonave turistike . • Eliminimi 100% i vendeve te paligjshme aktuale te hedhjes se mbeturinave në komunë • Daiferencimi i mbledhjes se mbeturinave • Ne vitin 2017 vendi i ri për mbetjet e ndërtimit • Promovimi i programeve te riciklimit dhe pastrimit për zonën bregdetare.	te deponive • Rritja e numrit të koshave të mbeturinave në Komunë • Cilësia Peisazhit • Cilesia e Trupave ujore	ujore • Studime/Kerkime • Vëllimi i mbeturinave te mbledhura ne landfill • Planet e manaxhimit dhe monitorimit te mbetjeve te ngurta • Realizimi i investimeve te komunes per manaxhimin e mbetjeve te ngurta
16	**Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit – Cilësia e jetës** **(Cilësia e jetës, mjedisi urban, të mirat materiale, peisazh)**	Cilësia e jetesës, Njerëzit asetet materiale, peizazhi	• Përmirësimi i mjedisit urban në zonat e vendbanimeve • Rregullimi i ndërtimit	• Zbatimi i rregulloreve vendore të planifikimit • Zbatimi i projekteve strategjike të propozuara te planit të infrastrukturës	• Monitorimi GIS i PPV • Leje ndërtimi • Projektet publike • Vendimet e Këshillit Baskiak • Buxheti i bashkisë
17	**Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit publik (siguria publike, cilësia e ujit, cilësia e tokës)**	Siguria publike, shëndeti njerëzor, njerëz, asetet materiale	• Eliminimi i rrezikut për shëndetin nga rrezatimi në zonat e banuara • Përmirësimi i sigurisë i rrugeve hekurudhore • Përmirësimi i sigurisë ne plazh	• Zbatimi i ndertimeve mbrojtëse • Heqja e numrit te elementeve të paligjshme të infrastrukturës • Sigurimi i objekteve të parë të ndihmes se shpejte dhe	• Monitorimi GIS i PPV • Leje ndërtimi • Vendimet e Këshillit bashkiak

			• Eliminimi i rrezikut ndaj zjarri.	vrojtuesit në plazhet e Nartes dhe Zvërnecit • Numri i zjarreve	
18	**Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit publik (siguria publike, cilësia e ujit, cilësia e tokës)**	Siguria publike, cilesia e ujit, toka, asetet materiale	• Mbajtja e balancit të ujit në lagune • Ulja e rrezikut nga përmbytjet	• Pastrimi i pritave • Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kanaleve	• Monitorim i shkembimit të ujit lagunë-det • Zbatimi i planeve të manaxhimit • Realizimi i investimeve per rehabilitimin, ndertimin dhe mirembajtjen e rrjetit te kanalizimeve

7. STUDIMET REFERUESE KRYESORE

- **PLANI I INTEGRUAR NDERSEKTORIAL I BREGDETIT 2030 (Qershor 2016);** zonimi i territorit; integrimi dhe ndërlidhja e zonimit territorial; struktura e planit të bregdetit; përkufizimi i zonës bregdetare; organizimi hapësinor)

- **PLANI I PËRGJITHSHËM KOMBËTAR SHQIPËRIA 2030 (Qershor 2016);** zhvillim i qëndrueshëm i territorit për 15 vitet e ardhshme; zhvillim i balancuar ekonomik e social i vendit; menaxhim i përgjegjshëm i burimeve natyrore të tij; mbrojtja e mjedisit; përdorimi racional i tokës.

- **RAPORTET MJEDISORE 2014-2015** (Monitorimi i Cilësisë së Ajrit, biodiversiteti, pyjet, ujrat.monumentet e natyrës)

- **INSTAT – census 2011** (Demografi, Ekonomi) Njësitë ekonomike familjare; Individët; Bashkëjetesat kolektive; Banesat (të banuara ose jo), dhe tipe të tjera banesash;Të huajt (prezentë në momentin e Censusit)
- **STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E MJEDISIT 2015-2020** (Kushtet aktuale, sfidat për të ardhmen, ndryshimet klimatike, Vizioni Politikat dhe Qellimet e Politikave, Objektivat e politikes dhe produktet madhore, Burimet finaciare).

- **STRATEGJIA KOMBËTARE SEKTORIALE E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE 2011-2017** (Gjendja Aktuale e Sektorit, Vizioni, misioni dhe objektivat prioritarë, Politikat dhe Planet e Veprimit, Përgjegjshmëria, Monitorimi dhe Vlerësimi)

- **2011-2017 PLANI KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE 2010-2025** (marrëveshjet aktuale per mbetjet bashkiake, Kuadri Aktual Ligjor, Prioritetet në Programin e Qeverisë, Prioritet strategjike dhe politikat)

- **METABOLIZMI I SHQIPERISE. AKTIVIZIMI I POTENCIALIT TË TERRITORIT SHQIPTAR (2016)**

  Libri "Metabolizmi i Shqipërisë` parashtron tërësine e sfidave me te cilat perballet Shqipëria duke u përpjekur te realizoj kalimin drejt ekonomisë se te ardhmes si një ekonomi e gjelbër dhe me nivel të ulët të karbonit.

8. VËSHTIRËSITË E HASURA

Vështirësitë e hasura gjatë hartimit të VSM-së së Bashkisë Vlorë janë të lidhura me një sërë problematikash që i referohen kryesisht: mungesës në disponueshmërinë e të dhënave dhe matjeve shkencore, komunikimit të dobët ndër institucional dhe dobësive administrative, mungesës së teknologjisë së duhur dhe sistemit të monitorimit. Më konkretisht, në lidhje me disponueshmërinë e të dhënave mund të përmendim:

- Të dhëna jo të plota të marra nga database i AKPT-së, të cilat, edhe pse ishin të organizuara për çdo Bashki, mbeten jo të plota, me mangësi të pa identifikuara si dhe me cilësi jo të mirë, mbi 50% e datave ishin në PDF.
- Në shumë sektorë/fusha mungojnë të dhënat nga Ministritë e linjës, ka mos përputhje të informacionit ekzistues me azhornimet e fundit të kërkuara nga legjislacioni si edhe mungesë masive të database GIS për çdo Ministri apo Institucion Qëndror.
- Mungojnë masivisht planet sektoriale nga te cilat duhej të përftohej informacion i detajuar nga GIS përkatës.

Përsa i përket Institucioneve Lokale, përfshirë këtu Agjencitë Rajonale, Qarkun dhe Bashkitë, përmbajnë informacion i cili nuk mund të referohet sipas natyrës së të dhënave të INSTAT dhe ky përbën një problem të veçantë. Në shumë raste, edhe pse informacioni është referuar si i përftuar nga Bashkia, në fakt të dhënat janë gjetur jashtë kontributit të tyre.

Ne çdo rast ne kemi arritur të krijojmë një sistem GIS duke u perpjekur të mbledhim të dhëna të ndryshme për një kohë shumë të shkurtër në dispozicion.

Gjatë realizimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë, pavarësisht kohës së kufizuar për realizimin e çdo etape (4+2 javë) na është dashur t`i rikthehemi vazhdimisht produkteve përkatëse me kërkesën e AKPT që është instuticioni përgjegjës. I tillë është rasti i përgatitjes së raportit të Vizionit dhe Strategjisë Territoriale si dhe i Planit dhe Rregullores përkatëse, për të cilat grupi i punës, përtej vështirësive specifike, është t`i rikthehej disa herë kërkesave për plotësime që vinin nga vlerësimi i raportin e Analizës. E gjithë kjo ka kërkuar kohë dhe energji shtesë.

Fusha e monitorimit dhe mbrojtjes të mjedisit është ende mjaft e pazhvilluar në Shqipëri, me gjithë hapat pozitive të ndërmarra në vitet e fundit drejt përmbushjes së standardeve të BE -se, siç është miratimi i Strategjisë Kombëtare të Mjedisit. Matjet shkencore të aspekteve bazë janë ende të pakta dhe jo të rregullta në kohë. Monitorimi kërkon një përpjekje të koordinuar dhe angazhim të dy palëve, në nivel kombëtar e lokal, në mënyrë që të prodhojë të dhëna të besueshme. Konsulenti ka hasur vështirësi si në marrjen e të dhënave të përditësuara nga institucionet si dhe ndërlidhjen midis institucioneve, në mënyrë që të arrinte konkluzione të vlefshme. Dokumentet e përdorura për draftimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Vlorë, pavarësisht spektrit të gjerë të referencave bazuar në intervistat dhe institucionet e

kontaktuara, reflektojnë dobësi ne të dhënat dhe mungesën e informacionit në disa aspekte, veçanërisht në rrjetin e ujësjellës kanalizimeve, mungojnë indikatorë qe matin cilësinë e mjedisit dhe ka te dhëna te pakta për turizmin.

Procesi i zbatimit te VSM-se është një përpjekje kolektive që duhet të zhvillohet me kalimin e kohës, në etapa të rëndësishme, por edhe si pjesë e veprimeve rutinë të autoriteteve bashkiake. Ndërtimi i kapaciteteve lokale është një faktor shumë i rëndësishëm, i cili është evidentuar qartë në objektivat e Planit. Kjo përpjekje ka filluar, por mbetet akoma për t'u bërë. Trajnimi i administratës bashkiake në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, duhet të shoqërohet me angazhimin dhe investimet në pozicionet e tyre të punës. Ndryshimet e shpeshta në postet administrative janë një pengesë e madhe në këtë përpjekje për të krijuar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri. Afati i shkurter kohor është një nga vështirësitë që ka ndikuar në përgatitjen e VSM-së për Bashkinë Vlorë.

Teknologjia është gjithashtu një faktor shumë i rëndësishëm për monitorimin e VSM-se. Zbatimi i Planit në vetvete përmban një mjet shumë të vlefshëm, qe është përditësimi i bazës se të dhënave te GIS, i cili mundëson përditësimin e vazhdueshëm të ndryshimit te përdorimit të tokës dhe të procesit të zhvillimit. Gjithashtu, leja e zhvillimit të procesit, sipas Ligjit me Nr. 107/2014 Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, e cila kërkon transferimin e vendimeve të zhvillimit ne Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, përbëjnë mjetet, që sipas përkufizimit, lejojnë monitorimin e vazhdueshëm të procesit të zbatimit të planit.

Ende të dyja këto mjete teknologjike nuk mund të zbatohen para se bashkitë te marrin softëare-in e duhur GIS. Sistemi mbështetës aplikohet ne nivel kombëtar për të mbuluar të gjithë territorin e vendit.

Deri sa këta faktorë te maturohen, procesi VSM do të vazhdojë të zbatohet me vështirësi në hapat e tij te para dhe është i bazuar në angazhimin dhe përkushtimin e stafit bashkiak.

9. PERMBLEDHJA JOTEKNIKE

9.1 Hyrje

Qëllimi i këtij Raporti Mjedisor është:

- Të sigurojë informacion mbi procesin e Vlerësimit Strategjik të Mjedisit (VSM) në lidhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Vlorës
- Të identifikojë, të përshkruajë dhe të vlerësojë efektet e mundshme të rëndësishme të Planit
- Të sigurojë mundësi për Këshillin Bashkiak, autoritetet në nivel kombëtar (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit) dhe publikut në përgjithësi, për të ofruar pikëpamje mbi Raportin Mjedisor.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor kërkohet nën Ligjin Nr.107/2014 për "Planifikimin dhe zhvillimin e territorit", dhe Ligjit Nr. 91/2013 për "Për Vlerësimim Strategjik Mjedisor". Ai synon të integrojë vendimet mjedisore në përgatitjen e planit dhe vendimmarrjes me qëllim që:

- Të përmirësojë planet dhe të përmirësojë mbrojtjen e mjedisit
- Të rrisë pjesëmarrjen publike në vendim-marrjen mjedisore

9.2 Konteksti i Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit

Studimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Territorin e Bashkisë Vlorë u përgatit në periudhën Mars-Nëntor 2016, si pjesë e realizimit të objektivave të programit të qeverisë dhe në një moment të rëndësishëm të riorganizimit territorial për Shqipërinë. Ky plan u mbështet në Planin e Përgjithshëm Kombëtar që mundëson zbatimin cilësor të reformës administrative territoriale në vend. Plani i Përgjithshëm Vendor u realizua nga Bashkia Vlorë duke u mbështetur tek konsulentët privatë. Ky Plan u realizua sipas përcaktimeve të kuadrit të ri ligjor Nr.107/2014 për "Planifikimin dhe zhvillimin e territorit" dhe në përshtatje me Planin e Integruar Ndërsektorial për Bregdetin (PINS bregdeti). Për realizimin e tij Plani ndjek rekomadimet e drejtëpërdrejta të Agjencisë Kombëtare të turizmit dhe është në përshtatje të Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin brenda kontekstit të Planifikimit dhe zhvillimit të Territorit si dhe të Planit të Përgjithshëm Kombëtar duke u organizuar sipas një ndarje në pesë sistemet kryesore të zhvillimit të territorit. Përkatësisht këto janë: sistemi urban, sistemi natyror, sistemi ujor, sistemi bujqësor, sistemi infrastrukturor.

Plani i Përgjithshëm Vendor, i cili parashikon një vizion afatgjatë për zhvillimin e ardhshëm dhe rregulloret e detyrueshme për 15 vitet e ardhshme, është dorëzuar për konsultim publik në faza të ndryshme duke ndjekur udhëzimet e ligjit. Plani është ndjekur nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit AKPT në tre faza specifike të zhvillimit të tij. Duke filluar me Vlerësimin dhe Raportin e Analizës, janë lënë në dispozicion 6+2 javë përgatitje të materialit për të katërta Bashkitë e LOT-it 6. Me pas, realizimit të Vizionit dhe Strategjisë Territorile, si dhe projekteve strategjike të investimeve infrastrukturore dhe turistike të lidhura me strukturën

hapësinore për zhvillimin e zonës, i janë lënë në dispozicion 4+2 jave gjatë të cilave ka vijuar gjithashtu edhe korrigjimi mbi bazën e vlerësimit dhe komenteve të Agjencisë. Pas dorëzimit të Vizionit dhe Strategjisë Territoriale është vijuar me përgatitjen e fazave përfundimtare të Planit, Rregullores dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Për të treja këto faza është lënë në dispozicion një kohë e përbashkët, 4+2 javë, me një shtesë prej 6 javësh të lejuara nga Ministria e Zhvillimit Urban. Duhet theksuar se AKPT ka qënë një Agjenci me një rol kyç për drejtimin e punës në funksionin e Institucionit përgjegjës për vlerësimin e produkteve.

9.3 Sfidat Kryesore Mjedisore të Zonës së Studimit

Analiza e gjendjes ekzistuese e situatës gjatë Studimit ka trajtuar këto çështje kyçe mjedisore dhe problematika qe duhet të adresohen nga Plani:

1. Problemet socio-ekonomike si rezultat lëvizjeve demografike.
2. Mungesa e investimeve dhe infrastrukturës.
3. Aktivitetet e paqëndrueshme ekonomike dhe cilësia e ulët e produktit turistik.
4. Ndërtime informale dhe zhvillim informal.
5. Zhvillimi sporadik dhe i shpërndarë që çon në përdorim të paqëndrueshëm të tokës dhe urbanizimit.
6. Cilësia e dobët e ndërtimeve ekzistuese dhe të objekteve të turizmit.
7. Dëmtimi i trashëgimisë kulturore e cila mbetet e pambrojtur.
8. Mangësi në shërbimet publike dhe infrastrukturë.
9. Degradimi i peizazhit.
10. Keqpërdorimi i resurseve natyrore dhe tokës.
11. Cilësia e detit dhe burimeve ujore.
12. Sistem i papërshtatshëm i vendgroposjeve dhe largimit te mbeturinave të ngurta.
13. Guroret dhe aktivitetet industriale.
14. Ndotja akustike.
15. Përkeqësimi i cilësisë së ajrit.
16. Mungesa e ndërgjegjësimit mjedisor të bizneseve, popullsisë dhe vizitorëve.

9.4 Objektivat e Veçanta të VSM-së

Raporti i paraqitur ka hartuar 18 objektiva tëVSM-s të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me presionet kryesore mjedisore dhe perspektivën e zhvillimit të zonës. Këto objektiva janë grupuar sipas ndarjes në 5 sisteme territoriale dhe në kombinimet e tyre dhe lidhen me qëllimin dhe orientimin e planit. Këto janë përkatësisht:

- Zhvillimi i qëndrueshëm social ekonomik per mbrojtjen e mjedisit
- Promovimi i vlerave mjedisore dhe panoramike
- Impakti mjdisor ne aktivitetet tradicionale ekonomike
- Promovimi i bashkepunimit nderinstitucional dhe rritja e kapaciteteve menaxhese mjedisore
- Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit-Ndërgjegjësimi Publik;
- Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit
- Përmbledhja e objektivave kombëtare te planifikimit te territorit
- Përmbledhja e objektivave të Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin

Objektivat janë në përputhje me Direktivave e BE-së dhe legjislacionit shqiptar dhe ato janë të lidhur me objektiva ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm dhe objektivave kombëtare të mjedisit dhe Planifikimit të Territorial (Kapitulli 3).

9.5 Skenarët Alternative

Gjatë kryerjes së VSM-se, ekipi duhet të vlerësojë efektet e mundshme mjedisore, sociale dhe ekonomike të Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe të alternativave të arsyeshme që mund të kishin ndjekur pa ekzistencën e këtij Plani specifik. Kapitulli 4 përshkruan vlerësimin e 3 alternativave në lidhje me ndikimin e tyre mbi objektivat e VSM:

- **Skenari zero,** ku zhvillimi i ardhshëm ndjek trendet ekzistuese, dmth një rast ku nuk janë zbatuar propozime të veçanta të ndërhyrjes sipas planit
- **Skenari ambicioz** i intensifikimit të zhvillimit që ndryshon rrënjësisht potencialin e zhvillimit të turizmit, sipas projekteve të parashikuara në infrastrukturën e transportit, por implikon alokimin e burimeve serioze për investime dhe stres të konsiderueshëm të burimeve mjedisore të zonës.
- **Skenari konservativ** i mbrojtjes së mjedisit i cili lejon vetëm forma miqësore mjedisore të zhvillimit të turizmit, suksesi i të cilit qëndron mbi harmonine e forcave më të gjera sociale dhe ekonomike, angazhimeve të forta të politikave dhe investimeve publike afatgjatë.

9.6 Vlerësimi i Planit Vendor

Kapitulli 5 përfshin vlerësimin e ndikimeve të pritshme mjedisore të skenarëve të përzgjedhur dhe masat e parandalimit / zbutjen. Procesi Vlerësimit është bazuar në një korrelacion matricor dhe metodologji vlerësimi, që krahason 18 VSM–të të zhvilluara në kapitullin 3, kundrejt një sërë programesh dhe projektesh për secilin prej 6 Orientimeve Strategjike të Planit duke u bazuar tek Vizioni dhe Strategjia Territoriale si dhe tek Projektet.

OS1: Përmirësimi i konkurueshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik
OS2: Zhvillimi i zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi të qëndrueshme
OS3: Nxitja e sipërmarrjes dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor
OS4: Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë rezidenciale dhe rritja e kohezionit social
OS5: Përmirësimi i lidhjes dhe zhvillimi i formave multimodale të transportit
OS6: Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore

9.7 Masat Zbutëse Mjedisore

Raporti Mjedisor duhet të tregojë masat e parashikuara për të parandaluar, zvogëluar dhe kompensuar çdo efekt negativ në mjedis nëpërmjet zbatimit të Planit. Disa masa zbutëse janë ndërtuar në politikat e planit, deri aty sa i kërkon zhvilluesve të adresojnë çështje të ndryshme mjedisore. Do te jete ne dore te Bashkise për të siguruar, për aq sa është e mundur, se këto kërkesa janë plotësuar, për të minimizuar ndikimet mjedisore që rrjedhin nga zhvillimi. Për më tepër disa nga propozimet e Planit, kryesisht projekte të infrastrukturës, të tilla si rehabilitimi i

sistemeve të ujit, përmirësimi i infrastrukturës së transportit, etj përbëjnë masat zbutëse për ndikimin mjedisor e masave të tjera zhvillimore dhe politikat hapësinore te Planit. Vlerësimi i propozimeve specifike të Planit identifikuan masa lehtësuese të nevojshme për propozimet e zhvillimit individual, të cilat janë të përcaktuara në tabelat e Kapitullit 5.

9.8 Monitorimi

VSM kërkon që Bashkia te monitorojë efekte të rëndësishme mjedisore të zbatimit të çdo Plani ose programi kualifikues, për të cilën ai ka kryer një vlerësim mjedisor dhe të identifikoje efekte të paparashikuara negative në një fazë të hershme, si dhe të ndërmarrë veprime korrigjuese të përshtatshme. Një proces monitorimi dhe rishikimi është projektuar për t'u drejtuar paralelisht me zbatimin e Planit, duke qenë një pjesë integrale e tij. Ky është fokusi i VSM-së, i cili është përpunuar në detaje në kapitullin 6. Të gjitha te dhënat, synimet dhe shifrat janë të bazuara në objektivat aktuale te Planit, ne kërkesat e standardeve kombëtare dhe pritet të përmirësohen gjatë te njëjtës rrugës qe Shqipëria po ndërmerr për te aplikuar standarde që propozohen nga BE apo marrëveshje te tjera ndërkombëtare. Matjet do të bazohen në metoda dhe burimeve të ndryshme, duke përfshirë sistemin e GIS te aplikuar te PPV, të dhënat kombëtare, statistikat lokale, matjet shkencore dhe vendimet e Këshillit Bashkiak, si dhe vendimet administrative (të tilla si lejet e zhvillimit etj).

9.9 Konkluzioni i Raportit

Procesi VSM është një pjesë integrale e procesit të përgatitjes së planit. Ndërsa elemente të procesit të vlerësimit mjedisor janë miratuar gjatë përgatitjes së Planit, ato nuk janë regjistruar formalisht. Plani i VSM, duke identifikuar disa ndikime negative mjedisore, duhet të ketë efektin e përmirësimit të përgjithshëm te kushteve mjedisore në të gjithë zonën ne studim, veçanërisht në ato zona të cilat do të hasin presione te larta nga zhvillimi i turizmit te tilla si ne zonat e plazheve (Plazhi i Vlorës rezulton: 36 % të cilësisë së ujrave i përkasin kategorisë A; Cilësi shumë e mirë e ujrave; 18 % i përkasin kategorisë B; Cilësi e mirë; 9 % i përkasin kategorisë C - Cilësi e mjaftueshme dhe 36 % i përkasin kategorisë D - Cilësi shumë e keqe. Masa të menjëherëshme duhen marrë tek Plazhi i Vjetër(D), Plazhi i Vjetër zona e Kabinave(D), Shkolla e Marinës(D), Plazhi i Ri(D), ndërkohë zonat si Ish Vilat Blloku(A), Jonufer (A), Plazhi Paradise(A), Plazhi Lame Borshi(A,) Radhimë, Hotel Grand(B), Lokali Boja(C), Komplexi Orikum(B) kanë një cilësi më të mirë), lagunat (Orikum, Nartë, etj), tokat bujqësore etj. Kjo do të adresojë disa nga objektivat mjedisore që mund të monitorohet me kalimin e kohës. Kudo që të jetë e mundur, masat zbutëse duhet të paraqiten në skemat zhvillimore, të cilat kanë potencial për të ndikuar negativisht mbi mjedisin, ne mënyre qe të minimizohet ndonjë ndikim i pafavorshëm, duke synuar të reduktoje "gjurmët ekologjike" në Bashki.

Prezantime me Publikun

U zhvillua në datë 07.12.2016, ora 17:30, në sallën e teatrit Petro Marko, Vlorë. Prezantimi i planit u bë nga eksperti, Z. Thanos Pagonis, eksperti i mjedisit, Z. Emil Xhuvani dhe Znj.

Mirlinda Rusi. Kryetari i Bashkisë, Z. Dritan Leli evidentoi rëndësinë e hartimit të planit dhe vlerësoi punën e bërë nga ekspertët, i kërkoi pjesëmarrësve të jenë bashkëpunues dhe të japin mendimet e tyre në shërbim të hartimit të një plani sa më efektiv.

Gjatë prezantimit u kerkuan nga pjesemarresit disa pika: 1. Menaxhimi i TEC-it Vlorë që është një nga problemet që është ngritur si shqetësim se kush do të jetë institucioni menaxhues dhe përgjegjës , në të ardhmen për këtë objekt me rrezik të lartë mjedisor.

2. Menaxhimi i zonës së pyllit të Sodës ishte një shqetësim tjetër i komunitetit i cili mendonte dhe dëshironte këtë masiv pyjor jo në gjendje të mjeruar por të rivitalizuar duke ju kthyer kohës dhe kujtimeve të kaluarës ku dhjetra qytetarë kan patur kaluar kohën e lirë në ambjentet çlodhëse.
3. Kërkesa për marina të vogla janë bërë për katër bashkit, të cilat janë marrë pjesërisht në konsideratë pasi rast pas rasti është parë dobia që ato i sjellin turizmit kundrejt dëmit mjedisor.

Përgjigjia e ekipit te studios ishte parashtrimi i dy projekt-ideve : Rruga e biçikletve si zgjatim i Lungo Mare-s dhe kthimi i vlerës rekreative te Pyllit të Sodës me ambjente ekspozitash të hapura natyrore apo me aktivitete kulturore ditore.



Figura 31 – Prezantime me publikun

Degjesa me Publikun

U zhvillua në datë 09.03.2017, ora 12:00, tek Qendra Rinore , ne Pallatin e Kultures, Vlorë. Prezantimi i VSM-se ne kontekstin e Planit te Pergjithsem te Bashkise Vlore u bë nga drejtuesi i ekipit Dr.Ark Thanos Pagonis, eksperti i mjedisit, Z. Emil Xhuvani dhe Znj. Mirlinda Rusi, dhe Urb.Ark Ervin Taçi. Gjate prezantimit kishte prezence te mediave lokale dhe Kryetarit te Bashkise me nderhyrjet e tij ne momente te caktuara, Z. Drital Leli.

Gjatë prezantimit u diskutuan nga pjesemarresit disa ceshtje mjedisore dhe alternativa perkatese por midis tyre tre ishin shqetesime te pjesemarresve ne prezantim:

1.Akuafarming per rritjen e peshqve. Nje perfaqesues i shoqerise civile ngriti problemin perzhvillimin e Akuafarmit ne Vlore. Pyetja ishte nese eshte parashikuar ne Plan ndertimi i nje akuaparku per rritjen e peshqve? Pergjigjia ishte qe nuk jane parashikuar zgjerime te ketij aktiviteti , pervec atyre ekzistuese. Diskutimi i tyre nxorri ne pah faktin qe nuk duhet te zgjerohen keto aktivitete pergjate bregdetit (Rradhime-Orikum) pasi behen pengese per zhvillimin e turizmit ne keto zona dhe gjithashtu specifikisht per zhvillimin e turizmit alternativ.

2.Nje diskutant tjeter pyeti nese jane marre parasysh ne Plan, kriteret e shfrytezimit te mbrojtjes se "Zones se Mbrojtur Nartë-Zvernec" dhe zonave te tjera te mbrojtura sic eshte ajo e Karaburun-Llogarase. Pergjigjia ishte qe Plani i perfshin "Zonat e mbrojtura " ne meyre te datajuar ne sistemin GIS duke vendosur kufijte e tyre si dhe zonat buferike, gjithashtu plani perfshin ne kete sistem dhe te gjitha "Zonat e Mbrojtura te trashegimise kulturore".

U sqarua me poshte nga ekspertet qe per keto zona Plani merr parasysh Legjislacionin Kombetar qe perdorimi i tyre te behet sipas Planeve te Menaxhimit te tyre duke i dhene fokus vetem ne zona te caktuara zhvillimit te ekoturizmit. Planet e detajuara per keto zona , sipas kritereve te percaktuara ne Plan ,do te miratohen nga Autoritetet Qendrore (AKPT) sipas kerkesave.

3. Nga nje perfaqesues i komunitetit u kerkua nese do te ishte i mundur perdorimi i tokes bujqesore ne Zonen Rradhime-Orikum per aktivitete te tjera . Nga pergjigjia u theksua, sipas rregullores te planifikimit te territorit se ato do te lihen ne zhvillim - ne gjendjen ekzistuese veçanerisht, ato qe jane me bonitet te larte (Kategoria I-IV) per te cilat nuk lejohet ndryshimi i destinacionit te tokes bujqesore.

Ne tokat bujqesore ku ka ndertime ekzistuese, nuk parashikohet zgjerimi i tyre per qellime banimi, pervecse per mbeshtetjen e aktivitetit turistik per zhvillimin e agroturizmit.

Figura 32 – Degjesa me publikun nr.2

Vlora, Mbretëresha e Rivierës Shqiptare

Bashkia Vlorë

BASHKIA | VLORA INFO | TURIZEM | KULTURE / SPORT | KESHILLI I BASHKISE | TRANSPARENCA

Njoftime › Prezantim para publikut te Raportit per Vleresimit Strategjik Mjedisit te Planit te Pergjithshem Vendor Bashkia Vlore

Prezantim para publikut te Raportit per Vleresimit Strategjik Mjedisit te Planit te Pergjithshem Vendor Bashkia Vlore.

FEBRUARY 27 2017

Prezantim para publikut te Raportit per Vleresimit Strategjik Mjedisit te Planit te Pergjithshem Vendor Bashkia Vlore.

Takimi ne daten 09 mars, ora rreth 12 e drekes.

Pjesemarres kryesisht OJQ te MJEDISIT.

Ju faleminderit!

LAJMET E FUNDIT

Bashkia e Vlores perjashton nga taksa e ndricimit, pastrimit

MARCH 17 2017

Sot, Kryetari i Bashkise inspektoi godinen e re te shkolles per femijet

MARCH 16 2017

Bashkia e Vlores dhe biznesi i qytetit bregdetar pritet qe te marre pjese ne panairin nderkombetar

MARCH 15 2017

Figura 33 – Njoftimi per degjesen publike te VSM-se dt: 09.03.2017

10. BIBLIOGRAFIA

Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. PINS Bregdeti 2015

Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015

Banka Botërore (2008), *Plan i Zhvillimit të Bregdetit Jugor*.

Banka Botërore (2007), *Shqipëri, Rishikimi i Sektorit Urban,* Raport Nr.37277-AL. Departamenti i Zhvillimit te Qëndrueshëm ne Rajonet e Evropës dhe Azisë Qendrore, 19 Janar 2007.

Banka Botërore (2006), *Status i reformës se Tokës dhe tregjet e pasurive te paluajtshme*, Banka Botërore, Zyra,Tirane.

Banka Botërore (2004), *Shqipëri: Decentralizimi ne Tranzicion* (Volumi II) Raport Analitik.

Bashkimi Evropian i Këshillit të Ministrave (2007), Karta e Leipzig në qyteteve të qëndrueshme evropiane.

Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 qershor 2001 mbi vlerësimin e efekteve të planeve të caktuara dhe programeve për mjedisin.

Këshilli i Ministrave, Vendim 88 i 1993, "Për Miratimin e Zonave qe kane përparësi zhvillimin e turizmit".

Hamilton, I.F.E., Dimitrovska, A.K. & Pichler-Milanovic N., (eds.) (2005). *Transformimi i qyteteve ne Evropën Qendrore dhe Lindore, drejt globalizmit*, Tokio: Kombet e Bashkuara Botime Universitare.

Këshilli i Ministrave, Vendim 722 i 1998, "Për Miratimin e Rregullores se Urbanistikes".

Këshilli i Qytetit i Glasgou (2008), Raporti i VSM e Mjedisit i Glasgou Planit të Qytetit 2.

King, Russell and Vullnetari, Julie. *Migracioni dhe Zhvillimi ne Shqipëri*. Sussex Qendra për Kërkim dhe Migracionin. Dhjetor 2003.

Kolegjit Imperial të Londrës (2005), Lidhja ndërmjet direktivave të VNM dhe VSM. Raporti përfundimtar për Komisionin Evropian.

Komisioni Evropian, DG Mjedis (2003), Implementimi i Direktivës 2001/42 mbi vlerësimin e efekteve të planeve të caktuara dhe programeve për mjedisin.

Komisioni Evropian, DG Regio (2009), Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm urban në Evropë. Arritjet dhe mundësitë.

Morris, Peter dhe Therivel, Riki (botuar) (2009), "Metodat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Vellimi III.

Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit "Draftstrategjia Kombëtare për Turizmin 2014-2020"

Ministrisë së Zhvillimit Urban (MZHU) & Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT). Metabolizmi i Shqipërisë (2016).

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave. "Programi kombëtar i monitorimit per vitin 2012"

Nientied, Peter.Pyetje *Planifikimi Rajonal i Qytetit ne Shqiperi*. Instituti i Studimeve te Zhvillimit Urban dhe Strehimit. Rotterdam 1998

Nurja, Ines and Dhrimaj, Hairije. Treguesit sipas Qarqeve 2005-2006. Instat, Tirane 2007.

Nurja, Ines, Shqipëria ne Shifra 2007. Instat, Tirane, 2007.

Organizimi i Planit Rregullues të Athinës (2011), Raporti i VSM e Mjedisit i Planit të Ri Rregullues të Athinës 2021.

Qeveria e Irlandës (2004), Për Zbatimin e VSM Direktiva (2001/42/EC): Vlerësimi i efekteve të planeve të caktuara dhe programeve në mjedis; Udhëzime për Autoriteteve Rajonale dhe Autoriteteve Planifikimit.

Qeveria e Shqipërisë. Ligj Nr.9244, date 17.6.2004 "Per mbrojtjen e tokes bujqesore"

Qeveria e Shqipërisë. Ligji nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar"

Qeveria e Shqipërisë. Ligji nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave".

Qeveria e Shqipërisë. Ligj Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"

Qeveria e Shqipërisë. VKM Nr. 321, datë 28.5.2014, "Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore"

Qeveria e Shqipërisë. Ligji 8906 i 2002, "Për Zonat e Mbrojtura" ndryshuar me ligjin 9868.

Qeveria e Shqipërisë ligj për "Mbrojtjen e Mjedisit" nr. 10 431, datë 9.6.2011

Qeveria e Shqipërisë. Ligji 9048 i 2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" ndryshuar Nr. 9882, datë 28.02.2008 .

Qeveria e Shqipërisë. Ligji 9424 i 2005 "Për Ratifikimin e Protokollit te Vlerësimit Strategjik Mjedisor".

Qeveria e Shqipërisë. Ligj nr. 68/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, "për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar

Qeveria e Shqipërisë. Ligji nr.107/2014 për "Planifikimin dhe zhvillimin e territorit"

Qeveria e Shqipërisë. Ministria e Mjedisit, Draft-Strategjia Kombëtare Mjedisore (2015-2020).

Qeveria e Shqipërisë. Ligj nr. 92/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar"

Qeveria e Shqipërisë. Udhëzim 3 i 2006 "Për Planet e Rehabilitimit të Sipërfaqeve të Dëmtuara nga Guroret".

Qeveria e Shqipërisë. Ligj nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"

Qeveria e Shqipërisë. VKM Nr. 587 datë 07.07. 2010 " Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike"

Rrjeti i Programeve te Zhvillimit te Gjelbërimit Rajonal (2006), Manual për VSM për politikën e kohezionit 2007-2013.

Stanilov, K. (ed.) (2007) *Qyteti Post-Socialist. Forma dhe Hapësira Urbane, Transformimet ne Evropën Qendrore dhe Lindore pas Socializmit*, Dordrecht: Springer

UN-Habitat (2009). Njëzet vjet Tranzicion: Evolucioni i Planifikimit Urban ne Evropën Lindore dhe Qendrore dhe ne ish-Bashkimin; 1989-2009, Vendbanimet Njerëzore Global Dialogu Series, Nr.5, Nairobi: UN Habitat Publications.

Zbatimi i Direktivës 2001/42 mbi Vlerësimin e Efekteve të Planeve të Caktuara dhe Programeve për Mjedisin, Komisioni Evropian, DG i Mjedisit.

Projekti "Ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e kuadrit kombëtar të biosigurisë", mbështetur nga (UNEP-GEF) Maj 2011- Qershor 2015

Projekti "Rishikimi dhe Përditësimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për biodiversitetin (2011-2020)

Projekti IPA 2013 për fillimin e procesit Natura 2000.

Konventa "Për ruajtjen e jetës së egër dhe të habitateve natyrore Evropiane" (konventa e Bernës) e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8294, datë 2.3.1998 "Për ratifikimin e Konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (konventa e Bernës)"

"Konventa e Ligatinave të Rëndësisë Ndërkombëtare Veçanërisht si Habitat i Shpendëve të Ujit" (Konventa e Ramsarit)

Strategjia 2020 e Evropës Jug-Lindore – Punësimi dhe prosperiteti në një këndvështrim Evropian (BE/ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal)

Bashkimi i operatorëve ekonomik " Dea Studio " sh.p.k &

" Thymio Papayannis and Associates SA ".

Ervin TAÇI

deastudio
Bul. "Deshmorët e Kombit, Kullat Binjaka Kull 1 Kat 3
info@dea-studio.com, www.dea-studio.com

Autorët: Emil Xhuvani

Mirlinda Rusi